

# MEHMET MYFTIU

E PARA VEPER DISIDENTE SHQIPTARE

## SHKRIMTARI

BIBLIOTEKA

854-31  
N. 99

roman


SHH-31  
17/99

Mehmet H. Myftiu

# SHKRIMTARI

*Pjesa e parë dhe e dytë*

roman



SHTËPIA BOTUESE "MARIN BARLETI"  
TIRANË 1995

Falenderojmë Fondacionin "Soros"  
që mundësoi botimin e këtij libri

Tirazhi 2 000 kopje

Kopertina M. Ahmeti

© të drejta të rezervuara

Shtypur në shtypshkronjën e shtëpisë botuese "MARIN BARLETI"

## I.

Ai ishte zhytur në botën e tij ku përziheshin në mënyrë të pandarë jeta e vërtetë, shpresat reale, me ëndrrat rinore dhe fantazinë e shthurrur. Në ato çaste përfytyronte sikur ta kishte përpara pamjen e sallës ku do të zhvillohej ceremonia dhe shihte veten që ngrihej të merrte çmimin, që kalonte midis sallës që ushtonte nga duartrokijtjet e nxehta dhe dëgjonte pëshpëritjet plot habi për suksesin e tij të ardhshëm. Mendoi se vërtetë do të bëhej i lavdishëm, se më në fund e kishte gjetur rrugën e tij. Iu kujtua se si qysh në vogëli e ëndërronte veten hero përrallash, se si pas çlirimit shpresonte të bëhej shkenctar i famshëm, general i madh dhe më rrallë, po mos të kishte sukses në fusha të tjera të veprimtarisë njerëzore, i pëlqente të bëhej shkrimtar i përbotshëm.

Mendoi se fitorja në konkurs ishte vetëm preludi, se njëëziti që e kishin çmuar aq shumë tregimin, ndaj të cilit vetë ishte i pakënaqur, do të çuditeshin kur të lexonin romanin që do të fillonte të shkruante së shpejti. Besonte se titulli i romanit "Dielli që sapo lind" ishte një alegori për personalitetin e tij. Ai do të ishte dielli që lind në letërsinë e tokës shqiptare. Të gjitha këto mbështilleshin si në pekt ëndre se pas konferencës ai do të takonte Jorgjetën, të dashurën me leshra të thurura gërshet dhe iu duk se në këto çaste kishte ndaj saj një ndjenjë të pakufishme.

Posa u duk ndërtesa dy katshe e klubit të shkrimtarëve, ëndrrat iu trembën dhe zemra filloi t'i trokasë me ndrojtje. Ngadalësoi hapat, u mundua të marrë një pamje sa më të thjeshtë dhe u fut në klub, ku mbrefëronte një atmosferë ceremoniale e gëzuar. Njëëziti me fytyra të çelura bisedonin me njeri tjetrin. Në ball të binte

menjëherë në sy parulla kadife me gërma të mëdha: "Shkrimtarët janë inxhinierët e shpirtit. Stalin". Në krye të sallës ndodheshin shkrimtarët më në zë, që bisedonin disi më seriozë nga të tjerët. Mënjatë bufesë ca balerina qeshnin lirshëm, sikur atyre mund t'u lejohej gjithshka. Afër tyre ishte një grup gazetarësh. Djaloshi andej po matej të shkonte, po i doli para Skënderi, një poet i ri, i cili e përshëndeti përzemërsisht.

Besniku u çlirua se gjeti me kë të rrinte. Skënderi kishte një pamje krenare që tregonte se ende rronte me bujën që kishin patur vjershat e tij të para, pamvarësisht se entuziazmi për to ishte ftohur. Gjer dje kulloste dhent, kurse tani vetëm në sajë të talentit zinte vend mes shkrimtarëve me universitete. Duke ia shtrënguar fort dorën Besnikut, i tha:

- I lexova me kënaqësi tregimet e botuara në revistë. Aty ka diçka të veçantë, ka forcë të madhe, sikur pas tyre fshihet një Eskil. Ty sigurisht nuk të rritet mendja. Ndofta nuk do të bëhesh as sa Poradeci ynë.

Besniku e humbi prapë nga këto lëvdata dhe falenderoi thjeshtë. Pastaj pa dashur i hodhi sytë nga ata të kryesisë së Lidhjes dhe dalloj Ismailin, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve. Ai i buzëqeshi dhe i bëri me shenjë me kokë që të afrohej. Djaloshi i kërkoi leje shokut dhe u drejtua andej. Tani që ëndrrat i ishin tulatur në ndonjë çip të humbur të trurit, iu dukën shkrimtarët si një grup perëndish, të cilët as shpresonte se do t'i arrinte. U afrua i emoncionuar, u dha dorën me nderim, sikur po ndodhte një ngjarje e jashtëzakonshme. Shkrimtarët e tokën ftohtë, veç Ismailit, i cili e përshëndeti me shumë përzemërsi dhe si e qasi mënjatë, i tha:

- Shumë mirë që paske ardhur. Desha të të lajmëroja vetë, po thuaj, më doli një minut kohë? Edhe bukën në këmbë e kam ngrënë këtë javë. E për çfarë do të thuash ti? ! Për hiç gjë, për këto telashet tona. Një mbledhje këtu, një komision atje, një diskutim vepre dhe ngryset.

Besnikut iu ngroh zemra nga vështrimi i tij i përzemërt e fjalët e thjeshta. Nuk dinte se si ta falenderonte dhe buzëqeshi i hutuar. Në këtë kohë pranë tyre u afrua Mihali, një burrë i ngjallur, afro tridhjetë vjeç, me fytyrë të freskët, i veshur me kostum të ri bojë çokollate, me krevatë të lidhur bukur. Posa ishte kthyer nga Bashkimi Sovjetik, ku kishte studjuar në Institutin "Gorki". Disa e mbanin si prozatorin më të mirë të letërsisë së re dhe të gjithë e vështronin me shpresë. Si u përshëndet me Ismailin, ai u kthye nga djaloshi:

- Eshtë rrezik që ky djalosh i ri të na e hedhë neve. - Dhe pastaj vijoi me një farë entuziazmi - Ke bërë shumë mirë që ke vajtur në qytetin "Stalin". Aty mund të kapësh fenomenet më tipike të botës së re, t'i theksosh ato dhe kështu të

krijosh diçka të përgjithësuar. Kjo është ajo që kërkojmë ne dhe kështu mund të bëhet arti i lartë. Të lumtë Besnik, të lumtë! Edhe ne do të dëshëronim të shkonim në një qendër të tillë, po kush të lë? Mua më mbërthyen pa zbritur nga aeroplani dhe më caktuan në revistën e Lidhjes se kemi nevojë. Do s'do do të bindesh, se jam dhe komunist.

Ceremonia e ndarjes së çmimeve filloi. Andrea, një burrë afro tridhjetë vjeç, pak i shëndoshë, mori çmimin për poezi. Ai u ngrit nga karrikja i tensionuar dhe përpiqej të kishte një paraqitje sa më të thjeshtë. Me hap të matur u afrua në tryezë, mori zarfin dhe me mirësjellje e nderim u shtrëngoi dorën fort anëtarëve të presidiumit. Pastaj u kthye në vend duke u përpjekur të fshehë mburrjen për duartrokitjet. Besniku priste i tronditur, kur befas në veshët e tij buçiti zëri i Ismailit:

- Besnik Daltit i jipet çmimi i parë në prozë për tregimin "Ruga e nderit"

Besniku u ngrit me rrëmbim, sikur të ishte ulur në zjarr dhe kaloi i hutuar mes njerëzve të ulur nëpër karrike. Nuk shihte dhe nuk dëgjonte ç'bëhej për rreth, shquante vetëm kryetarin e Lidhjes me një zarf në dorë. Kur u gjend para tribunës të gjithë shpërthyen në duartrokitje të zjarrta, ashtu si e kishte parashikuar ai vetë. Të pranishmit ishin entuziazmuar nga që fituesi ishte fare i ri. Shumë u ngritën në këmbë që ta shihnin më mirë, po Besniku, në kundërshtim me parandjenjat, nuk po e shijonte këtë sukses. Ishte i turbulluar. Nuk shihte as vehten, as sallën dhe zhurma e shuplakëve i dukej se nuk kishte fare lidhje me të. I shtrëngoi dorën mekanikisht Ismailit, mori zarfin, u kthye në vend dhe u ul sikur të kishte bërë një turp. Ishte i ndezur flakënë fytyrë. Ca pikëla djerse i ndrisnin në ballë. Duart i dridheshin. Gjithë trupin sikur ia përshkonte një korrent elektrik. Midis duartrokitjeve pranë tij përshpërisnin:

- Sa i ri!
- Do të bëhet shkrimtar i madh!
- I lumtë!
- Ua hodhi të tërëve!
- Çudi e madhe!

Po autori i ri nuk dëgjonte gjë. Si të qe zgjuar nga gjumi, u kthye i trembur nga Skënderi dhe e pyeti sa ishte ora.

Koha e takimit po afrohej. Duhej të largohej. E dashura po e priste. Menjëherë iu duk se mbledhja po zgjatej kot. Rrinte si në gjemba. Kthente kokën pas dhe matej të ikte. Shoku e mbajti gati me pahir duke e qortuar se do të bënte përshtypje shumë të keqe.

Në fund Ismaili thirri disa herë me rradhë emrin e një autori të një kritike

që kishte fituar çminin e parë, por askush nuk u përgjegj. U tha se askush nuk kishte dëgjuar një emër të tillë. Dikush shprehu dyshimin se atë kritikë mund ta kishte dërguar bibliotekari i shtëpisë së kulturës.

Me kaq ceremonia mori fund dhe Besniku u ngrit të dilte. Tek kapërcente prakun, atë e përshëndeti ftohtë Telhai. Ai ishte i zymtë. Dukej se ishte dëshpëruar, pse nuk i kishin dhënë asnjë çmim poezive të tij, të cilat ai i quante brilante. Fytyra e tij e zeshkët, e thatë kishte një seriozitet të tepërt, të panatyrshëm në atë atmosferë të gëzuar. Ndërkaq u dëgjuan tingujt e koncertit që ishte përgatitur për t'u dhënë pas ndarjes së çmimeve.

Ishte vonuar dy tre minuta, prandaj vraponte. Tani as i bënte ndonjë përshtypje çmimi, paratë, duartrokitjet që i kishte dëshëruar aq shumë. I dukeshin një hiç para të dashurës që ndofta po e priste në vendin e takimit. Gjëndja e tij emocionale ishte gjithënjë e tensionuar, por tani jo nga ëndrra për suksese në letërsi, por nga mendimi se së shpejtí do të takonte Jorgjetën. Do ta gëzonte buzëqeshja e saj e sinqertë. E përfytyronte të dashurën në ato çaste të paka kur asaj i binte një nur i rrallë bukurie. Zemrën e kishte plot me një vrrull ndjenjash të rrëmbyera.

Arriti te vendi i takimit. Qëndroi e mori frymë thellë. Ishte i lodhur dhe ndjeu dhëmbje në krahun e pneumotoraksit. Hodhi sytë rreth e rotull se mos e shihte, po asnjë vajzë nuk dukej gjëkund. Ora e takimit po kalonte. Një valë dyshimesh e hamendjesh iu zgjuan. Mendoj një herë se ndofta shoqja nuk e kishte lajmëruar. Por pastaj kjo iu duke e pamundur. Po sillej në errësirë dhe pak nga pak shqetësimi iu rrit, vehtja dhe rrugët iu dukën të mjera. Dyshoi se ajo, derisa vonohej kështu, nuk do të vinte fare për ndonjë shkak fare të vogël.

Kishin një muaj pa u parë. Kjo do të thoshte për të se ajo nuk e kuptonte zemrën e tij të zjarrtë. Dëshëronte ta bindëte vehten se Jorgjeta nuk e dashuronte që të largohej prej saj një herë e përgjithmonë. Po si gjithëmonë në të tilla momente iu kujtua fillimi i dashurisë. Gati dy vjet më parë ai i kishte shfaqur ndjenjat ashtu befas, pa ditur as vetë si e qysh. Ajo e kishte refuzuar pa i dhënë asnjë shpresë, megjithëse shoqërinë nuk e kishin ndërprerë.

Papritur Besniku ishte shtruar në senatorium. Atëherë Jorgjeta që ishte sjellur aq e ftohtë dhe indiferente, i ishte afuar dhe e kishte vizituar. Një ditë prej ditësh, pasi ai i kishte kërkuar mos ta vizitonte më, se ardhja e saj i shkaktonte dhëmbje, ajo i kishte thënë. "Ti ke dashuruar shumë vajza dhe i ke harruar. Unë jam tip tjetër. Unë nuk kam dashuruar tjetër në botë veç teje." Atëherë ai e kishte puthur atë dhe çdo mbrëmje ndjehej i lumtur, kur ajo vinte ta takonte të sëmurin nga tuberkolozia.

Sa herë dyshonte te e dashura, i kujtoheshin mbasditet kur ajo i vinte në senatorium e lehtë, e bukur plot nur. Ashtu edhe tani iu duk e padrejtë t'i shkëpuste lidhjet, por vendosi të shkonte në qytetin "Stalin" pa e takuar, meqë dukej se ajo nuk kishte ndonjë mall të madh për të. Pastaj çdo gjë do ta tregonte koha.

Me këto mendime në kokë u kthye i trishtuar në klubin e Lidhjes së Shkrimtarëve. Aty mbretëronte një qetësi e thellë. Të gjithë me fytyra të kthyer nga skena po dëgjonin me vemendje të madhe. Një vajzë e re, pak e zbetë, me hundë të drejtë si të statujave greke, po recitonte poemën "Demoni" të Lermontovit.

Ai qëndroi para skenës. I kishte lexuar shumë herë vargjet e poetit rus dhe ato e kishin tronditur. Po tani po i pëlqenin si rrallë herë. Shpirtin e shqetësuar ia fashitnin vargjet e zjarrta. Vajza e bukur vijonte recitimin, kurse atë po e mbyste një valë hidhërimi duke menduar se nuk i afrohej as letërsisë, as dashurisë të vërtetë, nga që shpirti i tij nuk shprehej plotësisht. Ai ndjente sikur kishte një forcë kolosale, si ajo e poetëve të mëdhej, por ç'e do, nuk po shpërthente dhe ai ndjeu një pakënaqësi të madhe ndaj vehtes.

Recitimi mbaroi dhe të gjithë duartrokiten në xhëhtësisht, ndërsa Besniku vështronte recitonjësën i menduar dhe i trishtuar. Po dilte nga salla i turbull, kur befasi tek dera pa Jorgjetën me flokët e arta të thurura gërshet. Ajo po kërkonte dikë me sytë e ëmbël. Iu duk po aq e bukur sa e përfytyronte dhe zemra i gufoi. Iu afrua, i shtrëngoi dorën dhe i buzëqeshi i lumtur.

Ajo nuk kishte ardhur në takim pse ishte vonuar në mbledhjen e rinisë. Kishte patur frikë t'u kërkonte leje, sikur ata ta dinin se ku do të shkonte. Pas mbledhjes mezi ishte vjedhur nga konvikti dhe kishte ardhur ta takonte. Ata dolën jashtë dhe po ecnin të heshtur. Jorgjeta e mirrte me mend se atij do t'i pëlqente t'i kërkonte të falur, t'i shpjegonte gjatë pse nuk kishte ardhur, por s'e bënte dot këtë. Mendonte se ai duhej të kuptonte vetë gjithshka derisa e kishte kërkuar mes njerëzve duke u ekspozuar. U mat ta përgëzonte për çmimin, por se si i dukej. Diçka artificiale. Më në fund mezi e çeli gojën dhe i tha:

- Të uroj .

Besniku pati kujdes mos të tregohej mendjemadh e mos të fliste për vehte, pse një herë ajo ia kishte prerë fjalën dhe e kishte qortuar: "Njeriu duhet të heshtë për meritat e veta." Ai ishte skuqur dhe megjithëse kishte dashur të justifikohej, kishte heshtur. Dhe tani, duke dashur të tregohej shumë i thjeshtë, u përgjegj:

- S'ka ndonjë rëndësi. . .

Jorgjeta kundërshtoi:

- Jo, ka rëndësi. Kjo tregon se ti mund të bëhesh shkrimtar i mirë. - Dhe



pastaj shtoi - Nuk do të vonohemi se mbyllen duert e konviktit.

Jorgjeta e parashikoi se Besniku do të prekej, por prapë nuk e mori me mend se çfarë hidhërimi të madh do t'i shkaktonin këto fjalë të thjeshta. Menjëherë ai u vrejt duke menduar se e dashura në vend që t'i shpjegonte arësyet e vonesës e t'i kërkonte falje, donte të ikte sa më parë. Kujtoi me sa mall e ëndërronte në qytetin "Stalin", se si e kishte pritur me padurim këtë orë dhe sa të lumtur e bënte vetëm përfytyrimi i saj. Ai mendoi prapë se nuk i duhej lidhja me një vajzë që nuk e përfillte (Tani ai e harroi fillimin e dashurisë), se do ta poshtëronte veten, po t'i lutej asaj, prandaj, dukë u munduar të përmbahej, i tha:

- Po deshe, shko!

Jorgjeta u pre. Heshti një hop dhe pastaj i foli me të butë:

- Ne rrimë ca. . . Bëjmë një shetitje të shkurtër. . .

Ecën përsëri të heshtur. Përgjigja e vajzës e zbuti djaloshin. Një copë herë bluajti me vehte mendime kontradiktore. Mendoi se të nesërmen do të ikte në qytetin "Stalin", se ndoshta kot zemrohej kështu me të, se me siguri atë e qortonin në konvikt. Diku në errësirë qëndroi, i buzëqeshi dhe iu sul ta puthte. Por Jorgjeta e shtyri dhe i bërtiti e fyer:

- Sa i çuditshëm je! Si ndryshon kështu! Po të kërcëllitnin dhëmbët, sikur doje të më haje, kurse tani më puth!

Ajo u qas mënjanë dhe e vërshtonte e tronditur. Ishte e ndjeshme. Prekej lehtë. Ndjenjat e saj nuk këmbeshin me aq rrëmbim dhe përshtypjet e ngjarjeve nuk i kalonin shpejt sa Besnikut, prandaj trembej. E ndjente veten të pasigurtë me të. E shihte që Besniku e donte, por atë e shqetësonte tipi i tij. Besniku nuk u prek nga qortimi se i dukej që ndryshimet e shpejta shpirtërore, dëshmonin vlerën e tipit të tij të veçantë dhe i tha:

- Kështu jam unë. . . Pse nuk më lë të puth? . . . Apo. . . - Atij i mbeti fjala në grykë.

. . . apo nuk të dashuroj. - Buzëqeshi lehtë, hidhur Jorgjeta.

Ai nuk kuptonte fare se ç'do të hiqte ajo në konvikt. Po t'i vinte në vesh dashuria e saj edhe familjes, atëherë do t'i mirrte djalli të gjitha. Prindët e kishin dërguar të mësojë, kurse ajo bënte dashuri. Profesorët e ngjnin: "Ç'ke, moj Jorgjeta? ! Pse ke rënë sivjet në mësim? . . . Mos je e sëmurë? ! . . . A je vizituar? "

Ishte bërë vonë. Në errësirë Besniku mezi i rëmbeu një të puthur. U nisën në konvikt dhe u ndanë rrugës me të mirë.

Rrugës u takua me Agimin, një djalë dy tre vjet më i madh nga ai, verdhacak, me sy të lamtë, të mprehtë. Ky ishte bibliotekeri i shtëpisë së kulturës, për të cilin

supozehej se ishte autori i asaj kritike që kishte fituar çmimin e parë dhe s'i dilte kush për zot.

- Të uroj! Më pëlqeu tregimi - I tha ai - E meritoje plotësisht çmimin.

Besniku u gëzua nga ky takim i papritur, e falenderoi për fjalët e mira dhe e pyeti:

- Mos ke dërguar ti një kritikë në konkurs?

Agimit i rrahu zemra fort dhe u përpoq mos të shfaqte tronditjen.

- Pse më pyësn!

Besniku shpjegoi në mënyrë krejt indiferente:

- Kish fituar çmimin e parë një person, të cilit nuk ia gjenin dot autorin.

Dikush më tha se e kishe bërë ti dhe e kishe dërguar me pseudonim.

Agimi i përpiu këto fjalë, por me që tjetri fliste ftohtë, dyshoi mos kishte ndonjë kleçkë dhe pyeti përsëri:

- Po ç'thonin për kritikën konkretisht?

- E lëvdonin. . . - U përegjeggj tjetri shkurt.

Agimi desh të pranonte që e kishte bërë vetë, por prapë pyeti për siguri më të madhe:

- Po ideologjikisht mos i kishin gjetur ndonjë gabim?

- Jo. . . Bile e çmonin shumë se problemet ishin ndriçuar thellë në bazë të kritikës marksiste.

Këto fjalë dëshmonin se Agimi kishte patur një fitore të madhe. Mbi të gjitha kjo do të thoshte që ai, derisa kishte fituar çmimin e parë, ishte një djalosh i zoti dhe kryesorja po hynte në rradhët e atyre që luftonin për socializmin në poste të rëndësishme. Këtë ai e ëndërronte prej vitesh. Prandaj u çlirua, sytë i ndritën me një dritë të ëmbël dhe pohoi thjeshtë:

- Unë jam vërtetë autori i asaj kritike. . . .

Besniku e shikoi me nderim dhe e pyeti:

- Po pse nuk e kini dërguar me emrin tuaj, por me pseudonim? !

Agimi heshti. Por, kur tjetri nguli këmbë dhe e qortoi për këtë veprim, pëshpëriti:

- Ashtu kot. . .

- Nuk të kuptoj fare - Protestoi Besniku.

Agimi u trishtua pak, u kthye nga bashkëbisedonjësi, e vështroi në sy dhe u

hap:

- Nga e kaluara ime. . .

Besnikut iu kujtua se gjatë luftës në gjimnaz, flisnin për ca ballistë në klasat

e larta. Në mes tyre i kishte rënë në vesh edhe emri i Agimit. Por pas çlirimit kishte dëgjuar fjalë të mira për të dhe tani që e takoi as i shkoi në mendje fare e kaluara e tij prej ballisti. Gjithashtu solli në mendje se dikur e kishte urreyer, se akoma i kishte mbetur ndofta pak nga ajo ndjenjë, por u përgjegj:

- Ajo është e kaluar. Pastaj atëherë ti ke qenë edhe shumë i ri. Rëndësi ka qëndrimi që mban sot. Unë nuk shoh asnjë arsye që ti ta dërgoje kritikën me pseudonim.

- Ky është mendimi yt personal? - Pyeti Agimi me ankth.

- Sigurisht. Po unë mendoj se të gjithë kështu e mendojnë këtë çështje. Ti e zmadhon pak frikën tënde.

Agimit iu bë qefi shumë nga këto fjalë dhe filloi të bisedojë lirshëm. E Pyeti Besnikun si e kalonte në qytetin "Stalin", u interesua hollësisht për punëtorët, drejtuesit, specialistët sovjetikë dhe shfaqti me bujë entuziazmin e tij për çdo gjë që dëgjonte. Biseda e tyre vazhdoi gjatë. Strumbullari i tyre u bënë shkrimet që do të shkruanin në të ardhmen.

Besniku po kthehej në shtëpi plot ndjenja të kundërta gëzimi e hidhërimi. E kishte quajtur diçka të jashtëzakonshme të fitonte çmimin e parë mes gjithë shkrimtarëve të Shqipërisë. Tani, megjithëse kishte në xhep një zarf me një vertetim dhe një çek, që dëshmonin se ia kishte arritur qëllimit, nuk i dukej se kishte ndodhur ndonjë gjë e çudiçme si pat pandehur. Pakënaqësia e ambicjes që e mundonte gjithënjë, nuk i ishte zhdukur. Ai e kuptonte se ishte shumë larg asaj që duhej të arrinte. Nga ana tjetër, megjithëse kishte ndenjur me Jorgjetën, të cilën e përfatyronte me aq zjarr në qytetin "Stalin" dhe më në fund e kishte puthur, nuk ishte i lumtur dhe ndjente një boshllëk në shpirt. E turbullonin edhe vargjet e Lermontovit, që i flisnin për një dashuri dhe letërsi të lartë, të tillë si ishte e etur zemra e tij.

Hyri në shtëpi i zymtë, krejt ndryshe nga ç'kishte dalë disa orë më parë. Nëna dëgjoi portën dhe doli në sallon. Kishte mall për të birin që, si thoshte ajo, ishte degdisur në qytetin "Stalin". Sytë e saj të bardhë, të lodhur nga jeta, u çelën. Fyftyres plot rrudha i ra një dritë gëzimi dhe e pyeti me zë të butë pse ishte vonuar. I tregoi se e kishte pritur shumë e motra me të shoqin dhe se i vëllai e kërkonte lart.

Besniku, pa i dhënë përgjigje nënës, ngjiti shkallët prej dërrase, trokiti në derën e kuzhinës të vëllait dhe hyri brënda. Kadriu u ngrit nga karrikja. Fytyra e dobët i ndriçoi gjithë gëzim. U përshëndetën me shumë përzemërsi dhe u ulën pranë njeri tjetrit. Të dy e ndjenë se duheshin, se kishin të gjallë në zemër dashurinë

vëllazërore, që ishte forcuar shumë gjatë kohës së luftës, kur rrezikonin kokat së bashku. Ishin zhdukur fare nga kujtesa ca grindje të vogla familiare, që kishin shkaktuar edhe ndarjen e tyre ekonomike. Kadriu ishte i gëzuar që vëllai kishte fituar çmimin e parë në konkurs dhe i ish-in shtuar shpresat që ai do të bënte diçka të veçantë në jetë. Ky besim që i kishte lindur gjatë luftës, kur vëllai kishte treguar guxim të madh e zgjuarsi, i ishte paksuar vitet e fundit, madje i ishte kthyer në përçmim për shkak të disa veprimeve të Besnikut. Tani Kadriu s'i kujtoi fare ato gjëra dhe filloi ta pyeste rreth ceremonisë. Besniku rrëfeu thjeshtë dhe zgjati zarfin, ku ishte dëshmia e çmimit dhe çeku. Vëllai i mori, i pa me vemendje dhe e përgëzoi:

- Tani i ke të gjitha mundësitë të bësh një vepër shumë të mirë. Qyteti "Stalin" është qendra më e madhe e klasës punëtore dhe gjer tani nuk kemi asnjë vepër të rëndësishme për punëtorët. Partia e shtron me forcë që të shkruhet për njeriun e ri dhe o e gjen këtë në atë qytet o nuk e gjen në asnjë vend tjetër. Ti duhet të krijosh një tip nga klasa punëtore që ta marrin shembull të gjithë.

Ai ndali në menduar që të derdhte më qartë mendimin e tij dhe vijoi me një farë entuziazmi:

- A je i zoti të krijosh një personazh si Pavël Vllasovi? Ashtu si e kishin shembull Pavlin në luftë, ashtu si na frymëzonte dhe na ndizte ai, ashtu ta kemi edhe atë në ndërtimin e socializmit. Mblidh karakteristikat më pozitive të njerëzve dhe na skalit një personazh, ku të mishërohet vrrulli i madh i masave në ndërtimin e jetës së re, në transformimet kolosale që po bëhen. Atëherë edhe Partia do të falenderojë.

- Do ta krijoj! - Premtoi Besniku me entuziazëm rinor pa kuptuar mirë se ç'vepër të rëndësishme angazhohej të bënte. Dhe emri i tij do të jetë Pal. Për këtë qëllim kam vajtur në qytetin "Stalin".

- Emri s'ka rëndësi, vëria si të duash. - Ia preu vëllai, sikur do të bëhej vërtetë një vepër si e kërkonte ai.

Kështu bisedonin dy vëllezërit. Motra e vogël dëgjonte pa hapur gojë. Sytë i shkëlqenin nga lumturia që vëllai i vogël kishte patur një sukses kaq të madh, por nuk guxonte ta shprehte me fjalë kënaqësinë. Vetëm nëna rrinte mënjanë pa qejf dhe dukej që nuk gëzohej fare. Ajo e donte të birin ndryshe nga të tjerët. E donte si njeri, mund të themi trupin e tij. Lavdia për të nuk kishte rëndësi. Fjalët e mira në shoqëri i vlerësonte nga përfitimet që mund të kishte djali për të siguruar shëndet të plotë. E linin të ftohtë përpyekjet e lodhshme për të arritur diçka që nuk e kuptonte. I dukej që i biri ishte futur në një rrugë pa krye, nga e cila nuk mund të kishte asnjë dobi. Ajo priti rastin dhe shprehu e ndrojtur mosbesimin e saj:

- Mua s'më pëlqen kjo punë. Natë ditë rri mbi libra, t'u qërruan sytë. U mbylle si murg. Po ja nxjerr shpirtin vetes. Pse të mundohesh e të bëhesh telef kështu? ! Me karar, si gjithë dynjaja. Puno, fito dhe rro rehat në shtëpi. Po ti e syrgjynose veten i sëmurë. Plagë e kam zemrën. Në shtëpi jam, por mendjen e kam atje tek ti. U dashka domosdo të ikësh larg që të shkruash? !

Besniku e qortoi si me zemrim:

- Ti gjithënjë do të dalësh kundër meje. Çdo gjë që bëj unë, do të ma tërheqësh ters.

Nënës iu ngulën si gozhdë këto fjalë. Kështu i fliste dikur i shoqi, kur ajo e kundërshtonte për ndonjë punë.

- Pse? ! Ke të mirë ti që je atje larg nënës? ! - U mbrojt ajo - Ç'e do jetën gjithënjë mbi libra? ! Edhe kuranin ta lexosh shumë, të llokaçitet mendja. Po ti bëj si të duash. Mua kurrë s'më ke pyetur as i vogël, as tani. ^ - Dhe heshti e lënduar.

Ata u ngritën.

Besniku zbriti poshtë dhe hyri në dhomën e tij. Një krevat, një minder i gjatë, tavolina, karrikja dhe një raft i vogël librash përbënin gjithë orënditë e kësaj dhome. Përballë në mes të murit ishte varur fotografia e Gorkit dhe poshtë saj ishte shkruar: "Fjala njeri tingëllon krenare." Ai mbylli derën dhe qëndroi më këmbë i menduar. Lexoi edhe një herë vertetimin e çmimit, çekun dhe ndjeu prapë në zemër gëzim e hidhërim të përzier. Ishte larg asaj që dëshëronte.

## II.

Mbasi mbaroi disa punë në redaksinë e gazetës, Besniku i hipi trenit me qejf duke menduar rreth ngjarjeve që do të shtjellonte në roman. Në fillim i kishte ardhur në mendje ideja që duhej të shprehte. Në shpirtin e tij kishte mbetur i gjallë dhe shumë i shtretjtë vrrulli i madh me të cilin banorët e Tiranës bënin punë vullnetare muajt e para të çlirimit të Atdheut që dëshmonte entuzazmin me të cilin kishte filluar ndërtimin i botës së re. Pikërisht këtë ide donte të fiksonte ne vepër. Nuk ishte i ndërgegjshëm se po e përqëndronte vemendje në atë vrrull të madh ndërtues të forcave njerëzore, që kishte shpërthyer fill pas çlirimit si nostalgji sepse tani nuk e shihte më. Që të dilte sa më i qartë ky entuziazëm, do të përshkruante punën për rindërtimin e kantierit të naftës. Prandaj kishte kërkuar që të punonte atje së paku gjashtë muaj si korespondent gazete.

Kur kishte zbritur në qytetin "Stalin" nga kamioni me një valixhe në dorë, ai pothuajse i kishte patur të qarta ngjarjet që do të përshkruante dhe personazhet kresorë, që do të ishin: sekretari i Partisë, drejtori i kantierit dhe punëtori shembullor. Që të nesërmen krahas punës kishte filluar të mbledhë edhe informata për rindërtimin e kantierit dhe ishte i çuditur nga ato që i thoshin. Plani i romanit që kishte bërë, pësoi ndryshime dhe i ishte afruar më tepër realitetit. Ai mësoi ngjarje të ndryshme dhe disa hollësi që dëshmonin se entuziazmi, vrrulli në punë, vështirësitë, pengesat gjatë rindërtimit kishin qenë shumë më të mëdha nga ç'i kishte përfytyruar dhe kjo gjë ia kishte forcuar besimin se do të krijonte një vepër të madhe.

Pasi jetoi në kantier mes punëtorëve dhe kuadrove gjashtë muaj, hodhi në fletore planin e hollësishëm të romanit dhe filloi ta shkruante me qëllim që të kishte të përfunduar dorën e parë, përpara se të nisej në Bashkimin Sovjetik për studime në Universitetin "Maksim Gorki" të Moskës.

Në mesnatë kamiomi iu ngjiti me zorr kodrës së Patosit. Makina qëndroi afër klubit. Besniku zbriti dhe hodhi sytë për rreth. Gumëzhitja e makinerive përhapej në qetësinë dhe errësirën e natës me një forcë shurdhonyjëse, shumë më të madhe se ditën. Aty pranë zhurmonte çentrali elektrik. Pak më tutje ofiçina mekanike ishte në aktivitet të plotë dhe atje tej nëpër pika të ndryshme e të shumta buçisnin sondat e shpimit dhe traktorët Diezel. Dritat elektrike ndriçonin me një shkëlqim të fortë shumicën e ndërtesave të qytetit të vogël dhe në pika të ndryshme rreth tij, atje ku vijonte shpimi i puseve dhe nxjerrja e naftës. Shkëlqimi i bardhë i dritave që i jipte një bukuri të veçantë këtij vendi, tregonte se aty punohej me vrrull për nxjerrjen e naftës. Djaloshi u entuziazmua dhe si gjithënjë në të tilla raste e ndjeu vehten të kënaqur që jetonte mes punëtorëve. Dyshimet, lufta me veten, Jorgjeta, shpresat dhe ëndrrat e egzaltuara që e mundonin aq shumë në Tiranë dhe e lëkundnin në çdo çast, pothuajse ishin zhdukur dhe kishin zënë fole diku thellë në ndonjë çip të shpirtit të tij. Eci nëpër rrugët plot baltë të kantierit, arriti në laboratorin gjeologjik dhe kërkoi gjeolog Polidhorin. I thanë se ai ishte në punë dhe i treguan pusin, ku mund ta gjente. Besniku u drejtua te sonda e çpimit për të gjetur shokun, të cilin e dalloj që larg. Edhe këtu vlonte puna me vrrull. Gazetari i ri kishte parë sonda shpimi, por tani në errësirën e natës i b'ri shumë përshtypje makineria gjikande. Dritat e forta ia verbuan sytë dhe motori bënte një zhurmë aq të madhe sa i shurdhoi veshët. Tubat e futura thellë në tokë vërtiteshin me shpejtësi dhe potere. Punëtorët vinin qark, ndërronin tubat, pastronin baltën që dilte.

Polidhori, një djalosh që para dy vjetëve kishte mbaruar degën e gjeologjisë

në politeknikumin e Tiranës, e vuri re Besnikun dhe e përshëndeti:

- Mirëseerdhe, shoku shkrimtar! - Iu afrua fare pranë dhe shtoi me shaka - M'u duk se nuk të erdhi mirë që të thirra shkrimtar, por tani s'i shpëton dot këtij titulli. More edhe çmimin e parë! Ç'kërkon më? ! Mos vallë pret të nxjerrësh kryevepra shekspiriane? Mos u mërzit. Atëherë do të të quajmë shkrimtar gjenial.

Duke e kuptuar pse kishte ardhur Besniku aty, ai e hodhi bisedën gjetkë.

- Sonte pa dashur jam bërë një objekt pozitiv për letërsinë shqiptare dhe për këtë jam i kënaqur pa masë. Detyrova një shkrimtar të shquar të shetisë në mes të natës kantierin që mos të shkruaj për punëtorët nga zyra. Dëshëron të prezantoj me udhëheqësin e brigadës së rinisë, për të cilin të kam folur? Nuk ta mbush syrin në të parë, një grusht njeri është, por shokët i ka të rrallë. Ka talent si organizator. Me këtë sondë që sheh, këtë dimër ka shpuar dhjetë pusa pa asnjë avari. Kjo është një mrekulli e vërtetë. A e di ç'do të thotë të zësh hekurin me duar në mesnatë, kur ngrin akull dhe era të pret? ! Njerëzit mërdujnë në dysheqet të mbuluar me dy jorganë, kurse këta kanë punuar sikur të ishte behar. Ç' mund të bëjë më tepër heroi?

Gazetarin e prekën këto fjalë dhe megjithëse ishte vonë dhe i vinte gjumë, u njoh me përgjegjësin e brigadës së rinisë dhe biseduan bashkë nja një gjysëm ore. Aty për aty vendosi të shtonte në roman edhe një punëtor të ri entuziast, të palodhur, me vullnet të çelniktë, të ngjashëm sipas tij me atë që po bisedonte. Ai mendonte se këto biseda të shkurtra do t'i mjaftonin për të krijuar tipin e të riut shembullor në ndërtimin e botës së re. U kthye në dhomë entuziast e plot ëndrra. U fut brënda në dhomë, ndezi dritën dhe vuri re shtratin e Polidhorit që ndodhej në çip të laboratorit. Shoku flinte këtu se s'kishte dhomë tjetër. Mbi tryezë gjëndeshin plot harta dhe skica. Raftet të mbështetura në mur ishin plot me materiale për analizë. Te jasteku ishte romani "Idioti" i kthyer për gjysmë.

E dinte se shoku zotëronte italishten dhe lexonte në këtë gjuhë. Solli në mendje se edhe babanë e tij e kishte parë duke lexuar libra në gjuhë të huaja dhe e pati zili shokun që kishte lindur në një familje të mësuar. U shtri në shtrat dhe ashtu dëgjoi një copë herë zhurmën e qytetit industrial që ishte e dashur dhe plot kuptim për të. Qepallat iu rënduan dhe pasi i tha si gjithëmonë "Natën e mirë" të dashurës nga larg, e zuri një gjumë i thellë.

Në mëngjez nuk e ndjeu shokun që u fut në laborator dhe u çudit kur e pa të krrusur mbi disa letra.

- Tërë natën ndenje jashtë? - E pyeti

- Po. . . Kisha turmin. Kështu është puna jonë. - U përgjegj shoku me

thjeshtësi.

Besniku po zbulonte cilësi të reja.

- Po shoh të dhënat e një pusi - Vijoi gjeologu i ri - Erdhën mbrëmë vonë dhe nuk pata kohë t'u hedh një sy. Ky pus ka rëndësi vendimtare për të ardhmen e naftës. Është kyçi i fitores sonë. Për herë të parë po bëjmë një çpim në thellësi të mëdha.

Polidhori iu afrua hartës që ishte varur në mur, tregoi me gish një pikë dhe foli:

- Shpresat tona këtu mbështeten. Zbulimet e kësaj zone do të tregojnë nëse ka rezerva të mëdha naftë si dëshmojnë të dhënat gjeofizike. Po të dalin parashikimet e studimeve, atëherë gjithë kjo zonë do të mbushet me puse. Vendi ynë do të mundet t'i nxjerrë të ardhurat kryesore nga nafta. Përfytyro ç' gjë e madhe do të jetë! Shqipëria do të bëhet një vend mjaft i pasur!

Polidhori fliste dhe një dritë fort e vogël që shkëlqente në sytë e tij gështenjë, tregonte se i digjej brëndë një entuziazëm i madh. Besniku e dëgjonte me habi shokunqë i hapej me një dritë të re, që nuk mirrej si dikur me organizimin e pionierëve, por me probleme shumë të rëndësishme të ekonomisë shqiptare. Për herë të parë atij iu duk se e zbuloi Polidhorin si një karakter të veçantë të denjë për tip letrar. E brente edhe zilia. Do të dëshëronte të ishte ai vetë gjeolog dhe të bënte zbulime të tilla.

Dolën bashkë që të hanin mëngjez në menci, por me që aty kishte rremujë, shkuan në klub. Rugës Besniku e pyeti papritur:

- Sikur një vajzë flinte po në një ndërtesë me ty. . . ? !

Polidhori ia ktheu me shaka:

- Si specialist që je në çeshtje dashurie, e diktove menjëherë edhe atë vajzë të re që jeton mes gjithë këtyre burrave. Ajo ka mbaruar këtë vit si teknike.

- Domethënë flini që të dy në atë ndërtesë në një sallon? ! - Pyeti përsëri

Besniku.

- Po. . . Pse? ! . . . Ç'ka këtu? ! - Ia priti tjetri me sinqeritet - Mos i ngatërro të tjerët me veten. Ne nuk kemi aftësitë e tua. Në shkollë kishim plot vajza dhe nuk ngjitëm dot në asnjërën, kurse ti i ndërrove nja tre a katër.

- Vërtetë ti nuk ke dashuruar asnjë femër gjer tani? ! - U habit Besniku.

- Jo. . . - U rrëfye tjetri me sinqeritet dhe vijoi - Kjo përgjigje ndofta më posht"ron në sytë tuaj, por është e v"rtetë. Të isha në Tiranë tani edhe unë mund ta kisha gjetur ndonjë të dashur, por këtu s'ka fare mundësi. Këtu vizita e ndonjë vajze të re është eviniment. Le që ndofta, edhe po të kishim ndonjë të dashur, nuk



dihej a do t'ia bënim yzmetin se po mbytemi në punëPo nejse, s'ke ç'i bën. Kështu paska qenë rrishtu ynë. Dashuroni ju nga tre katër për ne. Të paktën ne jemi krenarë se po i bëjmë fli dëfrimet dhe kohën më të bukur të jetës, rininë tonë për hir të socializmit. Tani i japim fund bisedave erotike dhe pijmë nga një salep të ngrohtë.

Pas dy ditësh, andej nga mbrëmja, Besniku u kthye në qytetin "Stalin", arriti në hotel,hyri në dhomën ku flinte dhe u përmallua. Që prej tri javësh nuk kishte fjetur fare aty dhe nuk kishte ndjerë atë gjendje të veçantë që i jipte ai vend. Dhoma e tij ishte e vogël, e thjeshtë, me dy krevate, një i veti dhe tjetri i një shokut të tij që shërbente si drejtor në uzinën mekanike. Te dritarja ndodhej tavolina, sipër saj ishin vendosur librat dhe një kornizë e vogël me fotografinë e Jorgjetës. Kishte pesë muaj që jetonte aty. Ndonëse dhoma ishte e ftohtë e me lagështi, nuk ankohej,Këtu po krijonte atë vepër që e kishte ëndërruar aq shumë. U afrua te tavolina, zgjati dorën dhe rrëmbeu kornizën. Jorgjeta buzëqeshte e sikur derdhte dashuri në çdo gjë që e rrethonte. Ai e puthi fotografinë dhe psherëtiu,Kishte mall. I kishte harruar grindjet, pakënaqsinë ndaj saj, dëshëronte ta kishte pranë. Do të ishte i gëzuar vetëm ta sodiste, t'i dëgjonte zërin. Hodhi sytë nga krevati tjetër. E kishte marrë malli edhe për shokun, por sigurisht ai punonte në uzinë dhe ndofta. si zakonisht, do të kthehej vonë. U zhvesh, u shtri në krevat, priti sa priti dhe ashtu e zuri gjumi se ishte i lodhur.

Kostandini ndenji në uzinë gjer në orën dy pas mes nate dhe u kthye në hotel me mendime të trishtuara. Kur hapi derën, e pa Besnikun që po bënte gjumë të qetë, pa trazime. Nga fytyra e lezeçme, e paqtë, dukej se djaloshin nuk e turbullonte ndonjë brengë dhe se ëndërronte gjëra të bukura. Konstandini që e kishte pritur çdo natë me një farë padurimi, u lehtësua, mendimet e trishtuara sikur u daravatën dhe buzëqeshti. Donte të bisedonte me të se e kishte marrë malli, por edhe pse kështu mund të harronte diçka nga hallet e veta, prandaj e shkundi dhe i thirri:

- Besnik! . . Besnik! . . Zgjohu!

Kur gazetari hapi sytë përgjumësh, e gënjeu me buzë në gaz:

- Ke letër nga Jorgjeta. . .

Besnikut i doli gjumi menjëherë, sytë iu kthjelluan, iu bënë xham dhe u ngrit në të ndenjtur. Një shqetësim i ëmbël i shprehej në fytyrë.

- Vërtet? ! . . .

- Pse do të gënjej ty? ! . . Ja ku e kam. . - Ai bëri sikur po nxirrte letërën nga xhepi dhe pastaj foli me të qeshur e dashamirësi - Hajde budalla, hajde. Ajo të ka harruar, ti edhe në gjumë e sheh në ëndërr.

- Më gënjeve? - U dëshpërua djaloshi.

- Sigurisht që të gënjeva. Desha të zgjoheshe që të bënim një çikë llafe dhe ty vetëm Jorgjeta të bën esëll. Shiko se si të vetëitjnë sytë. Po lot menç pas saj. Po hë, si e kalove andej nga Tirana? A e takove? A e puthe? Apo s'të la? ! - Ai qeshi - Ha. . ha. . Bëni dashuri platonike ju. Hajde tarallak, hajde. Të bën qole edhe ajo. Shih kur të të lërë ndonjë ditë.

Kostandini si bëri ca shaka të tilla, papritur u bë serioz dhe tha me ton të qetë:

- Ndofta shpejt ndahemi. Mua më pret gjyqi.


- Ç'gjyq? . . Pse talleh?! - U çudit tjetri që kurrë nuk mund të përfytyronte se mund të ndodhte kjo gjë.

- Kush tallet me gjëra të tilla? - Ia ktheu shoku me një farë trishtimi - Më akuzojnë se jam fajtor për prodhimin e qindra fuçijave me kualitet të dobët. Të kam thënë për atë racionalizimin në saldim që bëri ai punëtori. Po sipas asaj metode fuçijat shqiten, nuk i qëndrojnë dot presionit të bitumit dhe kështu kanë dalë skarco. Sot u nda shapi nga sheqeri. Erdhi një komision kontrolli. Provuan pesëdhjetë fuçi. Nja dhjetë nuk luajtën fare, megjithëse ata u përpoqën sa u lodhën që t'i çanin me dalta. Duket se ato i kishte punuar vetë ai punëtori. Por të tjerat u hapën. Saldimi me mënyrën e re duhej të bëhej me kujdes të madh, mirëpo punëtorët e tjerë punojnë shkel e shko dhe kështu janë dëmtuar qindra fuçija me një vleftë me mijra lekë. Komisioni i kontrollit bëri proçes verbalin dhe do t'ia shpjerë gjyqit.

Besniku u pre. E shihte me sytë e tij që Kostandini qysh në mëngjez herët e deri në mesnatë rrinte në uzinë. Edhe bukë hante më këmbë. Uzina ia përpinte energjitë dhe i kishte dhënë atë ngjyrë të zbetë në fytyrë. Gazetari habitej se si i bënte ballë gjithë asaj pune dhe nuk sëmurej. Herë herë pikëllohej se e shihte shumë të raskapitur me një vështirim të lodhur dhe nervoz. Ai nuk mund ta mirrte me mend se si një njeri të tillë mund ta nxirrnin para gjyqit.

- Sot u zura edhe me drejtorin - Tregoi Kostadini gjithënjë i qetë, bile tani i shkëlqeu një buzëqeshje e lehtë ironie - Sa nuk u rrahëm me grushta. U rrëzua një sondë dhe nuk e ndreqëm dot se nuk kishte energji elektrike. Çentrali i vjetër, i shkatërruar fare, punon s'ndonjë kalë ngordhalaq. Drejtori m'u hakrua si i lojtur mënj, sikur ta kisha aga. Ja ktheva ashtu si e meritonte, një me një. Dukesh se akoma nuk e kishte njohur kokën time. U shamë dhe u bëmë helaq më keq se kalamajtë. Nuk e di fare se si do t'i vejë filli punës sime.

Ai u ngrit, bëri ca hapa nëpër dhomë, qëndroi mes saj shumë serioz psherëtiu dhe vijoi me një hidhërim shumë të thellë:



- Nafta! . . . Nafta! . . . I thyen të gjithë kuadrot e forta! Prej çeliku të jesh e të bën dy copash. Kush ka mbetur pa ngrënë dru këtu? Pa u bërë i keq me të tërë? Vijnë nga qendrat e tjera të prodhimit si njerëz të zot, të zgjedhur, të kalitur, me shpresë se do ta ndryshojnë situatën. Nuk shkon shumë kohë dhe pësojnë disfatë. Në qëndrat e tjera të prodhimit, po të punonin kështu, do të shpallehin heroj. Unë për vehten time, më i ri, djalosh tetëmbëdhjetë vjeç kam drejtuar oficinë në Durrës, parkun e Shkodrës dhe gjithëmonë më lavdëronin. Këtu bëj trefishin e asaj pune, kam eksperiencë më të madhe dhe fundi? ! Më pret gjyqi! Ju shkrimtarët jetoni me ëndrra dhe s'e njihni realitetin. Dhe ti je shkrimtar dhe nuk mund t'i kuptosh këto.

- Unë e njoh dhe e kuptoj realitetin - U hodh Besniku plot bindje.

Kostadini vuri buzën në gaz, u ul në karrike, e vështroi butë dhe pak si me tallje.

- Sa për ty, po të them se nuk e njeh jetën fare. U bënë gjashtë muaj që jetojmë bashkë dhe akoma nuk më ke kuptuar se ç'tip jam. Duket se tani për tani as nuk do të më njohësh dot. Shkrimtarët nuk janë kështu. Ata i thithin mendimet e të tjerëve dhe të zbrërthejnë menjëherë. Do të ishte qejf i madh, po të më përshkruaje. Kushedi se ç'do të përrallisje. Do të shkrihesha gazit duke lexuar. Besniku mbeti i shtangur nga këto fjalë që i dëgjonte për herë të parë. Mundi të mirrte diçka me mend nga tipi i shokut, por prapë Kostandini iu duk mister, megjithëse shpesh kishte kujtuar se e njihje në thellësi.

- Mjaft tani. Flemë se po gdhihet. . . - Dhe Konstadini mbylli dritën.

Të nesërmen Besniku u ngrit vonë, u la, hëngri mëmgjez, u ul në tavolinë dhe po shfletonte romanin. Iu dukën të zbeta personazhet dhe përshkrimet, sikur nuk u kishte hyrë thellë njerëzve të kohës së pasçlirimit, nuk i kishte paraqitur aq të gjallë sa ato ngjarjet që jetonte tani. Ai mendoi se sa mirë do të ishte sikur t'i kishte njohur personazhet, t'u kishte hetuar të fshehtat shpirtërore, ashtu si bënte tani në kantier dhe se kur do të vinte vallë ajo kohë që të shkruante për gjëra që i kishte zbuluar vetë me hollësi, që ishin bërë gjaku dhe mishi i tij? ! Qëndroi ashtu i zhytur në vehte dhe kujtoi ngjarje dhe njerëz që i kishin lënë më tepër mbresa. Mendoi për dramën e Kostandinit, për Polidhorin, për brigadën e rinisë që kishte punuar gjatë gjithë dimrit pa asnjë avari dhe për shumë gjëra të tjera.

Në këtë kohë dikush trokiti në derë dhe e lajmëroi se i kishte ardhur një telegram. Vajti me vrap në postë, mori telegramin dhe lexoi i tronditur: "Na doli të dyve e drejta e studimit për në Bashkimin Sovjetik. Eja urgjent të plotësosh dokumentat. Jorgjeta. "Djaloshit iu mbushën sytë me lotë gëzimi. Fantazia e tij

posi një vetëtimë që zbulon në errësirën e natës gjithshka për rreth, krijoi në mëndjen e tij me ngjyra të shkëlqyeshme tablo të jetës së ardhshme në Moskë: Ai sikur po shihte si në film që, i veshur me rroba të reja, shëtiste kapur për dore me Jorgjetën e bukur, të ngjashme me një flutur magjepse, që rednin bashkë në rrugët plot diell të Moskës, shkonin në opera, në teatër dhe luanin nëpër parqe si fëmijë. E përfytyroi Jorgjetën në Moskë si më të bukurën e kësaj toke, pa u thelluar se disa herë nuk i pëlqente fytyra e saj dhe mendoi se kurrë nuk do ta tradhëtonte, se atë e kishte kërkuar gjatë jetës plot mundime dhe vuajtje. Këtu kishte parasysht sëmundjen, përpjekjet për të shkruar dhe dëshpërimet e dashurisë.

U kthye në dhomë. Në tryezë ndodhej dorëshkrimi i romanit të posafilluar dhe ai mendoi se romani patjetër do të botohej, se ndofta do të përkthehej rusisht, se më vonë do të shkruante me realizëm një roman tjetër me ngjarjet të jetuara në kantier, se romanet e tij do të kishin përmbajtjen e re socialiste të shkrirë me fuqinë artistike të kolosëve të letërsisë botërore. Me këto shpresa e iluzione filloi të mblidhte rrobat që të nisej menjëherë në Tiranë dhe sikur të parandjente diçka të keqe pëshpëriti me zë të ulët: "Oh, lumturi e parakohëshme! "

Ndërsa kërkonte vend për t'u ulur, vuri re te dritarja e vagonit një vajzë të re, e cila ia kishte qepur sytë. Ishte Edi që kishte recituar me aq pasion vargjet e Ljermontovit. Iu kujtua ajo natë, figura e saj në skenë, recitimi, zëri. Të gjitha u lidhën me atë vështrim të bukur, pak melankolik dhe iu ngjall dëshira ta njihte. U drejtua tek ajo dhe pa u afruar mirë, i tha:

- Edi! . .

Buzëqeshi i hutuar dhe i shtrengoi dorën e butë, të lëmuar, me gishtërinj të gjatë dhe të bukur, që iu dukën atij se shprehnin gjithë atë finesë, hijeshi e krenari të trupit dhe të fytyrës.

Si u përshëndet edhe me shoqen e saj, i tha:

- Ju njoh. . . Para disa javësh ju kam dëgjuar duke recituar "Demonin" e Lermontovit. Kurrë nuk do ta harroj atë recitim të zjarrtë dhe aq shprehës.

Edi e përkëdhelur nga këto lëvdata buzëqeshi lehtë dhe ja ktheu:

- Edhe ju nuk jeni i panjohur për mua. Mos gabohem ju fituat çmimin e parë në konkurs.

Besniku u skuq gjer në rrëzë të veshëve. Edin e habiti kjo gjë dhe e kuptoi se nuk ishte aq kryelartë e medjemadh sa e pandehte dhe kjo i pëlqeu.

- Nga vini kështu? - Pyeti djaloshi për të ndëruar bisedë.

Isha në Pogradec. - U përgjegj Edi dhe duke kuptuar se çdo gjë e saj atij do t'i bënte shumë përshtypje si edhe shumë djemve të jerë, vijoi - Dhe jam shumë

e kënaqur. Më falni se ndofta po tregohem një çikë si shumë romatike, por e kam sinqerisht. Natyra ishte vërtetë e mrekullueshme. Çdo ditë e soditja liqenin në mbrëmje, ashtu si e ka përshkruar Poradeci. Më pëlqen shumë muzgu me atë hije trishtimi që shpërndan kudo. Rrija si e magjepsur në breg sa të tjerëve u dukeshin budallaqe. . . Po për mua nuk ka gëzim më të madh se sa të sodis bukuritë e natyrës.

Ajo besonte se shprehte ndjenjat e veta pa asnjë fije artificialiteti, por e vërteta ishte se i egzagjëronte ca pa e kuptuar as vetë. Ky rrëfim e preku Besnikun më tepër nga ç' dëshëronte dhe ç' kujtonte ajo. Ai nuk mund të mos pranonte se ishte inferior ndaj shumë të rijve për shkak se nuk e shijonte aq shumë natyrën. Ata që magjepseshin pas kuadrove të mbrëmjes dhe të mëngjezit i dukeshin atij natyra më të larta. Nuk dyshoi aspak në fjalët e Edit. I lidhi ato me vargjet e Lermontovit, me bukurinë e saj dhe ajo u ngrit më tepër para syve të tij. Tek e vështronte gati me admirim, i zuri syri një libër dhe e pyeti:

- Ç' lexon kështu?

Edi mori librin, ia dha në dorë duke i thënë:

- "Ana Kareninën". Po e lexoj për të dytën herë. Ky është romani që më pëlqen më tepër se çdo roman tjetër. Për mua dy vepra janë me të vërtetë të mëdha: "Ana Karenina" dhe "Hamleti". Më vjen të qaj, kur lexoj skenën te varret.

Besniku u çudit nga gjykimet e saj për këto kryevepra letrare dhe e ndjeu vehten inferior edhe në letërsi. Shumë pjesë nga "Hamleti" i dinte për menç, por nuk kishte arritur të qante nga fuqia e dhëmbjes që kishte tragjedia. Ai nuk dinte mirë se shumica e gjykimeve estetike që japin njerëzit, vidhen nga librat ose dëgjohen nga të tjerët dhe nuk janë zbulime personale si ia kërkonte ai vehtes.

- Edi lexon shumë - Ndërhyri shoqja e saj - Unë habitem. . . Ajo edhe...

Qëndroi , i mbeti fjala në grykë se Edi i ra me grusht dhe e qortoi:

- Mos na i nxirr të palarat në sheh.

- Mos shkruani? ! - U habit Besniku.

Shoqja dekospiroi:

- Ajo më lexoi një tregim shumë të bukur që më bëri të qaj.

- Budallallëqe. . . E ndërpreu Edi me përçmim - As vetë nuk e di se ç' më gjeti që e shkrova. . Shkarravina. Asgjë më tepër. .

Besniku e kundërshtoi:

- Pse flet kështu? Kush shkruan sot ashtu si duhet?

Ata filluan të bisedonin për letërsinë dhe t'i hapnin zemrën njeri tjetrit, t'i zbulonin shpresat për t'u bërë shkrimtarë. Edi po tregohej gjithënjë e më e afërt.

E vështronte si të njiheshin prej vitesh. Besniku për herë të parë takonte një vajzë që recitonte bukur, që fliste me zjarr për letërsinë, që adhuronte natyrën, që ëndërronte të bëhej e madhe dhe tallej me ëndrrat e veta. Iu duk se ajo ishte një kopje e karakterit dhe e temperamentit të tij. Jorgjeta ishte ndryshe. Gjithënjë i fshihej, ndruhej t'i tregonte meritat, dyshonte në to dhe nuk fliste kurrë pa qenë e sigurtë. Ajo as veten, as botën nuk e vishte me ngjyra romantike. Ai e shihte se e dashura kishte një zemër të dhëmbshme, se ishte shumë e thjeshtë, e natyrëshme në ndjenjat e saj, por nuk mund t'i çmonte aq shumë këto cilësi. Prandaj e shqetësoi Edi. Iu duk se ia pakësoi dashurinë për Jorgjetën.

Por në Tiranë, si u nga nga Edi, figura e të dashurës iu bë më e gjallë, cilësitë e saj më të theksuara e më me vlerë. Iu kujtuan ëndrrat e lidhura me të dhe e vrau ndërgjegjia. Nuk mund ta fshihte se Edi i kishte bërë një përshtypje shumë të madhe, se ndofta ajo ishte vajza e dashurisë të jashtëzakonshme, të tillë si te herojtë e "Demonit" dhe të "Ana Kareninës". Por sidoqoftë mendoi se ishte takuar vonë me të, se zemrën ia kishte falur për jetë Jorgjetës dhe se më mirë vdiste se sa ta tradhëtonte. Po shkonte në konvikt dhe Edi u zhduk pak nga pak nga përfytyrimet e tij. Iu tretën ndjenjat e turbullta. U bë prapë i gëzuar, i lumtur. E ardhmja me Jorgjetën iu shfaq përsëri me drita të shkëlqyera.

Në konvikt u takua me të dashurën dhe e lanë që të nesërmen ajo të vinte në shtëpinë e tij.

Në mëngjes Besniku shkroi autobiografinë dhe e përktheu rusisht. Plotësoi fletë anketat, doli në fotografi dhe pasdite po priste me padurim të dashurën. Ajo erdhi në orarin e caktuar, gjë që ndodhte rrallë. I ra portës dhe qëndroi në rrugë. Besniku u sul jashtë me nallane. Jorgjeta iu duk tepër e bukur. Atë e ngacmoi sidomos një buzëqeshje çapkëne që endej në buzët e saj. I dha dorën dhe e ftoi brënda, ndërsa sytë i xixëllonin. Vajza e kuptoi se djali kishte dalë i paveshur, me nallane, që ta fuste në shtëpi, prandaj, që ta ngacmonte edhe më shumë, shtihej sikur nuk donte. Në të vërtetë një dëshirë rinore ia ngrohte zemrën, tek shihte sytë e ndezur të Besnikut.

- Hyr pra! - I tha për së dyti ai.

- Pse të futem? . . . Jo Jo. . . Vonohemi - Kundërshtoi ajo me djallëzi, po me atë buzëqeshje çapkëne. - Ti vishu, unë po të pres këtu në rrugë.

- Hyr! . . . Nuk të ha! . . . - U lut Besniku dhe syve të tij u ra një hije trishtimi. Jorgjeta e zënë ngushtë pranoi:

- Mirë, po hyj. . .

Hynë të dy në dhomë. Besniku mbylli derën dhe u kthye nga Jorgjeta që u

ul në minder pa teklif, sikur nuk e dinte se ç'ë priste. Ai u afrua. Zembrën e kishte plot dashuri. Donte ta përkëdhelte, ta puthte, ta shtrëngonte në krahëror. Ajo e kuptoi fare qartë, por nuk desh të dorëzohej aq shpejt.

- Mos Besnik! Ti je fare. . .

U ngrit nga vendi që t'i largohej, u ul pranë dritares dhe i tha:

- Këtu jam e sigurtë se na shohin nga jashtë.

Besniku u prek dhe i foli i shtypur shpirtërisht:

- Nuk do të më lësh të të puth? !

Ajo qeshi dhe u përgjegj duke e vështruar në mënyrë ngacmuese:

- Kur qenke bërë kaq djalë i mirë, sa të marrësh leje? Më ke thënë dikur se puthjet që rrëmbehen janë më të ëmbla.

Besniku u ndez shumë nga këto fjalë dhe bëri drejt saj. Jorgjeta u largua nga dritarja, i shpëtoi nga duart dhe u qas rrzëzë murit. Ai e ndoqi, e kapi, e përmbodhi në krahë, por nuk i voliste ta puthte se ajo e kthente kokën sa andej këndeje. Buzët e tij çikën fare pak të sajat.

- Më lësho se do të thërras! - Pëshpëriti dhe i iku nga duart.

U rras në çipin tjetër të dhomës. Të dy merrnin frymë me zorr, të lodhur dhe të emocionuar. Jorgjeta, kur pa se Besniku po mjaftohej me atë puthje të lehtë dhe nuk po e trazonte më, e ngacmoi:

- S'ë kam ditur që e paske kaq frikë mamanë.

- Unë të putha, prandaj të lëshova. .

- Atë quan të puthur ti? ! . . Sa m'i çike një çikë buzët. . . . Unë dola më e fortë.

Atëherë Besniku u sul drejt saj, e përfshiu si i tërbuar, e mblodhi në krah si bisha gjahun. Në sytë e ndezur, në lëvizjet e shpejta, në duart që e shtrëngonin fort, ajo dalloi shpirtin e tij të rrëmbyer, të cilit i ndruhej aq shumë. Pamja e gëzuar e çapkëne iu zhduk menjëherë. E kundërshtoi, por kësaj radhe ai ishte i vendosur dhe ja ktheu kokën me pahir nga vetja. Buzët e tij të trasha dhe të nxehta u ngjitën në buzët e saj të holla e delikate dhe ashtu ndenjën disa çaste. Asaj sikur iu pre fuqia. U llahtarit mos shkonte më tej. Tashmë nuk e kishte në dorë veten dhe ai mund ta përdorte si t'i pëlqente.

Kur e lëshoi, u qas menjandë pak e zverdhur. Qëndroi aty në çip si e ngrirë dhe i nguli sytë fytyrës së tij. Në zembrën e saj kishte zënë vend një frikë e habitshme, që as vetë nuk ia kuptonte mirë shkakun. Ndofta i friksohej ndjenjave të tij të rrëmbyera që për një çast kalonin nga ekstremi në ekstrem dhe mund të shkatërronin gjithshka që çmonte, edhe jetës. Duke qenë se po shkonin bashkë në

Bashkimin Sovjetik, ajo mendoi se po e lidhte veten me këtë njeri të çuditshëm, të papërmbajtur, me të cilin kushedi se çfarë gjërash të papritura mund të ndodhnin. Trishtimi një hop ia mbushi zemrën, por ajo e largoi këto mendime duke shpresuar se ndofta gjithshka do të vinte mbarë.

- Të putha tani? - E pyeti ai.

- Po. . Ti je i fortë. . Eja tani të shkojmë në ambulancë se fillon komisioni.

Vizita mjekësore kishte filluar. Besniku sapo ia kishin thirrur emrin. Ai u fut i tronditur. U turbullua edhe më tepër para mjekëve dhe zemra i ndolli keq. Mjekët e vizituan me vemendje dhe kryetari i komisionit, një burrë me fytyrë të vrazhdë, ia preu me sëpatë, sikur fliste për diçka fare të parëndësishme në jetë:

- Nuk mund të japim raportin për të lejuar të shkosh jashtë për studime. Shteti kërkon të vendosë kapital të sigurtë për njëzet vejt, kurse ti nuk jep garanci as për pesë vjet.

Besniku u zverdh.

Vizita zgjati mjaft, prandaj edhe Jorgjeta u shqetësua. Dinte vetëm se ai vuante nga tuberkolozi, por nuk kishte idenë se çfarë procesi kishte dhe kurrë nuk e kishte pyetur. Nga pamja e jashtme, nga gjendja shpirtërore e tij, besonte se kishte diçka të lehtë dhe kurrë nuk i kishte vajtur mendja se mjekët mund t'i prisnin bursën. Zgjatja e vizitës mjekësore e trembi. Besniku doli. Shkëlqimi i syve ishte zhdukur.

- Ç'të thanë? - E pyeti ajo me padurim

U qasëm mënjanë dhe Besniku e kuptoi se duhej të rrëfente gjithshka për sëmundjen, gjë që nuk e kishte bërë më parë nga frika se ajo mos trembej. U ulën në një stol dhe i tregoi se kishte patur gavernë, se tani bënte pneumotoraks dhe se doktorët mund t'ia prisnin bursën. Ai nuk e vuri re se e dashura u zverdh.

Jorgjeta u kthye në konvikt pa qejf. Hëngri bukë pa shije. Vajti të flerë duke ndjerë një ankth si pa shkak. U përpëlit në dyshek gjer në mesnatë dhe gjumi nuk e zinte, qepallat s'i mbylleshin. Ç'e brengoste atë vallë kaq shumë? ! . . Besniku. . . Priste të qetësoheshin marrëdhëniet e tyre, të bëheshin më të sigurt, kurse dita ditës lëkundeshin edhe më tepër. Atij po i prisnin bursën. Që të dy po fillonin një jetë krejt të ndryshme dhe kështu nuk kishte asnjë siguri për të ardhmen. Ajo arësyetoi se ai mund të rrëmbehej në çdo çast nga një vajzë tjetër dhe këtë mund ta bënte lehtësisht edhe pse ajo nuk i jipej. Asaj iu duk se kishte gabuar rëndë që i kishte vajtur në shtëpi, që ishte ekspozuar shumë më të, që i kishte premtuar të shkonin bashkë gati si të fejuarën në mbrëmjen e redaksisë që do të organizohej të nesërmen. Besniku mund të bëhej shkrimtar i madh. Po ja edhe kjo nuk mjaftonte, derisa asaj nuk i rrihte zemra me aq zjarr, derisa gjithshka ishte në dyshim e pasiguri.



Nuk dëshëronte të bënte dashuri si disa vajza të tjera, që kur ndaheshin, thonin me ftohtësi: "U ndamë. Nuk na përputheshin karakteret. "Ç' të bënte pra? ! Mos vallë duhej ta braktiste? ! Ajo u vërtit në dyshek plot vuajtje, me lot në sy dhe e kundërshtoi këtë zë të egër duke menduar se kishte vajtur me dëshirën e saj në senatorium dhe kishte lidhur dashuri me të, megjithëse dihej që ai ishte tuberkuloz.

- T'ia lëmë kohës. . - Vendosi e dëshpëruar, se asgjë nuk mund të kuptonte veç atij ankthi që e shtypte dhe e linte pa gjumë.

Pak nga pak po zbardhej. Ishte e raskapitur fizikisht dhe shpirtërisht. Rrinte ashtu e dërmuar pa fuqi.

### III.

Jorgjeta ishte mbështetur te muri me një pamje të raskapitur dhe të mjerë. Vështrimi i qe fikur. Buza i qe tharë. Ajo dritë e brëndshme që i jipte harmoni dhe nur tipareve të patheksuara mirë, që s'dalloheshin për ndonjë formë të bukur, qe zhdukur fare. Tani edhe flokët e artë nuk i jipnin hije. Besniku, pasi i dha ftesën për në mbrëmje, e pyeti me dhimbje:

- Çfarë ke kështu? !

- Asgjë. . . - Tha ajo me një fije zëri.

- Mos je e sëmurë?

- Edhe ajo na duhej! - Buzëqeshi hidhur duke vertetuar kështu se diçka e mundonte.

Ecën bashkë një copë rrugë të heshtur. U ulën në një lulishtë. Jorgjeta kishte gjithënjë një pamje të prerë. Ai u përpoq ta gjallëronte, po ishte e pamundur. Më në fund i tha:

- Çfarë ke? Pse nuk më tregon? ! . . . Ti gjithënjë më fshihesh. .

Vetullat e saj të holla u mblodhën pak. Ajo u ngrys. Edhe herë të tjera ai e kishte fyer se gjoja i fshihte diçka. Por kjo nuk kishte qenë aspak e vërtetë. Tani ajo mendoi se duhej t'i rrëfente domosdo diçka prej vuajtjeve të saj. Ai fundi i fundit duhet ta dinte se po të ngjante ndonjë gjë në të ardhmen, mos të ishte e papritur për të. Pa i kuptuar mirë pasojat, i foli:

- Me që ngul këmbë, po të tregoj. Më duket se ne nuk do të përfundojmë.

Besniku u pre. Ndonjëherë edhe dyshonte nëse do të bashkoheshin për jetë,

por në këto çaste ishte i sigurtë se asgjë nuk mund t'i ndante, prandaj pyeti i çuditur:

- Pse? !

Jorgjeta nuk u mendua gjatë:

- Unë të dua ty, por kam disa çaste. . - Ajo u drojt, nuk desh të flasë më, se parandjeu diçka jo të mirë.

- Fol lirisht! - E nxiti Besniku.

- Ka çaste kur më duket nuk ndjej dashuri. .

Besnikut sikur i përmbys gjithshka. Harroi që edhe vetë kishte raste që nuk e donte aq shumë Jorgjetën, se një ditë më parë gati ishte dashuruar pas Edit. Tani kishte bindje të plotë se gjithënjë e kishte dashur me pasion të pakrahasueshëm. Kujtoi se dy netët e fundit nuk kishte fjetur fare duke menduar për Jorgjetën, duke thurrur ëndra për martesë ideale me të. Ai u trondit nga dyshimi se ndofta në këto çaste ajo nuk e kishte dashuruar. Mandej edhe mund të kishte patur neveri ndaj tij. Pak nga pak iu ngjall një zemrim i fuqishëm. Besniku mund të puthte, mund të përkëdhelte ëmbël, vetëm atë vajzë që e dashuronte dhe dashurohej prej saj. Mendoi se po ta kishte ditur se ajo kishte raste që nuk e donte, do ta kishte flakur me kohë. Ai solli në mendje ardhjen në senatorium që e quante fakt të pakundërshtueshëm të dashurisë së saj dhe e pyeti:

- Atëherë pse erdhe në senatorium dhe më the se nuk rroje dot pa mua? ! Unë në atë koha nuk të kërkoja dashurinë.

Vajza buzëqeshi hidhur. I kishte vajtur në senatorium se i dhëmbej dhe kishte shpresuar se do ta ndihmonte të shërohej, po të lidhej me të. Kjo sjellje asaj i ishte dukur e arsyeshme dhe e virtytshme. Por nuk ia kishte shpjeguar duke kujtuar se mund ta lëndonte. Por tani ajo ishte e mendimit se duheshin të sqaroheshin mirë marrëdhëniet e tyre dhe nuk duhej të shtyhej si budallaqe më thellë. Ajo i foli duke e nuhatur se mund ta fyente:

—Më vinte keq. . Desha të ndihmoja të shëroheshe sa më parë.

Këto fjalë të singerta u ngulën si thika të helmuara në zemrën e djaloshit. Dashuria e pakufishme që i dukej se ushqente ndaj saj, ishte gënjer. Për atë Jorgjeta në fakt po pohonte me gojën e saj se nuk e kishte dashur kurrë, se mëshira e kishte sjellë në senatorium. Ai kërkonte ta dashuronin dhe ta nderonin për cilësitë e rralla, kurse ajo e kishte dashuruar nga keqardhja. Por atij i dukej poshtërim i madh të futej në kategorinë e të mëshiruarve.

- Mirë. . Mund të ndahemi. . - Tha ftohtë ai.

Jorgjeta u pre. Nuk i pëlqente të ndaheshin kështu, sidomos tani, kur atij mund t'i prisnin bursën. Ndjenjat më të ngrohta ndaj tij iu ngjallën:

- Pse të ndahemi? ! . - Kumndërshtoi ajo - Unë shpreha vetëm dyshimin tim. .

Por Besniku u ngrit.

Jorgjeta desh ta zbusë, t'i mbushte mëndjen se nuk duhej të ndaheshin kështu. I kërkoi falje, por pa dobi.

Ai mori rrugën për në shtëpi i tronditur. Tek ecte i vinin në mendje ngjarje, fakte fjalë, që hidhnin dritë të zezë në karakterin e të dashurës së tij. Pak nga pak filloi t'i ngjallej mëria për të. Shkaku që e paskësh shtyrë Jorgjetën t'i shkonte në senatorium ia bënte të neveritshme. Ai mendoi se ajo u suall ashtu se dëshëronte të ishte e lirë në Bashkimin Sovjetik. I kishte ngelur në mendje se me sa zjarr e kishte puthur një herë, tamam si një femër e sprovuar në dashuri dhe mendoi se ajo e gënjente kur i shitej si ëngjëll. "Nuk të linte ta puthje se kishte merak nga tuberkulozi" i tha një zë i brëndshëm. Por ai nuk e dëgjoi këtë arsytim se iu duk shumë poshtërues për vehte. I kujtoheshin gjëra të vogla, krejt të parëndësishme: ndonjë fjalë, thumb, vështrim dhe Jorgjeta i errësohej fare, i paraqitej gjithënjë e më e ulët, më tinzare.

Së fundi ai mendoi se ajo nuk e dashuronte, me që nuk honepste dot virtytin që sigurisht përfaqsohej nga ai. Harroi se shpesh i dukej vetja me të meta shumë të mëdha. Mendoi se me siguri ajo e kishte bërë planin që tani, sa për sy e faqe, të dukej se dashuroheshin dhe pastaj nga Moska t'i shkruante se ishte ftohur dhe dëshëronte të ndahej.

Këtu iu errësua gjithshka nga zemrimi dhe u hutua aq shumë sa për pak nuk u përplas me një kamion. Qëndroi në mes të rrugës. Polici i ra bilbilit. Kaloi. U hodh në trotuar. I zhytur në këto mendime të turbullta atij iu duk se e urrente Jorgjetën. Kurrë nuk do ta takonte. Nuk do t'i fliste më. Atë që nuk e kishte mposhtur dot me dashurinë e zjarrtë, do ta mundëte me urrejtjen.

Hyri në shtëpi. U shtri në shtrat i dërmuar. Pikërisht në këto çaste, kur i dukej se ishte gënjyer në shpresat më të larta, iu kujtua Edi. Ajo lidhej me vargjet e Ljermontovit, me atë dashuri dhe urrejtje që i dukej se ndrynte shpirti i tij. Ajo e kishte vështruar e menduar, i kishte folur për natyrën, për "Ana Kareninën", "Hamletin". Besoi se në shpirtin e saj fshiheshin ndjenjat e demonit, ashtu si në të tijën.

Atë natë fjete i turbull dhe pa ëndrra të trishtuara. Në mëngjez ishte diçka më i qetë. I erdhi në mendje prapë Edi. Ishte gënjyer te Jorgjeta duke menduar se ajo përfaqsonte idealin dhe kishte nevojë më tepër se çdo herë ta gjente këtë ideal te një vajzë tjetër. Zemra e diziluzionuar kërkonte një strehë të re që të mëshironte

ëndrrat e dëshirat e dështuara. Atij iu duk Edi si mishërimi i tyre. Iu kujtua mbrëmja, ku do të shkonte bashkë me Jorgjetën dhe vendosi të ftonte Edin atje. Ajo edhe mund të recitonte.

U ngrit nga shtrati dhe eci nëpër dhomë i tronditur nga ky mendim. U vesh shpejt, hëngri mëngjez dhe doli të kërkonte Edin.

Poza perëndoi dielli, Edi po e priste te porta e shkollës pedagogjike. Besniku erdhi tamam në orarin e caktua dhe u turbullua së tepërmi, kur e pa të veshur për mbrëmje. Zakonisht ajo mbante grykësen e shkollës, kurse sonte kishte veshur një fustan vishje, të prerë ngushtë. Kështu i dukej shumë qartë forma e bukur e trupit. Sidomos gjoksi i hedhur. Në anën e djathtë të fustanit shkëlqenin gurët e një karfice. Flokët i kishte krehur me kujdes dhe dukej krenare, tërheqëse. U përshëndet plot ëmbëlsi dhe u nisën.

Kur po kalonin rrugës, para u doli Jorgjeta.

Ajo u skuq gjer në rrëzë të veshëve dhe më kot i mbajti sytë një hop te Besniku. Pastaj uli kokën dhe i kaloi në krah fare pranë. Bërrylat e tyre u çikën. Jorgjetës iu mbushën sytë me lot. U mbështet anash murit e ligështuar. Edi ktheu kokën prapa tepër e habitur. Shikoi pastaj Besnikun. Ai shtirej i qetë, sikur nuk kishte ndodhur asgjë.

Hyrja e Edit në sallën e mbrëmjes bëri përshlyetje. Gati të gjithë kthyen kokën dhe e ndoqën me vështrim deri sa zuri vend atje në cep. Kur u ul, krenaria e saj u shkri. Ajo sikur shtyri një perde dhe u zbulua me një pamje krejt të kundërt. Faqet iu skuqën, sytë i vështronin ëmbël. Besnikut iu duk se drita e syve të saj buronte nga thellësitë dhe lëshonte një vegim misterioz. Me guxim dhe gjoja si pa të keq ajo i tha në atë çast:

- Mund t' u bëj një pyetje?

- Sigurisht. . . - U përgjegj djaloshi i bindur.

Dritëza e vogël në bebëzat e syve të saj u drodh.

- Unë kam dëgjuar se e njihni Jorgjetën, vajzën që ndeshëm rrugës. . .

Ajo i nguli sytë për të kuptuar edhe nuancat e vogla të shprehjes së fytyrës, që mund të tradhëtonin të fshehtën e tij.

Besniku tregoi i qetë:

- Gjer dje kujtoja se e njihja shumë mirë atë vajzë. Nuk dua të fsheh asgjë.

Ne dashuroheshim.

Ai me fjalë të paka rrëfeu historinë e dashurisë së tyre.

Edi e dëgjonte me vemendje. Diçka e rrezikshme fshihej për të në pasionet që këmbeshin. Ajo, pasi ai kishte mbaruar së treguari, i tha e çuditur:

- Nuk mund të kuptoj fare se si një ditë e kini dashuruar , kurse sot as nuk i folët fare.

Besniku uli sytë. U mendua një hop. Duhej t'i shpjegonte pse e kishte braktisur atë shpejt Jorgjetën, pse ishte ftohur krejt ndaj saj, që Edi të mos e quante të pabesë dhe të poshtër. Ngriti kokën , e vështroi me ata sy, ku ajo dalloi pasion e mirësi dhe i foli:

- Nuk di a do ta shpjegoj dot dhe a do të më kuptoni. Kjo për mua është gjëja më e llogjikshme që mund të ngjasë. Ju mbani në duart tuaja një gur të çmuar, e ruani si sytë e ballit dhe mund të jepni edhe jetën në çdo çast për të. Befas vini re se jini gënjyer, se ajo që ruani nuk është një xhevahir, por veçse një gur i fëlliqur brake. Atëherë sigurisht do ta hidhni dhe do ta fshini dorën.

Në këtë kohë u afrua përgjegjësi i mbrëmjes dhe i kërkoi Edit të recitonte. Edi u ngrit dhe kaloi plot hijeshi mes sallës. Qëndroi atje në ballë pranë orkestrës, priti e qetë gjersa nuk dëgjohej më asnjë pëshpëritje, bëri një hap para dhe zëri i saj i kristaltë me nuanca tragjiciteti u përhap në sallë. Ajo recitonte një poemë të Filipit që vende vende ishte shkruar me një ndjenjë të hollë poetike. Bukuria, , gjestet, zëri, vargjet e goditura i rrëmbyen dëgjonjësit dhe posa mbaroi, zhurmoi një valë e nxehtë duartrokitjesh. Ajo u kthye kokëlart pa i përshëndetur admironjësit. U ul në karrike, sikur nuk po duartrokisnin për të. Veçse një i kuq i lehtë, që i jipte më hijeshi, dëshmonte se ishte e tronditur.

Besniku gati ishte magjepsur. Atij i erdhën në mendje përsëri vargjet e Ljermontovit dhe i dukej se po ja pëshpëriste asaj, se dashuria e zjarrtë demoniane ndizej në zemrën e tij. Kur filloi muzika, e vështroi i nënshtruar. Ajo ia kuptoi dëshirën dhe u ngrit. Ecën së bashku, qëndruan, i hodhën krahun njëri tjetrit dhe kërcyen një tango sikur pëshpërisnin diçka të fshehtë. Herë pas here vështtrimet u takoheshin si të magnetizuar dhe buzët çelëshin pa dashur. Tangoja mbaroi. U ulën. Kapën gotat e birrës, i tokën dhe pinë me shije si miq të vjetër dhe të ngushtë. Si heshtën një hop , Besniku i foli i ndrojtur:

- Kam dëgjuar se kini një jetë të trishtuar. . .

Ajo nuk mund të mos e kuptonte se ky interesim për jetën e saj dëshmonte një admirim akoma më të madh për të. Nga vështrimi i përlulur, nga buzëqeshja që shprehte vuajtje të fshehtë, ajo mirrte me mend se djaloshi i ri po dashurohej gjithënjë e më tepër ndaj saj. E dinte se rrëfimi i jetës së vet linte përshtypje të thellë në zemrat e reja dhe e vishte me një hije melakolije magjepse. Kështu sigurisht do të ngjiste edhe me Besnikun. Sytë iu errën ca, një hije trishtimi i mbuloi tiparet pa e zhdukur pamjen e kënaqur dhe u përgjegj ngadalë:

- Po. . Unë jam rritur jetime nëpër dyert e botës.

Muzika vazhdonte. Në tavolinë ishin gotat e birrës. Ajo filloi të tregonte ngjarje të trishtuara me zë të ulët e të zvarur.

- Unë akoma derdh lot, kur dëgjoj përrallat me njerka. Të gjithë çuditen. U dukem sentimentale, se asnjë nuk e di se Maro përhitura jam vetë, vuajtjet e saj janë vuajtjet e mia. Isha pesë vjeçe, kur u martua babai dhe njerka më rrihte. I dhëmbej buka që më jipte dhe më poshtëronte në çdo mënyrë. Vuajta kështu derisa u bëra nëntë vjeç. Pastaj nuk munda të duroj më dhe ika te gjyshja.

“Ç’fëmijë kam qenë! Nuk qeshja, nuk qaja, nuk luaja si gjithë fëmijët e tjerë, sepse jetoja në familje të huaj. Shpesh ata më harronin. Nuk e ndjenin fare se unë isha aty dhe mua kjo më trishtonte, më vriste. Jetoja me kujtimin e nënës. E shihja në ëndërr, i pëshpërisja emrin në gjumë, qaja nga hidhërimi.

“E kam të gjallë kujtimin e mamasë ditën kur më vdiq. E shoh në arkivol nënën të veshur bukur, që megjithëse e zbetë, ka një nur të rrallë. Babai qante i përmbysur mbi kufomën e të shoqes. Nuk linte ta mirmin arkivolin dhe betohej se do të varrosej bashkë me të. Mezi e shqitën nga arkivoli. Më duket se tani akoma i dëgjoj dënesjet e tij. Dhe sa çudi! Nuk shkuan as gjashtë muaj dhe ai e harroi gruan e parë. U martua. Hamleti i shan gratë si të dobëta, por unë akuzoj për të tillë burrat. . . .

“Si u rrita pak, shkoja më të rrallë në shtëpinë e babait. Më pëlqente t’i shërbeja, t’i pastroja rrobat, ta hekurojsja. Por njerka s’më linte. I flakte tej rrobat, hekurin dhe më shfynte të shporresha. Kishte frikë mos i ngjallej babait dashuria për mua. Kështu jam rritur unë, pa gëzime, pa përkëdhelje, pa rroba të reja dhe pa prindër. . . .

Besniku i kishte qepur sytë fytyrës së saj dhe çdo fjalë i jehonte në shpirtin e tij të dhembshur. Sigurisht, nëqoftëse një tjetër do t’ia tregonte këto ngjarje, ndjenjat fisnike do t’i prekeshin, ndofta mund të mallëngjehej gjer në lot. Po tani dëgjonte jetën e asaj femre që lidhej me idealin e kërkuar, prandaj e besonte plotësisht. Shtonte me fantazi tragjicitetin e atyre ngjarjeve dhe një valë e thellë dhëmbje e trondiste.

Kur ajo mbaroi, ai psherëtiu thellë. Ndjeu një shtypje të madhe. Dëshëronte t’i betohej se do të jepte çdo gjë që të lehtësonte sadopak vuajtjet e saj, por friksohej mos dukej qesharak dhe u nemit.

Ishte bërë vonë. Ora po i afrohej dymbëdhjetës. Më në fund u ngritën. Kur u ndanë Edi i buzëqeshi në mënyrë të veçantë. I shtrëngoi dorën dhe atij i dogji shuplaka. Një korent ia dridhmoi gjithë trupin. Kështu nuk i kishte ndodhur me

asnjë vajzë në jetën e tij.

Po kthehej në shtëpi i turbulluar, sikur ndodhej në një botë fantastike. Sikur nuk ishte Besniku, por një tjetri i kishin ndodhur ngjarje të çuditshme. I shfaqej në sytë e mendjes fytyra e Edit, i tingllonte në vesh zëri i saj dhe të gjithë këto i përziheshin me një trishtim për ngjarjet që kishte dëgjuar. Befas dikush e thirri.

- Besnik!

Qëndroi dhe u habit. Përpara tij ishte shoqja më e ngushtë e Jorgjetës. Iu bë sikur nga ëndrrat po kthehej në realitet. Për çudi dëgjoji këto fjalë:

- *Gjertanisha te Jorgjeta.* Ç'ka ndodhur me të? ! Tërë ditën ishte e hidhëruar, kurse në mbrëmje u shtri në krevat dhe ia plasi vajit. U mblodhën të tëra shoqet për ta qetësuar. E lutën të na tregonte ç'i kishte ngjarë, por nuk përgjigjej fare. E pyeta mos ishte grindur me ty, por e mohonte. Ç'i ka ndodhur? ! A di gjë ti? !

Këto fjalë e bënë esëll Besnikun. Iu përfytyrua Jorgjeta, të cilën gati e kishte harruar fare i magjepsur nga Edi. U prek. Iu duk vehtja i poshtëruar, se e dashura e tij vuante, kurse ai dansonte dhe vështronte i mahnitur një tjetër. Iu kujtua se ajo dikur e kishte ndihmuar në fatkeqësi, kurse ai po e bënte fatkeqe. I dha shoqes dorën i hutuar, pa i kthyer përgjigje dhe vijoi rrugën i tronditur.

Po i vërshonin në kokë kujtimet më të ëmbla të dashurisë së tyre, iu shfaqën me një dritë të fortë cilësitë më të mira të Jorgjetës dhe ndjenjat e tij të zjarra ndaj Edit sikur u fashitën. E quajti veten budalla që nuk kuptonte ndjenjat e pastra dhe të vërteta. Ai mendoi se ndofta Edi ishte një vajzë e përsosur, më e përshtashme për të, por në asnjë mënyrë nuk mund ta braktiste Jorgjetën. Atij iu mbush mendja që ta takonte qysh atë natë të dashurën. Nuk kishte mbetur asnjë pikë nga ajo urrejtja e djeshme që i ishte dukur e thellë dhe përjetësisht e qëndrueshme.

Shpejtoi hapat dhe arriti sakaqë në konvikt. Porta ishte mbyllur. Trokiti me forcë. Askush nuk iu përgjigj. Dukej se të gjithë ishin në gjumë. "Po Jorgjeta vallë a flë? ! Sa do të dëshëroja të jetë e qetë edhe sikur të mos më dojë mua" Mendoi me vehte.

Trokiti prapë. Po përsëri asnjë përgjigje. Vështroi murin dhe po mendohej të hipte lart, ta kapërcente murin dhe të hidhej në oborr. Ta kërkonte në dhomë. Nuk mund të rrinte pa e takuar atë natë. U mat të kacavirej lart, kur u dëgjua zëri i portierit:

- Kush i bie portës si i çmendur? ! Ç'kërkoni në mes të natës? !

Ai u përgjigj i vendosur:

- Dua të takoj një shoqe.

Portieri ia ktheu me zemrim:

- Nesër. . Dita do të zbardhë. . .

Besniku nguli këmbë:

- Kam diçka urgjente. Duhet ta takoj patjetër sonte Jorgjetën.

Portieri pyeti me ankth, i trembur:

- I ka vdekur kush? !

Djaloshi i mbetur keq tha:

- Jo. . . .

- Nesër! - Ia priti plaku i zemruar dhe u kthye të shkonte në shtrat.

Besniku më kot u lut. Më në fund u detyrua të largohej në shtëpi i dëshpëruar dhe i vendosur që të vinte të nesërmen.

Asaj i rrahu zemra me forcë dhe u hodh nga krevati. Ashtu si ishte me robdishanin e vjetër zbriti shkallët me rrëmbim dhe pyeti e tronditur portierin që po kthehej:

- Më kërkoi kush?

- Po. . Një djalë. . I binte portës si i krisur. . . Pa le, desh të kapërcejë dhe murin.

Jorgjeta ndjeu një lehtësim në zemër, E dinte se vetëm Besniku mund të bënte një gjë të tillë.

- Pse nuk më thirrët? ! - I doli asaj pa dashur nga goja si e hutuar që ishte.

- Nesër do të gdhihet dhe takohu me të - Ia ktheu me indinjatë portieri.

- Iku? !

- Iku, shyqur!

Jorgjeta u kthye në shtrat. Lëmshi i hidhërimit që i zinte grykën u shkri. Kokën nuk e kishte më të rëndë. Gjunjët nuk i pritëshin. Kishte dëshirë të flinte.

U zhvesh, ra të flerë. Të tjera dyshime i erdhën në kokë, por i largoi duke kujtuar se ai e kishte kërkuar si i çmendur.

Atë natë Besniku përsëri nuk mbylli sy.

U ngrit herët. U vesh dhe pa ngrënë bukë u nis për në konvikt. Dera e konviktit ishte e hapur. Aty në oborr nuk kishte asnjë njeri. Hyri brëndë, ashtu si nuk kishte bërë kurrë. Por edhe në koridor nuk dukej kush. Nuk mund të ngjitej në dhomat e fjetjes, prandaj u fut në drejtori dhe i foli pa teklif një gruaje që ndodhej aty:

- Të lutem, a mund të ma thirrni pak Jorgjetën?

- Jorgjetën? . . Jorgjeta iku në mëngjes herët - Tha ajo.

- Ku? ! . . .

- Në shtëpi. . Në Gjirokastër. . . .



## IV.

Në Lidhjen e Shkrimtarëve mori vesh diçka të çudiçme dhe ekstravagante. Hyseni, për veprat e të cilit do të referohej kryesisht, refuzonte të mirrte pjesë në mbledhje. Kjo gjë i kishte skandalizuar të gjithë. Besniku kishte dëgjuar për Hysenin. Thoshin se djalë nëntëmbëdhjetë vjeç kishte qenë komandant batalioni gjatë luftës dhe kishte treguar zotësi dhe trimëri. Dikush ia kishte lëvduar edhe si njeri me talent të vërtetë dhe kulturë të gjërë. Nga të tjerë, sidomos nga ata të Lidhjes, kishte dëgjuar se Hyseni ishte gati i çmendur sa e mbante veten gjeni dhe kishte shpallur se ishte Bajroni i kohës. Një herë që qe takuar me të, ai ishte sjellur në mënyrë të çudiçme. I kishte lexuar ca poezi të vetat duke i lëvduar shumë dhe pastaj i kishte dhënë edhe një tregim për ta lexuar. Besniku nuk e kishte lexuar ende, se pat harruar ta mirrte në qytetin "Stalin".

Kjo sjellje e Hysenit ia shtoi kureshtjen për tregimin. Prandaj u nis në shtëpi që ta lexonte. E ëma e priti e merakosur dhe e pyeti në kishte marrë ndonjë lajm për bursën. Besniku u përgjegj se jo dhe u fut në dhomë. Tregimi "Komiti" i pëlqeu qysh në faqen e parë. Bënte fjalë për shqiptarët kryengritës në shekullin e kaluar, kur Shqipëria ishte nën sundimin e Turqisë. Personazhi kryesor, komiti i ri, që e karakterizonte një temperament impulsiv, vritej duke rrëmbyer vajzën syzezë nga sarajet e pashait. Ky tregim kishte tipare të theksuara romantike dhe jo më kot autori e kishte quajtur poemë. Besnikut i pëlqeu shumë tregimi. Ai e vlerësoi këtë tregim më të mirë se të vetin që kishte fituar çmim dhe mendoi se në letërsinë e kohës nuk kishte lexuar një vepër aq të mirë.

Ai shkoi në mbledhje me qejf. Në klub zotëronte një atmosferë nervozizmi për shkak se Hyseni nuk kishte begenisur të vinte në mbledhje. Vetëm një aktor, një farë Osmani, i pëshpëriti Besnikut me gëzim:

- Mirë ua bën këtyre faqe me nder shkrimtarëve. Kujtojnë se kanë kapur qiellin me dorë. Pluhur janë. T'u frysh, zhduken. Këta janë të zot vetëm të pengojnë talentet e vërteta. Mua të parin.

Besniku nuk i vuri rëndësi këtyre fjalëve.

Mbledhja filloi. Telhai, pasi e qortoi rëndë Hysenin për mëndjemadhësi të patolerueshme, sidomos në shtetin tonë demokratik, filloi të lexonte referatin për shkrimet që nuk kishin fituar në konkurs. Gati gjysmën e referatit ia kishte kushtuar shkrimeve të Hysenit. Teklhai theksoi në fillim se autori nuk ishte pa talent dhe

se me kohë mund të krijonte gjëra të bukura. Pastaj analizoi një nga një veprat. Ai tha se ato ishin të paplota. Herë herë kishin skena të tepërta, jo organike, që mjerisht ndonjëra prej tyre nuk ishte shkruar keq, kurse disa vjersha nuk kishin gjer në fund frymë të shëndoshë partie. Referuesi vuri re se në përgjithësi autori ngutej, fillonte mirë, po pastaj ngatrollohej, se duhej të piquej akoma dhe se këtë do ta arrinte vetëm me ndihmën e shokëve. Ai e përmendi fare pak tregimin "Komiti" vetëm duke u skandalizuar se autori e kishte quajtur poemë.

Të pranishmit e dëgjuan me vemendje referatin dhe, megjithëse nuk i kishin lexuar shkrimet për të cilat bëhej fjalë, e pranuan si serioz dhe e dënuan me indignatë autorin që nuk kishte marrë pjesë në këtë mbledhje shumë të dobishme, sidomos për atë. Si u bënë ca diskutime të parëndësishme, mbledhja mbaroi.

Besniku doli i pakënaqur, pse jo vetëm u hesht për vlerën e tregimit "Komiti", por bile u ironizua për shkak se ishte quajtur poemë. Ai u nis drejt e në shtëpinë e Hysenit që t'i kthente tregimin dhe t'i jipte përshtypjet e veta.

Trokiti me ndrojtje në derën e sallonit. Dërrasat e dyshemesë së koridorit këcitën, dera u hap dhe në prak u duk gruaja e Hysenit. Ajo pyeti me një fije zëri kush ishte dhe çfarë kërkonte.

Besniku i tha se donte të takohej me Hysenin. Në këtë çast Hyseni doli dhe e ftoi të futej brenda, kurse e shoqja u largua pa e vështruar burrin në sy. I zoti i shtëpisë kishte pamjen e zakonshme, veç sytë e zij ishin më të ftohtë, të egërsuar dhe buzët e holla më të shtrënguara se zakonisht. Fytyra e thatë, e zeshkët ishte tendosur nga nervozizmi.

Besniku përshkoi sallonin e vogël dhe hyri në dhomë. Hyseni u tregua mikpritës. Ju lut të ulej në kolltukun më të mirë. I zgjati duhan dhe kur tjetri nuk e mori, i tha se të dy qenkeshin rehat, se duhani ishte diçka e keqe, se edhe Gëtëja e kishte quajtur turp për njerëzit. U duk sikur po e priste të porsaardhurin me gëzim, po kjo nuk ishte e vërtetë. Ardhja e Besnikut e nervozoi se e mori me mend se ky çunak kishte qenë në atë, sipas tij, komedi, ku komediantët qesharakë ishin përpjekur të hidhnin baltë mbi të. Pastaj Besnikun e quante armik personal. E kishte lexuar tregimin që kishte fituar çmimin e parë në konkursin, ku kishin konkuruar edhe veprat e tij dhe e kishte flakur tutje me përbuzje duke u shprehur si zakonisht: "Unë kështu shkruaj me buthë." Atij i dukej një padrejtësi dhe poshtërsi tepër e madhe që një tregimi të tillë i jepeshin dhjetë mijë lekë si çmim, kurse veprat e veta bëheshin objekt sulmesh e talljesh. Nuk i pëlqeu as pamja e jashtme e djaloshit. Iu duk tepër i kënaqur me veten. Hyseni mendoi me vehte se ai mburravec dhe maskara kishte duartrokatur, kur e shanin dhe tani guxonte t'i vinte edhe në shtëpi.

Pa le që as tregimin nuk ia kishte kthyer , megjithëse e kishte marrë para një muaji.

Besniku që kurrësesi nuk mund të mirrte me mend se ç'bluante Hyseni, nxori tregimin nga xhepi dhe i tha:

- Më ka pëlqye shumë. Një tregim të tillë nuk e kam lexuar në letërsinë shqipe. Mendoj se ky e meritonte çmimin më tepër nga tregimi im.

Qepallat e Hysenit u drodhën lehtë nga këto fjalë të papritura.

Pas kësaj hyrje Besniku filloi t'i jipte vlerat më konkretisht.

Në këtë kohë e zonja e shtëpisë hyri me dy kafe. U përkul t'i jipte musafirrit filxhanin dhe buzëqeshi hidhur, me pahir. Pastaj Sabrija u kthye nga i shoqi. Burri e vështroi me ftohtësi të madhe dhe refuzoi:

- Nuk dua.

Atij iu duk se çdo tipar i saj, fytyra pak e shëndoshë, faqet si të verdha, sytë e urtë dhe buzëqeshja e shtirë, tregonin meskinitet dhe diçka bajate. Ndjeu neveri për të shoqen që i bëhej se bashkohej me korin e shumicës kundër burrit të saj dhe nuk e kuptonte gjenialitetin e tij.

Gruas iu duk sikur t'i kishte hedhur dikush një kovë ujë të ftohtë në trupin lakuriq. Një çast mbajti sytë në fytyrën e hidhëruar të burrit duke ndjerë gati urrejtje. Megjithëse ajo e donte dhe e kishte dashur aq shumë, siapas saj ai sillej si tiran. Në këtë çast asaj iu duk një lumturi të ikte nga kjo shtëpi. Doli nga dhoma e vrarë, hyri në kuzhinë, la tabakanë në tavolinë, ndenji në minder, uli kokën dhe ia plasi vajit.

Një herë ajo nuk kishte dashur t'u piqte kafënë dhe ishte përpjekur shumë të gjente se si duhej vepruar, por më në fund kishte vendosur të shtihej sikur nuk kishte ndodhur asgjë. Burrë e grua ishin grindur keqas atë ditë për shkak të qëndrimit të Hysenit ndaj Lidhjes së Shkrimtarëve dhe shokëve të Partisë. Më në fund i shoqi i kishte thënë se do t'i pëlqente më shumë të shporrej nga shtëpia. Këtu kishin pushuar fjalët. Sabrija ishte kthyer në dhomën e gjumit. Atë ditë kishin ngrënë bukë veç e veç. S'kishin këmbyer asnjë fjalë dhe s'i kishin dalë fare ballë për ballë njeri tjetrit.

Vjehri që hyri në atë çast, e kuptoi se kush ishte shkaktari i lotëve të saj dhe i foli:

- Mos ja vë re se është bërë i shkalluar.

Hyseni vijonte të dëgjonte djaloshin pa e ndërprerë dhe dalëngadalë u zhduk mëria kundër tij. Në fillim u çudit që Besniku e kishte kuptuar ashtu tregimin dhe këto fjalë të mira në këto çaste , kur pandehte se të gjithë, pa përjashtuar as gruan,

as babanë, ishin sulur kundra dhe donin ta mbytnin, e lehtësuan shumë dhe e bënë të largonte paragjykimet ndaj tij. Megjithëse djaloshi fliste me ton prej mësuesi, si të kishte para një nxënës të shkollës fillore, po në atë mënyrë që jepeshin vërejtjet në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe nuk e shpallte gjeni, iu duk i mëmçur dhe i mirë. Kur ai mbaroi, sytë e Hysenit vështronin qetë. Buzët i ishin puqur lehtë. Fytyra i kishte marrë një pamje të paqtë.

- Po habitem. Nuk e prisja kurrë që ti të pëlqeje poemën time - Foli ai i kënaqur.

- Nëqoftëse janë të tilla edhe shkrimet e tjera, Telhai nuk ka patur të drejtë në kritikën e tij - Kostatoi Besniku - Kurse drama e botuar nuk më ka pëlqyer, megjithëse fillimi ishte i bukur.

Pejziti e nofullës së Hysenit lëvizën me një farë nervozizmi duke marrë me mend, bile duke e zmadhuar kritikën dhe fyerjen që i kishin bërë në mbledhje, me gjithëatë ai i foli Besnikut i qetë:

- Kjo ishte më e mira e atyre shkrimeve dhe këtu filloi kthesa ime drejt artit të vërtetë. Të tjerat që i kam shkruar para kësaj poeme, kanë vetëm një vlerë studimi për rrugën që kam ndjekur unë.

Besnikut iu dukën fjalët e tij të pakuptueshme dhe të çudiçme, por duke vënë re se po e trajtonte me afërsi, e pyeti me mirësjellje:

- Pse nuk erdhe sot në mbledhje? ! Nuk e kuptoj fare këtë qëndrim.

Hyseni heshti një hop. Diçka i lëvizi brënda. Sytë nuk i shprehnin më qetësi, por zemrim. Tani që mendonte se kishte patur doza hipokrizie në shkrimet e tij të para, të cilat i kishte krijuar në frymën e realizmit socialist, ishte e natyrshme që t'i quante pothuajse krejt hipokrite veprat e shkrimtarëve të kohës dhe të paarrira artistikisht, që në një shkallë shumë më të madhe se ai dikur, përshkruanin dhe ngrinin lart me servilizëm shtresat e ulta, megjithëse pothuaj asnjëri prej tyre nuk kishte origjinë të varfër dhe as i njihje ato shtresa. Kjo e shtynte të ndjente neveri për ato shkrimtarë që e kishin kritikuar dhe u derdh me inat:

- Nuk kam ndërmend të dëgjoj dënglat e kalemxhijve që hanë paratë e popullit badihava dhe mburren për të ditur. Mua nuk më japiq dot mësim. Ata janë plehra që koha do t'i shkelmojë. Vijnë prej hiçit dhe shkojnë drejt hiçit. Me sjelljen time u tregova se nuk vlejnjë një dysh, se nuk janë të zot të thërresin një njeri në diskutim. Pinguinët! Duan të më presin rrugën! Gabohen! Oqeani nuk futet në një gropë! Lufta e meskinëve është një barometër që tregon se unë jam në rrugë të drejtë! Unë jam pishtar në errësirë!

Besniku mbeti i shastisur nga këto fjalë. E tronditi pasioni dhe bindja e madhe

me të cilën fliste bashkëbisedonjësi. Shpesh herë edhe atij i dukej se kishte një zjarr të madh në krahëror, se kishte lindur të krijonte vepra të mëdha, pamvarësisht se disa herë ndjehej i pafuqishëm dhe i vogël. Këto dëshira i zienin brënda dhe s'guxonte t'ia shfaqte botës. Por ja Hyseni e shpallte hapur se ishte gjeni dhe kjo i pëlqeu, pamvarësisht se nuk ishte i sigurtë në ishte e vërtetë apo jo. Ai ndjeu se kishte diçka të përbashkët me Hysenin, por ai u duk më i fortë, më i sigurtë në vlerën e vet dhe në të ardhmen. Megjithatë veprimin e tij e quante të gabuar dhe e qortoi:

- Pamvarësisht se cilët ishin ata, ti të vijë në mbledhje. I dëgjoje dhe shprehje mendimin tënd.

Tjetri mbrojti qëndrimin e vet:

- Unë do t'u plasja në turij të vërtetën dhe do të bëhej një sherr më i madh.

- Atëhere heshtje.

- Kjo nuk i shkon shtatin tim - Kundërshtoi ai - Çdo njeri duhet të veshë rrobën e tij. Ata të dërdëllisin për veprën time budallallëqe me thasë, kurse unë të mi sus si një qen i mësuar në cirk?! Nuk jam aktor komik. Do të ishte poshtërsia më e madhe që do t'i bëja vetes.

Besniku mbeti. Nuk dinte ç't'i thoshte. Me kaq u ngrit se ishte bërë vonë. Duke kaluar në sallon, tani e ndjeu ftohtësinë e madhe të kësaj familje. Rrugës po ecte i turbull. Iu kujtuan hallet e veta, Jorgjeta, Edi, e drejta e studimit, romani.

Të nesërmen i komunikuan se për arsye shëndetsore ia hiqnin të drejtën e studimit. Ai protestoi deri në sekretarinë e Komitetit Qëndror të PPSH, kërkoi të caktohej edhe një komisiom mjekësor tjetër, por pa dobi. Pastaj u nis në qytetin "stalin" dhe mendjen e kishte vetëm te romani.

## V.

U zgjua nga gjumi dhe e kuptoi se kishte qenë në ëndërr, se në të vërtetë nuk po i shfaqte dashurinë Edit. Ndodhej në shtrat. Rreth ishte errësirë. Jashtë çfrynte tufani si i marrë. Era vërshtëllente dhe përplasej nëpër muret e ndërtesave, tundëte pemët që shushuritnin me poterë. Një llamarinë në ndonjë ndërtesë aty pranë ulërinte dhe godiste si bishë e lidhur. Pastaj qielli gjëmoi frikshëm. Shungulloi dheu i tërë. Zhurma e tufanit u mbyt. Shkrepëti vetëtima. Në dhomën e tij u bë

një çast dritë. Nga dritarja u dukën pemët, oborri, shtyllat e elktrikut, ndërtesat. Ndërkaq gjithshka e mbuloi një errësirë edhe më e thellë. Pastaj një hop qetësi. Kishte filluar shiu.

Ai solli në mendje se si e kishte parë Edin në ëndërr pak më parë. I ishte bërë sikur ishin të dy në një vend të papërcaktuar. Ajo qëndronte para tij më këmbë. Ai i magjepsur nga bukuria e trupit të saj, nga vështrimi melankolik dhe flokët e zinj të derdhur në supe, i ishte afruar i tronditur me sy të shkëlqyer dhe i kishte thirrur: "Edi! "Ajo kishte kthyer kokën, i kishte buzëqeshur gjithënjë krenarë. "Të dashuroj - I kishte pëshpëritur ai me zë të ulët - Kurrë nuk kam dashuruar me kaq zjarr! "

I ishte afruar edhe më, i kishte kapur dorëm e butë, i kishte puthur gishtërijtë e hollë dhe të bardhë dhe kishte dëshëruar ta përfshinte në krahëror. Edi i kishte buzëqeshur përsëri dhe si një hije ishte tretur në errësirë. Ai ishte sulur drejt saj dhe kishte thirrur prapë: "Edi! "Po errësira nuk ishte përgjegjur. E dashura ishte zhdukur pa gjurmë duke e lënë të trishtuar.

Ai ndjeu një ankth në shpirt se nuk kishte ndodhur ashtu në të vërtetë. Dashurie për Jorgjetën po i dukej lodër e lehtë rinie. Asnjë gjurmë s'i kishte lënë dhe për të nuk ishte faji i tij. Ajo s'e rrëmbeu, s'e ndezi gjithë zjarrin e zemrës. "Unë tani dashuroj për herë të parë dhe kjo do të jetë edhe hera e fundit. Edi është vajza që kam kërkuar në jetë, ideali im, ëndrra ime. Dhe këtë nuk do t'ia fsheh. Nesër do ta kërkoj dhe do t'ia them. "

Befas dritarja u hap me zhurmë, sikur ta kishte shtyrë dikush me forcë, me dorë. Një rrymë e ftohtë ajri vërshoi vërshoi brënda. Perdet vallëzuan, ca fije letre u përhodhën, një libër u rrëxua. Djersët iu thanë. Ai po mërdhihte. U ngrit të mbyllte dritaren. Soditi një çast natyrën e shqetësuar. Iu duk se tufani që shfrynte kishte një farë ngjasimi me gjendjen e tij shpirtërore, se edhe shpirti i tij, që qenkej i fuqishëm, përplasej në jetë i paqetë dhe madhështor si ai. Tështiu. E puthiti dritaren dhe u kthye në shtrat duke u drithur nga të ftohtët. Pas një çike e zuri gjumi.

Në mëngjes, posa u zgjua, i vajti mendja përsëri te Edi. Po shkonte në zyrë i zhytur në mendime, kur pa Edin së largu. Një drithmë i përshkoi trupin. Ajo e kishte mbështjellë kokën me një shall të bardhë, që s'ia mirrte gjithë flokët e zij. Ata i derdheshin me hijeshi në supe. Buzët e puthitura lehtë kishin një formë të bukur me një buzëqeshje pak të trishtuar. Një ngjyrë pak e zbetë në fytyrë e bënte më tërheqëse.

Besniku u magjeps. Iu duk se ajo derdhte dritë për rreth dhe çuditej se këtë

nuk e vinin re kalimtarët. Ai i thirri i tronditur, ashtu si në ëndërr:

- Edi! . .

Ajo qëndroi. Ktheu kokën ngadalë dhe i hodhi vështrimin. Duke e kuptuar se ai do t'i thoshte diçka të rëndësishme, e pyeti ftohtë.

- Ç'është? ! . . .

Djaloshi i foli i përlur me zë të butë:

- Dua t'u them gjithshka që kini lexuar në sytë e mi.

Edi kishte pritur deklaratë dashurie prej tij prej kaq kohësh. Por tani pamja e përlur e tij, zëri që i dridhej, iu dukën pak qesharake. Ajo e soditi ftohtë, fitonjëse.

- Nuk është aspak nevoja që të më ndalosh në rrugë për të thënë diçka që unë e di me kohë dhe ndofta edhe shumë të tjerë.

Këto fjalë të ekullta nuk e sprapsën Besnikun. Iu dukën shtirje. Mbante mend Edin që recitonte "Demonin", që admironte natyrën, që i dukej se kuptonte thellë Shekspirin. Shihte fytyrën e saj që i bëhej se ishte mishërimi i ëndrave të tij. Ai derdhi i tronditur ndjenjat e turbullta që e kishin zgjuar nga gjumi:

- Gjithë njerëzit për rreth kujtojnë se dashurojnë. Dhe unë vetë pandehja se dashuroja. Por tani e di fort mirë se gabohesha. Një ndjenjë qesharake, të përciptë kanë njerëzit për femrën që thonë se e dashurojnë. Një ndjenjë të tillë kam patur edhe unë. Vetëm, pasi u takova me ty, njoha dashurinë e vërtetë. Tani e kuptoj thellë veten dhe ty. Njerëz si ne ka pak në botë. Ata rrallë takohen. Po muk e kuptove këtë tani, jam e sigurtë që do të vijë koha dhe do të bindesh. Ne do të dëshëronim të bënim diçka të madhe, humane, t'u jipnin njerëzve lumturi. Po kjo është e pamundur. Ne të dy nuk ua zhdukim dot vuajtjet. Na mbetet vetëm të dashurohemi marrëzisht.

Edi e dëgjoi me vemendje, e qetë, gjakftohte atë që pretendonte se e njihte thellë. Ajo u kënaq se djaloshi e pëlqente shumë dhe i shprehej me fraza të bukura. Ishte e bindur se Besniku gabohet plotësisht në vlerësimin e saj. E kuptoi se ishte e panevojshme të shoqërohej tani e tutje me të, prandaj, si mbaroi ai, u përgjegj ftohtë:

- Një gjë dua të them që ta kesh shumë të qartë. . Mos kujto se je origjinal. . . Këto fjalë i kam dëgjuar nga shumë të tjerë. Bile ata i kanë recituar edhe më bukur.

Ajo heshti pak e tronditur nga fjalët therëse dhe pastaj shtoi duke dashur ta fyente edhe më shumë:

- Si mund t'u besoj, kur me siguri, para disa muajve, i jini shprehur një tjetre po kështu? !

Besniku duke kuptuar se bëhej fjalë për Jorgjetën, u përgjegj me vendosmëri:

- Kjo nuk është e vërtetë. Asnjë femre nuk i kam thënë fjalë të tilla. Ato për herë të parë lindin në zemrën time. Ju do të bindemi pa tjetër për këtë ndjenjë.

Ajo ia priti shkurt:

- Nuk është nevoja të pres dhe të bindem. Duhet ta dini se unë dashuroj dikë. Nuk ta kam thënë gjer tani, se nuk ka qenë nevoja, por po ta them për të mirën tënde që mos të ushqesh shpresa të kota.

Besniku buzëqeshi.

- Kjo nuk ka rëndësi. Edhe nëqoftëse dashuroni një tjetër, unë do t'u bind të vini me mua.

Në sytë e tij shprehej një ngulmim i verbër që vërtetë e trembi Edin. Ajo mendoi se Besniku mund t'i nxirrte telashe, prandaj domosdo duhej të largohej prej tij. T'i jpte fund asaj shoqërie që kishin patur së bashku, ishte për të aq e thjeshtë, sa kishte qenë dikur edhe njohja spontane. Këto ditë e kishte tjerrur miqësinë me një djalë tjetër, që dinte të kontrollonte veten. Në këto rrethana Besniku sillte pengesa.

- Ju më trembni. Jini vërtetë i rrezikshëm me pasionin tuaj. Por do t'ju kalojë patjetër. . . - I tha ajo duke e zmadhuar rrezikun që të shkëputej sa më shpejt e sa më lehtë. Pastaj duke i thënë të kuptonte se nuk do të rrinte më me të shtoi:

- Më falni se do të blej diçka në Mapo.

- Po ju përcjell. . - I propozoi ai.

Ajo i deklaroi prerë:

- Nuk bëj më asnjë hap me ju. Ju lutem mos më ndaloni më në rrugë. Nuk dua t'u flas. Kjo do të jetë mirë edhe për ju.

Ajo e vështroi djaloshin ftohtë, me krenari dhe i zgjati dorën, sikur po i bënte një nder të pamerituar. Besniku i shtrëngoi dorën me gjallëri, por ajo nuk digjte si dikur. Ishte si dora e një të vdekuri.

Edi i ktheu shpinën triumfonjëse dhe u fut në Mapo, megjithëse nuk kishte për të blerë gjë. Djaloshi mbeti në rrugë i trullësuar. Ku ishte zhdukur Edi e sjellshme, e zjarrtë dhe pse? ! Nga xhamat e vitrinës shikoi se si ajo sorollatej kot më kot nëpër Mapo. E priti dhe kur doli, i vajti pas dhe i thirri:

- Edi!

Ajo qëndroi. Ktheu kokën. Vështroi me habi, krejt ndryshe nga herët e tjera dhe foli

- Ç'kërkoni? ! . . Pse më ndaloni? ! Kush jini? ! . . Nuk ju njoh fare. Ç'kini



me mua? !

Si shqiptoi këto fjalë si aktore, në mënyrë krejt të natyrëshme, vijoi rrugën sikur vërtetë nuk e njihte dhe nuk e kishte parë kurrë.

Mbushej një javë që nuk kishte qenë në zyrë. Megjithatë nuk ndjeu ndonjë gëzim që do të takonte punonjësit e Lidhjes. Kishte kaluar ajo kohë, kur ata i dukeshin kushedi se çfarë dhe ndruhej t'u afrohej. Vetëm për një njeri e kishte marrë malli. Për Hysenin. Si ishin caktuar të dy në punë në Lidhjen e Shkrimtarëve, ata e kishin shtuar shoqërinë. Ishin bërë pothuajse shokë të ngushtë, megjithëse kishin një pikë të dobët. Besniku nuk shprehej me entuziazëm për shumë nga poezitë e tjetrit. Ndërsa Hyseni nuk i kishte lexuar shkrimet e tij, veç tregimit që kishte fituar në konkurs.

Ngjiti shkallët e drujta që kërcitnin mga vjetërsia dhe u gjend në koridor. Dera e seksionit të prozës ishte hapur. Esati, i ulur në tavolinë, po lexonte romanin e tij. Sa e pa Besnikun, e ftoi:

- Po hajde, shoku Besnik!

Fytyra e tij kuqalashë ndriste. U ngrit, i zgjati dorën e butë, e ceku fare pak me të djaloshit, i afroi karriken dhe i foli:

- Po e mbaroj romanin. Të lumtë! Më ke kënaqur. Ky është roman! Në disa vende më ke mallëngjyer shumë. Bile turp të them, një herë mbusha sytë me lot. Me këtë vepër ti çan në letërsi me shpatë të madhe!

Esati nuk gënjente. Përgjithësisht kështu mendonte.

- Ua hodhe ca akademikëve - Shtoi ai në intimitet

Nënkuptohej se e kishte fjalën për Filipin, Andrean, Mihalin.

- Romani yt për mua është më i miri. Disa të shtyrë nga zilija edhe mund të ngrihen kundër, por e vërteta më në fund do të triumfojë.

Besnikun nuk e ngacmuan këto fjalë dhe u shpreh thjeshtë:

- Të them të vërtetën mua nuk më kënaq romani.

Esati u çudit, iu bë qejfi dhe e lavdëroi:

- Kjo është shenjë e mirë. Kjo do të thotë se ke më tepër forca dhe e ke kapërcyer veten. . . Me që qenka kështu, do të tregohem më rigoroz në vërejtje. . . Nesër besoj do ta mbaroj dhe do të bisedojmë.

- Ç'kemi kënde? - Pyeti Besniku për të ndëruar bisedë.

Esati u përgjegj me mërzi:

- Hiç. . . E shtyjmë. . .

Këto fjalë Besnikut nuk i pëlqenin fare. Mendoi se Esati vërtetë e çonte duke

e shtyrë. Përpara se të vinte në Lidhje kishte patur shumë simpati për këtë njeri. Ndonjë tregim ia kishte çmuar dhe e kishin tërhequr bisedat e tij për shkrimtarët klasikë. Por tani i njihje edhe plot të meta. Megjithëse ishte në të dyzetat, kur burri duhej të punonte shumë, ishte ca përtac dhe mirrej shumë me llafe. Shpesh fliste si kompetent për gjëra që s'i njihje mirë. Po ajo që ia ftohtë figurën e tij ishte përçmimi kundër kolegëve. Kur fillonte Esati, nuk mbaronte orë të tëra duke sharë Ismailin, Filipin, Andrean, Telhanë dhe Mihalin. Edhe tani që s'e kishte nuhatur këtë qëndrim të djaloshit, foli:

- U zumë edhe kësaj rradhe me Mihalin. Mëndjemadh. Ka mësuar pesë fjalë në Bashkimin Sovjetik dhe kujton se ç'është. Tani çeshtja e këtyre po bëhet problem vital për zhivillimin e letërsisë. Këta po i pengojnë talentet e reja. Hysenin e kanë shpallur të çmendur. (Ai vetë i pari e kishte hapur këtë fjalë dhe e mbante mend mirë, por nuk i interesonte ta pohonte.) Tani po vjen rradha jote. S'është çudi të ngrihen kundër romanit tënd, prandaj në krye të Lidhjes duhen elementë që i përkrahin me gjithë shpirt të rihtë. Si thua ti? !

- Tamam ashtu - U përgjegj Besniku pa e kuptuar mirë se ku e kishte hallin tjetri.

Esati s'u përmajt dot ç'i ziente brënda dhe tha:

- Si të duket ty? Nuk bëj unë për kryetar? ! Nuk i përkrah unë forcat e reja? ! Si thua ti? !

Kjo dëshirë i kishte zjerë përbrenda dhe nuk kishte guxuar ta shfaqte, por tani ai pati një çast dobësie, pse kujtoi që djaloshi do ta përkrahte plotësisht. Besniku e urrente karrierizmin. Pas këtyre fjalëve ndjeu neveri për bashkëbisedonjësën duke menduar se ai poshfaqte thelbin e karakterit të vet. Me gjithëatë duke patur parasysh vetëm pyetjen: "Nuk i përkrah unë forcat e reja? "U përgjegj:

- Po. . .

Esati i vetëtinë sytë nga gëzimi. Ai kujtoi se kolegu ishte dakort që ai të bëhej kryetar. Duke e vlerësuar si të sunqertë, i tha:

- Neve të treve - (Ishte fjala për atë, Besnikun dhe Hysenin) - na bie një detyrë e rëndë këtu në Lidhje. Ne jemi forca të gjalla dhe mund ta pastrojmë ambientin.

Besniku heshti. Nuk desh t'i thoshte se këto fjalë ishin në kundërshtim me qëllimet e tij. Në këtë kohë në zyrë hyri Telhai. Sytë e tij të zinj ndritën nga një shkëlqim i ftohtë. Ai tha me një farë ironie:

- Mirëseerdhe, Besnik! Esati po na thotë fjalë të mira për romanin. Të uroj! . . Ne dëshërojnë që shokët të shkojnë gjithënjë përpara. . Vazhdoni ju. Mos u

preva bisedën. . . . Sigurisht për romanin po flisnit.

Dhe ai ul në tavolinën përballë.

Besniku doli. Kjo gjë nuk i pëlqeu Telahit. Mendoi se ata të dy e prenë bisedën në mes. Kuptohej se diçka i fshihnin atij. Kohët e fundit nuk e shihte me aq sy të mirë Besnikun. Mendonte se po i rritej mendja nga që po e përkëdhelnin shumë. Nuk i pëlqente as shoqëria e tij e tepërt me Hysenin, ardhjen e të cilit në Lidhje e kishte quajtur një gabim të rëndë. Ai nuk mund të kuptonte se si shokët e Partisë e kishin sjellë aty Hysenin që nuk kishte lënë gjë pa thënë kundër shkrimtarëve dhe kishte fyer vetë institucionin e Lidhjes, fundi i fundit vetë Partinë, duke mos marrë

jesë në diskutimin e veprave të veta.

Në koridor Besniku takoi Ismailin, i cili e përgëzoi menjëherë:

- Po dëgjohen fjalë shumë të mira për romanin tënd. Gëzohem shumë. Te ju të rihtë e kemi shpresën. Brezi ynë ashtu si diti erdhi gjer këtu. Ju do të shkoni më tutje. Kështu do të kemi edhe ne pse të mburremi se i hapën rrugën talenteve të reja, apo jo?

Ismaili, megjithëse nuk e kishte lexuar romanin, ishte gëzuar shumë për fjalët e mira që i vinin. Besonte e shpresonte te Besniku. E donte dhe i pëlqente që ai djalë të ecte përpara. Veç ndjente një brengë për vehte, paditur mirë si e qysh, që nuk po krijonte ndonjë gjë të re. Herë e pengonin punët zyrtare, herë s'i ecte pena dhe kështu, gati gjithëmonë i linte të papërfunduara shkrimet e posafilluara.

Besniku iu bë qejfi nga këto fjalë dhe e falenderoi. Kur hapi derën e zyrës, Hyseni përballë tij ngriti kokën. La penën, u çua më këmbë dhe tha me shaka:

- Ne thamë se humbe me ndonjë vajzë shkodrane se nuk na e mirrte mendja që do të rrije në Shkodër kaq gjatë.

Ata u përqaftuan me mall. Andreas në tryezën aty pranë, nuk i erdhi aq mirë që herën e parë u takua me Hysenin, me që çdo njeri në fillim takohej me kryeredaktorin. Besniku u tok me Andream me një përzemërsi pak të shtirë dhe pastaj u ul në tryezën e punës. Në këtë kohë dera u hap dhe hyri Mihali:

- Mirëseerdhe, shoku Besnik! - Thirri ai sa e pa - Na mori malli. Sidomos pas atyre fjalëve të mira që dëgjuam. Të uroj për romanin singërisht. Në vend që ti të marrësh shembull nga ne që kemi vite këtu, po detyrohemi në të ndjekim ty.

- Oh, vërtetë, harrova. Suksese. Iu shtua kolegjimit të redaksisë edhe një romancier i ri. - Ndërhyri Andrea që mos të mbetej pas.

Nuk e kishte harruar romanin dhe posa hyri Besniku iu kujtua, por as vetë

nuk e kuptonte pse nuk e përgëzoi. Kurse Mihalit i vinte keq që nuk e kishte bërë vetë një roman të tillë për punëtorët, por kjo nuk e ndalonte atë të gëzohej me gjithë shpirt për suksesin e Besnikut.

- Edhe unë kam menduar me kohë të shkruaj një vepër të tillë . - Tha ai  
- Dua t'i vendos ngjarjet në Kënetën e Muzeqesë dhe u kam propozuar shokëve që të shkoj të rri një vit atje.

Ndërsa ata bisedonin, Hyseni dëgjonte i qetë në dukje dhe nuk ndërhynte fare. Askush nuk e dinte se edhe ai e kishte lexuar romanin.

Mihali doli. Andrea po lexonte referatin që do të mbahej për veprën e tij në një mbledhje të afërme. Hyseni vazhdonte të shkruante. Pena e tij rrëshqiste mbi letër. Pjesëm më të madhe të orarit zyrtar ai e përdorte për të shkruar. Tani kishte filluar të shkruante me dëshirë të madhe një poemë gjysmë fantastike, të cilën e kishte ëndërruar vite me rradhë dhe besonte se ajo, jo vetëm do të ishte kryevepra e tij, por do të vlerësohej edhe në literaturën botërore. Këtë kishte menduar ta shkruante qysh në Bashkimin Sovjetik, kur kishte vendosur të bëhej poet i madh.

Por në lidhje me ndryshimin e botëkuptimit të tij kishte ndryshuar edhe përmbajtja e poemës. Ai kishte dashur të shkruante se si një grup njerëzish nën udhëheqjen e heroit kryesor, nisen të kërkojnë tokën e lumtur dhe pas peripecish të shumta e gjenin atë. Në mënyrë fantastike simbolike aty do të përshkruheshin katër sistemet shoqërore sipas përcaktimit marksist: Skllavopronar, feudal, kapitalist dhe socialist. Aty do të tregohej se si skllavi e gjente lumturinë e vet vetëm në socializëm. Forma e jashtme kishte mbetur po ajo, por kishte ndryshuar qëllimi dhe heroi kryesor. Tani pothuajse vetëm heroi kryesor, i pakënaqur nga shoqëria, kërkonte të gjente tokën e lumtur. Bashkonte skllavë e skllavopronar dhe nisej në kërkim.

Pas shumë peripecish arrinte tokën "e lumtur", ku shoqëria ishte organizuar në mënyrë mekanike. Ajo shoqëri në atë çast shkatërrohej. Në thelb aty tregohej se njerëzit më kot kishin shpresuar në socializëm, se socializmi ishte një shoqëri mekanike e destinuar të shkatërrohej. Tani ai po shkruante një skenë, ku gjatë udhëtimit ziheshin skllavë e skllavopronar. Heroi kryesor ngrihej kundër dy palëve. Po ashtu edhe dy palët e urrenin atë. Barka fundosej dhe ai takohej në botën tjetër me të dashurën. Pastaj të dy i shfaqnin edhe një herë dashurinë njeri tjetrit. Hyseni e mbaroi dhe tha:

- Jam i kënaqur. Sot përfundova një skenë të bukur. Po deshe ta lexoj.

- Mirë . . - Tha Besniku me gjysmë zëri.

Hyseni filloi leximin pa u merakosur shumë se ç'përshtypje do t'i bënte

tjetrit. Ishte i bindur se e kishte shkruar shumë bukur. Besniku e dëgjoi me një farë habie. Nuk e zbuloi domethënien e asaj skene dhe nuk i la ndonjë përshtypje. I pëlqeu ca heroi kryesor se dashuronte me zjarr, ashtu si kujtonte se dashuronte edhe ai. Kur mbaroi, Hyseni i tha:

- Mirë. Tani për tani unë nuk të arrij dot. Jam në fazën e parë tënden, në atë të tregimit për kryengritësin shqiptar. Po do të arrij edhe këtë shkallë me dramën time.

Kohët e fundit Besniku po mendonte të shkruante një dramë, ku si material bazë do t'i shërbenin marrëdhëniet e qeverisë shqiptare me ato të Jugosllavisë.

Një hop Hyseni e vështroi Besnikun i heshtur. Një buzëqeshje tallëse shkëlqeu në buzët e tij dhe iu duk tjetri i pështirë pse kishte guxuar të krahasohej me të. Hyseni ishte i bindur se vetë ishte gjeni, kurse Besniku asgjë. Këtë bindje ia kishte përforcuar edhe më tepër leximi i romanit, që ishte shkruar sipas modeleve të veprave të realizmit socialist të letërsisë sovjetike. Këto lloj veprash jo vetëm që i quante antiartistike, por i konsideronte dhe armike të personalitetit të vet, si krijime që kërkonin ta shtypnin, ta zhduknin, prandaj gjatë gjithë leximit kishte ndjerë një neveri dhe rrevoltë tepër të madhe. Por kishte vendosur të mos ia thoshte troç të vërtetën dhe të sillej butë për hir të shoqërisë së tyre dhe e dinte që nuk do të kuptohej. Tani hapi sirtarin, nxori tregimin dhe i tha Besnikut me një farë shpotie:

- Dëgjo!

Dhe ai i lexoi skenën e fundit ku komiti shqiptar vdiste duke qeshur dhe i tha me një farë nervozizmi:

- Dhjetë romane të shkruash ti dhe nuk vlejné sa kjo skenë.

Besnikut i pëlqeu shumë kjo pjesë dhe i kishte pëlqyer edhe më parë. Megjithatë edhe romani i vet nuk nuk i dukej më poshtë, por nuk e kundërshtoi dhe e pyeti:

- E lexove romanin tim?

Hyseni u përgjegj shkurt:

- Po.

Besniku tani e pyeti me një farë ankthi:

- Si t'u duk?

- Nuk është fare i keq - Ia ktheu tjetri pa qejf.

Besniku e kuptoi se shoku nuk po i hapej. Diçka të hidhur po i fshihte.

- Mendimi yt për mua ka rëndësi të madhe. Ti e di. Duhet të më flasësh atë që mendon, qoftë edhe ashpër. Nuk do të prekem, përkundrazi do ta di për nder. Unë jam në kërkim. Dëshëroj të gjej rrugën e artit.

Shoku i foli me ironi:

- Eshhtë më mirë ta kërkosh atë nga Kryesia e Lidhjes. Ato po e presin me entuziazëm romanin tënd.

Besniku i foli me bindje:

- Unë e dua nga ti!

Hyseni e këshilloi me një farë inati:

- Mos të bjen keq dhe pastaj pendohesh.

Besniku u shpreh i patundur, i prerë:

- Jo!

Hyseni qëndronte pak larg. Shtatin e mbante drejt. Fytyra e tij kishte një pamje shumë serioze. Vështronte krenar, bile me përbuzje. Kishte besim të palëkundshëm se do dhej shumë më lart se bashkëbisedonjësi. Buzët e shtrënguara, vështrrimi i mprehtë, qëndrimi i trupit dëshmonin për vendosmëri të palëkundur, të pa mposhtur. Ai futi në sirtar tregimin dhe pyeti:

- Pra ty të pëlqen të them të vërtetën? !

- Atë kërkoj. . - Mërmëriti Besniku këtë herë i shtypur si para një profesori.

Hyseni u skuq. Sytë iu hapën. iu duk më tepër kokërdhoku, ca damarë të kuq nëpër të dhe u derdh gjithë zemrim:

- Nuk vlen asnjë dysh nga shkrimet e këtyre faqe me nder shkrimtarëvr të tjerë. Ti ha në një çanak me Andrean, Filipin, Mihalin, Teklhanë, je shok i tyre i ngushtë. Ju kini shpikur realizmin socialist dhe kujtoni se i zgjidhët gjithë problemet, se arritët kulmin e artit dhe i dhatë fund zhvillimit të mëtejshëm të tij. Ju shiteni si hoxhë të mësuar, sikur dini çdo gjë dhe të tjerët duhet t'u mbjanë në kurriz, t'u binden si shërbëtorë sahan lëpirës. Gaboheni rëndë , zotërij! Letërsia juaj është kartë! Nuk ndryshon asnjë çikë nga klasiçizmi francez. Vetëm se vjen në një kohë më të vonë dhe normalisht ka një vlerë më të pakët. Ashtu si ata ju i kini ndarë herojtë për komedi dhe tragjëdi, i shërbeni interesave të caktuara të një shteti dhe e keni ndrydhur letërsinë.

"Ti të gjithë romanin e ke prodhuar në laboratorin e kokës tënde sipas modeleve pa sukses të kohës. Edhe te ti personazhi kryesor është sekretari i Partisë. Asnjë prej personazheve nuk është marrë nga jeta dhe nuk kishte mundësi të mirrej. Ku i njohe ti punëtorët? ! Mjaftojnë për këtë gjashtë muaj? ! Të gjithë tipat i ke krijuar nga mendja sipas skemave dhe u ke theksuar ato tipare që të kanë pëlqyer ty më shumë. Çdo gjë e ke vendosur me qëllim të caktuar politik duke e përdhunuar jetën nga pikëpamja artistike. Edhe dashurinë e ke futur artificialisht, si piper, për ta bërë më të shijshme. Nuk shoh mes veprës edhe teje asnjë lidhje të vërtetë"

artistike, veç dëshirës për të bërë roman dhe pikëpamjeve politike.

“Ti je pjellë shterpë e kohës, ashtu si edhe të tjerët. Ju mendoni se jini zotër, se i njihni të gjithë njerëzit. Se mjafton të shtrini dorën, ku t’u pëlqejë dhe problemi ka mbaruar. Gaboheni rëndë. Ju nuk njihni akoma veten tuaj. Artisti i flet botës vetëm për atë që njuh thellë, që e ka zbuluar vetë në jetë. Ju kujtoni se me letërsinë tuaj përfaqsoni kohën. Këtë shekull e përfaqsoj unë.”

Ai i ra gjoksit me grusht dhe vijoi:

- Unë jam pishtar në errësirë. Lumë që do të mbys gjithshka që më del para. Vepra ime nuk është anakronike si pëshpërisin disa. Ajo është e lidhur ngushtë me truallin shqiptar. Ata që e ndalojnë, e bëjnë me qëllim. Ky shekull do të përfaqësohet prej meje dhe juve koha do t’ju fshijë pa mëshirë, si plehra!

Nuk kishte se si të fliste ndryshe, në çastin, kur sapo kishte mbaruar skenën, që simbolizonte në fakt shkëputjen e tij prej komunistëve. E interpretonte veten hero mbi klasat duke kërkuar ngushëllim vetëm në dashuri. Nuk kishte se si ta kuptonte ndryshe romanin e Besnikut, kur kishte në mendje të përskruante në mënyrë alegorike botën e re dhe ta vlerësonte krejt ndryshe me atë që predikonte tjetri.

Autori i romanit dëgjonte i shtangur. Për herë të parë në jetë ndeshej me mendime të tilla, të cilat e goditnin pa mëshirë duke i zbuluar drejtimin letrar të kohës dhe shkrimtarët e tij krejt ndryshe nga ç’i kishte besuar gjer tani. Bindja, vendosmëria, vrrulli, dufi me të cilën po e sulmonte shoku e turbulloi, e lëkundti nga themelet. Edhe atë nuk e kënaqnin disa vepra të kohës. I dukeshin të zbeta. Po kurrë nuk mund t’i trajtonte të metat e tyre në atë mënyrë. Duke lënë mënjanë gjykimet rreth letërsisë në përgjithësi, të cilat as nuk mund t’i hidhte poshtë, as nuk mund t’i pranonte, iu duk se shoku e kritikonte me të drejtë romanin e tij, se zbulonte me zotësi shkakun e pakënaqësisë së tij të pavetëdijshme.

Ai mendoi se vërtetë nuk njihnte as vehten, as botën, se i kishte krijuar ngjarjet dhe personazhet kryesisht nga fantazia, se të dhënat që kishte marrë gjatë atyre muajve ishin krejt të pamjafshueshme. E pranoi se romani ishte ndërtuar në bazë të një skeme të përgjithshme dhe nuk kishte origjinalitet. Edhe dashuria aty ishte e vakët dhe nuk ndjehej asnjë fije e atij pasioni të zjarrtë që ushqente për Edin. Po, e kishte parë jetën përciptazi, pa kontradiktat e saj që e mundonin tani dhe nuk e kishte zbuluar botën tamam ashtu si ishte. E kuptonte mirë se ato që kishte shkruar në roman nuk ishin mishi dhe gjaku i vet dhe Besniku që e quante vehten të zgjuar, tani rrinte si një i patidur i turbulluar, për shkak se nuk i kishin shkuar kurrë në mendje këto probleme.

E kishte ëndëruar veprën e tij kaq kohë, kishte shpresuar se ajo do ta mbulonte me lavdi, se do ta trondiste vendin dhe do ta njihte në botën mbarë dhe ja tani shoku e dërmonte, e quante krejt pa vlerë me argumenta të pakundërshtueshme. Atij i theri në zemër se ishin bërë pluhur e hi shpresat më të shtrejtja dhe u ndje i mjerë dhe i dobët.

Hyseni mbaroi. Dridhej i tëri nga emocioni. Priste që tjeri ta kundërshtonte dhe ndofta të prisheshin fare. E vështronte me përbuzje dhe ishte gati ta sulmonte papë me nerva të tendosura, por për çudi të madhe dëgjoi këto fjalë:

- Në përgjithësi jam dakort me ty. Ke gati plotësisht të drejtë përsa i përket romanit tim. Për gjërat e tjera nuk mund të flas tani për tani.

Hyseni që nuk i priste kurrë këto fjalë, mbeti i hutuar. Besniku po i shfaqej krejt ndryshe nga ç'e pandehte. Ishte i pari njeri në jetë që i paraqitej kështu. I iku zemërimi i egër. Ndjente tani një lodhje shumë të madhe. Në këtë kohë u kthye Andrea dhe ata e prenë bisedën.

U takuan pasdite te sahati i madh i qytetit dhe vendosën të bënin një shetitje nga Kisha e Shën Prokopit. Duke u ngjitur lart kodrës e ndjenin se kishin ndryshuar. Miqësia e tyre ishte forcuar. Besniku vërtetë ishte i hidhëruar ca për dështimin e romanit, por gëzohej se kishte kuptuar të metat e krijimtarisë së vet. Tani besonte se i ishte hapur vizioni në rrugën e letërsisë së madhe. Ai e lidhte këtë kthesë edhe me dashurinë për Edin, e cila sipas tij po e ndihmonte për të kuptuar thellë çdo dukuri të jetës.

Lart kodrave ecej me qejf. Mbrëmja ishte e ngrohtë, frynte një filad i lehtë. Gjethet fërfërinin. Natyra ishte e gjelbëruar. Qetësi. Dielli po perëndonte në horizonte me ca re të zeza. Ata morëm poshtë një bregorje të ulët. Ecën nëpër livadh rrzë një përroi të vogël, anës të të cilit ngriheshin druj e pemë. Te këmbët e tyre kishte ferra e lule. Hyseni u përkul, këputi me kujdes ca lule. Formoi një tufë të vogël, u mori erë me kënaqësi dhe pëshpëriti:

- Janë të bukura. Në natyrë se si e ndjen veten njeriu, sidomos në fushë, ku merr frymë lirisht. Qyteti të shtyp me ndërtesat e mëdha, zhurmën dhe hallet.

Ata ecën mjaft kështu duke biseduar për gjëra të thjeshta dhe të këndshme. Pastaj Besniku u interesua për të kaluarën e tij. Hyseni i tregoi me qejf mjaft gjëra nga jeta. I rrëfeu se ishte lidhur me lëvizjen, si ishte hedhur në çetë, si e kishin caktuar komandant batalioni në moshën 18 vjeçare, se si dallohej në qitje të saktë. I përshkroi ca ngjarje të rrezikshme e të rënda gjatë kohës së luftës. Besnikun e preku sjellja e Hysenit ndaj një shoku, të cilin e kishte nxjerë të plagosur nga



rrethimi. Pastaj ai i tha se pas çlirimit e kishin çmobilizuar, se ishte zënë me dy oficerë jugosllavë kapadaj. Përshtypje të jashtzakonshme i bëri atij, kur Hyseni i tregoi se kishite braktisur në vitin e dytë Universitetin e arteve të bukura në Leningrad duke deklaruar se nuk kishte ç'të mësonte nga shkolla sovietike dhe i kishte kërkuar ambasadës shqiptare në Moskë të kthehej menjëherë në Shqipëri. Ky veprim kishte shqetësuar gjer personalitetet më të larta të qeverisë të Bashkimit Sovjetik. Këto rrëfime e ngritën edhe më tepër Hysenin në sytë e Besnikut.

Edhe ai kishte marrë pjesë i vogël në Lëvizje, kishte qenë partizan, kishte qenë i burgosur dhe i internuar, por nuk kishte luftuar në beteja të ashpra, prandaj u ndje inferior ndaj tij. Por Hysenin, pasi i tregoi për pjesmarrjen në luftën për liri, nuk i vajti mendja të mburrej, por ndjeu trishtim në shpirt. Gjithë këto ngjarje kishin lidhje me një tjetër Hysen, ndaj të cilit tani nuk kishte simpati. Ashtu si heroi i poemës së tij ishte shkëputur nga shokët, me të cilët ishte nisur drejt një qëllimi të përbashkët e të lartë dhe e ndjente vehten të huaj ndaj tyre. Gati gati rruga e luftës nacional çlirimtare i dukej pa kuptim dhe pa vlerë. Kujtimi i ngjarjeve të atyre viteve e rëndoi.

Po ktheheshin në qytet. Dielli ishte falur, perëndimi ishte i kuqrremtë, me re të zeza. Qielli po errej. Muzgu afrohej. Hyseni shikoi për rreth me një brengë të thellë në shpirt dhe foli:

- E sheh natyrën, ngjyrat e saj në këtë perëndim? Të tilla nuanca ka edhe vepra ime, një melankoli të përzier me dritë dhe errësirë. Ajo shpreh një shpirt të diziluzionuar plotësisht, ashtu si ka qenë dhe vetë jeta ime. Ndryshe e kujtoja botën dhe qysh nga ëndrrat e fëminisë ajo më ka gënjyer. Atëherë fantazoja gjëra të çuditshme. Të ikja larg në Indi. Të martohesha me gruan më të bukur të botës dhe të jetoja si princërit e pashallarët. . . Pastaj erdhi rinia. . . Atëherë pas një periudhe të zymtë u futëm në luftë me ëndrra të mëdha. Kujtoja se do të ndërtonin një botë të re, të drejtë, ideale. As unë nuk e di se si të them. Kujtoja se po kryenin një vepër heroike, të pavdekshme si revolucionin francez dhe vehtja më ngjante me Dantonin. Por ndryshe e përfytyroja unë revolucionin francez nga ç'thuhet sot. Dhe fundi? ! . . Na thonin se në Bashkimin Sovjetik gjëndeje një botë e lumtur, njerëz të rij që nuk ngjanin me ne, që nuk kishin vese. Besonim se komunizmi do ta ndryshonte gjithë botën, por tani jam tepër plak që të gënjehem. Komunizmi nuk është gjë tjetër veçse një fe, një opium. Bota do të mbesë ashtu si ka qenë gjithmonë, e zhatur në kontradikta, pa rrugëdalje. Njerëzimin nuk e pret një e ardhme e bukur. Kudo që të hedhësh sytë, sheh ëndrra të dështuara, shpresa të gënjyera.

"Vetëm për diçka më vjen mirë, se m'u hoq perdja që kisha vënë në sy, të

cilën e kanë akoma shumica e njerëzve. Kaloi ajo kohe dhe s' do të kthehet kurrë më, kur unë isha vetëm një fanatik qorr. Qysh në vitin 1947 fillova ta ndjej veten të ndrydhur dhe të turbull. Tani shoh qartë gjithshka. Jam po në atë lartësi mendimi që isha në vitin 1938 dhe për këtë jam shumë i kënaqur.

Kështu foli Hyseni dhe i erdhi në mendje koha e shkuar. Iu kujtuan vitet e bukura të feminisë dhe të rinisë në fshat. Atëherë ai ishte djalë i vetëm, i përkëdhelur në një familje të pasur fshatare. Pikërisht këtë kohë quante më të lumtur dhe i dukej se gjithshka e shihte me syrin e saj. Periudha e luftës nacional - çlirimtare i kaloi në imagjinatën e tij si diçka shumë e turbull dhe tronditëse. Nuk i pëlqente ta kujtonte me imtësi se aty kishte diçka në kundërshtim me gjendjen e tanishme shpirtërore. Ai mbante mend mirë kohën pas vitit 1947, kur vërtetë filloi ta mbërthente një angushti si pa shkak. Atëherë ai filloi të ëndërronte të bëhej shkrimtar, ashtu si kishte dashur në vitin 1938.

Besnikun e turbulluan së tepërmi këto fjalë dhe Hyseni u ngrit akoma më lart në sytë e tij, si enigmë, si njeri tepër i zgjuar. Për herë të parë një komunist i thoshte se gjithshka për të cilën kishin luftuar ata, kishte qenë gënjeshtër, gabim fatal dhe kjo i ra si bombë. Nuk mund t'i pranonte këto mendime, por nuk mund të mohonte se diçka prej tyre ishte e vërtetë. Atij iu kujtua se si në kohën e luftës e përfytyronin Bashkimin Sovjetik si një vend gati përrallor dhe ishin të bindur se edhe Shqipëria do të bëhej e tillë. Tani nuk kishte për Bashkimin Sovjetik një mendim aq të lartë dhe jeta shqiptare nuk i dukej ideale.

Atij i bëri përshtypje të madhe dhe i shkaktoi dhëmbje sidomos bindja e Hysenit se komunizmi është fe. Qysh i vogël kishte besuar ashtu turbull se komunizmi ishte ideali i njerëzve, se komunizmi do t'u jipte lumturi të plotë njerëzve dhe tani një shok i luftës, të cilin e nderonte gjithënjë e më tepër, i cili e kishte besuar vetë këtë, i thoshte të kundërtën. Atij i dukej ky vlerësim i komunizmit si zbulim personal i Hysenit dhe nuk e dinte se në përfundim kjo trumbetohej gjysmë shekulli më parë, prandaj, megjithëse nuk e pranoi, pyeti me trishtim:

- Ti mendon vërtetë se komunizmi është fe? !

- Fë puro bile, ashtu si kristianizmi dhe muslimanizmi. Këtë e tregon edhe fakti se ai përhapet atje ku njerëzit akoma mund të turbullohen nga idetë fetare, në vende të prapambetura.

Ishte bërë vonë dhe shokët u ndanë. Hyseni u largua i lehtësuar dhe i kënaqur se më në fund dikush e kishte dëgjuar me vemendje dhe e kishte pranuar. Kurse Besniku u kthye me mendime të trishtuara. Kishte shpresuar gjithmonë se bota në të ardhmen do të ishte më e mirë. Në roman kishte dashur të përshkruante lindjen

e botës së re që do t'i jipte lumturi njerëzimit. Tani Hyseni i kishte thënë të kundërtën dhe ai filloi të mendojë në ishin të vërteta ato fjalë.

Në shtëpi gjeti Shahinin, një fshatar i pakët, mik i vjetër i babait. Para çlirimit shpesh gjatë muajve të verës gjithë familja e Besnikut shkonte në Tushë te Shahini, fshat buzë rrugës Tiranë Durrës. Miku fshatar, që atëherë ishte i pasur, i priste me gjithë të mirat dhe tregonte për ta një bujari që nuk mund të shpërblehej.

Besnikut menjëherë i erdhën në mendje kujtime të bukura që lidheshin me bollëkun e madh dhe u prek shumë nga pamja e jashtme e Shahinit, që kishte ndryshuar shumë. Ai nuk ishte veshur me rroba të reja dhe të pastra, fytyra nuk i shkëlqente nga mirësia dhe gëzimi, ashtu si dikur. Ishte i parruar. Mustaqet e mëdha të varura e tregonin të raskapitur. Brekushet s'i kishte të reja. Xhoka i qe grisur. Çorapet dhe këpucët i qenë ngarkuar me baltë. Qe mplakur shumë, nuk rrefente fuqi dhe shëndet si dikur.

Besniku i foli me gëzim, duke fshehur hidhërimin që i shkaktoi pamja e tij:

- Oh, mirëseerdhe, Shahin! Sa mirë e paske bërë!

Për çudi miku nuk u tregua aq i përzemërt, plot zhurmë e gaz si dikur. Dukej i ftohtë. Sytë e vegjël plot zgjuarsi mezi qeshnin. Si këmbyen ca fjalë të zakonshme, fshatari u ul prapë në minder. Përballë më këmbë qëndronte vëllai i përhumbur në mendime. Shahinit iu zhduk ajo buzëqeshje e sforcuar. Dalë ngadalë u vrejti. I nguli sytë Kadriut dhe e pyeti:

- Domethënë të mos mbaj ndonjë shpresë në ty?

Kadriu u gjet ngushtë. Nuk i pëlqente ta zhgënjente mikun. Por meqë nuk kishte nga t'ia mbante, u përgjegj:

- E kanë ata të fshatit në dorë. Po të bëjnë padrejtësi, ankohu.

Fshatari hodhi gurin e fundit:

- Po ti ke shokë plot. . . filanin mos e bëni kulak se e njoh personalisht, dhe puna ka mbaruar.

*Kadriu kundërshtoi:*

- Nuk mund të përzihem kështu. . . Pastaj ç'është kjo? ! . . Pse nuk hyn në kooperativë, do të të bëjnë kulak? ! Duhet të jetë ndonjë gjë tjetër. . .

Shahini buzëqeshi hidhur:

- Kjo është pak! . . Njërit në mëhallën time i nxorën dy letra dhe i thoshin: "O firmo këtë për kooperativë o firmo këtë tjetren që je armik i pushtetit." Ai i shkreti thoshte: "As këtë, as atë!" "Po ku e leshin ata. Ia nëmojshin me penë në dorë." "Njëren do ta bësh që të plasësh!" "U detyrua i varfri të firmosë atë për kooperativën.

Kadriu u nevríkos ca:

- Kjo nuk është vija e Partisë. Partia e shtron vullnetarisht kooperativizimin. Ma jep emrin e atij që e ka detyruar në atë mënyrë dhe brënda njëzet e katër orëve merren masa kundër tij.

Shahini buzëqeshi këtë herë me djallëzi:

- Emrin ta gjesh vetë! E doli fjala për mua? ! Nuk më lënë rehat kështu pa faj e jo më si spiun.

- Kadriu mori një pamje më të butë dhe nisi nga agjitacioni:

- Mirëpo ti pse nuk hyn në kooperativë? E ke shumë gabim. Kooperativizmi është e vetmja rrugë e përmirësimit të jetës në fshat dhe e përparimit të bujqësisë. Po të bashkoheni, modernizohet bujqësia. Vjen traktori. Shteti ndihmon me kredi. Jipen fara të mira. Bëhen kushedi se sa lehtësira që duhet t'ua kenë spjeguar mirë. Unë kam parë në fotografi fshatin që kini pranë, Lalsin. Ç'përmirësime të mëdha kanë bërë! Shtëpi të reja, veshjen e kanë ndryshuar. Bijtë e tyre po dalin agronomë dhe inxhinierë. Kush i bëri këto? Kooperativizmi. Hyr edhe ti në kooperativë që ta rregullosh jetën edhe më mirë.

Ndërsa Kadriu fliste kështu, një buzëqeshje e hollë endej në fytyrën e Shahinit. Pastaj ai u bë serioz. Përbrënda ziente. Priste me padurim të mirrte fjalën:

- Tamam e ke pa në gazetë. Ashtu duket bukur së jashtmi. Por nga puna me normë ata u bënë të gjithë për doktor. Nuk zgjat më shumë se dy vjet dhe i ke të gjithë te Tartari. Pastaj ata i gjetën gati qetë, vreshtat, binatë e kuajt. Punoi agai për ta dhe ua la trashëgim pa pare.

Kadriu u skuq në fytyrë, fjalët e mikut nuk po i pëlqenin fare.

- Sipas teje kooperativizimi nuk qenka i drejtë? !

Shahini ia priti menjëherë:

- Atë e di Partia e qeveria. Ajo për të mirën tonë e ka.

I zoti i shtëpisë e fajësoi:

- Nëqoftëse ti nuk hyn në kooperativë dhe u flet kështu fshatarëve, kanë të drejtë të të shpallin kulak. Kulaku nuk ka brirë. Kështu si ti mendon dhe vepron.

Miku u pre. Një hije trishtimi mbuloi tiparet e tij. Hëngri buzën e poshtme me dhëmbë. Një zemërim i brëndshëm ngrinte krye. Atij iu kujtua se sa bujar kishte qenë me këtë familje dikur dhe i vinte të çahesj se Kadriu, të cilin e kishte dashur shumë, jo vetëm nuk po e ndihmonte, por po i jipte të drejtë atyre që donin ta cilësonin kulak. Ai kishte besuar se djali i mikut mund ta ndihmonte, por u bind se atij nuk i pëlqente ta përkrahte dhe ndjeu se miqësia e herëshme me këtë familje kishte marrë fund. Djali i madh i ngjante shumë pak të jatit. Si heshti një hop, u përgjegj duke e përmbajtur veten:

- Harrove më duket se ti vetë gjer në dyzet partizanë i ke pru në shtëpinë time. Ta kam shtruar sofrën si bejlerëve edhe më mirë. Nuset e mia i kanë larë, i kanë qep. Mos të ishin ca si ne, nuk vlenin asnjë lek partizanët, se nuk mbahet robi vetëm me bar dhe nuk kalohet dimri vetëm në pyll. Po ne vejshim në zjarr kokat tona e të kalamajve dhe i pritshim partizanët me një mijë të mira. Ata e kishin kollaj. Një pushkë dhe vrap tre sahat larg.

Ma shpejt se gjylja e topit. Gjermani mua më digjte e më piqte. Me shpatullat e kaptinat e njerëzve si unë asht ngrit ky pushtet dhe ti më thue kulak. Sot nuk kam vakt me hy në kooperativë, nesër shohim e bajmë. Po nejse. Çava dërrasa kot dhe ty të dhemb kaptina se je sëmurë. Më fal se të mbajta në kambë. Shko shplodhu se je këput gjithë ditën në zyrë. Edhe kalemi ka lodhjen e vet.

Kadriu, duke e kuptuar se e kishte fyer mikun, e zbuti:

- Eshhtë e vërtetë se e ke ndihmuar luftën, prandaj ti duhet të jesh i pari.

Shahini ia ktheu me ironi e mllef:

- Tashti kam djalin përpara dhe ca zogj pa pupla që e kanë gjet shtruet. S'asht nevoja për mue. . . Nejse shko. . dhe unë po ngrihem.

- Kështu pra. . Të më falësh. Më pëlqente të bënim muhabet se kemi kohë pa u parë, por jam i lodhur. Duhet të pushoj pak që të kem forca për nesër. Kemi disa punë urgjente.

Ata u përshëndetën. Kadriu ngjiti shkallët lart me një peng në zemër. Atij i vinte shumë keq që Shahini nuk donte të hynte në kooperativë dhe nuk mbante qëndrim të mirë si dikur. Dhe ndofta i kishte marrë koka erë dhe kushedi ç'kishte bërë derisa rrezikohej të shpallej kulak. Ishte i bindur se fajin pak a shumë e kishte Shahini, se e çonte në atë rrugë mentaliteti i tij prej fshatari të pasur, pamvarësisht nga e kaluara e mirë. Dëshira e fshatarit që ai të ndërhynte, iu duk e padrejtë dhe e rrezikshme. Bile atij i pëlqeu që Shahini po largohej po atë çast, se nuk ishte aspak e hijshme që një nëpunës i komitetit të Partisë të mbante për darkë një që ndofta nesër do të shpallej kulak. Ai e kishte shumë të qartë se në këto kondita nuk mbetej as lidhja më e vogël mes familjeve të tyre.

Shahini i foli Sanijes:

- Unë s'po ulem më. . .

- Qyqja? ! Pse? ! . - U çudit ajo.

Besniku e kundërshtoi:

- Ku do të vesh tani? !

- Po gjeta makinë, kthehem në shtëpi. Po nuk pata fat, futem në ndonjë hotel. Shyqyr shteti ka hapur hotele plot.

Besniku e kapi për dore dhe i tha me qortim:

- Më vjen shumë keq që flet kështu. Sonte do të flesh këtu.

Miku nguli këmbë në të tijën:

- Jo, jo. Po iki.

Nënë e bir iu sulën:

- Nuk të lëmë kurrë!

Fshatari i tha me të tallur Besnikut:

- Vëllait yt është i zgjuet. I dhëmb koka dhe ra me fletë. E zamë se sonde më kanë shpallë kulak mue si do ta bash ti? ! Do të hapet fjala se ka fletë kulaku në shtëpinë tande. Të piu e zeza, mor i mjerë. Kulakët kanë me vete murtajën.

Besniku i foli i qetë dhe sinqerisht:

- Ajo puna e kulakut është tjetër. Ti ke ardhur sonde, rri.

Ishte i bindur se qëndrimi i tij ishte mirësjellja më e zakonshme. Me vete e dënoi vëllanë që i foli aq ftohtë mikut, që jo vetëm nuk e ftoi për darkë, por edhe e fy duke shkuar të flerë. Ky qëndrim i vëllait ndaj njerëzve shpjegonte ca edhe ftohtësinë mes tyre këto kohët e fundit.

Fshatarit iu mbush mendja se e lutnin me zemër dhe qëndroi. Si heshti një copë herë, ai iu drejtua Sanijes:

- Halli i madh më ka gjetur me djalin tim. Më thoshte mbramë: "Po nuk hyre në kooperativë, unë do të marr pjesën dhe do të ndahem, se nuk e duroj titullin e kulakut." E vështrova e vështrova kështu kopilin nja pesë dekika. M'u turbullue mendja. Më vinte të merrja sëpatën dhe dang në dysh ta çaja aty në vend.

"Partia, Partia! Mirë xhanëm nuk kam ndonjë kundërshtim me Partinë, por unë e rrita atë kodosh dhe jo Partia. E bana njëzet e kusur vjeç me djersën time, me këta krahët e mij. E martova dhe i jam përgjegjë deri në pikën e fundit. Tashti kërkon pjesëm që të ndahet. Teveqeli! E ka bosh fare.

"Eh, si erdhët kohët Sanije. S' do fëmija babën e baba fëmijën. Socializëm tamam ma. Këta thonë bashkoi me gjithë katundin dhe jetoni si vëllazën. Ishalla ban zoti diçka se kështu nuk i dilet.

Fshatari psherëtiu thellë, ndezi duhan dhe e thithi me duf.

Emë e bir u ngrysen. Dhëmbja e plakut i preku. Pas një copë here Besniku pyeti:

- Si është puna? ! Me zorr duan t'u fusin në kooperativë? !

Miku shpjegoi:

- Jo, ore me zorr. Këta të vrasin me pambuk. Larg e larg më kanë çue fjalë: Po s'u bane kooperativë, do të shpallim kulak. Unë jam i moshue. Vjet dolëm si hollë,

një martesë do ta baj. Kurse po hyne në kooperativë, i lave duert. Unë çoj dy pendë qe sa një bina, tjetri asnji bisht sqepari. Po ne jse. E lemë këtë. A hec puna mbarë, kur shohim njeri tjetrin shtrembër? !

“Po e shohim edhe në disa kooperativa të tjera. Unë i ngas qetë mirë, mbjell me kujdes, prashis bukur, korr pa firo, tjetri i dhet një mut punës. Bëhet bujqësia kështu? ! Koooperativë. . . Edhe unë nuk kam pse mos ta due koooperativën, por gjithsekushi të punojë pa hile, ma mirë se në tokën e vet. Se si imdivid, damton vetëm veten, kurse në kooperativë merr në qafë kalamajtë e katundit. Të bashkohen të gjithë, t’i venë gjoksin punës, të shikohet e drejta në fijet të flokut, atëherë bereqetin nuk ke, ku ta shtish se plasin depot. Po duhen njerëz. Pikësëpari udhëheqja. Po të jenë si Kadriu që ta peshojë të drejtën e përbashkët në katandar farmacisti, atëherë po. Kryetarët e kooperativave andej kush e kush për vehte dhe s’ dinë me lidh gomarin. Po ai s’ka qenë i zoti të rregullojë shtëpinë e vet, do të drejtojë katundin. Lere më. . Mjerë ne ç’na gjeti. . . .

Ai psherëtiu përsëri. Hoqi duhan thellë dhe heshti një copë herë.

- A ka njerëz që hyjnë në kooperativë me dëshirë? - E theu heshtjen Besniku.

- Po. Ata që s’kanë sahan në shtëpi. E mban mend kasollen e keqe para shullanit? Djali i zotit të asaj, një qyrrec. Vinte me luejtë me kalamajtë tonë. Ai e don me gjithë mend kooperativën, se helbete, shpreson të bahet kryetar. Sa herë i kam shpëtue prej urisë ata. Tek unë vijshin e merrshin borxhë qaset e misrit. Prej shtëpive të mira vetëm ajo e sekretarit të Partisë e ka dhanë fjalën me zemër, të tjerat, si unë, **përpiqen si pulë e therme.**

- **Po ata të Lalsit, vërtetë, si e çojnë në kooperativë? !**

- Jo ore, jo aq keq. - U përgjegj Shahini tani që nuk ishte me inat - Po ata i ka ndihmue shumë qeveria. E kanë kap veten dhe kanë organizim të mirë. Ne s’bahemi kurrë si ata. Jemi katund i keq.

Kaq foli për Lalsin, por në të vërtetë i dinte punët shumë më thellë. E mbante mend mirë se shumica e fshatarëve të Lalsit s’e bënë bukën e vitit dhe mirmin kot më kot me harar në kurriz. Kurse tani kooperativa ndihmonte edhe ndonjë individ që s’i dilte bereqeti. Pastaj edhe ai vetë çuditej se si kishte ndryshuar pamja e Lalsit. Më parë një pjesë e mirë e katundit banonin mos më keq, kurse tani kishin bërë shtëpi të reja. Por sonte ai nuk donte ta kuptonte kështu të vërtetën dhe aq më pak ta thoshte. Ai mendoi prapë për kohën, për të cilën i foli me aq duf Kadriut, kohën kur i ndihmonte partizanët, kur i donte ata dhe i dukeshin shumë të drejtë dhe të mirë. Tani ata komunistë donin t’ia mirmin tokën dhe megjithëse për persona të veçantë udhëheqës ruante akoma dashurinë dhe nderimin e parë, ai ndjeu një

armiqësi të përgjithshme kundra komunistëve. Iu duk se ata e kishin gënjyer keq dhe tha:

- Po të zgjuet sa s' u gjendet shoku. Vijshin në luftë në byth të qarrit dhe s' e merrshin një kokërr rrush. Nji xhanëm, sa për ta kërkue. Jo! Bajshim çudë ne e thoshim :Njerëz si këta nuk kemi pa, sikur me qenë pejgamerë! Po dardha e paska pasë bishtin mbrapa. E paskan dasht rrushin me gjithë qarr! Me gjithë rranjë!  
- Ai qeshi si me hidhërim dhe shtoi - Do të hamë me lugë florini, do të hamë të gjithë njësoj! Njëpër vetura nuk do të hipë kush! Bubur vallahi! Po ju s' jini keq xhanëm. Me triska vërtetë, po mashallah. Shtëpija juej s' ka qenë ndonjëherë ma mirë. . . Po unë. . .

Besniku e njihte fshatin pas çlirimit vetëm nga gazetatat. Fjalët e Shahinit e goditën keq. Ai ndjeu dishka të përbashkët mes Hysenit dhe Shahinit. Që të dy e turbulluan. Ai e pyeti pastaj për fshatin si e mbante mend para çlirimit. Por fshatari i tha se nuk ishte më fshati i parë, se njerëzit ishin mbushur me halle. Besniku mbante mend në Tushë vetëm shtëpinë e Shahinit plot bollëk. Kujtimet e tij atje ishin lidhur vetëm me begati, hare dhe çapkënlleqe. S' e kishte njohur kurrë jetën e fshatarëve të varfër, prandaj gati e besoi plotësisht mikun. I mori ankesat e mikut si pakënaqësi të përgjithshme të fshatarëve.

Vonë ranë të flenë.

Në shtrat Besniku mendoi plot trishtim dhe i lodhur për ngjarjet e asaj dite.

Në mëmgjez kishte hequr dorë nga romani që kishte ëndërruar një vit të tërë. Nga ky fakt rënkoi si i plagosur. Pasdite Hyseni i kishte folur për gjëra të çuditshme, që vërtet nuk mund t' i pranonte, por që e turbullonin dhe e shtinin në mendime të thella, të trishtuara. Në darkë Shahini i kishte qarë hallet e veta dhe të fshatit. Të gjitha këto atë e brengosnin shumë. Kishte besuar te komunizmi, kurse tani faktet kontradiktore i vërtitëshin në kokë.

Papritur e pushtoi mendimi për Edin. Iu kujtua çfarë kishte ndodhur mes tyre dhe prapë rënkoi. I tingëlluan në vesh fjalët e saj, por nuk ia pakësuan ndjenjat e dashurisë. Përkundrazi ia nxitën edhe më tepër.

Edhe Shahinin që flinte në dhomën tjetër, nuk e zinte gjumi. Një kohë të gjatë e pati mendjen te fshati. Do t' i kishin ardhur vallë prapë të dërguarit e Partisë për t' i bërë agjitacion që ta futnin në kooperativë? ! Hamendjet e tija nuk ishin të kota. Po atë natë i kishte trokitur në derë një gjeneral, i cili i kishte ngrënë bukë shpesh në luftë e pas çlirimit. Të nesërmen do t' i vinte përsëri. Ajo natë do të ishte përpëlitja e fundit e tij. Të nesërmen mbrëma i zënë ngushtë nga gjenerali, Shahini do ta jipte fjalën për të hyrë vullnetarisht në kooperativë dhe djali i tij do të caktohej nën kryetar i saj.



## VI.

Në klub kishin ardhur mjaft shkrimtarë, gazetarë, letrarë të rij dhe amatorë të tjerë të letërsisë. Në sallë hyri Skënderi. E tërhoqi Besnikun mënjanë dhe e përgëzoi për romanin. Besniku e dëgjoi ftohtë. Skënderi nuk e dinte mirë se si ishte çeshtja, prandaj e interpretoi këtë ftohtësi si vrrull forcash krijuese. Ato ditë ai vetë po shkruante një poemë të re “komunizmi” dhe i dukej sikur po e kapërcente vehten, se po shkruante një vepër shumë të mirë. I lidhi dëshirat e Besnikut me poemën e tij dhe iu ndez fantazia. U largua ca dhe duke i ngritur duart si e kishte zakon, tamam si ndonjë dirigjent orkestre, foli me zjarr:

- Përkëdheli, rriti shpresat, ëndrrat e tua, ashtu si nëna e mirë foshnjën e bukur si yll, të shtrejtë si sytë e shpirti. - Ai heshti një copë herë dhe pastaj vijoi i frymëzuar - Po. . . Komunizmi është ai që na ushqen ëndrrat e dëshirat e mëdha! Komunizmi fjalë që ngre peshë miliona njerëz! Ç’do të ishim ne pa të? !

Ai uli kokën, buzëqeshi hidhur dhe psherëtiu:

- Hiç. . . Asgjë: Pluhur këpuce! . . . Po me këtë fjalë? Gjithshka! - Ai i ngriti prapë duart e zërin dhe vijoi - Ne jemi shqiponjat lart në qiell, që fluturojmë krenare! Krijues të jetës së re, të shkollave, të uzinave, të aeroplaneve, të tankeve, jo për kapitalistët, por për veten tonë. Çlirimtarë të botës, nuzëqeshja e jetës, ja ç’jemi ne me këtë fjalë! Jemi edhe krijuesit e artit, e veprave të mëdha!

Ai uli zërin, u bë më pak madhështor dhe vijoi e duke shënuar me gisht:

- Unë i nderoj ëndrrat e tua, i justifikoj ato. Nuk të kritikoj si disa të tjerë meskinë. E kam thënë me kohë. Kushedi se sa Shekspirë kanë vdekur me krrabë në dorë duke kullotur bagëtinë dhe duke i fryrë fyllit plot magji. Shpirtin e tyre të madh askush nuk e ka kuptuar.

Ai buzëqeshi pësëri hidhur duke shprehur kështu keqardhjen për Shekspirët e humbur.

Besniku i dëgjoi gati me mërzi këto fjalë. Iu dukën mjaft qesharake dhe nuk solli në mendje se edhe vetë ndizej më parë nga të tilla mendime. Nuk e kundërshtoi shokun se iu duk e kotë, se ai nuk kuptonte pse ishte i trashë dhe primitiv. Skënderi ndërroi bisedë befas.

- Pa shih, pa shih se kush na vjen.

Në sallë po hynte i ndrojtur një djalë i ri, me pantallona të shkurtëra, që posa

i kishte mbushur të pesëmbëdhjetë vjetët. Besniku e vështroi me ftohtësi.

- E njeh? ! - Pyeti Skënderi

- Jo. . - U përgjegj me indiferencë Besniku.

Djaloshi ishte afruar tani pranë tyre dhe Skënderi e prezantoi:

- Ky çunak na qenka Hamiti! . . . Edhe unë dje e njoha!

Besniku kishte botuar me kënaqësi të madhe vjershat e tij që ai i dërgonte nga qyteti mesjetar i Beratit, por nuk ia mirrte kurrë mendja që vërtetë ai "çunak" mund të ishte autori i poezive që e habiste me vargun plot muzikalitet, mbushur me ndjenja të holla e delikate, me origjinalitetin e kapjes të temave.

- Hamiti ky? ! Kaq i ri? ! - Shpërthyen me entuziazëm plot çudi këto pyetje.

Poeti i ri u bë flak i kuq dhe drita e shkëlqyer e syve të tij u turbullua. Duart e njoma e të holla, delikate, të lëshuara drejt gjunjëve nuk lëviznin fare, sikur i trembeshin ndonjë gabimi. Besniku e afroi në krahëror dhe e shtrëngoi me ngrohtësi.

Poeti i ri buzëqeshi i hutuar.

Në këtë kohë në sallë hyri edhe Hyseni me një pamje të qetë si e kishte rrallë në ambiente të tilla. Ardhja e tij bëri mjaft përshtypje. Shumë kthyen kokën të çuditur.

Esati që në këtë kohë po tregonte episoda nga kompozitorë italianë dhe po shkrihej gazit, sa e pa, iu pre qejfi, shpejtoi të mbaronte ç'ka kishte për të thënë se mos i dëgjonte ai. Nuk mund të harronte se qysh në takimin e parë e kishte thumbuar hollë. Hyseni, duke e kuptuar se do të mirëpritej në atë grup, u drejtua atje. Ndjeu diçka shterpë në marrëdhëniet e Esatit me të rijtë dhe foli me buzë në gaz, gjoja si pa të keq:

- Qenkeni mbledhur si zogjtë rreth kllोकës.

Esati luajti vendit dhe i dha dorën me nderim sa të rijtë u habitën. Atij iu zhduk ajo pamje madhështore prej mësuesi dhe bëri sikur nuk e kuptoi fare thumbin e hidhur.

Salla sikur u gjallërua me ardhjen e tij. Ishte futur mes tyre një element i jashtëzakonshëm, i çuditshëm dhe ndofta fare i huaj.

Para dy javësh Hyseni, i shtyrë edhe nga Esati dhe Besniku, kishte dorëzuar një vëllim me vjersha që të diskutoheshin nga nëpunësit e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të pregatiteshin për botim. Andrea që ishte caktuar si referues dhe kishte filluar t'i lexonte, por përpiquej të mos binte në sy që nuk po i pëlqenin. Edhe tani e përshëndeti Hysenin me shumë përzemërsi. Andrea e kishte ftuar atë personalisht në këtë mbledhje dhe ai kishte ardhur vetëm për mirësjellje për shkak të referatit

që po pregatiste rreth vjershave të tij.

Hyseni bëri sikur nuk e pa Hamitin, të cilin e njihte dhe nuk i dha pikë rëndësie.

Të gjithë u ulën. Mbledhja po fillonte.

Telhai u ngrit plot seriozitet, u afrua në podium, nxori letrat, qëroi fytin dhe filloi:

- Unë do të referoj sot për veprën e Andreas, i cili është pa dyshim një nga talentet më frytdhënëse. Veprimtaria e tij ka marrë një hov të dukshëm kohët e fundit dhe nuk kishte se si të ndodhte ndryshe. Andrea, si u pasurua me kulturë të gjërë dhe të shëndoshë në Bashkimin Sovjetik, u kthye në Atdhe për të zhvilluar një krijimtari të gjithëanëshme. Ka shkruar poezi, novela, drama. Ka reflektuar jetën fshatare dhe qytetare. Mbi të gjitha ka skalitur relativisht mirë figurën e punëtorit, tipa pozitivë, njeriun e ri, ndërtues të Shqipërisë së re. Të shkruarit në të gjitha gjinitë, përhapja në ambiente të ndryshme ka anën e vet të mirë, por edhe vështirësi të mëdha. Fatkeqsisht talenti i shkrimtarit tonë nuk është pjekur gjer në atë shkallë sa të manevrojë lirisht në fusha kaq të gjëra të jetës dhe pa dyshim ndonjë veprë edhe ka dështuar. Më poshtë unë do të flas hollësisht dhe hapur për të metat. Po një gjë është fakt i padiskutueshëm: Andrea është sot një nga përfaqësuesit më të denjë të letërsisë së re, personazhet pozitivë, sidomos punëtorët, zënë një vend të dukshëm në letërsi dhe lozin rol të madh në edukimin e masave punonjëse me frymën e Partisë!

Si bëri një hyrje të tillë, ai analizoi novelën :”Dorëzimi i Bereqetit”, Poemën “Endësja”, dramën “Kurthi” dhe një shumicë vjershash, ku i këndohej Partisë, punëtorit, fshatarit, paqës. Në disa vjersha autori derdhte përshtypjet nga koha e luftës. Andrea i kishte krijuar shumicën e këtyre veprave pothuajse ashtu si Besniku romanin e tij duke u bazuar në disa vizita, biseda, informata dhe kishte qenë fare i sigurtë se veprat e tij do të mirëpriteshin.

Besnikut nuk po i pëlqente referati, por nuk ishte në gjendje të kuptonte psenë. Hyseni që rrinte pranë tij dukej se dëgjonte i qetë, por kjo nuk ishte e vërtetë. Ai ishte i bindur se veprat e Andreas ishin kartë, jasht artit dhe i dukej e neveritshme përprjekja e autorit për t’u treguar gjoja i thjeshtë në kohën kur vlerësohej tamam si një artist i vërtetë. U inatos se i dukej që referuesi përralliste me kompetenca të jashtëzakonshme, thua se ishte krim të dyshoje në vërtetësinë e mendimeve të tij. Iu dukën boshe dhe antiartistike mendimet e referuesit për realizmin socialist, për influencën e letërsisë sovjetike, për rolin gjoja edukativ që na luajtka vepra e Andreas. Atij iu kujtua se Telhai po me këtë mëndjemadhësi kishte hedhur poshtë

veprën e tij që, ndonëse e papjekur, kishte bindje se kishte vlera më të mëdha se sa ajo e Andreas. Dhe këta pjesmarrës në këtë mbledhje po ashtu si duartrokisnin autorin që ngrihej sot në qiell, kishin aprovuar poshtërimin e tij.

Hysenit i lëvizi një nerv nga nervoziteti. Ai papritur mendoi se kishte gabuar që e kishte dorëzuar vëllimin. Parandjeu se po me këto argumenta që shtronte referuesi në favor të Andreas, duke u nisur plotësisht nga pozita politike, do t'ia hidhnin poshtë veprën e tij. Ju neverit gjithshka që dëgjonte dhe ata që rrinin aty dhe dëgjonin gojëhapur. Humori iu prish. Në shpirt iu ngjall një ndenjë trishtimi. E shtypte dhe ia mirrte frymën hija e rëndë e atyre që rrinin në presidium.

Mbas një ore referati mbaroi. Telhai me një pamje shumë serioze, sikur nuk i peshonte duartrokijtjet, u kthye në vend. Besonte se të pranishmit ia kishin çmuar mençurinë e fjalës dhe kjo e kënaqte. Por thellë në shpirt kishte edhe një farë pakënasie. Mendonte se vjershat e tij vlenin më tepër nga ato të Andreas dhe të tjerët, me të padrejtë, nuk e vinin këtë në dukje. Heshtja e vet për këtë gjë i dukej shpirtmadhësi.

Hyseni u ngrit i mërziur dhe foli:

- Unë po shkoj.
- Pse? ! - Pyeti Besniku.

- Mjaft më! - Ai vuri dorën te hunda dhe shtoi - Gjer këtu më ka ardhur. Paraqet mirë klasën punëtore dhe fshatare. . . . Ai nuk di ç'ërë mbajnë punëtorët. I vjen turp ta shohë e fejuara me ta në bulevard. Po fshatin e sotëm? E ka parë me dylbi nga Moska dhe na e paraqiska realisht. Profka! Dhe shteti lejon dhe financon mbledhje të tilla, ku mediokrët mburrin njëri tjetrin. Të vjen të plasësh.

Ata po zbrisnin shkallët, kur dikush erdhi nga prapa dhe u hyri në mes duke u futur duart në bel. Ishte Esati që rrëfente kështu afërsi ndaj tyre. Në fytyrën e tij shprehej një buzëqeshje lodhjeje e pasigurie. Ai i shtyri mënjanë dhe u foli me zë të ulët:

- Hë, shokë shkrimtarë, ç'bëni? ! Shkrimtarë të vërtetë dhe jo si ky që po e fryjnë me pompë aq shumë, sa ka rrezik të bëjë pof si ajo bretkoca që desh të trashet sa një ka. . . Hi . . . Hi . . . Hi . . - Qeshi ai me zë të ulët, me frikë - E patë Andrian si kapardisej? ! Na grifet. . - E preu fjalën se dikush po vinte.

Pranë tyre kaloi Filipi. Hyseni e Besniku i shkëlën syrin njëri tjetrit me djallëzi duke shprehur kështu përbuzje për frikën e Esatit. Ai që nuk kuptoi gjë, heshti një hop sa kaloi rreziku. Ktheu kokën se mos vinte ndonjë tjetër dhe vijoi:

- Na grifet si gjeli në pleh! . . Tek unë i ka marrë mësimet dhe tani kujton se ç'është! M. . është, me nder jush. . .

Esati ndjente një urrejtje gati fizike. Kishin qëndruar jashtë porte dhe po bisedonin, kur njerëzit po ktheheshin në seancën e dytë të mbledhjes. Esati u tha:

- Hajde të futemi. . .

Hyseni kundërshtoi:

- Unë për vehten time do të iki, ju futuni brëndë në atë grazhd.

- Ti shko, unë po e përcjell pak. . . - Foli Besniku.

Esati i pakënaqur u tha:

- E po mirë, ju shkoni. Jeni të rij dhe mungesa juaj nuk bën përshtypje. Unë po kthehem.

Nxitimi i Esatit, krejt figura e tij në ato çaste ishte pak qesharake, prandaj dy shokët buzëqeshën.

- Mos u gabo me të. Është shok i tyre. Flet keq nga nakari - Tha Hyseni.

Besniku u kthye në mbledhje pas një gjysmë ore. Në çastin kur hyri në sallë, Skënderi sipas zakonit të vet, po fliste me duar e këmbë. Ai qëndroi në hyrje dhe dëgjoji me vemendje.

- Referuesi e bëri Andrean - Skënderi pushoi pak, sikur u mendua që të gjente fjalën e përshtashme - gati profit. Kurse diskutuesi i mëparshëm i vuri atij dhe kurorën e shenjtë, të tillë siç e mbajnë profetët në pikturat gjeniale të piktorëve të rilindjes europiane.

Salla e humbi pamjen solemne. U gjallërua. U bë zhurmë sa oratori u detyrua të heshtë. Ca u skandalizuan, protestuan. Të tjerë qeshën, u tallën me diskutonjësën duke e quajtur të pagdhundur fare. Ndonjërit iu duk interesant, iu bë qejfi dhe priste çdo të thuhej më tej. Skënderi sikur nuk e vinte fare re ilaritetin që ngjallën fjalët e tij. Priti sa u vendos qetësia, u kthye nga Andrea, shënoi me gisht dhe tha:

- Nuk shihni gjë ju? ! . . . Si është e mundur? ! . . . Unë shoh kurorën, lëshon rreze të arta!

Filipi që drejtonte mbledhjen, e dëgjoji Skënderin me seriozitet. Në një farë mënyre iu bë qejfi që një nga diskutuesit më në fund, nuk po i thurte lavde Andreas. Ai e çmonte veprën e kolegut për temën e re që sillte, por ishte i pakënaqur nga forma artistike dhe nuk i pëlqente që kjo gjë nuk po vihej në dukje. S'i vinte mirë edhe pse poezitë e Andreas po vlerësoheshin më shumë nga të tjerat. Dëshëronte të fshikullohej pak Andrea edhe pse kishte vënë re që ai mbahej me të madh, me që kishte studjuar në Bashkimin Sovjetik. Por nga ana tjetër ai nuk mund të pranonte që Skënderi të sillej arrogant në mbledhje duke i fyer të gjithë, prandaj u ngrit dhe e ndërpreu:

- Shoku Skënder, diskuto në mënyrë serioze. E dimë se poetëve u pëlqejnë

figurat, por të gjitha duhen me karar dhe me vend.

Skënderi pranoi me kokë sikur të ishte plotësisht dakort me kritikën e tij dhe vijoi në të veten:

- Një fjalë e moçme thotë: "Gjella me kripë, kripa me karar". Ç'mbetet të themi atëherë për Migjenin? Këtë kolos të letërsisë shqipe, kur e ngremë në qiell Andrean? ! . . Fjalët e lëvdatat u mbaruan, shumicën i mbaroi shoku referues, të tjerat diskutuesit, atëherë të çpikim të tjera? ! . . . Kini pak durim dhe unë do të vertetoj se shumë vepra të Andreas kanë të meta të mëdha dhe disa prej tyre janë byk, bile byk shumë i keq.

Në sallë përshpëritën me tallje.

- Të shohim një herë. .
- Kritik, s'i thonë shaka!
- Flet si Belinski me figura!

Skënderi, pa i marrë parasysh kundërshtimet e tyre, filloi kritikën. Gjykimet e tij nuk të bidnin, nuk kishin forcë argumentuese dhe nganjëherë ia bëhej qesharak duke thënë gjëra të paqarta. Me instiktin e vërtetë prej poeti e kuptonte artificialitetin e shumë skenave, por i mungonte zotësia e kritikut dhe mbi të gjitha auditori nuk ishte përgatitur për ta dëgjuar dhe pranuar. Të pranishmit u mërzhitën dhe kërkonin t'i pritej fjala. Besniku, megjithëse e shihte që Skënderi u bë pak qesharak, u kënaq nga diskutimi i tij.

Pas Skënderit u ngrit Esati me një pamje prej akademiku. Zuri vend plot seriozitet dhe tha:

- Skënderi vërtetë e teproi me mënyrën e të diskutuarit të tij dhe gjer në një farë pike i ekzagjeroi të metat. Por edhe unë nuk jam dakort me disa diskutonjës, që nuk panë asnjë rresht të autorit me sy kritik. Një qëndrim i tillë vetëm e dëmton Andrean, e bën të numërojë në vend, kurse ne dëshirojmë të lexojmë prej tij vepra shumë më të bukura. Për të mirat u fol këtu mjaft. Dua të shtoj diçka për të metat, pse pikërisht aty duhet të përqëndrohemi që t'i ndreqim.

Dhe ai diskutoi për një farë cektësie psikologjike të personazheve. Kritika e tij i dogji Andreas sa u skuq, kurse dëgjuesve u pëlqeu dhe iu duk e pjekur. Vetëm Besniku ndjeu një fare neveritje për Esatin, pse ai u kishte thënë fjalë të tjera për Andran.

Filipi u kthye nga Ismaili dhe e pyeti me shenja në dëshëronte të fliste. Ismaili mohoi me lëvizjen e kokës. Në sytë e tij mezi mund të dalloje një hije trishtimi, të cilën mendohej ta fshihte në një skaj të shpirtit. Ismaili e ndjeu veten hiç gjë në këtë mbledhje dhe i erdhi keq. Askush nuk e përmendi as atë, as veprën e tij

dhe ai vuri re se nuk e çmonin, se autoriteti i tij edhe si kryetar po binte dita ditës.

Me kaq mbledhja mori fund.

Besniku u drejtua në shtëpi i zhytur në vete. Në kokën e tij bëhej luftë mes mendimeve që ishin shprehur në favor të Andreas dhe fjalëve të ashpra të Hysenit. Krahasonte faktet, përpiquej të gjente të vërtetën dhe më në fund tha: "Po e gjithë kjo mbledhje ishte një gënjeshtëri. Hyseni ka plotësisht të drejtë. Andrea nuk i njeh as punëtorët, as fshatarët. Veprat e tij janë kartë!" "Iu kujtuan anët më të dobta të romanit të Risto Pasit, poezitë e Telhait, disa poezi të dobta të Filipit dhe përfundoi: "E gjithë letërsia e kohës është e tillë. S'ka asnjë vlefë, ashtu si edhe romani im!" "Në mënyrë të turbull mendonte se letërsia që do të krijonte tani e tutje vetë do të ishte e ndryshme si nga idealet që do të mëshironte, ashtu edhe nga disa parime estetike. Kishte bindje se këtë letërsi do ta fillonte me dramën rreth ngjarjeve shqiptare - jugosllave.

Tingujt funebër përhapeshin në gjithë qytetin. Spikëri i radios me një ton tragjik lajmëronte vdekjen e Josif Visarionoviç Stalinit. Banorët e Tiranës kalonin nëpër rrugët të përzishëm. Askush nuk fliste me zë të lartë dhe të gëzuar. Edhe Besniku hyri i trishtuar në ndërtesën e Lidhjes. Hapi derëm e zyrës dhe e gjeti Hysenin të menduar. Ai po shkruante një vjershë. Nuk e trazoi shokun. U ul i heshtur në tavolinën e punës. Pas pak shoku ngriti kokën e tha:

- Më duket se e kam arritur. . Dëgjo! . .

Dhe ai lexoi një vjershë dhëmbje për vdekjen e Josif Visarionoviç Stalinit. Atë ditë vdekja e Udhëheqësit të Bashkimit Sovjetik e kishte tronditur edhe Hysenin. Urrejtja e poetit ndaj socializmit dhe gjithshkaje që lidhej me të sikur ishte fashitur krejt dhe shpirtin e tij e kishte pushtuar nostalgjia e kohës kur besonte te komunizmi, te Bashkimi Sovjetik dhe Stalini. Gjurmët e saj akoma nuk ishin shuar plotësisht.

Besniku e pëlqeu poezinë dhe i tha që ta shpinin për botim. Ata të dy u nisën në redaksinë e "Zërit të Popullit". U ngjiten lart në katin e dytë të ndërtesës dhe trokitën në zyrën e kryeredaktorit, të Aliut. E gjetëm në tavolinë me një ndjenjë dëshpërimi të thellë, me sy të përlostur. Besniku i zgjati poezinë dhe kërkoi që ta botonin. Aliu i hodhi një sy, e përgëzoi Hysenin dhe megjithëse i dinte ngatërrersat e tij me Partinë dhe Lidhjen, premtoi se do ta botonte.

Të nesërmen në faqet e gazetës "Zëri i Popullit" të rrethuar me shirita të zez shpallej vdekja e Josif Visarionoviç Stalinit dhe në faqet e brëndshme ndodhej poezia e Hysenit kushtuar Udhëheqësit të Bashkimit Sovjetik.

## VII.

Pasdite Besniku po ngjitej në kodrën e senatoriumit për t'u konsultuar me mjekun për pneumotoraksin. Në mendje i vërtiteshin skena, monologje, karaktere të dramës. Personazhi kryesor do të kishte shumë tipare të reja. Ndërsa në romanin e dështuar cilësitë e veta ishte munduar t'ia vishte një personazhi pozitiv optimist, tani do t'ia vishte një personazhi melankolik, pesimist, që vuan, përpiqet për zgjidhjen e problemeve të mbarë popullit dhe të njerëzimit dhe më në fund vret veten se nuk gjen rrugëdalje. Kësaj rradhe ishte i bindur më tepër nga çdo herë tjetër se do të krijonte art të madh.

Arriti në senatorium. Po futej në pavionin e parë, kur befaz u ndodh ballë për ballë me një pamje të pabesueshme. . Edi, e veshur me një robdishan, po dilte nga porta. Zemra i rrahu me forcë. Një hop qëndroi në prak i shtangur. Pastaj u fut brëndë në koridor. U mbështet në mur. Ndenji ashtu pak. Mendimet për kryeveprën ju tretën si vetëtima. Pastaj u ngjit në katin e dytë që të shikonte me kë do të takohej e dashura e tij. Te porta e priste një djalë, të cilin e njihte diçka. Nuk u bë xheloz. Dhëmbja që i shkaktoi sëmundja e saj ishte më e madhe dhe e mbyste. U fut i turbulluar në një sallë ku ndodhej një pacient i njohur. U përshëndet me të dhe ndërkohë vështronte nga dritarja. Bisedonte , por mendjen e kishte te Edi. Donte së paku ta shihte edhe një herë, prandaj po e ruante. Pas pak i la përshëndetjen të sëmurit dhe zbriti i tronditur.

Doli në oborr. Ajo po vinte drejt tij. Do të takoheshin ballë për ballë. Zemra i rrahu prapë, mezi përmbahej. Përpiqej të mos e rrëfente tronditjen. U mundua të dukej i ftohtë, indiferent, thuaj se nuk njiheshin fare. Sa kaloi ajo, Besniku qëndroi. Mbylli sytë plot dhëmbje. Pastaj po zbriste në qytet dhe fantazia e tij mori kot duke imagjinuar ngjarje nga më të çuditshme. Si arriti në qytet, ndjeu një boshllëk se tani e tutje do të hante, do të flinte, do të shetiste dhe do të bisedonte, ndërsa Edi ishte e sëmurë dhe ai nuk do të dinte asgjë për të.

Tek ecte ashtu i turbulluar, befaz iu duk se nën shtytjen e ndjenjave të fuqishme të dashurisë po i ndryshohej karakteri dhe po e shihte gjithshka në një dritë tjetër. Vendosi ta hidhte tej krenarinë qesharake dhe të shkonte ta vizitonte Edin, pamvarësisht se ajo e kishte fyer dhe i kishte kërkuar që mos ta takonte më, se gjoja nuk e njihte. Zemra e tij u mbush plot gëzim, qepallat iu njomën me lot. se



do ta shihte, do të bisedonte me të, do t'i qëndronte pranë. Ai u kënaq se e ndjeu vehten njeri të transformuar, të përsosur, se dashuria e kishte ngritur më lart nga egoizmi meskin. Vendosi të shkonte tek ajo po atë natë, posa të errej. Nuk mund të qëndronte më gjatë pa e parë. I dukej se në shpirtin e tij nuk kishte asgjë tjetër veç dashurisë të pakufishme për të, veç mirësisë së pa fund që rridhte prej saj.

U ngjiti lart ne senatoium dhe po e priste i tronditur nën një pemë. Kishte dërguar një infermiere të lajmëronte Edin. Ajo nuk u vonua. Erdhie e lehtë, krenare, e mbështjellur me një robdishan. I hodhi sytë nga Besniku. E pa. Një fërgëllimë i përshkoi trupin dhe bëri një hap prapa .

- Edi. . - Pëshpëriti Besniku.

Ajo qëndroi e habitur. Gjoksi i ulej dhe i ngrihej si valë nga emocioni. Fytyra iu ndërrua dhe pyeti me gjysmë zëri:

- Ti? !

Asaj kurrë nuk mund t'ia mirrte mendja se Besniku që e kishte vështruar me aq mospërfillje, mund të vinte ta takonte atë natë. Ishte çuditur dhe zemruar me të. Besonte se vetë kurrë nuk do të sillej ashtu me një njeri të njohur që e kishte gjetur fatkeqsia. Edhe po të ishte e zemruar. Ai i ishte dukur tepër egoist.

- - Nuk e besoja kurrë që do të vije!

Besniku e soditi së afërmi Edin. Një i verdhë i lehtë i kishte rënë fytyrës së saj duke ia shtuar melankolinë dhe duke e dhënë një nur të veçantë. Flokët e mbledhur, qafa që i dukej më e gjatë, i jipnin pamjen e një statuje. Ai i përfshirë nga bukuria e saj i foli me zë që i dridhej:

- Para një ore ndofta isha sedërprekur, por ju më ndezët në shpirt një ndjenjë të papërballueshme, si asnjë herë në jetë. Nuk mund të mirrni me mend sa sa shumë u jam mirënjohës. Në çdo rast tjetër për mua vetja, krenaria kanë qenë më të shtrejta, por kësaj rradhe nuk mendova se si do të më prisnit. Kjo për mua kishte shumë pak rëndësi. Dikur dashuroja një mijë herë, por të më dashuronin një herë dhe përbuzja një mijë herë, po të më përbuznin një herë. Tani në daç më doni, në daç jo. Ndjenja ime nuk do të pakësohet asnjë fije. Unë jam i lumtur vetëm se ju egzistoni në botë dhe se unë ju dashuroj.

Ishte e pamundur të mos e besoje se fliste sinqerisht.

Edi u prek nga këto fjalë. Ajo u kënaq deri diku që ai e admironte aq shumë. Megjithatë kjo deklaratë i ngjalli vetëm keqardhje dhe nuk ia shtuan aspak simpatinë ndaj Besnikut. Asaj iu duk shpirtmadhësi të bënte diçka për të, prandaj e tërhoqi me një anë që mos ta dëgjonin të tjerët dhe i foli me zë të butë:

- Pse vuan kaq shumë? ! . . . Më vjen keq! . . Kam ndonjë faj unë? ! . .

. Ç' mund të bëj për ty? .. Veç duhet të më kuptoni se nuk duhet të kërkoni prej meje diçka që nuk e kam në dorë ta jap.

Ajo psherëtiu.

Besnikut iu duk se rënkimi i saj dëshmonte më tepër se gjithshka, se shprehte pa dashur ndjenjat e saj të vërteta, se tregonte që e ardhmja i përkiste atij.

- Ju thashë se nuk kam asnjë arësye t'u quaj fajtoje. Përkundrazi, ju falenderoj. Nuk do të harroj kurrë që ju më kini bërë t'u dashuroj dhe nëqoftëse marrëdhëniet tona prishen këtu. Ju kini bërë të njoh dashurinë e vërtetë. Unë do të dëshëroja vetëm t'u shoh një herë në javë, qoftë edhe pesë minuta. Beto hem se asgjë tjetër nuk kërkoj.

Në atë çast Besniku ishte i sigurtë se do ta bënte të lumtur vetëm takimi qoftë edhe pesë minuta një herë në javë, sikur nuk kuptonte që ky takim ishte edhe mjet për të arritur qëllimin. Edi sikur e besoi se vetëm kjo ishte kërkesa e tij dhe u përgjegj e sjellshme:

- Mirë. . .

Besniku psherëtiu i lehtësuar. Pastaj filluan të bisedonin pothuajse përzemërsisht.

Edi u suall e afërt për shkak se ishte në një gjendje fatkeqe dhe se e mëshiroi. I foli pa shpresë, sikur gjithshka për të kishte marrë fund. Fjalët e saj e tronditën tepër Besnikun. Ai e kundërshtoi. I erdhi keq që nuk e ndihmonte dot. Pastaj u ndanë miqësisht dhe djaloshi u kthye në shtëpi i lumtur, si me krah. Në fund të fundit kishte biseduar me të dashurën dhe përsëri do ta takonte pas një jave me mall e padurim. Ai mendoi se sigurisht do t'i dukeshin shumë të gjata ditët, orët, bile edhe sekondat, por më në fund do të vinte ai çast aq i pritur.

Atë natë nuk mbylli sy fare dhe jastëku u lag me lotë të nxehtë. Kujtonte, përfytyronte, ëndërronte Edin. Fantazonte me të dashurën ngjarje të habitshme. E imagjinonte vehten të ri, plak, të lumtur dhe fatkeq dhe aty ku mund të shprehej dashuri e pakufishme, i shpëtonin lotë. Ishte i sigurtë që në një mënyrë apo një tjetër diçka prej atyre do të ndodhte. Ishte i sigurtë se atë ditë i kishte ndodhur një ndryshim tepër i madh, se ishte aq lart në forcën e dashurisë sa asnjë njeri tjetër në botë. Ai besonte në mënyrë të patundur se gjëja më shtrejtë në botë ishte kjo ndjenjë, se ajo do ta udhëhiqte në jetë. Nuk i kujtohej se dikur kishte patur ideale të tjera dhe se atëherë do t'i dukeshin të cekta mendime të tilla.

Ai mendoi edhe për mbledhjen që do të bëhej pas disa ditësh për të diskutuar poezitë e Hysenit dhe iu duk se kishte arritur një pikë të lartë, nga ku po kuptonte shumë mirë veprën e shokut, të cilën gjer tani e kishte me një farë dyshimi.

Nuk mbylli sy fare atë natë dhe sa filloi të zbardhej, shkroi nën dritën e zbetë të agimit vargje të frymëzuara.

Pasi i dha dorën Besnikut, Edi u kthye në dhomë duke kujtuar fjalët e tij. Ra në shtrat dhe gjumi nuk e zinte. Përpëlitej dhe mendohej. Ajo u friksua nga premtimi që i kishte dhënë djaloshit se mund ta mirrte vesh ai tjetri dhe pastaj mund t'i prishej krejt e ardhmja. Ajo përfundoi se ishte treguar budallaqe duke i ardhur keq për Besnikun, se nuk ishte koha të mirrej me lodra çilimijsh e të sillte rrotull djemtë, kur tuberkolozi po e brente dhe i rrezikohej jeta.

Përfytyroi një herë sikur të martohej me Besnikun, po kjo iu duk marrëzi e plotë. Ajo ishte e bindur se Besnikut nuk mund t'i besohej, se atij nuk i dihej se çfarë mund t'i ndodhte nesër. Vërtetë ai e dashuronte, po ishte i turbull dhe i pasigurtë. Ajo përfytyroi djaloshin tjetër që ishte i heshtur dhe i matur. Po ashtu si edhe nga shumë djem të tjerë kishte pritur që ai t'i shfaqte dashurinë, por më kot, ai heshte si mumje. Ishte e sigurtë se dashuria e tij ndaj saj ishte shtuar tani. Ishte e bindur se ai ishte shpirtmadh dhe ndofta nuk ia shfaqte dashurinë nga që i dukej se sikur shfrytëzonte fatkeqësinë e saj.

Ajo u përpëliti gjer në mesnatë dhe pastaj, duke arsyetuar se çdo ditë mund t'i keqësohej gjendja, vendosi të sillej ashtu si Besniku, të përulej, t'i shkruante atij letër të thjeshtë, ku të nënkuptohej qartë dashuria e saj.

U ngrit dhe shkroi një letër të tillë. E mbaroi dhe u shtri e turbulluar. Nuk e pandehte kurrë se do të ndodhte kështu. Ishte shoqëruar me atë djalë ashtu si kot, si edhe me shumë të tjerë dhe kurrë s'ia kishte marrë mendja se do të martoheshin bashkë. Gjithshka kishte filluar si lodër dhe ja përfundonte si martesë.

Ajo ndjeu një hidhërim në zemër se krejt ndryshe e kishte përfytyruar bashkëshortin dhe martesën. Pa dashur i shpëtuan lotët dhe pëshpëriti me vehte: "Pse o fat më ke ndëshkuar kështu? ! . . Në moshën më të bukur të vashërisë u bëra tuberkoloze. Pse m'i prishe ëndrrat e mia? ! Pse më ndëshkon kaq rëndë? ! Ç'të keqe kam bërë? ! A nuk jam unë një jetime e vuajtur, e pafajshme, bile mund të them ëngjëllorë? ! "

## VIII.

Besniku u nis në mbledhjen e shkrimtarëve, ku do të diskutoheshin poezitë e Hysenit me bindje se kishte përgatitur një diskutim të mirë. Besonte se do të shprehte singerisht mendimet e veta, por do t'i veshte ato me frazeologji marksiste që të mund të pranoheshin më lehtë. E kishte parashikuar se për shkak të këtij diskutimi mund të humbiste të drejtën e studimit për në Bashkimin Sovjetik, por i dukej poshtërim të heshte, kur të tjerët mund t'i hidhnin poshtë poezitë e shokut.

Hyri në zyrë.

- Prit një minut - I tha Hyseni që po daktilografonte.

Pastaj e nxori letrën nga makina, i dha një kopje Besnikut duke i thënë.

- Po nuk e pranuan veprën, unë do t'i dorëzoj këtë.

Besniku lexoi letrën. Aty Hyseni kërkonte të dilta nga Partia dhe në mes të tjerash shkruante.

"Ju e mohoni veprën time, por vepra jam unë. Në fakt ju më zboni nga Partia. Unë kërkoj vetëm që ky akt të kryhet de juro."

Besnikut iu rrëngqeth gjithë trupi, megjithëse deri diku ai ishte bërë shkaktar që ajo letër të shkruhej në atë kohë. Në mëngjez Hyseni i kishte deklaruar atij se kishte patur iluzine të kota, se kishte gabuar që kishte dorëzuar vjershat për diskutim. Besniku e kishte kundërshtuar dhe e kishte këshilluar se po t'ia hidhnin poshtë veprën, mund të kërkonte edhe daljen nga Partia, se nuk kishte kuptim të ishte anëtar Partie dhe mos t'ia botonim shkrimet.

Hyseni kishte heshtur aty për aty, por kjo ide nuk i ishte hequr nga mendja. Në drekë, tek hante bukë në shtëpi, duke paradherë se me siguri do t'ia hidhnin poshtë veprën, vendosi të kundërvepronte duke kërkuar daljen nga Partia.

Besniku e kishte këshilluar të dilte nga Partia pa u thelluar shumë dhe tani do të dëshëronte mos të ishte shkruar kjo letër, prandaj i tha:

- Mirë. . . Megjithëse ndofta nuk duhet të ngutesh. Të bëjmë përpjekje të tjera që ta botojmë veprën.

Hyseni u përgjegj prerë:

- Unë e tërheq kërkesën për të dalë nga Partia, nëqoftëse ata e rishqyrtojnë veprën time.

Besniku e nuhati se po afrohej një përplasje e egër dhe foli me dhëmbje:

- Tani jam i sigurtë se do të më pritet bursa.

Hyseni e kundërshtoi i qetë dhe singerisht:

- Nuk e besoj. Pse ta bëjnë këtë gjë? !

Besniku nguli këmbë në të tijën:

- Ata do të zemrohen, se unë do të mbroj veprën tënde.

Hyseni kundërshtoi prapë:

- Mund të zemrohen, por bursën nuk do ta presin.

Besniku u përgjegj i bindur:

- Jam i sigurtë se nuk do të më çojnë në Bashkimin Sovjetik. Po fundi kjo s'ka ndonjë rëndësi. Unë nuk mund të hesht , kur vepra jote sulmohet. Heshtja do të ishte poshtërsi.

Në dhomë hyri Andrea me vjershat e Hysenit në dorë. Përshëndeti si gjithëmonë plot mirësjellje të shtirë. Dukej si i përgatitur për ta lëvduar Hysenin. Pyeti plot edukatë në kishin ardhur të tjerët dhe u duk se nuk e vuri re fare që Hyseni kishte ndryshuar, se sytë e tij të turbull shkëlqenin me zemrim. Doli në sallon se dëgjoji zërin e Ismailit dhe pyeti me shpresë:

- Sigurisht i lexuat vjershat? !

Ismaili u përgjegj i ndrojtur:

- Më falni. Jam fajtor. Por më besoni se nuk kam patur një minut kohë. Mbrëmë i hapa pak andej nga ora dymbëdhjetë, por isha i lodhur dhe më mbylleshin sytë. Poezia kërkon të jesh i freskët dhe i ngeshëm. .

Ismaili nuk gënjente, vërtetë kishte qenë shumë i zënë. Por ai ishte i kënaqur që kishte ndodhur kështu. Ishte në dilemë me ato poezi që kishte lexuar. Ca i pëlqenin. Një shumicë i dukeshin të çuditshme dhe të pakuptueshme. Ndonjë e dobët artistikisht dhe ideologjikisht. Dhe në përgjithësi nuk dinte se çfarë qëndrimi të mbante.

Andreas kjo gjë nuk i erdhi hiç mirë dhe u pre. Dëshëronte të kishte edhe përkrahjen e kryetarit të Lidhjes së Shkrimtarëve në dënimin e veprës së Hysenit. Ismaili e vuri re këtë dhe i dha kurajo:

- Po kjo nuk ka rëndësi. Ti je shok i pjekur dhe di të gjykosësh e të vlerësosh. Bile në një pikëpamje je më i përgatitur nga unë. Ti ke kryer studimet në univeristetin "Gorki". Thirri shokët të vijnë në zyrën time.

Nëpunësit e Lidhjes po mblidheshin në zyrën e kryetarit. Ismaili zuri vend në krye duke parashikuar një farë debati në mbledhje, por jo dhe aq të rreptë. Telhai hyri duke pëshpëritur me Andream. E përshëndeti shumë ftohtë Hysenin, ashtu si

do të ishin edhe mendimet që do të shprehte për veprën e tij. Mihali u fut buzëgaz, përshëndeti dhe u ul pranë Ismailit me një pamje të qetë. I fundit erdhi Filipi si zakonisht serioz dhe i zhytur në vete. Në mbledhje mungonte Esati që ishte larguar me shërbim në Durrës, gati me dëshirë që mos të mirrte pjesë në këtë diskutim. Ai i kishte ngritur shumë lart vjershat e Hysenit dhe për këtë shkak parashikonte të ndodhej në pozitë të vështirë në mbledhje. Kështu e quajti të arësyeshme të mungonte.

U ulën të gjithë. Heshtëm dhe pritën të fillonte Andrea. Tani Ismaili e kuptoi nga pamja e jashtme e shokëve se mbledhja do të ishte më e rreptë se ç'e priste dhe u vrejti.

Andera nuk e kishte pëlqyer pjesëm më të madhe të poezive të Hysenit. Disa poezi e kishin revoltuar dhe shpesh ai kishte qeshur me ironi duke kujtuar se autori e mbante vehten gjeni. Por nga ana tjetër nuk kishte dashur ta kritikonte veprën se e parashikonte që do të ngatërrohej me Hysenin dhe kjo nuk i pëlqente. Bile edhe kishte kërkuar të ngarkonin një tjetër, por kryesia kishte refuzuar. Tani diskutimin ishte përpjekur ta përgatiste sa më objektivisht në përputhje me bindjet dhe shijen e tij. Ai filloi të flasë me një ton shumë të natyrshëm dhe të qetë:

- Pasi e mbaron këtë vëllim, lexonjësi ndjen një trubullirë, mërzitje, një farë trishtimi. Kjo vepër nuk i ngjall atij besim dhe optimizëm për komunizmin dhe Atdheun, bile gjer në një farë shkalle e dobëson gatishmërinë e tij luftarake, por mos të harrojmë se Zhdanovi ka thënë se letërsia duhet të jetë e qartë, e thjeshtë, të edukojë njeriun me ndjenjat e larta të patriotizmit dhe të komunizmit, ta përgatisë për mbrojtjen e atdheut socialist. Partia kërkon një letërsi militante nga ne. Poeti ka kaos, turbullirë, mjegullirë, trishtim, që janë të papajtueshme me letërsinë e re. Temat e tij janë të përgjithshme dhe nuk i përgjigjen realitetit, aktualitetit. Poezia e tij mund të themi është jashtë kohës.

"Kjo frymë përshkon në përgjithësi edhe vjershat e dashurisë, që zënë një vend shumë të madh në këtë vëllim, gjë e cila prapë është e pakuptueshme. Pastaj nuk dashuron kështu njeriu i ri që ndërton socializmin, që është gati të japë jetën për idealet e larta të komunizmit dhe të patriotizmit.

Si bëri një hyrje të tillë dhe si e hodhi poshtë vëllimin në përgjithësi, Andrea tha se nëpër të ndodhej ndonjë vjershë e bukur erotike, shoqërore dhe ndonjë fabull. Ai mbaroi i lodhur.

Të pranishmit mbetën si të ngrirë. Askush nuk lëvizte, nuk pëshpëriste. Disa kishin ulur kokën. Dikush shënonte në fletore. Hyseni dukej indiferent. Besniku shfaqte një lloj padurimi. Këtë heshtje të rëndë befasi e prishi Telhai. Kërkoj leje

të diskutonte dhe u hodh i skandalizuar:

- Unë për hesapin tim jam habitur me vjershat e Hysenit. Ato nuk janë kërkund. Nuk mund të kuptoj aspak se si njeriu mund të shkruaj në atë mënyrë. Kam vrarë mendjen të gjejë se si poeti ndodhet në atë botë poetike, se si mund të frymëzohet për vjersha të tilla dhe nuk ia kam dalë në krye. Ashtu mund të shkruanin në shekullin e kaluar Bajroni, Ljermontovi dhe romantikë të tjerë. Po sot në shekullin e njëzet? ! Të shkruash ashtu tani është një anakronizëm i tmerrshëm. Bëj çudi edhe për një fakt tjetër. Shoku është komunist, ka luftuar, bile ka qenë kuadër gjatë luftës, por kjo nuk gjen fare shprehje në veprën e tij, që është më duket mua një pseudoromantizëm i dëmshëm. Më kujtohen shkrimet që kishte dërguar Hyseni në konkurs dhe për të cilat referova unë.

Qepallat e Hysenit lëvizën me nervozizëm.

Telhai vijoi:

- Ato shkrime kishin dobësi artistike, por ideologjikisht në përgjithësi ishin të shëndosha. Kurse tani kemi një prodhim poetik krejt të patolerueshëm. Andrea gjeti ca vjersha të mira. Për mua edhe ato nuk vlejnë. Poeti o pranohet o hidhet poshtë komplet. Sa rëndësi kanë dhjetë vjersha të bukura, ku dyqind nuk mund t'i pranojmë kurrësesi? !

"Ku e kanë burimin këto vjersha? ! Mund të gjenden shumë shkaqe, por unë them kryesorin. Hyseni nuk ka krijuar sipas metodës së realizmit socialist, si na mëson Partia. Ai është larguar nga problemet e mëdha të kohës dhe të socializmit. Ai nuk ecën në gjurmat e letërsisë sovjetike dhe është hutuar pas klasikëve të letërsisë botërore të shekujve të kaluar.

E shfletonte vëllimin fletë pas flete. Dëshëronte të gjente në to format, idetë, temat e letërsisë së kohës dhe rrevoltohej duke gjetur heronj të lashtë, tema fantastike, humanizëm të përgjithëm, jo klasor, një art absrakt, ku indirekt sulmohej poezia e kohës. Ai e dënonte veprën e Hysenit gati gati me gëzim. Ishte i sigurtë se diskutimi i tij luante një rrol me rëndësi, varroste një vepër të shtrembër ideologjikisht, militonte për çeshtjen e Partisë, për artin militant socialist dhe ai për këtë nuk mund të mos ishte krenar.

Pastaj atij i vinte mirë që Hysenin po e mbështesnin me shpatulla për muri, si thoshte me vehte, edhe pse dikur ai e kishte fyer padrejtësisht dhe dukej fare qartë se nuk e çmonte. Lufta kundër Hysenit ishte për të edhe një luftë për egzistencë, ku arësyet personale fshiheshin pas motiveve shoqërore.

Gjykimet dhe kërkesat e Andreas dhe të Telhait për Besnikun ishin shtypje, pengesa poetike, kanune që duheshin flakur poshtë me vendosmëri. Ai kishte bindje

se këta njerëz që kuptonin fare cektë artin, donin të mbytnin, të asgjësonin një artist. Nuk i pritej të fliste që të kundërshtonte kategorikisht gjykimet e tyre sipërfaqore. Ishte plot besim në drejtësinë e pikëpamjeve të veta dhe nuk i shkonte mendja se si do të reagonin të tjerët.

- Unë nuk jam aspak dakort me shokët që diskutuan. - Protestoi ai - sidomos me Telhanë. Duhet të kuptojmë se para nesh kemi një poet të vërtetë që jam i sigurtë do të mbetet në letërsinë shqipe. Shokët e akuzuan se nuk lidhet me realitetin, por unë e hedh poshtë kategorikisht këtë akuzë. Mos të kërkojmë gjithëmonë një lidhje të hapët, tendencioze me kohën. Engëlsi ka thënë se sa më e fshehtë të jetë tendeca aq më lart është vepra artistike, se nuk duhet të bëhemi altoparlantë të ideve të kohës. Kështu vepron e shkruan edhe Hyseni.

“Imperializmi është ideologjia e errët e luftës, mohon dashurinë dhe natyrën, kurse Hyseni i pohon me forcë. Në këtë mënyrë ai lufton për jetën, kundër vdekjes.

“Telhai e akuzoi se nuk e ka përvetësuar metodën e realizmit socialist. Ai kërkon ta fusë letërsinë në kallëpe, ta përdhunojë, të përjashtojë temën e dashurisë dhe të natyrës. Po artisti si metodë kryesore ka realitetin. Shoku Stalin ka porositur shkrimtarët:”Shkruani të vërtetën! ”Kjo porosi duhet të jetë motoja më e lartë e çdo artisti. Po më të vërtetë se dashuria nuk ka.

“U tha se Hyseni është shkëputur nga letërsia sovjetike. Mua më duket se të flasësh kështu do të thotë ta ngushtosh horizontin e përvojës letrare. Duke i shikuar problemet në prizmin dialektik, ne duhet të përfitojmë nga gjithë letërsisë botërore e shekujve të kaluar duke filluar që nga grekët e vjetër, pa përjashtuar këtu as letërsinë sovjetike. Në shkrimet e Hysenit ndihet edhe ndikimi i letërsisë klasike botërore, që fatkeqësisht është e dobët në veprat shqipe të letërsisë të sotme. Një nga arësyet që letërsia jonë gjëndet në një nivel të dobët, është se nuk e studjojmë sa duhet letërsinë klasike botërore dhe mbështetemi më tepër në letërsinë sovjetike, e cila akoma s’e ka arritur artin e madh.

“Vërtetë në veprën e Hysenit ka nota pesimizmi. Po ky trishtim rrjedh nga dashuria për jetën dhe nuk mund të dënohet si i gabuar ideologjikisht.

Filipi dëgjonte gjakftohtë dhe askush nuk mund ta mirrte me mend se ç’bluante. Kishte ardhur në mbledhje me dyshime dhe rezerva. Hyseni i dukej poet i vërtetë. Vende vende i kujtonte poezitë e tij të rinisë, kur ishte nën ndikimin e rrymave romantike. Por me që nuk mbante dot qëndrim ndaj një shumice poezish të turbullta, kishte vendosur të prononcohej sipas situatës konkrete. Diskutimin e Andreas në përgjithësi e pëlqeu, gjithashtu edhe të Telhait, megjithëse e vlerësoi si ekstremist. Ndërsa fjalët e Besnikut iu dukën përçartje dhe një herë nuk përmbajti



dot një buzëqeshje të lehtë ironike. Teorizimet e tij për realizmin socialist dhe mohimin e nevojës që të kishin bazë letërsinë sovjetike iu dukën skandaloze, tepër të rrezikshme, antiparti dhe çuditej se si ky djalosh i hidhte frazat ashtu si pa të keq.

Si mbaroi Besniku, ai kërkoi fjalën. Pa u futur në gjykime të përgjithëshme ai tha se për një pjesë të madhe të vjershavë as që mund të bëhej fjalë të botoheshin, por shënoi vjersha të bukura më shumë se Andrea dhe pastaj foli për gjuhën e bukur, të gjallë, të rrjedhshme. Në fund ai theksoi me nervozëm:

- Besniku shprehu ca pikëpamje që besoj askush nuk mund t'i marrë seriozisht. Askush nuk e mohon letërsinë klasike botërore, por ai po e mohon letërsinë sovjetike, e diskretiton atë duke deklaruar se nuk ka arritur majat e artit të madh. Ne kemi Gorkin, Fadajevin, Majakovskin, Shollorovin, Aleks Tolstoin të tepërt për një kohë kaq të shkurtër dhe të presim ca se ç'do të thuhet për ta. Ndofta Gorki në të ardhmen do të zërë një vend më të rëndësishëm se Homeri.

"Pastaj edhe ajo puna e realizmit bie erë pasaktësie. Engëlsi ka thënë kështu apo ashtu, po mos të harrojmë se sot kemi të përpunuar një teori të plotë të realizmit socialist nga estetët dhe shkrimtarët sovjetikë, që Besniku kërkon ta hedhë poshtë si ndonjë copë leckë. Nënveftësimi i letërsisë sovjetike, sidomos i letërsisë sonë të realizmit socialist që si një foshnjë posa ka filluar të hedhë çapat e para është i padrejtë, i dëmshëm dhe mund të shpjerë larg, prandaj djaloshi të reflektojë thellë për ato që tha.

"Na foli këtu ex. katedra. Kur i bëri këto studime dhe përgjithësime? ! Ai di gjithsej 100 fjalë rusisht. Është i ri në moshë, ka mbaruar vetëm shkollën e mesme dhe nuk di ai i ka lexuar mirë nja 100 libra. Të jetë pak më modest. Neve na ranë flokët dhe nuk guxojmë të flasim me kompetecë.

I fundit diskutoi Mihali. Ai nuk e kishte pëlqyer fare veprën e Hysenit, me përjashtim të një numri të vogël poezish. Diskutimet, veç atij të Besnikut, i pëlqyen dhe shpresonte se Hyseni ishte ndihmuar mjaft dhe do të nxirrte konkluzione të drejta e të dobishme. Ai desh të tregonte konkretisht se ç'duhej të bënte autori, prandaj me sinqeritet dhe me një farë emocioni foli me zjarr:

- Unë dua t'i bëj thirrje muzës së Hysenit që të këndojë punëtorit që çan malin, bujkut që braktis pronën private dhe futet me entuziazëm në kooperativë, të varfërit që bëhet inxhinier, doktor, agronom, oficerit të sigurimit që sogjeton dhe mbron me heroizëm Republikën e re, gjithë popullit shqiptar që bën përpjekje titanike në ndërtimin e jetës së re. Hyseni mos të heshtë për këto dhe t'i këndojë një gruaje syzesë. E ç'është ajo? ! Një grua fundi i fundit, kurse komunizmi, atdheu,

Partia janë gjëra të larta dhe të shejta.

“Henrik Hajne i ka shkruar me talent të mrekullueshëm Lorelaos. Ashtu ishte koha. Po me një talent të tillë t’i këndojmë këtij realiteti të mrekullueshëm, atëherë do t’ia kalojmë Haines, ashtu si ja kanë kaluar poetët sovjetike. Unë si shok i bëj thirrje Hysenit t’i këndoje jetës së re me atë varg të rrjedhshëm dhe gjuhë të bukur se kështu sigurisht do të jetë i nderuar nga Partia dhe populli.

Dhe ai u ul i kënaqur se kishte folur me një gjuhë poetike për poezinë.

Hyseni gjatë gjithë mbledhje heshte me një shprehje të zymtë dhe të pakënaqur. Asnjë nuk mund ta kuptonte se çfarë qëndrimi do të mbante ndaj diskutimeve. Atë e neveriti Andea me atë ton zyrtar profesorial predikues plot udhëzime e këshilla për poezinë dhe poetin. Armik i egër i poezisë së tij ishte si gjithëmonë Telhai që fliste si prokuror. E përbuzi atë duke qenë i sigurtë se mendja e tij e ngushtë, nuk e kuptonte dot poezinë, se gjithshka ai e maste me metrin e tij prej liliputi, se flakte çdo gjë që nuk i përshtatej si shtatanik që ishte. Por nga ana tjetër mendoi se ai me nihatjen prej qeni kishte gjetur ca të vërteta, se me të drejtë e quante veprën e tij romantike që duhej pranuar ose hedhur poshtë komplet. Diskutimi i Besnikut e la të ftohtë, megjithëse i erdhi mirë që e lëndoi si poet që do të mbetej në letërsinë shqipe. Edhe Filipi e inatosi se i hidhte poshtë shumicën e veprës. Diskutimi entuziast i Mihalit iu duk përçart dhe ndjeu në të po aq armiçësi sa edhe në folësit e tjerë.

Ai mendonte se poezitë që hidhnin poshtë ata, ishin shumë më të bukra se ato që pranonin dhe u mbush me inat se këta njerëz që, si thoshte ai, mbareshin në karriket e Lidhjes në sajë të ndërhyrjes së shtetit, ia dënonin veprën me medjemadhësi e ligësi.

Derisa u mbaruan diskutimet, u mbajt i qetë. Posa u ngrit të fliste, ndryshoi. U bë flakë në fytyrë. Vështroi me zemrim dhe tha me një ton përbuzës:

- Dëshëroj edhe unë të them ca fjalë të paka. Veprën time e kam hedhur në erë dhe as e lëndoj, as e shaj, as e mbroj. Po juve mos t’u gënjejë mendja se kini fuqi ta varrosni. Vepra ime, nëqoftëse është vërtetë artistike, dhe këtë nuk e sheh vetëm një miop, do të rrojë dhe kritika asaj i rruan bishtin.

“Do të vijë një kohë, kur ju do të kapërdini gjithshka që vollët këtu sot. Unë nuk jam poet i disave fabullave dhe i poezive të lehta. Unë jam poet i 18,000 vërgjeve dhe ato do t’i pranoni të tëra. Mos ju, të tjerët, mos tani, pas vdekjes sime. Mua koha nuk më tremb! Po unë nuk pranoj të bëhem palaço me pesëdhjetë poezi.

“Tani rruga jonë këtu ndahet. Ky jam unë, kjo është vepra ime. Ju kërkoni një Hysen tjetër që nuk egziston dhe as që mund të egzistojë. Jemi njerëz të

ndryshëm. Mes jush nuk kam vend. Atëherë urdhëroni!

U afrua në tavolinë, i dha zarfin Ismailit dhe u ul në vend.

Mbledhja u trondit nga zemrimi dhe qëndrimi përbuzës i Hysenit. Andrea dyshoi mos e kishte vlerësuar ndopak gabim veprën. Telhai e quajti poetin të krisur dhe qeshi me vehte duke u mbajtur serioz. Filipi u zemrua se po i akuzonte padrejtësisht, me arrogancë. Kurse Besniku u entuziazhua. Sjellja e shokut iu duk e denjë për një gjeni.

Ismaili hapi zarfin. Një tronditje e lehtë përshkoi tiparet e tij. Ngriti kokën dhe foli i shtypur shpirtërisht me zë të ulët:

- Kjo letër nuk ka lidhje me këtë mbledhje, prandaj mendoj t'i japim fund.

Hyseni kundërshtoi me nervozizëm:

- Mund ta mbyllim, por letra ime me këtë mbledhje ka plotësisht lidhje.

Hyseni u ngrit dhe doli i mbushur me inat. Besniku e ndoqi pas i revoltuar. Ismaili, të cilit i kishte rënë një hije trishtimi, u spjegoi të tjerëve me dy fjalë përmbajtjen e letrës. Telhai brofi më këmbë dhe briti i skandalizuar:

- Ky s'është në vete fare! Duhet shpënë urgjentisht në Vlorë! Ju siguroj se psiqiatri nuk e nxjerr në rregull.

Andrea u pre. Po i mblidhte letrat i pikëlluar. I dukej sikur Hyseni e quante atë fajtor për të gjitha.

- U përpoqa ta shikoj veprën me mirëdashje, - Tha ai i zënë ngushtë - por nuk mund të them atë që nuk është. Ndofta gabova që pranova të referoj, por unë desha t'i bëj një të mirë. t'i tregoj të metat pa e fyer. Ç'faj kam unë? !

- Ti fole shumë mirë. Mbrojte parimin dhe s'ka asnjë arsye që ta ndjesh veten fajtor. - Tha Mihali i mërziur se i doli krejt ndryshe nga ç' e kishte parashikuar, kur fliste.

Filipi buzëqeshi dhe e ngushëlloi:

- As ti, as ne nuk kemi faj. I thamë mendimin tonë. Kurse ai hidhet përjetë. Kërkon të dalë nga Partia. Fundi diskutuam keq ne, ç'hyn këtu anëtarësia në Parti? ! Po atij duket nuk i pëlqen të jetë komunist, po atëherë udha e mbarë. Me zor nuk do ta mbajë kush. E ka marrë më qafë mania e gjemiut. Kam takuar një të tillë edhe në Francë. E kishte mëndjen top që ia kishte kaluar Shekspirit. Ç't'i bësh? !!! Fiksasion!

- Ha. . Ha. . . Ha. . E paska shokun. - Qeshi Telhai.

Ismaili po shfletonte i tronditur vëllimin, lexonte ndonjë vjershë tek tuk dhe foli:

- Gjynah. . Gjynah. . Shih sa bukur! . . . Ç'ndjenjë e pastër, e vërtetë! Çfarë

fantazie poetike! Apo gjuha? ! Asnjë shkrimtar nuk e ka toskërishten e kulluar posi ky. Tamam Naimi!

Filipi buzëqeshi prapë:

- Talentin e tij nuk e mohon askush.

Ismaili shtoi:

- Të vjen të qash për këtë njeri. . . Mbytet me duart e veta. Po këtu kemi edhe ne faj. Nuk kemi qenë aq të zotët. Nuk duhet ta lejonim në asnjë mënyrë të ndodhte kështu. Gaboi ai, por ne çfarë bëmë? !

Sytë dhe fytyra e Jamailit shprehnin vuajtje. Ai ishte i trishtuar se mbledhja kishte përfunduar si nuk ia kishte marrë mendja kurrë. Ky qëndrim Telhait iu duk i dyshimtë, kurse Filipit qesharak. Mihali e shpjegoi me shpirtmadhësinë e tij.

Në këtë kohë dy shokët po ecnin në rrugët e qytetit të mbushura me plot njerëz.

Hyseni mendonte se kishte ndodhur ajo që priste, se ishin shkëputur krejt ato marrëdhënie të papërcaktuara që kishin egzistuar në Lidhjen e Shkrimtarëve, se do të ishte e vështirë dhe pa kuptim që të nesërmen të vijonte punën aty. Ai nuk dinte se me ç'gjuhë të fliste me ata njerëz. Atij iu duk se ajo mbledhje e kishte përzënë dhe jasht këtyre rrugëve, ku kalonte, pse njerëzit për rreth nderonin dhe përkrahnin Ismailin, Andrean, Filipin, Telhanë dhe Mihalin. Ai ndjeu një dëshpërim të madh nga që nuk dinte se ç'të bënte. Nuk kishte, ku të shkonte tani që s'rrinte dot në Lidhje. Shoku në krah nuk i jipte atij asnjë ngushëllim.

Besnikut nuk i dukej situata tragjike. Mendonte se të nesërmen mund të shkonte në zyrë, se poezitë e Hysenit do të pranoheshin më vonë. Ai nuk mund të ishte fatkeq, kur mendonte se pas tre ditësh do të takonte Edin.

Të pasnesërmen në mëmhjez Besniku nuk e gjeti në zyrë Hysenin dhe i thanë se e kishte thirrur Ministri i Punëve të Brëndshme. E priti shokun, por ai nuk erdhi. Pasdite shkoi ta takonte në shtëpi, por e shoqja i tha se kishte vajtur në zyrë. Besniku shkoi drejt e në Lidhje. E gjeti Hysenin duke shkruar dhe menjëherë e pyeti me kureshtje e interes:

- Hë, ç'kemi? Vërtetë ishte te ministri.

Hyseni me penë në dorë u përgjegj ftohtë:

- Po. .

- Po ç'tha? ! - Pyeti plot shpresa Besniku.

- Hiç. . të zakonshmet. . - Ia ktheu Hyseni duke ndjerë atë dhëmbje që kishte provuar, pasi doli nga ministri.

Ai kishte vajtur te ministri plot iluzine, me besim se shoku i dikurshëm diçka do të kuptonte, se do ta përkrahte, bile kishte marrë me vehte edhe dorëshkrimet që t'ia japë për t'i lexuar. Nuk ishte plotësisht i ndërgjeshëm për përmbajtjen e veprave të veta. Pandehte se vjershat që i kishin hedhur poshtë shkrimtarët, mund t'i pëlqente dhe t'i përkrahte ministri i punëve të brendshme. Një natë më parë kishte shpresuar se do të mirrin fund padrejtësitë kundër tij, se vepra do t'i botohej, se do të dilte fitimtar kundra Lidhjes së Shkrimtarëve, se do të bëhej shpejt i famshëm. Por tani i vinte turp të kujtonte se çfarë kishte shpresuar, të kujtonte se ministri nuk kishte pranuar të bëhej ndërmjetës i veprave të tij, duke i deklaruar se nuk ishte kompetentë në art dhe e kishte drejtuar të diskutonte me ata që e kishin zanat letërsinë. Po Besniku nguli këmbë.

- Po hë. . ç'të tha. Më trego një çikë. .

Hyseni la penën dhe tregoi pa qejf:

- Gjepura. Më tha se çmobilizimi im ishte bërë gabim në kohën e Koçi Xoxes. Më propozoi të bëhesha prapë oficer dhe më premtoi se do të më krijonte kondita të favorëshme për zhvillimin e talentit. Nisej nga qëllime të mira. I dhëmbej shoku i luftës dhe jam i sigurtë se e kishte me sinqeritet. Po ku ai, ku unë. Me shokët që kam luftuar, sikur më lidhnin ca fije të padukshme, por edhe ato m'i këputën sot, m'u tretën të fundit iluzione. Pashë shumë mirë ndryshimin e madh mes atyre dhe meje. E ku mund të ketë miqësi deri sa neve na ndajnë roje pas rojesh? ! Kurse kjo atij i duket e zakonshme, normale, pandeh se mund të ruhet miqësia në të tilla kondita. Nejshe hesap për ta.

"Unë i thashë të miat. Nuk jam më i përshtashëm për oficer. Jam poet dhe do të çaj me poezinë time. Gabohen rëndë ata që mendojnë se mund ta varrosin artin. Pastaj ai e ndërroi bisedën dhe e hodhi fjalën për kërkesën time për të dalë nga Partia. Duket se atje lart i ka tronditur kjo gjë. Më bëri agjitacion: "Ti je i yni. Ke qenë luftëtar i zoti. Bashkë kemi ndarë kotheren e bukës. " e të tjera e të tjera. Avazi i Mukes. Kujtojnë se gjërat nuk lëvizin përjetësisht. Unë heshta. Kaq.

"Kur dola nga zyra e tij, e kuptova më tepër vetminë time. Rrugët, pemët, shtëpitë, krejt qyteti për mua janë të zymtë. Më mbyti ajri i këtushëm. Mezi marr frymë. Edhe babai sikur është tjetër njeri. I dua fëmijët, por sikur nuk kam ndaj tyre ndonjë detyrim. Për të gjithë jam i huaj. Tokën shqiptare nuk e ndjej më timen. Të ndjesh veten të vetmuar në një vend të huaj është e dhëmbshme, por e kuptueshme. Por të ndjesh veten të huaj në vendin tënd, për të cilin ke derdhur gjak dhe trupin e ke me plagë, është tmerr i vërtetë. . . Nuk do të mërzhitesh të lexoj diçka?

Ai i lexoi Besnikut një pjesë nga poema. Aty kishte përshkruar se si personazhi kryesor shkonte në botën e re dhe të lumtur të ndërtuar prej atyre skllëvërve, bashkë me të cilët ishte nisur dikur për të kërkuar të vërtetën. Bota e re ishte krejt e mekanizuar, gjithshka aty kryhej automatikisht. Ajo kishte arritur çudira teknike sa edhe oqeanin e kishte futur në kazan. Njerëzit atje ishin tërë njësoj e të tërë të bukur dhe përsëritnin për mendsh vetëm disa formula: "Jemi të lumtur! Ne dimë gjithshka! Rroftë bota e re harmonike dhe unike! "

Kur një ish skllav po e detyronte heroin me forcë të përfitonte edhe ai nga bota e re, kazanin, ku ishte futur oqeani, pëllciste dhe uji mbyste gjithshka. Mbytej edhe heroi kryesor i kënaqur se fitonte natyra dhe spontaniteti. Në këtë skenë bëhej aluzion për shoqërinë socialiste dhe profetizohej përfundimi i saj.

Kur i thanë një natë më parë se e kërkonte ministri, Hysenit iu duk e vështirë ta krijonte këtë skenë në mëngjez. Nuk kishte asnjë shtytje të brëndshme dhe kujtoi se ndofta nuk do ta shkruante fare. Po tani po e shkruante me dëshirë, megjithëse me dhimbje. Atij i dukej sikur po coptonte me duart e veta të padrejtën, që kishte besuar dikur në mënyrë të patundur, që ishte një pjesë e tij. Kjo skenë ia kishte shtuar trishtimin e hidhërimin e madh dhe e kishte shtyrë t'i shprehej ashtu shokut.

Besniku nuk e kuptoi mirë domethënien e kësaj skene. I vaji mendja se mund të ishte aluzion për socializmin, por më tepër e interpretoi si protestë kundër kultit të teknikës, kundër atyre që donin ta mbytnin natyrën me teknikë, prandaj leximi i skenës nuk iu duk se lidhej aq shumë me bisedën. Nga ana tjetër ai u prek shumë se Hyseni e ndjente veten keq në Atdhuen e vet, deri diku e kuptoi, por nuk mund t'i pranonte në asnjë mënyrë arsyetimet e tij. Pasi ia lëvdoi skenën me ca shprehje të thata, më tepër për t'i bërë qejfin, e kundërshtoi:

- Nuk jam dakort aspak, kur ti në fakt e mohon Atdheun. Atdheu nuk është i disave, por i të gjithëve, bile më tepër ai është i yni.

Hyseni e kuptoi se shoku nuk kishte në shpirt aq protestë të madhe sa ai dhe i tha:

- Ne jemi të ndryshëm. Këtë gjë disa herë e kam menduar vetë. Ti gabohesh, kur na kujton njësoj.

- Unë nuk shoh ndryshim mes nesh. - Kundërshtoi Besniku që i dukej fyerje të ishte ndryshe nga Hyseni, megjithëse e shihte se rrugët e tyre ndaheshin në ndjenjat ndaj Atdheut.

Hyseni i tha krejt i sigurtë në vete:

- Me kohë do të bindesh për këtë.

## IX.

Të nesërmen Besniku mezi ç' priste të ngrysej për të vizituar Edin. Por portieri i solli një pusullë, të cilën ai kishte dhënë një vajzë e panjohur. Ai e hapi copën e letrës me indiferencë, por u çudit shumë, kur lexoi: "Mos ejani. Nuk pranoj. Nuk do të dal. E."

Nga këto fjalë të shkruara prej dorës së Edit më shpejt se vetëtima iu tretën pa gjurmë përfytyrimet e bukura. Ai e kishte imagjinuar Edin në takimin e afërt me hollësitë më të imta, kishte pëshpëritur me vehte fjalët që do t'i thoshte asaj, kithte thurur biseda e ngjarje të çuditshme që e kënaqnin së tepërmi dhe ja tani duhej të hiqte dorë prej tyre.

U përpoq të mirrte vesh shkaku pse e dashura nuk e mbante premtimin dhe iu duk se e gjeti. Sipas tij ndofta atë natë që e kishte vizituar ai, ajo nuk kishte mundur të flinte dot dhe kishte kuptuar se takimi me të nuk ishte aq i thjeshtë, se nuk do t'i bënte dot ballë pasionit të jashtëzakonshëm dhe do të mposhtej. Por ai nuk mund t'i bindej të dashurës dhe vendosi të shkonte në senatoium qysh atë natë, megjithëse ajo e kishte ndaluar.

Hëngri drekë me mëndjen te Edi dhe megjithëse ishte ftohtë, doli se nuk i rrihej në shtëpi. Befas u përplas me Osmanin dhe do të kishte vijuar rrugën pa e vënë re, sikur ai mos ta kapte për krahu dhe ta ftonte të pinin një gotë birrë. Ata hynë në një kafene. Ajri ishte i rëndë, i mbushur me tym duhani dhe frymë njerëzish. U ulën në një çip. Kamrieri i pruri birrë, meze. Tek mbushnin gotat, Besniku u hutua prapë i zhytur në botën e vet. Aktori i foli me të qeshur:

- Hej ku je? Në stratosferë? ! Hajde të pijmë për shoqërinë tonë në tokë. Besniku erdhi në vete, po mendja i rrinte gjithnjë te Edi, prandaj ngriti gotën dhe foli:

- Të pijmë për dashurinë e shpirtrave të mëdhej!

Aktori buzëqeshi dhe u përgjegj me shaka:

- Qenke bërë tanan Hamlet, se gjer tani ke qenë vetëm për gjysmë. Të kishin vvarë babanë dhe të kishin marrë fronin, do të ishe bërë shumë më keq nga ai, kur kështu pa arësye, duke pirë birrë me mua, dukesh kaq pesimist. Mblidhe veten. Mos fluturo me pras. . E di pse jemi të mërziur ne? !

- Pse? ! - Pyeti Besniku duke shpresuar se do t'i përmendëte dëshirat e

mëdha.

- Gjithë çeshtja është te gjendja ekonomike, te tigani me vaj. U bënë kaq vjet çlirim dhe akoma me triska. S'ka ndonjë popull në Europë që jeton kështu si ne. Po ata lart kanë zënë karriket dhe nuk çajnë kokën fare. Pa zbrit një çikë të lutem se Shqipërinë nuk e ke çiflik. Të hipi kush të jetë më i zoti dhe do të shohësh se do të bëhet vendi lule. Atëherë do të zhduket edhe pesimizmi yt.

Aktori kohët e fundit kishte filluar të ishte i pakënaqur nga gjendja në Shqipëri dhe herë pas here e shfaqte këtë.

Besniku u përgjegj:

- Unë për vehten time nuk vuaj nga ky shkak.
- Po ku e ke hallin? - Pyeti tjetri me të tallur.
- Ljermontovi thotë: "Eto mir dlja menja tesen"\*

Osmani qeshi me ironi, piu birrë, hëngri meze, iu afrua dhe i foli:

- I lojtur ka qenë edhe Ljermontovi. Kjo botë ka vend për një miliardë ljermontovë dhe për ty bashkë me ta. Mos i merr shumë seriozisht fjalët e poetëve. Edhe ata kështu si ne kanë qenë dhe kanë folur ç'u ka ardhur për mbarë. Je takuar edhe me Hysenin që i ka të gjitha dërrasat mangut dhe kushedi se si të duket bota. Dëgjo babaxhanin ti.

- Jo. . - Kundërshtoi Besniku.
- Mirë. . mirë. . Po sot se si më dukesh. . Ç'ke?

Besniku u përgjegj me seriozitet:

- Sonte vendoset gjëja më e rëndësishme e jetës sime.

Shoku buzëqeshi prapë, piu birrë dhe tha me indiferencë:

- Sigurisht punë dashurie. . Me ndonjë tjetër kështu?
- S'është dashuri. .
- Po çfarë?
- Ashtu është diçka.
- Punë dashurie është, por ti nuk e tregon.

Ai u ngjit në senatorium i tronditur dhe ngjarjet fantastike që thurte në mendje, u zhdukën. Po shqetësohej për takimin me Edin dhe nuk parashikonte dot se si do ta priste ajo. Hyri në senatorium fshehurazi portierit dhe kontrolloi me kujdes se mos e gjente Edin, por askund nuk e pa. Hodhi sytë andej nga dritarja e dhomës së saj dhe priti. Pas pak vuri re se ndodhej në dhomë. Vendosi të gjitej lart se po ta thërriste, ndofta ajo nuk vinte.

Te dera e pavionit kishte njerëz dhe qëndroi sa u larguan. Pastaj shpejtoi



hapat dhe u fut brëndë me guxim.

U ngjit nëpër shkallë i tronditur, kaloi ngadalë nëpër sallonin e katit të dytë. Trokiti lehtë. Hapi derën.

Ballë tij ndodhej më këmbë Edi e bukur dhe e habitur. Asnjë njeri tjetër nuk kishte në dhomë. Besniku bëri dy hapa dhe pëshpëriti:

- Edi . . .

Edit i përshkoi trupin një drithmë dhe instktivisht u spraps e trembur. Djaloshi i ri kishte një pamje tepër të guximshme. Nuk ishte i butë, i përlurur dhe as lypte mëshirë. Sytë e tij nxirrin xixa. Dukej i vendosur për çdo veprim . Më kot përpiquej , si i dukej asaj, të mbulomte gjithshka me pamjen e tij gjoja si i dashuruar. Edi posa ishte ndarë nga ai djaloshi tjetër. Ata kishin lidhur dashuri atë natë. Vajza e re ndjente akoma shijen e buzëve të puthura. Asaj iu duk Besniku i rrezikshëm dhe duke dashur ta hiqte qafe, i foli me një zë të ftohtë akull:

- Kujtova se ishte ai, se posa u ndamë. Por qenkeshit ju! Ç'kërkoni ju lutem këtu lart në dhomën time?

Besnikut nuk i bënë aspak përshtypje fjalët e saj se një tjetër kishte qenë tek ajo pak më parë. Dyshoi se ajo gënjente, se fshihej prapa një perdje të zezë. Por edhe po ta konsideronte të vërtetë, nuk i jipte rëndësi këtij fakti. Ai bëri një hap para dhe i foli me zë të ulët:

- Erdha te ti . . .

Fjalët e tij tinglluan plot vendosmëri, sikur askush nuk mund ta kundërshtonte të drejtën për ta vizituar atë. Edi parandjeu rrezik të vërtetë dhe e lëshoi zemra. Pamja e saj mospërfillëse dhe krenare u zhduk. Trupi i dridhej dhe ajo foli e pafuqishme, me një zë të prerë, si me të qarë, sikur lypte mëshirë:

- Pse nuk më lini të qetë? ! Të kam thënë se nuk të dua. Ç'njeri paske qenë kështu? ! . . . Ç'ke me mua? !

- Të dashuroj! - Pëshpëriti Besniku plot zjarr, sikur nuk po i dëgjonte fjalët e saj.

Ajo u friksua mos ndodhte ndonjë skandal i madh. Fytyra iu shtrembërua, iu bë pulla pulla të verdha. Sytë iu zmadhuan të llahtaritur, gjunjët iu drodhën dhe u sul jashtë duke qarë pa lot, duke bërtitur:

- Ik! . . . Ik! . . . Ç'ke me mua? !

Ajo ishte një Edi tjetër që ai nuk e njihnte. Nuk ishte ashtu si e përfytyronte, krenare, madhështore, e guximshme, me pasione të mëdha, por një femër që qante e trembur me hysterizëm, që ankohej e lypte mëshirë. Fytyra e ngërdheshur, zëri vajtonjës, lëvizjet, krejt sjellja e saj, që dëshmonin dobësi, iu ngulitën në ndërgjegjen

e tij dhe sikur atje thellë ia neveritën.

Menjëherë kërcitën me zhurmë dyert e dhomave të tjera dhe nga të gjithë anët rendën të çuditura gra e vajza. Ato e vështruan me dyshim dhe armiqësi Besnikun dhe e ndoqën pas Edin që zbriste shkallët duke qarë dhe bërtitur.

Atje poshtë u mbloodhën njerëz të tjerë. Nja dy infermiere u sulën me vrap se mos kishte ndodhur ndonjë fatkeqësi.

Besniku u gjend shumë ngushtë. Nuk ishte i vendosur. Vështronte me ndrojtje të sëmurat, dëshironte t'i thoshte të dashurës ndonjë fjalë qetësonjëse dhe të largohej pa u ndjerë. Zbriti poshtë, doli në oborr dhe iu afrua Edit që sillej rrotull e trembur.

- Qetësohu. . Unë po iki. . . - I tha.

Po ajo nuk i dëgjoji fjalët e tij aq e tronditur ishte. Dy vajza e shanë me zemrim djaloshin:

- Ky qenka fare i çmendur!

Besniku e kuptoi se gjithshka kishte marrë fund, se nuk mund të sqarohet me Edin, se në senatorium kishte bërë skandal pa asnjë përfitim. U fut mes pemëve i dërmuar shpirtërisht dhe aty pak më tej u rrëxua në bar me fuqi të prera. I shtrirë pëmbys në tokën e ftohtë dukej si i vdekur. Kokën e kishte të turbulluar, sikur t'i kishin rënë me dru. Ndenji mjaft ashtu pa lëvizur fare. Pastaj u kthye në kurriz. Psherëtiu thellë. Zemra i dhëmbte.

Ai e pyeti vehten: E kishte humbur vallë përgjithëmonë Edin? A mund dhe a duhej ta shkulte nga zemra? A mund të pranonte se ishin bërë hi e pluhur shpresat e zjarra, fantazitë? A ishte e mundur të rronte pa Edin? ! A mund të tërhiqej fatkeq dhe i mundur? Rënkoi. U kthye përsëri në kurriz i vvarë, i dërmuar.

U përpoq nëpër bar. Pastaj u kthye prapë në shpinë dhe soditi yjet larg. Drita që vezullonte dobët, që vinte prej shumë, shmë lart, prej qindra vjetësh largësi, sikur i kujtoi Timurlengun. Kishte lexuar dikur në gazetë se ç'i kishte ndodhur pas disfatës së parë. Timurlengu e kishte braktisur ushtërinë i dëshpëruar dhe tek rrinte në hijen e një lisi, kishte parë një mizë përdhese që po ngrinte në breg një kokërr rërë. Miza e kishte ngritur kokrrën e tërshërës, pasi ishte rrukullisur poshtë bashkë me të tridhjetë herë. Gjenerali i madh ishte mahnitur dhe kishte thënë me vehte: "Një mizë nuk u mposht nga tridhjetë disfata, po unë? ! "Dhe ishte kthyer prapë në beteja.

Besnikun e ngushëlloi kjo gojëdhënë dhe mendoi se nuk duhej të sprapsej, se duhej ta kishte edhe ai shembull mizën e dheut. Të ftohtët i kishte hyrë gjer në palcë. Po dridhej i tëri. U ngrit dhe u nis në shtëpi i trishtuar.

## X.

Besniku i afrohej aparatit të Komitetit Qëndror të PPSH. E kishte thirrur në zyrën e vet sekretari i Komitetit Qëndror. Atë nuk e mallëngjeu ndërtesa e madhe nga ku drejtohej gjithë vendi, ashtu si i ndodhte dikur. Rrugët e asfaltuara mes gjëlberimish, koridorët, shkallët, që dikur i përshkonte një vit e ca çdo ditë me gëzim e krenari tani iu dukën të ftohta dhe sikur e përzinin. Ja edhe dera e dhomës, ku punonte para një viti si instruktor i letërsisë pranë aparatit të Komitetit Qëndror. Tani bluante mendime krejt të ndryshme nga ato që mbronte me zjarr në këtë zyrë. Kaloi i ftohtë para saj dhe trokiti dy dyer më tej.

Sekretari i K. Q. , një burrë i gjatë, i zeshkët, i thatë, priti sa u afrua dhe i dha dorën i akullt. Besniku u ul. Dikur aty mblidhej për të diskutuar problemet e Lidhjes së Shkrimtarëve. Edhe tani për problemet e Lidhjes e kishin thirrur , po me një kuptim krejt tjetër dhe po priste. Sekretari si formalisht rregulloi diçka në tavolinë dhe e pyeti:

- Si është puna? Ç'janë ato teza që ke ngritur në Lidhjen e Shkrimtarëve?

Dhe ai e vështroi ftohtë, serbes. Një fije zemrimi dhe kërcnimi shkëlqente në dritën e syve të tij.

Besniku u përgjegj me zë të ulët, thjeshtë:

- Ato që mendoja dhe që janë. . .

Sekretari foli me habi e zemrim:

- Po na i thuaj t'i dëgjoj dhe unë.

- Mendimi im është se metodën e realizmit socialist nuk duhet ta ngushtojmë në kanune artificiale. Letërsia e sotme shqipe nuk është në lartësinë e duhur se mbështete krejtësisht në letërsinë sovjetike dhe ka nënvleftësuar letërsinë klasike botërore.

Qepallat e sekretarit u përplasën me habi. Ai nuk po i besonte veshëve, sikur nuk po kuptonte ku ndodhej, kush ishte ky djalosh dhe bile ai vetë.

- Sipas teje letërsia sovjetike e pengoka zhvillimin e letërsisë shqipe? !!

- Jo nuk dua të them atë. Ne duhet të mësojmë nga shkrimtarët e saj të mëdhej Gorku, Majakovski, Shollohovi, por në vazhdim të gjithë letërsisë botërore.

- Nuk mësoke ti nga Goergi Gulia? !

Ishte shkrimtari sovjetik që po vizitonte ato ditë Shqipërinë.

Djaloshi u përgjegj me pafajësi:

- Në një kuptim ne mund të mësojmë nga të gjithë, bile edhe nga një fshesaxhi.

Sekretari i K. Q. i ra me pëllëmbë tavolinës dhe kërcnoi;

- Si flet kështu? ! A e di ti se ku je këtu? ! Merre vesh se je në zyrat e Komitetit Qëndror të Partisë. Si guxon të krahasosh shkrimtarin sovjetik me një fshesaxhi? ! . . S'ke turp! . . Ke qenë edhe punonjës i këtij aparati!

Besniku uli kokën. Sekretari u ngrit më këmbë, vajti te biblioteka, që ndodhej në mur, mori një libër dhe tha:

- Na i ngren pak si tepër klasikët e letërsisë botërore. Unë e kal lexuar dikur "Iliadën", para dhjetëve vjetëve dhe ndofta mund t'i hedh një sy edhe ndonjë herë tjetër, por këtë libër - Ai kishte në dorë raportin e Malenkovit të mbajtur në Kongresin XIX të P. K. të B. S. - e lexoj çdo ditë, e mbaj në tavolinën e punës.

Për Besnikun ishte një kulm injorance që Malenkovi të vlerësohej më i rëndësishëm se Homeri që jetonte prej më shumë se dy mijë vjetësh, por ai heshte i vendosur të mos çilte gojë deri sa nuk lejohej të fliste aty atë që dëshëronte. Sekretari foli edhe pak dhe duke e parë që tjetri heshte, i tha:

- Me këto mend nuk është e arësyeshme të shkosh në Bashkimin sovjetik. Sipas teje atje nuk ke as ç'të mësosh. Shko në ministri dhe dorëzo pasaportën.

Besniku e priti qetë këtë ndëshkim. Ishte i pregatitur. Disa shokë e kishin porositur atë ditë që të tërhiqej nga mendimet e tij qoftë sa për sy e faqe dhe të shkonte në Bashkimin Sovjetik. Po atij iu duk e pandershme kjo gjë dhe foli atë që mendonte.

- Ke gjë për të thënë? - E pyeti tjetri.

- Jo - U përgjegj thjeshtë Besniku.

U ngrit dhe pa i dhënë dorën, doli nga zyra.

- Realizmi socialist është një dogmë, një shpikje, një teori artificiale e huajtur nga Bashkimi Sovjetik. - I fliste Besniku Agimit, ndërsa ecnin nga rruga e dispanserisë - Rezultatet e tij i sheh qartë po të lexosh "Pranvera në Saken" dhe "Kalorësin e Yllit të Artë". Këto teori kanë si qëllim ta ngushtojnë artin e ta pengojnë. Në letërsi ka vetëm realizëm. Shih e shkruaj të vërtetën. I vetmi ligj i krijimit letrar është realiteti, e vërteta.

Agimi dëgjonte si i ngrirë këto fjalë dhe nuk u besonte veshëve. Nuk dinte asgjë për ngjarjet që kishin ndodhur në Lidhje. Kishte vërtetë një farë pakëmaqsije ndaj veprave kontemporane shqipe dhe sovjetike, thjesht nga ana artistike, por nuk

mund të hidhte kurrë poshtë rrymën e realizmit socialist siç po bënte tjetri.

Një ditë si krejt rastësisht kishte dëgjuar një emision të radio Londrës. Problemet estetike për të cilat kishte folur spikeri i kishin bërë shumë përshtypje, por ai nuk kishte dashur të mendonte rreth tyre. Tani zbuloi një farë ngjashmërie mes radio Londrës dhe Besnikut dhe kjo e tronditi. Menjëherë mendoi se kishte të bënte me influencën borgjeze dhe u çudit se si i ndodhte kjo një komunisti. Duke dashur t'i mposhte këto pikëpamje, u kundërvu:

- Ti po flet për çart. E mohove krejt rëndësinë e teorisë, të estetikës dhe s'ke fare parasysh mësimet e Leninit. Ç'është kjo fjalë: i vetmi ligj i krijimit letrar është realiteti? Realiteti është një si për borgjezinë, ashtu edhe për komunistët, por gjykimet rreth tij ndryshojnë. Borgjezia jep një pasqyrë të shtrembëruar të realitetit, kurse proletariati e jep të saktë. Revolucionarët të udhëhequr nga teoria e tyre, ecin përpara dhe e transformojnë botën.

Besnikut iu duk Agimi si një nxënës që jep provim para profesorit, prandaj e kundërshtoi me përçmim:

- Pallavra të vjetëruara. . I ke mësuar për menç në historinë e PK të BS. Në Shqipëri nuk bëjnë gjë tjetër veçse përtypin formulat e këtij libri tamam si hoxhallarët kuranin. Dhjetë vjet po lexojnë po ato faqe dhe kujtojnë se e përvetësuan diturinë botërore.

Qepallat e Agimit u përpëliten, frika ia shtrëngoi zemrën dhe një copë herë eci i heshtur, i mpirë. Dyshoi se tjetri mos e provokonte. Pastaj i foli i zemruar:

- More, a je në vehte? ! Ti të mohosh teorinë marksiste? Harrove se Lenini ka thënë ose teori proletare ose teori marksiste? Hedh poshtë romanin tënd. Ne jse ajo është vepra jote dhe puna jote. Mohove letërsinë tonë, letërsinë sovjetike, realizmin socialist dhe së fundi po llomotit për marksizmin?

Besniku u mbrojti:

- Marksizmin nuk e hedh poshtë. Unë them se nuk duhet të përsërisim si papagallë paragrafet e Historisë së PK të BS.

Agimi qëndroi. E vështroi në sy dhe papritur e akuzoi:

- A i di se këto ide i propogandon borgjezia? Se je përkulur nga lufta e klasave? Mos kujto se janë të rastit këto fjalë. Lidhen ngushtë me luftën e ashpër të klasave që po bëhet sot në Shqipëri. Edhe borgjezia e jashtme ka bërë presion mbi ty.

Besniku, që e quante vehten, jashtë çdo influence, u përgjegj:

- Mos u bëj qesharak, or Agim. Të njoh për djalë të zgjuar.

Agimi buzëqeshi hidhur:

- Nuk dihet se cili prej nesh po bëhet qesharak.

Gjatë bisedës Agimi u bind se tjetri nuk po e provokonte dhe fillozofoi:

- Shpesh herë e kam pyetur veten: pse nuk ka sot art të madh, të tillë si në shekullin XIX ose në kohën e Rilindjes? ! Dhe e kam spjeguar këtë me kalbëzimin e sistemit kapitalist. Fatkeqsisht influenca e borgjezisë hyn edhe në vendet socialiste, na pengon edhe neve. Ti je një shembull shumë i qartë i kësaj influence. Ke patur në kokë të tjera idera, kurse tani je trullorur fare. . . Sa keq!

Ai psherëtiu si nga një vuajtje e madhe dhe shtoi me pasion:

- Kur do të vijë ajo kohë që borgjezia të zhduket nga faqja e dheut, që të vendoset kudo sistemi socialist dhe të shpërthejnë talentet në të gjitha fushat? Atëherë, kur njerëzimi do të jetë i shkëputur nga problemet e luftës së klasave, do të derdhen energji të mëdha edhe në fushën e artit. Atëherë njeriu i thjeshtë i çliruar nga shfytëzimi dhe ideologjia borgjeze do të ngrihet në një shkallë shumë të lartë. Bota nuk do të ketë tek tuk njerëz të zgjuar, por do të mbushet me gjeni. Unë kam besim të patundur se kështu do të ndodhë. Njeriu ka aftësi të pafundshme, të cilat do të shfrytëzohen plotësisht vetëm në kushtet e komunizmit. Kjo prespektivë mua më entuziazmon dhe më shton energjitë.

Besniku iu dukën përçartje këto fjalë dhe e kundërshtoi me përbuzje:

- Këto janë ëndrra në diell. Bota do të mbesë ashtu si ka qenë.

Agimi ia priti i zemëruar:

- Nuk beson ti se proletariati do ta ndryshojë plotësisht botën dhe veten? !

- Po e shoh si e ka ndryshuar në Shqipëri.

Këto fjalë e goditën Agimin. Nga dhoma ai ndiqte me kujdes ekonominë e Atdheut në të gjithë fushat. Analizonte planet e shtetit, shifrat e realizimeve, buxheti. Lexonte lajme dhe reportazhe ekonomike. Kur takonte ndonjë të njohur, që punonte në sektorin e prodhimit, e mërziiste me pyetje.

- Në Shqipëri janë bërë shumë gjëra, zotni Besnik! - Foli me inat - Një nga sukseset është dhe paisje jote me kulturë gjer në atë shkallë sa të përrallisësh kundër teorisë marksiste. Por unë fola për të ardhmen, kur nuk do të ketë fare gjurmë klasash.

- Bota njësoj do të mbetet. Po këta njerëz do të jenë.

Agimi e vështrroi drejt në sy me keqardhje Besnikun.

- Nuk po të njoh fare. Ti ke ndryshuar krejt. Të mbetesh të mohosh vetëm luftën tënde si partizan që të transformohesh në mënyrë të plotë, se në të gjitha re dakord me borgjezinë.

- Në një pikëpamje e mohoj edhe atë! - Shpalli Besniku.

Agimi bërtiti i tmerruar:

- Mohon jetën partizane?

- Mohoj njerëzit që më çuan gjer në atë pikë sa unë fëmijë trembëdhjetë vjeçar të rrok armët dhe të vras, të bëhem kriminel akoma pa filluar jetën, ashtu si edhe ti. Unë e akuzoj njerëzimin. Do të shkruaj fëmininë time dhe ajo do të jetë një protestë kundra njerëzve, kundër shoqërisë.

- Ule, ulë pak zërin. - I bëri vërejtje Agimi.

E tërhoqi në errësirë, i nguli sytë i dëshpëruar:

- Nuk të vjen turp nga vehtja? ! Nuk skuqesh që ke qenë revolucionar qysh në fëmëni? Je anëtar Partie e flet kështu? Unë një ish ballist të shpjegoj ty socializmin, të sulmoj borgjezinë?

“Gjithëmonë të kam patur zili. Ti për mua ke qenë revolucionar i vërtetë, njeri me vlerë, ideali im në një farë mënyre. Të kam mbajtur gjithmonë si në piedestal, pse i vogël ke luftuar armikun dhe kam mdjerë inferioritet të tmershëm ndaj teje, pse jam ngritur një kohë kundër idealit tënd. Endrra ime ka qenë të të ngjaj ty dhe kjo më ka shtyrë të punoj në muzikë se është e neveritshme që njeriu të kalojë si krimb antirevolucionar nëpër botë. Dhe ti tani, komunist, do të më mbushësh mendjen mua të kthehem atje, ku kam qenë? ! Të bëhem prapë ballist! Turp për ty! Nuk mund të marrësh me mend sa poshtë ke rënë! Mblidh veten!

Askujt Besniku nuk i ishte shprehur kaq hapur dhe askush nuk i kishte bërë një kritikë aq të rreptë. Mendimet e Agimit, sidomos fjalët e fundit plot zemërim, iu dukën shumë të sinqerta dhe e hutuan, e lëkundën. Për herë të parë dyshoi se diçka nuk ishte e saktë në pikëpjetet e veta të kohëve të fundit. Ai u largua nga shoku i shqetësuar, i pa fuqishëm, i mbytur në dyshime. Donte të ishte unik, të mos vuante, por nuk mundëte. Në këtë botë të gjërë, të pakufishme u ndje i vetmuar. As dashuria për Edin nuk e ngushëllonte. Në këto çaste shpirti i pati nevojë ta takonte Hysenin. Ai e ndjente atë mik, të afërt, njeri që e kuptonte. Vetëm atij mund t'i shprehej lirisht dhe vetëm tek ai mund të qetësohej. U drejtua në shtëpinë e tij.

## XI.

Rrugës po mendonte për letrën që i kishte dërguar Hyseni Qeverisë Shqiptare, ku kishte kërkuar ta lejonin të largohej në Perëndim. Kjo kërkesë atij i ishte dukur e habitshme, krejt e paarësyeshme dhe e kishte këshilluar shokun mos ta dërgonte në asnjë mënyrë duke e paralajmëruar se mund të ndodhte edhe ndonjë e papritur, se edhe mund ta arrestonin. Hyseni kishte ngulur këmbë në të tijën duke qenë i bindur se ligjërisht nuk mund të mirmin asnjë masë administrative. Besniku kishte buzëqeshur hidhur dhe i kishte thënë se ligjet Qevria i zbatonte sipas interesit të vet. Pastaj i kishte kërkuar që ta shtynte dërgimin e letrës një javë. Shoku kishte pranuar. Gjatë kësaj jave Besniku ishte përpjekur të takohej me sekretaren e Partisë të Qytetit të Tiranës që ta lajmëronte për kërkesën e Hysenit dhe të konsultohet në kishte ndonjë rrugë dalje me mirëkuptim. Por ajo e kishte refuzuar takimin. Pasi Besniku nuk kishte mundur të bënte asgjë për të penguar përplasjen e Hysenit me shtetin, i kishte thënë që nga ana e tij ishte i lirë ta dërgonte letrën.

Kishte tri javë që Hyseni e kishte postuar letrën dhe nuk kishte ndodhur ndonjë gjë, prandaj edhe Besnikut i ishin larguar mendimet e këqia. Arriti në shtëpinë e shokut, hapi portën dhe si gjithëmonë thirri në derën e sallonit:

- Hys! O Hys!

Një hop s' u dëgjua kush. Një heshtje e madhe mbretëronte në shtëpi. Pastaj dikush lëvizi në dhomën matanë. Dyshemeje kërciti. Sabrija u duk me fytyrë të vrazdë. Ajo iu afrua ngadalë dhe pëshpëriti:

—Më trembe! . . Ç' thirrë kështu? !

Besniku buzëqeshi me dashamirësi dhe i foli:

- S' e paskam ditur. Paske zemër pule. Po flije kështu? ! . . Më dukesh si e përgjumur. .

- Nuk flija, por hallet - Pëshpëriti ajo.

Besniku u merakos:

- Pse , ç'ka mdodhur? !

- S' e di ti? ! - U habit ajo.

- Jo. . - Tha Besniku duke ndjerë diçka të keqe.

- E arrestuan Hysenin. . - Tregoi ajo si në të qarë.

Besniku u pre. Zemra iu ngushtua. Hyri në dhomë i heshtur. E bija pesë



vjeçe po hante bukë dhe as nuk e çoi fare kokën që të shihte se kush erdhi. Ishte mekur. Në faqet e zbeta dukeshin gjurmë lotësh. Qoshja e oxhakut ishte bosh. Çiltja nuk ishte zhubrosur. Dukej se aty nuk ishte ulur kush.

Besnikut iu përfytyrua se si aty gjetë ditëve të ftohta të dimrit Hyseni, si ndonjë plak i lashtë, rregullonte zjarrin, i frynte, shtynte urat dhe kënaqej pa masë duke u ngrohur. Pastaj ngrinte kokën dhe vijonte të shtjellonte mendimin e tij ose të tregonte ndonjë histori, anekdotë me një gjuhë të kulluar, të rrjedhshme, plot shprehje të bukura. U ul në karrike i trishtuar dhe pyeti me dhëmbje:

- Kur kështu? . .

- Pambrëmë. Të gjithë po pregatiteshin për festën e vitit të ri dhe atë e muarën.

Bëlbëzoi ajo dhe nuk u përmbajt. Lotët i rrodhën nëpër faqe. Ktheu kokën dhe u përpoq të qetësohej. E bija mbaroi së ngrëni dhe rrinte si e ngrirë. Në shtëpi qetësi e dhëmbshme. Në vatër s' digjej zjarr. Hyseni gjëndeje në burg. Gruaja dhe vajza dukeshin të shkreta dhe të vetmuara. Besniku rënkoi i pikëlluar dhe foli:

- I thashë mos e dërgo letrën se edhe mund të arrestojnë. Por s'më dëgjoi. Pastaj, edhe sikur ta lejonin të shkonte në Perëndim, ai nuk duhej të pranonte se do të shkatërrohej. U përpoqa të këshilloheshim edhe me shokët e Partisë, por ata nuk më pranuan në takim.

Sabrija u kthjellua pak dhe foli:

- Edhe unë e luta mos ta dërgonte letrën, mos të bëhëj budalla se nuk e shpinte njeri në Perëndim. Sikur ma ndjente zemra të keqen. Atë e arrestuan, unë mbeta qyqe në shtëpi. Vjehri iku. Mori dyshekun në krah dhe sigurisht ka fjetur në dyqan. U largua mbrëmë se gjoja nuk më të flinte në shtëpinë e reaksionarit. Desha të vija në shtëpinë time se kisha frikë të flija fillikat, por im vëlla nuk më pranoi. Ti hajde tha, po e bija mos të shkelë prakun.

Asaj prapë iu nbushën sytë me lot, fjala iu pre. Ktheu kokën sa u qetësua dhe shtoi:

- Bile m'u mblodhën dhe më kërkonin ta ndaja. I ra një e keqe atij dhe unë t'i kthej shpinën. Më thoshin se më ka tradhëtuar dikur. Po ta braktisje atëherë, kisha një farë të drejte. Por ata vetë atëherë nuk më lanë, më detyruan të kthehesha prapë këtu, kurse tani ngulnin këmbë:Lëre!

"Hyseni nuk është njeri i keq. Ti e njeh më mirë nga unë. Veç i merr koka erë nga ajo letërsi e mallkuar. Edhe ata shkrimtarët janë vërtetë të liq. Kur e shohin se është kokëfortë dhe nevrík, pse i bien në qafë? ! Ai është i sinqertë dhe i thotë troç mendimet e veta, por sot nuk duhet ashtu.

“Mbrëmë më bëhej nata e gjatë fort, sikur nuk do të zbardhej kurrë. Tani më mori frika sa u err. Nuk e di se si do ta kaloj edhe sonte vetëm. Mbete kërcure me çupën.

Ajo heshti një hop e dërmuar dhe pastaj shtoi:

- Shyqyr që erdhe. Tek ti më shkonte mendja. Besniku, thosha me vete, nuk do ta braktisë.

Besniku u dëshpërua thellë nga fjalët e Sabrijes. E tronditi fakti që i jati kishte braktisur shtëpinë dhe kishte vajtur me dyshek në krah të flerë në dyqan. U rrevoltua nga sjellja e vëllait të Sabrijes dhe e vështroi me dhëmbje vajzën e vogël. Ai e kuptoi se bota po i shfaqej e pamëshirëshme.

Në oborr u dëgjuan këmbë. E zonja e shtëpisë ngriu. Pëshpëriti e tronditur:

- Kush është kështu? ! Kush mund të vijë në këtë orë? !

Vështroi në dritare dhe foli e shqetësuar:

- Vjehri. . Më prit një minut. .

Ajo doli. Dikush eci në sallon dhe u futën në dhomën ngjitur.

Plakun e kishte vrarë shumë burgosja e të birin. Ai ruante për njerëzit e qeverisë po atë nderim që kishte pasur në luftë dhe besonte se ata nuk e kishin arrestuar kot Hysenin. Ishte zemëruar me të birin dhe e kishte nemur.

Pas kthimit nga Bashkimi Sovjetik e kishte humbur besimin e parë te djali dhe e shihte me dyshim. Nuk i pëlqente që ai shkruante e shkruante pa nxjerë gjë në dritë. Pastaj ishte i pakënaqur që grindej me shkrimtarët. Kurse tani kushedi se ç’pauhdësi kishte bërë që Qeveria ishte detyruar ta kapë. I vinte turp nga vehtja, nga i biri, nga shtëpia dhe plak i thinjur kishte marrë një dyshek dhe flinte në dyqan aty në çimento. Vonë, kur po errej ,po hynte në shtëpi si hajdut. Ishte mekur, fytyra i qe tharë. Dukej më i mplakur, më i kërrusur. Ajo ditë larg shtëpisë e kishte dërmuar.

Pyeti ngadalë se kush ishte brënda. U fut në dhomën tjetër. U ul në karrike i këputur. Ktheu vështrimin e vrarë nga e reja dhe i tha:

- Ke marrë vesh gjë?

- Jo. . Pëshpëriti ajo dhe sytë iu përlotën.

Plaku uli kokën, rënkoi dhe foli me zë të ulët, të dredhur:

- Ç’dite ja arrita! Më turpëroi në pleqëri. S’takohem dot në rrugë me të njohur dhe fas e fis. Më skuqet faqja. Sikur më godasin në lule të ballit kur më pyesin për Hysenin. Pleqëri e mallkuar!

“Oh, si nuk u gjend një sahat i bardhë në luftë dhe s’e mori një plumb. Oh, djalë, djalë, kur s’të qava!

Atij iu drithërua trupi. Iu ligstua zemra, iu përlotën sytë. Ngriti duart, mbuloi me pëllëmbë fytyrën, uli kokën dhe për çudi, ashtu si nuk kishte bërë kurrë në jetën e tij të gjatë, ia plasi vajit.

E reja shtangu e nemitur nga pamja e dhëmbshme e babit. Nuk vuante aq shumë sa ai dhe kjo sikur ia lehtësonte dhëmbjen. U prek nga gjëndja e rëndë e vjehrrit, po nuk dinte ç't'i thoshte. S'guxonte ta ngushëllonte. Plaku pushoi sa iu derdh hidhërimi dhe duket u turpërua. Fshiu sytë, mustaqet, mblodhi veten e tha:

- Nuk kish njeri më të dashur dhe më të lëvduar se ai në Parti. Nëntëmbëdhjetë vjeç kishte në komandë tre qind burra. Djalë për kokën e djalit. S'i thashë një fjalë kur vajti në mal. E kisha për mburrje se përpiquej për Shqipërinë. Luftuam, e çliruam vendin. Po tani ç'kërkon më? ! Hasmë në vatër s'ke, shokët tëmd qeversin. E kishin mbi krye të tërë. I dhanë bursë të mësojë. E flaku. Ishte në Parti. Doli. . . . Ç'mëkat paskam bërë që më dënon Perëndia kështu? !

Pëshpëriti prapë thellë, u ngashërye dhe dukej se ishte gati prapë të qante. Pastaj i tha Sabrijes që do të flinte në dyqan dhe doli. Nga dritarja Besniku vuri re se shkonte i kërrusur dhe fshinte lotët.

Ai ishte prekur shumë nga fati i familjes së shokut. I dhëmbej Sabrija që do të flinte vetëm me frikë në zemër. Para syve i mbeti fytyra e ngrysur e vajzës së vogël dhe babai i mjeruar.

Besniku doli dhe tek kthehej në shtëpi iu kujtuan shkrimtarët, Andrea, Telhaj, Filipi, Mihali, që e kishin goditur veprën e shokut. Ata tani rrinin në hotel Dajti, pinin kafe të mbështetur në kolltuqe luksoze, bisedonin për letërsi dhe përsëritnin të njejtat gjëra. I përfytyroi pastaj tel dilnin rëndë, tek ecnin kryelartë nëpër plakat e pastra dhe tek kthenin në rrugë përshëndetjet me lëvizjen e lehtë të kokës, të kënaqur që njerëzit i shihnin me interes dhe nderim për ato që kishin krijuar.

Ai ishte i bindur plotësisht se Hyseni ishte i ndershëm, shumë i talentuar dhe megjithë kërkesën e gabuar për të vajtur në Perëndim, e donte Atdheun shumë më tepër nga ata, prandaj i vinte për të qarë që ata ishin të nderuar, kurse ai i burgosur.

Arriti në shtëpi dhe hyri në dhomë. Aty gjëndej si edhe më parë krevati, tavolina, karrikja dhe kishin ndryshuar vetëm portretet e varura në mur. Në vend të fotografisë së Gorkit, poshtë së cilës ishte shkruar: "Fjala njeri tingëllon krenare", ishte vënë një vizatim i Hamletit me shprehjen: "Të rrosh apo të mos rrosh - Kjo është çeshtja." Te tavolina ndodhej portreti i Ljermontovit në vend të atij të Majakovskit.

Besniku u ul në tavolinë dhe filloi të shfletojë një vëllim me poezi të Hysenit që i ndodhej aty. Në këto çaste revoltimi dhe keqardhje iu paraqit vepra në një

dritë të shkëlqyer, sikur ajo shprehte saktë të vërtetën e jetës, bile ishte gjeniale, ashtu si deklaronte vetë autori. Lexoi i entuziazmuar baladën e çimkave. Aty përshkruhej se dikush i vinte zjarrin shtëpisë për të çfarosur çimkat që simbolizonin meskinët. Në ato çaste truri iu ndez nga një flakë e turbull që ia errësoi shikimin e qartë mbi botën dhe iu duk se këtu shoku kishte arritur kulmin e të vërtetës.

Iu kujtua drama që kishte vendosur të shkruante për Neronin. Përytiroi skenën e fundit, ku Roma ndizej yll, kur flakët e pamëshirëshme shkruamonin të varfër e të pasur dhe njerëzit të gjithë këlthisnin të tërbuar, si të çmendur. Aty Neroni qeshte dhe flakte në zjarr një fëmijë duke thënë: "Roma nuk meriton të jetojë! Romakë, të varfër dhe të pasur, nuk jini gjë tjetër veçse mij të ngopur dhe të uritur! "U entuzazmua nga veprimet e Neronit, i cili në emër të virtyteve të larta shkruante njerëzit në zjarr dhe mendoi me krenari se kjo skenë do të shprehte më me forcë idenë e baladës së çimkave.

Si u kënaq me këto përfytyrime, iu kujtua prapë Hyseni. Rënkoj plot hidhërim dhe dëshëronte të bënte diçka në mbrojtje të shokut. Befas i erdhi në mendje t'i shkruante një protestë KQ të Partisë për burgosjen e Hysenit. I pëlqeu dhe u ndez nga kjo ide, pamvarësisht nga konsequencat që do të kishte. Parashikoi gjer burgim për shkak të kësaj proteste, por nuk u tremb. Nuk mund të heshte, kur ndodhej në burg shoku i tij poet. E shkroi dhe të nesërmen e postoi qysh në mëngjez.

## XII.

Kadriu eci ngadalë në koridor, hyri në kuzhinë dhe pyeti t'ëmën me zë të ulët:

\_Erdhi Besniku?

- Hala s'ka ardhë. . - U përgjegj e ëma që po gatuate gjellë ndenjmur në bisht te vatra.

E çuditur që djali i madh po e kërkonte, pyeti me frikë në zemër:

- Pse? Ç'e deshe? !

Kadriu qëndroi në mes të kuzhinës dhe foli i hidhëruar:

- Besniku ka bërë një gabim të madh, o nënë. I ka dërguar qeverisë një letër dhe e ka sharë pse është burgosur një reaksionar.

- Qyqja! - Bërtiti nëna Sania, sikur t'i kishte rënë shtëpia në kokë.

Ajo ishte një grua e urtë shtëpijake. Nuk dinte mirë ç'ishte qeveria dhe kurrë

nuk kish parë qeveritarë. Iu duk një hata e madhe që Besniku t'i kishte sharë me letër dhe u tremb mos e gjente ndonjë e keqe të birin. U ngrit më këmbë, iu afua Kadriut dhe u shpreh plot hidhërim:

- Pse kaq budalla qenka ky sa të mësojë qeverinë? ! Ç'i duhet reaksionari atij? ! Ne jemi shtëpi komuniste. Po ky paska lafit fare. Kushedi ç'do t'i bëjnë tani!

Dhe ajo rrahu shuplakë, sikur t'i kishte vdekur i biri.

Kadriut i erdhi mirë që e ëma u hidhërua dhe u zemrua kaq shumë dhe i foli:

- Shokët e Partisë më porositën që të këshilloj Besnikun të heqë dorë nga letra. Unë do t'i flas, po thuaj edhe ti që të pranojë gabimin.

Nënë Sania u lut:

- Aman , o bir, mbushja mendjen ti. Në të dëgjoftë ty, se mua s'ma vë veshin fare. E ka kaptinën si guri ai. Një qind sëpata me i ra, një ashkël s'ja nxjerr. Po ky reaksionari ku u bë sebeb që i rëntë një pikë! Medet unë, veç halle po heq prej atij dushmani!

Kadriu u ngjit lart, nëna u kthye te gjella që po digjej. Asaj i ra një hije e zezë dëshpërimi. Iu këputën gjunjët sa s'rinte dot në bisht dhe u ul e lodhur.

Besniku erdhi në shtëpi pas një ore dhe hyri i zymtë në dhomën e vet. Nënë Sanija, që e përgjonte, u ngjit lart me të rrahura zemre dhe e lajmëroi Kadriun. Ai zbriti shkallët i tronditur, trokiti në derë, e hapi, hyri brëndë dhe përshëndeti "Mirëmbërëma" me një pamje të ftohtë. Afroi një karrike dhe u ul ballë Besnikut që rrinte në minder.

Shumë rrallë hynte në këtë dhomë se zakonisht vinte në kuzhinë, ku takonte t'ëmën dhe vëllanë. Besniku e kuptoi se ai kishte diçka të rëndësishme për t'i thënë, se ardhja e tij mund të lidhej me protestën dërguar KQ dhe zemra i rrahu, por u mundua të paraqitej sa më i qetë. Kadriu ia nguli sytë të vëllait dhe i foli me zë të ulët:

- Shokëve të Partisë nuk u ka ardhur aspak mirë për letren që që ke dërguar në lidhje me arrestimin e Hysenit. Sot në një mbledhje më takuan disa anëtarë të Byrosë Politike. Jam habitur se ata gati një gjysmë ore qëndruan me mua në këmbë dhe biseduan për çeshtjen tënde. Kishin konsideratë për ty dhe të donin. Ata thanë se ti je i rrëmbyer dhe je nxituar ta bësh atë letër. Po tani duhet ta shohësh me gjakftohtësi problemin dhe të pranosh gabimin. Mua më kanë dërguar apostafat për këtë gjë. Nuk është e drejtë që ti mos të kesh besim te Partia. Nuk kapet njeri kot në Republikën Popullore të Shqipërisë.

Kadriu heshti. Priste në amkth përgjigje.

Besnikut i erdhi shumë mirë që anëtarët e Byrosë Politke kishin biseduar për të gati gjymë ore, se iu duk që kjo tregonte vlerën e personalitetit të vet, por këshillat e tyre nuk mund t'i pranonte. Ai u përgjegj i prerë:

- Arrestimi i Hysënit për mendimin tim është i padrejtë. Ne e turpërojmë veten duke burgosur një poet të shquar si ai. Kjo është bindja ime dhe unë nuk mund t'ia fsheh Partisë.

Një hop tiparet e fytyrës së Kadriut sikur ngrinë. Këto fjalë të paka ia shuan edhe atë shkëndijë të vogël shprese që pat. Ai u bindej udhëheqsëve të Partisë pa hezitim dhe mendonte se ata gjithënjë kishin të drejtë. Mbrojtja që i bënte Besniku një personi që kishte shkruar vjersha armiqsore dhe që kishte kërkuar të shkonte në Perëndim, i dukej jo vetëm antiparti, por edhe një marrëzi e plotë. Një zemërim i madh mgrinte kokë dhe ai pyeti me inat:

- Pse ti do të dalësh mbi KQ të Partisë dhe t'u japësh urdhëra atyre? ! Ti do t'i mësosh ata kë të arrestojnë dhe kë të lirojnë? !

Besniku u përgjegj gjakftohtë, por i vendosur:

- Jo. . Unë kam shprehur vetëm mendimin tim. Nuk pranoj të jem një vegël qorre në Partinë time.

Vëllait të madh i dogjën këto fjalë, se e kuptoi që ai po e akuzonte se ishte vegël qorre, por e shtypi zemrimin duke menduar se ndryshe mund vetëm të prishte punë. Në këto çaste, kur në mes tyre mund të hapej një hendek i madh, kur mund të ndodhte një shkëputje e plotë, iu kujtuan ndjenjat më të ngrohta që kishte provuar për Besnikun. I harroi rastet e ndryshme të grindjeve dhe të pakënaqsive dhe u shpreh kështu:

- Nuk mund ta marrësh me mend se çfarë dashurie kam për ty dhe nuk është e nevojshme të bëjmë deklarata se nuk jemi kalamaj. S'ka njeri në botë që e don të mirën tënde më tepër nga unë, prandaj vëri vesh fjalëve të mia. Më ke vëlla të madh dhe disa çeshtje i gjykoj më thellë nga ti. Duhet ta kuptosh se po nuk bëre autokritikë, do të përjashtohesh nga Partia. Mendohu mirë se rruga që ke zënë është krejt e gabuar. Edhe në Lidhjen e Shkrimtarëve nuk janë dakort me ty. Ata janë më të vjetër, me përvojë, shokë Partie dhe ti duhet t'i dëgjosh, po deshe të bëhesh shkrimtar i mirë. Mos të rritet mendja se je i ri dhe nuk mund të dish gjithshka.

Besniku e dëgjoi i heshtur. Fjalët për dashurinë vëllazërore i prekën ato ndjenja që ishin formuar gjatë jetës së përbashkët, sidomos gjatë luftës. Por në shpirtin e tij në këto çaste më tepër sundonin ndjenja të tjera. Ai i zmadhonte së tepërmi

grindjet familiare. Tani i dukej vëllai një mekanizëm i verbër. Bindjet e tij politike ose i çmonte pak ose i përbuzte. Duke dashur të justifikonte qëndrimin e vet dhe t'i mbushte mëndjet vëllait, ai i foli për dëshirat e tij për të krijuar vepra të vërteta arti që të ishin dinjitoze për epokën e re.

Kadriu nuk i mori aq seriozisht shpresat e tij për të krijuar vepra të mëdha, por duke dashur të mos e fyente, i foli me të butë:

- Mirë, unë nuk kam ndonjë kundërshtim për këto, por çeshtja tani është te letra. Do ta tërheqësh? !

- Jo. - U përgjegj shkurt dhe i vendosur Besniku.

Kadriu i lëvizën qepallat. Diçka u thye brënda tij. Për të kjo fjalëzë e vogël "Jo" thoshte shumë. Ajo dëshmonte se i vëllai e flakte Partinë dhe shkonte si teveqel pas Hysenit, se gjithshka mes tyre po rrokullisej drejt fundit. Dhe ai ndjeu ndaj vëllait mëri dhe ftohtësi të madhe. Dyshoi se Besniku që vepronte kështu mund të kishte shumë rezerva, se ndofta mund shkonte aq larg sa nuk pritej. Tani atë e lidhte me Besnikun vetëm ajo një farë dashamirësie që kishte shprehur udhëheqja për të. I erdhi shumë keq që vëllai ngulte këmbë në rrugë të tillë, por e shihte se s'kishte ç'të bënte. Ai ungrit i rrevoltuar dhe doli i peznatuar. Nëna që i dëgjonte pas dere me zemër të ngrirë, e pyeti:

- Ç'thotë? !

Kadriu u përgjegj me zemrim dhe i dëshpëruar:

- Po kokën e tij!

Nënë Sanija hyri brëndë në dhomë me një pamje të mjeruar dhe iu derdh të birit me qortim:

- Pse nuk e dëgjon vëllanë e madh, o bir! Ai për të mirën tënde e ka. Pse ta shash qeverinë ti? ! Ç'të duhet ty reaksionari? Për hatrin e nënës, bëj ashtu si të tha vëllai. Nuk mund të jesh ti më i mënçur se qeveria.

Besniku ia ktheu me mospërfillje:

- Mos më çaj kokën. Mbylle derën dhe shko!

Nëna mbeti e shastisur. Nuk dinte ç'të thoshte e ç'të bënte. Biri i saj nuk ishte si dikur i vogël që t'i skuqte faqet e shalët me shufër. Ajo e ndjeu veten të dobët se nuk mund t'ia ndryshonte mendjen atij dhe klithi e dëshpëruar:

- Ç'e ke këtë kaptinë kaurri kështu që nuk gdhendesh edhe me të ra kres me pushkë! O zot, më merr shpirtin që të shpëtoj prej këtij!

Dhe ajo doli jashtë.

Besniku mbeti vetëm dhe i piklluar.

Pas dy ditësh Besniku hyri në zyrën e kryetarit të Lidhjes, ku do të bëhej mbledhja e organizatës bazë për të shqyrtuar protestën që i kishte bërë Komitetit Qëndror dhe u çudit, kur pa Aliun që po bisedonte me Ismailin dhe Andrean. Fytyra iu çel, iu afrua dhe i zgjati dorën anëtarit të Byrosë Politike, që gjithashtu i buzëqeshi dhe e vështroi qetë me ata sy të mëdhej.

Nga pamja e jashtme dukej se asgjë nuk kishte ndodhur mes tyre, megjithatë Besniku dalloi ftohtësi dhe qortim. U ul në kolltuk i tronditur. Të gjitha parashikimet e tij për zhvillimin e mbledhjes u shembën. Fjalët e ashpra me të cilat kishte menduar të mbrohej, vendosmëria dhe mospërfillja që duhej ta karakterizonte në këtë mbledhje, u tretën. Ai nuk mund të mbante një qëndrim të keq ndaj Aliut, për të cilin ruante një respekt të thellë qysh në kohën e luftës dhe ishte i bindur se ai e donte me të vërtetë. Djaloshi u hutua dhe nuk e dinte fare se si do të zhvillohej mbledhja. Pas pak të gjithë zunë vend me një pamje të zymtë.

Mihali, si sekretari i organizatës së Partisë, u ngrit me një pamje të qetë e të natyrëshme dhe ia dha fjalën të deleguarit të K. Qëndror të Partisë. Aliu nxori ca letra nga xhepi dhe me një ton të butë filloi:

- Jini në dijeni për një letër që i ka dërguar KQ shoku Besnik. E quaj të arësyeshme që ju të njiheni me të.

Dhe ai lexoi thjesht letrën. Aty thuhej se Hyseni me vjershat, tregimet, me poemën fantastike e kishte vënë veten me figurat më të shquara të letërsisë shqipe. Pastaj më poshtë deklarohet se burgosja e Hysenit ishte e padrejtë, se pasardhësit do të indinjoheshin nga ky akt dhe bënte thirrje që të lirohej sa më parë poeti. Përmbajtja e kësaj letre e habiti dhe e zemroi Mihalin dhe Filipin. Telhait iu duk përçartje e vërtetë dhe reaksionare. Andrea u vra shpirtërisht se kurrë nuk i kishte vajtur mendja se pas referatit të tij, do të ndërlikoheshin çeshtjet kaq shumë. Ismaili u hidhërua. Edhe vetë Besniku e dëgjoi letrën me një çudi të pakuptueshme, sikur ta kishte shkruar një tjetër.

Pasi e lexoi letrën, Aliu foli:

- Pse e arrestuan organet tona të sigurimit Hysenin? Ne nuk mund të merremi me hollësi me këtë problem e ta vendosim këtu, se nuk jemi këtu as në hetuesi, as në gjyq. Sigurisht Hyseni do të dalë para gjyqit dhe do të vlerësohet me drejtësi fajet e tij. Po ne mendojmë se shoku Besnik është nxituar shumë që u ngrit kundër organeve tona të sigurimit. Të kishte menduar një çikë më thellë mbi ato fakte që dinte. Besniku i njeh mirë vjershat e Hysenit, por prapë të lexojmë nja dy prej tyre.

Ai lexoi një vjershë, ku thuhej se nënat ishin gënjyer për djemtë duke kujtuar se ata do të bëheshin të vlefshëm për Atdheun. Në vjershën tjetër flitej në mënyrë



të errët për beteja të përgjakshme dhe në një të tretë poeti qahej se ishte i vetmuar, i trishtuar, se shokët e vet e kishin tradhëtuar. Si mbaroi leximin e vjershave, Aliu vazhdoi:

- Shoku Besnik duhet ta marrë vesh shumë mirë kuptimin e këtyre vjershave. Me fjalë të tjera këtu propagandohet se komunistët nuk i kanë justifikuar shpresat e popullit, se i kanë tradhëtuar ata, se i shtypin dhe i vrasin njerëzit. Ne nuk mund të lejojmë të thuhet fjalë të tilla për pushtetin popullor. S'e kemi fshehur kurrë dhe e kemi të shkruar në ligjet tona se kemi diktaturë për ata që flasin kundër popullit. Pastaj i lemë të gjitha këto. Po me ç'mendje shoku Besnik shkruan një letër të tillë në mbrojtje të një personi që ka kërkuar të largohet nga Atdheu, në fakt ta mohojë atë dhe të shkojë në Perëndim? ! Atëherë pse e mbron shoku Besnik në emër të socializmit dhe e quan poet të pavdekshëm?

"Poetët e pavdekshëm nuk kanë qenë dhe kurrë nuk mund të jenë të tillë. Partia është treguar shumë e duruar me Hysenin. I ka dhënë mundësi t'i ndreqë gabimet, por çdo mirësjellje ka kufi.

Aliu mbaroi dhe nuk ishte i qetë si zakonisht. Fytyra e tij e bardhë kishte marrë një pamje të kuqe, sytë i shkëlqenin më shumë se çdo herë. Një fije zemrimi dukej në çdo tipar. Besniku u ngrit i hutuar, vështroi fletoren e shënimeve, por nuk dinte nga të fillonte. Nuk kishte atë vendosmëri dhe inatin e mëparëshëm. Ai foli me zë të ulët:

- Unë pranoj se Hyseni ka bërë gabime, se disa vjersha janë të shtrembta ideologjikisht, se ai nuk duhej të kërkonte kurrë largimin në Perëndim. Dihet se jam përpjekur ta ndaloj këtë gjë dhe kam dashur të njoftoj edhe sekretarin e parë, por prapë arrestimin e tij e quaj të paarësyeshëm. Unë pranoj se toni i letrës sime është i ashpër dhe shpreh mëndjemadhësi, por përmbajtja e saj është e drejtë. S'kam ç'të flas tjetër.

Buzët e anëtarit të Burosë Politike ishin hapur pak me çudi. Vështrimi i tij i ngulur mbi Besnikun, sikur kërkonte të zgjidhte një mister.

I pari e kërkoi fjalën Mihali, i cili u ngrit me një pamje serioze dhe tha:

- Nuk dua të cek këtu faktin që Besniku ka bërë një veprim të palejueshëm duke dyshuar në organet e sigurimit. Do të flas pak për vlerën e poezive të Hysenit që ngrihet në qiell në letër. Është një turp që ne të lejojmë të krahasohet Hyseni me Migjenin dhe Naimin. Hyseni si të gjithë ne ka bërë ndonjë vjershë të mirë, por ka shkruar edhe shumë të këqija. Për mua Besniku që ka pikëpamjet që dihen për letërisinë sovjetike, letërsinë tonë dhe realizmin socialist dhe shkruan një letër të tillë Komitetit Qëndror, nuk meriton të jetë në rradhët e komunistëve. Unë

propozoj përjashtimin e tij nga Partia.

Besnikut, që kishte parashikuar edhe burgim për shkak të asaj proteste, tani ia përshkoi trupin një drithmë. Atij i erdhi keq që mund ta zbonin nga Partia. Menjëhërë pas Mihalit u ngrit Telhai, i cili kishte ardhur në mbledhje me një farë gëzimi të brendshëm, që përpiquej ta fshihte.

- Jam plotësisht dakort me propozimin e Mihalit - Tha ai - Unë nuk i spjegoj veprimet e Besnikut vetëm me nxitim, papjekuri e mëndjemadhësi. Çështja duhet të analizohet shumë më thellë. Çdo xhest i tij kohët e fundit është armiqësor, kundra Partisë. Ai sillet me përbuzje ndaj çdo vepre shqiptare dhe sovjetike, ndaj vetë metodës së realizmit socialist. Është kuptim plote mbrojtja që i bën Hysenit që kërkon të largohet nga Shqipëria socialiste. Besniku nuk na e ka hapur barkun neve. Ai është hipokrit dhe mban rezerva të rëndësishme. Ai duhet të flaket nga rradhët tona me motivacionin armik i Partisë.

Fjalët e fundit e rënduan atmosferën e mbledhjes. Besniku ndjeu një urrejtje të madhe kundër Telhait dhe mendoi se kurrë nuk do t'ia falte këto fjalë. U ngrit të fliste lamaili. Fyfyra e tij zakonisht paqësore, e butë shprehte hidhërim. Ai çuditej se si ngjarjet rrokulliseshin kështu dhe i vinte keq për fatin e Hysenit dhe të Besnikut. Por ama e shihte se nuk kishte ç'të bënte, se patjetër duhej të dënohej Besniku. Psherëtiu dhe tha:

- Edhe unë e dënoj letrën e Besnikut për ato arësye që u përmendën dhe jam dakort të përjashtohet nga Partia. Është bërë i huaj ndaj komunistëve dhe s'ka pse të qëndrjë në rradhët e tyre. Sigurisht neve na vjen keq që humbim një shokun tonë, por u përpoqëm mjaft që mos të largohet prej nesh dhe tani s'kemi ç'të bëjmë më. Ne e përkrahëm Besnikun që në shkrimet e para. Kishin shumë dëshirë dhe shumë shpresa që të bëhej shkrimtar i mirë. Bile e përkëdhelëm ca si shumë dhe atij iu rrit mendja. Por megjithatë dua të theksoj se edhe jashtë Partisë ai ka mundësi dhe kohë t'i ndreqë gabimet dhe të jetë një qytetar i ndershëm. Nuk mendoj se ai është armik i Partisë.

Fjalët e Ismailit e mallëngjyen Besnikun, pamvarësisht se edhe ai shprehej qëta përjashtonin nga Partia.

Bile iu duk se kishte të drejtë. se vërtetë ishte bërë i huaj në rradhët e komunistëve.

Andrea, po me atë pamje të vvarë, u ngrit dhe u solidarizua thjeshtë me shokët. Atë e vriste ndërgjegja të shprehej ashpër dhe kjo u kuptua gati nga të gjithë. Edhe Filipi kërkoi përjashtimin e Besnikut nga Partia me ca fjalë të ftohta dhe fyese. Ai nuk kishte patur atë ditë asnjë farë emocioni dhe kishte bërë jetë të zakonshme.

Kishte ngrënë bukë me shije, kishte shkruar një artikull me qejf dhe kishte lexuar rehat. Sipas tij Hyseni dhe Besniku gjenin atë që kërkonin gjersa nuk ishin aq të zgjuar të matnin veprimet e tyre.

Diskutimet kishin mbaruar. Mihali pyeti Besnikun në kishte për të thënë gjë.

Besniku ishte pranuar në Parti për shpirtin e tij revolucionar në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare, duke shkëlur statutin, ku përcajtohej se anëtar Partie mund të bëhej vetëm ai që ishte tetëmbëdhjetë vjeç. Kështu i ishte plotësuar dëshira që i ziente qysh fëmijë, kur luftonte me armë në dorë fashizmin. Të qenit komunist kishte qenë për shumë vite ideali i tij më i lartë dhe tani, që po vendosej të përjashtohet nga Partia, u trondit së tepërmi. Shpërthyen nga shpirti i tij ndjenjat më të thella, më të ngrohta dhe më besnike ndaj komunizmit, por prapë ai nuk mund të ishte dakort me burgosejen e Hysenit. Nga ana tjetër nuk dëshëronte as të përjashtohet nga Partia, prandaj kundërshtoi:

- Unë e pranoj programin e Partisë, luftoj për realizimin e tij dhe nuk është e drejtë të përjashtohem pse nuk jam dakort me një çeshtje të veçantë, si burgosja e Hysenit. Pastaj nuk i kuptokam problemet e artit dhe të letërsisë. Aq mend dhe aq pjekuri kam. Më çoni të punoj në një sektor tjetër, me kazëm fundi dhe do të zbatoj vijën e Partisë aty. Nuk është e arësyeshme të më përjashtoni. Kundërshtoj!

Anëtari i Burosë Politike e pyeti:

- E zemë se ne të gjithë e paskemi gabim, pse ndahesh ti nga ne? ! Bashkohu me ne, sido që të jetë puna.

Besniku u përgjegj:

- Nuk ndahem nga ju. Me ju jam. Po nuk më mbushet mendja për burgosjen e Hysenit me ato fakte që di dhe këtë nuk mund t'ia fsheh Partisë.

Qepallat e Aliut u drodhën me çudi. Nuk pandehte kurrë që Besniku të përgjigjej ashtu, kur rrezikohej të dëbohej nga Partia. U ngrit dhe foli i prekur:

- Shokë, po më bën përshtypje të madhe qëndrimi i Besnikut. Nuk e mendoja kurrë që ai të pranonte më mirë të përjashtohet nga Partia se sa të tërhiqet qoftë edhe një çap nga gabimet. Në Komitetin Qëndror u befasuan nga letra e tij. Unë iu luta shokëve që të më sillnin mua në këtë mbledhje. I sigurova që do ta bindja Besnikun të hiqte dorë nga letra, por dola shumë i zhgënjyer. Besniku paska ndryshuar shumë. Nuk qenka më ai që dija unë. Mua më vjen keq për të se e njoh qysh fëmijë. Ishte kalama, kur luftonte krah për krah me të rriturit. Kurse tani ai po i flak që të gjitha. Si mund të hedhësh poshtë Partinë, shoku Besnik? ! E po mirë pra, në s'kemi se si të mbajmë me zorr. Ti mund të largohesh!

Besniku dëgjonte kokëulur, po me atë pamje kryeneçe dhe dukej se nuk i

bënin asnjë përshtypje këto fjalë, por kjo nuk ishte e vërtetë. Ai u mallëngjye, gati iu zhdukën ndjenjat kundërshtare. Iu kujtua gjithë ato anë të mira që e lidhnin me komunistët dhe konkretisht me persona të njohur udhëheqës të Partisë dhe u prek aq shumë sa mezi mbahej. Lotët i erdhën në grykë.

Sa mbaroi mbledhja, u ngrit menjëherë dhe doli me të shpejtë i pari se për pak do të ndodhte diçka e jashtëzakonshme, mund të qante aty në mes të mbledhjes. Të gjithëve kjo sjellje iu duk armiqsore dhe u habitën. Telhai buzëqeshi, i ra krahëve me dashamirësi Ismailit dhe i tha:

- E sheh? ! Nuk e njeh mirë ti atë!

Besniku shetiti mjaft nëpër rrugët e Tiranës, gjersa i kaloi tronditja. Fshiu gjurmët e lotëve dhe po kthehej në shtëpi, kur dikush e kapi nga krahu. Ishte Esati, me të cilin kishte kohë pa u takuar. Një natë më parë e kishin thirrur në Komitetin e Partisë dhe e kishin pyetur në dinte gjë për letrën e Besnikut. Ai kishte treguar të vërtetën se nuk dinte dhe kishte fshehur me dinakëri kënaqsinë për atë protestë. Tani u gëzua nga ky takim dhe desh të marrë vesh ndonjë të re.

- Ku ishe? ! - E pyti me qëllim Esati.

Besniku tregoi shkurt për mbledhjen, ku e kishin përjashtuar nga Partia.

Esati, pasi e informoi se edhe atë e kishin pyetur për letrën, u çfry me inat:

- Eshhtë një ai Aliu, tamam ujk me fytyrë qëngji! Bëri gabim Hyseni që doli nga Partia dhe ne kot e përkrahëm. U nguta edhe unë burrë në moshë.

Besniku e kundërshtoi:

- Unë mendoj se kam vepruar shumë mirë. Kurrë nuk i kam fshehur Partisë gjëra të rëndësishme dhe as nuk do t'ia fsheh!

Esati e qortoi:

- Ç'përfitove? ! Të nxorrën fishek nga Partia dhe mbetën brënda ca njerëz që janë shumë të liq. Nuk ke mundësi të luftosh as për një vije të drejtë Partie. Ti mirë thua, duhet të jesh i sinqertë, por me kë? !

Ai i futi krahun, e tërhoqi në ca rrugica që askush mos ta shihte ose ta gjurmonte dhe i foli me zë të ulët:

- Ka ardhur koha, kur duhet t'i shikosh çeshtjet më seriozisht. Nuk je më kalama. Në moshën tënde njerëzit kanë drejtuar shtetin. Ti je djalë i zgjuar, prandaj të dua shumë. Nuk nuhat diçka ti? !

- Çfarë të nuhas? ! - Pyeti Besniku duke dyshuar për diçka jo të pëlqyeshme.

Esati u përgjegj me urrejtje:

- Eshte qelbur peshku nga koka. Kujtoja se ngatresat i nxjerrin të vegjëlit,

por nuk qenka e vërtetë. Kam dëgjuar se andej nga Veriu kanë filluar prapë si në kohën e Koçi Xoxes. Po bëjnë kërdi. . . Republika u kalb! . . . Duhet të mendohemi thellë!

Besniku kishte simpati për udhëheqësit kryesorë të Partisë dhe Esatit nuk i besoi. Po prapë e brejtën dyshimet se mos vritej më kot populli i pafajshëm, se mos fillonte një periudhë e zezë si ajo e Koçi Xoxes, se mos shkonte kot gjaku i dëshmorëve. Zemra iu drodh dhe ndjeu një vuajtje të madhe. Nga ana tjetër iu shtua pakënaqësia edhe ndaj Esatit që iu duk atij se fliste për gjëra aq të tmerrshme me një pamje të thjeshtë. Esati sipas tij i ngjante një korbi që ndillte zi.

Edhe Hyseni i kishte folur shumë për diziluzione, kishte shkruar vjershë për nënat e gënjyera, e ndjente veten krejt

të huaj në Atdhe dhe kishte kërkuar zyrtarisht ta braktiste, por shpirtit dhe vuajtjes së tij i besonte, ishte i bindur se synonin drejt idealeve të larta. Vetë ai kishte bluar mendime të hidhura, armiqsore, por nuk e kishte kuptuar veten dhe ato ide nuk ia kishte pëshpëritur fshehurazi në vesh dikujt. Ndryshe e gjykonte Esatin. I dukej se urrejtja e tij ndaj Udhëheqjes bazohej në meskinitet dhe pakënaqsira personale.

Pastaj në këto çaste ndjente diçka më ndryshe nga kohët e fundit. Esati e nuhati se Besniku i priti ftohtë fjalët e tij dhe i frikësuar se mos e kishte tepruar, ndërroi bisedë. Ata u ndanë dhe do ta ndjenin veten tani e tutje armik të njëri tjetrit.

Pas dy javësh byroja e Partisë për Tiranën po shqyrtonte anëtarësinë në Parti të Besnikut. Ai nuk ishte as i tronditur, as i mallëngjyer. I ishte përforcuar mendimi se Hyseni nuk duhej të burgosej dhe ishte i bindur thellë se po e përjashtonin padrejtësisht nga Partia atë që mishëronte idealet e pastra të komunizmit dhe të patriotizmit. Kur u dha vendimi për përjashtim dhe sekretarja e parë i kërkoi tesian, ai e nxori, ia zgjati dhe i foli:

- Kur i kërkoni njerëzit që nuk e duan Partinë dhe socializmin tek unë, vallë ku do t'i gjeni miqtë? !

Dhe ai e lëshoi me protestë, gati me përbuzje tesian në dorën që u drodh të sekretares së parë.

## XIII.

Dera e rëndë prej hekuri u tërhoq me zhurmë. U mbyll. Shuli u shty. Besniku i mbetur vetëm hodhi sytë për rreth. Ndodhej në një birucë të vogël prej çimentoje, gati krejt nën dhe, që ishte e zhveshur, e ftohtë dhe shumë e pastër. Nga frengjia e ngushtë me hekura të kryqzuara, që ishte puq me tavanin, vinte pak dritë.

Atje lart e kishin kërcnuar me inat se do ta futnin në një vend të tmerrshëm. Kishte kaluar shumë dyer të mbyllura me shule të trashë, pastaj polici kishte hapur njëren prej tyre, kishte zbritur dy tre shkallë dhe kishte thirrur: "Brënda! "

Besniku qeshi me vehte dhe foli si me shaka: "Këtu qenka tamam dhomë pritje! " dhe fërshëlleu për t'i dhënë vehtes kurajo. E hoqi pallton, e hodhi në çimento dhe desh të ulej, kur vuri re një fletë që ishte ngjitur te dera. U afrua dhe lexoi rregulloren e birucës.

Aty urdhëroheshin të arrestuarit të mos këndonin, të mos fërshëllenin, të mos flisnin me zë të lartë, të mos goditnin muret, me një fjalë të mos bëhej aty asnjë lloj zhurme. Besniku e kuptoi se e kishte thyer rregulloren duke fërshëllyer dhe tha me vehte: "Duhet bindur tamam si në ushtëri. "

Pastaj u ul dhe padashur përfytyroi veten dhe botën. Gjendej aty nën tokë i mbyllur mes muresh të trasha, ku nuk hynte rrezja e diellit. Sipër tij ishte bota e lirë, me të cilën po priste çdo lidhje, për të cilën tani ishte i huaj. Aty sipër kryqëzoheshin rrugët, ndodhej çesmja, furra, dyqanet, shtyllat dhe selvia e gjatë. Pak më tutje shtëpia e tij. Dielli i mëngjezit e ndriste plot shkëlqim qytetin e lindjes. Njerëzia ecte me gjallëri dhe qejf, se akoma nuk kishte filluar zhegu i mesditës. Atë ditë ai ishte ngritur herët atje lart dhe kishte marrë të lexonte një libër duke parandjerë një ngjarje të hidhur. Pas pak vërtetë e kishin marrë në degën e brëndshme.

Dhe ja tani ndodhej në birucë. Nuk kishte aty as njerëz, as shtëpi, as rrugë, as makina, as diell. Ishte i vetëm mes katër mureve. "S'ka gjë - Mendoi ai si me shaka - Do të pushoj pak. Këtu qenkam shumë freskët. U lodha jashtë. "Dhe sikur të pyeste veten si kishte ndodhur që ishte brënda, iu përfytyrua ngjarja e djeshme në gjyq.

Ai kishte vajtur në gjyqin e Hysenit i qetë, thujse i gëzuar dhe kur ishte

takuar me Mihalini dhe Telhanë, kishte filluar bisedën me ta, sikur nuk pritej asgjë e jashtëzakonshme, sikur nuk kishte asnjë kontradiktë mes tyre, sikur të kishin ardhur aty për një qëllim të njejtë. Ai ishte sjellur sikur të ishte akoma në kampin e pushimit Qafshamë, nga ku ishte kthyer dy tre ditë më parë, pasi kishte ndenjur gjithë qershorin. Në ato çaste fytyra i shkëlqente, sytë i ndrisnin me hare, fliste lirshëm, me zë gazmor, lëvizte duart vazhdimisht. Kur biseda ngecte, pyeste me interes për gjëra të parëndësishme. Kjo sjellje i kishte çuditur Mihalini dhe Telhanë dhe u ishte dukur krejt e pakuptueshme dhe e paarësyeshme.

Por, kur Hyseni me duar në hekura i shoqëruar nga rojet ishte ngjitur në katin e dytë, krejt pamja e Besnikut ishte transformuar në mënyrë të rrufeshme. E kishte prekur pamja e zymtë dhe e zemëruar e shokut dhe i kishte ardhur turp nga vehtja, që fliste e qeshte me Mihalini dhe Telhanë, të cilët në një farë mënyre ishin shkaktarët kryesorë të burgosjes së Hysenit. Ishte turbulluar dhe fytyra i ishte ndezur gjithë zemërim.

Gjyqi kishte filluar shpejt. Mihali dhe Telhai ishin futur brëndë. Besniku kishte mbetur jashtë në sallon se do ta thërrisnin si dëshmitar.

Gjatë gjithë kohës që zhvillohej gjyqi me dyer të mbyllura, ai ishte vërtitur në koridor duke kujtuar gjithshka që lidhej me Hysenin dhe shpirtin ia kishte pushtuar indinjata. Kishte ardhur gati po në atë gjëndje të asaj nate kur kishte shkruar protestën. Një farë qetësie shpirtërore që i ishte krijuar në kampin e pushimit, po i zhdukej pa gjurmë. Ishte shfaqur prapë Besniku i trishtuar. I tillë ai do të paraqitej para gjyqit.

I kishte buzëqeshur shokut me dashuri dhe pastaj i kishte hedhur sytë trupit gjykues. Kryetari i gjyqit në mbështetje të procedurës penale i kishte kërkuar të thoshte të vërtetën dhe ai ishte përgjegjur:

- Unë vetëm të vërtetën di të flas!

Kryetari kishte filluar nga pyetjet.

Besniku ishte përgjegjur me një farë arrogance dhe mes të tjerash kishte deklaruar se nuk e pranonte realizmin socialist si metodë artistike, se kishte vetëm realizëm në letërsi, se veprat e letërsisë sovjetike me përjashtim të atyre të Gorkit, Shollohovit, Majakovskit dhe të ndonjë tjetri ishin kartë pa vlera, se nuk kishte letërsi shqipe bashkëkohëse, se Hyseni ishte poet i vërtetë, se burgosja e tij ishte e padrejtë dhe do të dënohej nga pasardhësit.

Kryetari i gjyqit i kishte prerë fjalën duke i rënë ziles dhe i kishte tërhequr vërejtjen:

- Përgjigjeni vetëm për ato që ju pyesim. Këtu nuk jemi në konferencë, por

në gjyq.

Ai ia kishte pritur me arrogancë:

- Unë vetëm kështu di të flas!

Atij i ishte dukur se trupit gjykues i kishte shkuar një drithmë, se ata ishin habitur dhe se kishin ndjerë forcën e drejtësinë e tij. Kryetari i kishte përfunduar pyetjet. Seanca kishte mbaruar dhe Besniku kishte dalë nga salla e gjyqit i ndezur flakë e plot zemërim. Duart i dridheshin.

Telhait dhe Mihalit nuk i ishte përgjegjur thjeshtë, ashtu si para fillimit të gjyqit, por me rreptësi e nervozitet. Në ato çaste i pat ardhur keq që Hyseni nuk kishte folur në gjyq siç e kishte zakon, me nervozizëm, nuk kishte shfryrë fare, por fjalët i kishte patur të paka dhe të përmbajtura.

Të djeshmen pasdite i kishin thënë se dy burra e kishin kërkuar në shkollë te sekretari i Partisë dhe kishte vajtur që të interesohej që cilët e kishin kërkuar. Ai kishte dyshuar mos donin ta arrestonin dhe kishin vendosur të shkonte vetë në degë e brendshme që mos të lodheshin oficerët e sigurimit për ta gjetur. Por sekretari i Partisë e kishte gënjyer duke i thënë se nuk dinte gjë se cilët qenë ata që e kërkonin ta takonin.

Ishte kthyer në shtëpi pas mesit të natës. Nëna ishte ngritur në këmbë dhe i kishte thënë se tre shokët të tij posa ishin larguar. Një herë nuk i kishte vajtur mendja për keq dhe ishte përpjekur më kot të gjente se cilët e kishin pritur gjer në mesnatë. Ishte fytyrë në dhomë plot kureshtje, ishte zhveshur dhe kishte rënë të flinte. Pas një çike dera e vëllait të madhe kishte kërcitur lehtë. Dikush kishte zbritur në majë të gishtërijve. Kishte hyrë në kuzhinë pa bërë zë dhe ai kishte dëgjuar këtë buisedë mes të vëllait e nënës:

- Erdhi Besniku?

- Po, bir.

- Shkoi të flerë?

- Po, bir.

Heshtje pak çaste.

- U zhvesh?

- Po, më duket se e zuri gjumi.

Zhurme këmbësh. Duket se ai i ishte afruar nënës :

- I the ti për shokët që e prisnin?

- Si nuk i tha nëna? !

- I zure gjë në gojë se cilët ishin?



- Jo... Ku i njihte nëna e shkretë ata? ! Pse duhej t'ia kisha thënë? ! ..  
 .. Ç'ka ndodhur kështu? !

Zëri i saj kishte tinglluar i merakosur.

- Asgjë. . asgjë. . Natën e mirë!

Vëllai ishte larguar në majë të gishtërijve. Dera e tij ishte hapur prapë dhe ishte mbyllur me çelës nga brënda.

Kjo bisedë iu kujtua. Tani ishte i bindur se njerëzit e sigurimit e kishin pritur në shtëpi që ta arrestonin që atë natë dhe dyshoi se i vëllai kishte qenë i shqetësuar se mos ai mund të arratisesh për t'i shpëtuar arrestimit. I cëmboi në zemër dhe psherëtiu. Një lëmsh iu ngjiti në grykë. Nuk i rrihej në vend. U ngrit dhe shetiti ec e jakë në birucë gati një gjysmë ore sa u lodh. Mendimet e hidhura iu larguan. Sikur u qetësua pak dhe mendja i fluturoi gjatë.

Iu kujtua se dikur Napoloni i Madh me ball të vrejtur, i heshtur dhe i trishtuar vinte e vinte pa pushim, si luani në kafaz, në dhomën e tij në ishullin e Shën Helenës, gjersa edhe dërrasat e dyshemesë qenë ngrënë. Ai mendoi se me krahe të kryqëzuar po shetiste edhe vetë, por çimentoja nuk do të pësonte asnjë ndryshim, sikur edhe tërë jetën të ecte ashtu. Buzëqeshi pastaj e tha me vehte: "Pse bëhesh qesharak? ! Ç'është ky krahasim? ! Perandori i Francës e tronditi botën. Po ti, ç'ke bërë? ! - Pyeti veten dhe u përgjegj - Asgjë! "Hiç" thotë Liri"

Ai qëndroi disa çaste ashtu më këmbë dhe ndjente në gjoks një fuqi të jashtëzakonshme. "Po - Mendoj - Këtë nuk e mohoj. Edhe tani hekurat e kryqzuara të dritares, dera e fuqishme, muret e trasha prej çimentoje më duket të dobta. Nuk mund të më mposhtin. S'më bëjnë dot rob, s'e shuajnë dot frymëm e shpirtit tim. Po ç'kam bërë në botë mes njerëzve? "Hiç" thotë Liri dhe nga hiçi nuk del asgjë. Jam një djalosh i ri dhe akoma as kam dashuruar ashtu si dua. Gjithshka përmblihet tek unë vetëm në ëndrra! Pse e krahasoj veten pra me vuajtjet e vërteta të Napolonit? ! .. E bëj për trill. Po për trill. . . Kur të dal, do t'u them njerëzve duke u talluar se shetisja në birucë duarkryq si Napoloni në Shën Helenë. Kam përfytyruar se nuk do të thyhesha në birucë, se do të kërkoja libra, letra për të shkruar. Ja tani mund ta vertetoj këtë gjë. Unë mundem mes këtyre mureve të trashë me pak bukë e ujë të krijoj letërsi. Shpirti im nuk është dobësuar asnjë thërrime."

Në dysheme ra një reflektim i dobët drite. Hodhi sytë nga frengjia. U afrua te muri dhe vështrroi jashtë. Nuk dukej qielli, por një mur rrethues i lartë mbi majën e të cilit ishin vendosur copa qelqesh të mprehtë. Rrezet e diellit binin mbi to dhe copat e xhamit e reflektonin në birucë. Ai mendoi se ai reflektim do t'i nevojitej që me anë të tij të orientohej për orën, nëqoftëse e mbanin gjatë aty. "Ashtu si

Abati Fario dikur "buzëqeshi ai.

I vetmuar aty në qeli, i mbyllur, i shtrënguar dhe i shtypur nga muret e trashë prej betoni, nga frengjia me hekura të kryqzuara, dera e rëndë e siguruar nga jashtë me shula dhe dryj të mëdhej, i ruajtur rreth e qark nga policët, ai po thellhej në veten për të kuptuar shkaqet e këtij realiteti dramatik, për të kuptuar thelbin e karakterit të vet. E ndjeu gjallë në brendësi pathosin që kishte patur gjatë luftës për çlirim dhe mendoi se ai nuk do t'i shuhej kurrë gjer në vdekje, se i kishte dhënë dhe do t'i jipte gjithënjë kuptim jetës së vet. Po nuk mund të mohonte se kishte patur kontradikta me komunistët, me shokët bashkë me të cilët kishte luftuar, sidomos me disa prej tyre, që ishin bërë krejt të ndryshëm nga ç'kishin qenë gjatë luftës. Por në këto çaste mendoi se i kishte zmadhuar ca të metat e tyre dhe se më tepër kishte keqkuptime. Ishte gati i bindur plotësisht se me Aliun e të tjerë ia kishte kushtuar jetën komunizmit. Kujtoi me dëshirë të madhe ato ngjarje dhe ato persona që e lidhnin ngushtë me Atdheun e socializmin dhe tha me zë gati të egzaltuar: "Unë jam ushtar i komunizmit dhe i tillë do të mbetem gjer në vdekje!"

Atij nuk iu kujtua asgjë në jetë që të ishte në kundërshtim me këto fjalë dhe iu duk se as kishte patur kurrë të tilla.

Përrjashta u dëgjuan këmbë. Llozi lëvizti. Roja bërtiti:

- Dil! Para!

Shkundi mendimet, doli nga biruca dhe iu ngjit shkallëve.

Koloneli hetues, një burrë dyzet e ca vjeç, shtatshkurtër, ballë të ngushtë, me sy të futur, me vështrim të ftohtë dhe të mprehtë, me hundë të madhe, kishte pamje të rreptë dhe të egër. Atij ia dhanë lajmin e arrestimit të Besnikut, kur po bisëdonte në birucë me një diversant, që e kishin hedhur me parashtutë dhe që së shpejti do të dilte në gjyq të hapur. Herë me kërcënim, herë me zgjuarsi e dhelpëri, herë me dëshmitarë e kishte detyruar diversantin t'i pohonte vetë krimet ndaj shtetit dhe tani ishte i sigurtë që gjyqi do të dilte me sekses, se i pandehuri do të shkaktonte reaksion dhe shumica e popullit do ta mirëpriste pushkatimin e tij. Si përfundoi bisëdën me të, doli i kënaqur, por tek i afrohej zyrës, ndryshoi. Atij iu kujtua sjellja e Besnikut në gjyqin e Hysenit. Kurrë nuk kishte pandehur që të ndodhej në Shqipëri një djalë që të kishte aq guxim dhe të tregohej aq i marrë sa të shprehej aq lirisht dhe me aq arrogancë.

Hetuesi ishte i bindur se Besniku u reklamonte me mburrje letrarëve dhe të

rijve pikëpamjet e veta. Nuk dinte me hollësi ç'u thoshte, por dyshonte se fliste shumë më keq nga ç'i ishte shprehur për shembull Agimit. Qëndrimi i shkrimtarit në gjyq e dëshmonte për të katërcipërisht këtë gjë. Ai gjykonte se një njeri i tillë që fliste si armik para gjyqit, kushedi se ç'u llapte të tjerëve. I kishte bërë përshtypje edhe ndryshimi i menjëhershëm i Besnikut në gjykatë, se si nga i qetë dhe i gëzuar ishte bërë menjëherë agresiv dhe i rrevoltuar. Nga kjo kishte nxjerrë si përfundim se i arrestuari dinte të paraqitej me mjeshtëri ndryshe nga ç'ishte. Tipat e tillë i kishte shumë inat.

Hetuesi hyri në dhomën e hetimit, u ul në tavolinë dhe qëndroi me bërrula të mbështetura në të, pak i krrusur duke vështruar nën vetulla në mënyrë të frikshme dhe kërcnonjëse.

Te dera u shfaq Besniku. Hyri sikur aty mos të ishte në zyrën e sigurimit, thujse prapa nuk e ndiqte polici. Sytë e tij vështronin qetë, drejt. Ngjyra e fytyrës nuk i kishte ndryshuar, bile dukej i çlodhur. Asnjë shenjë frike nuk shprehej në tiparet e tij. Kjo e zemëroi hetuesin dhe sapo i arrestuari u ndal në mes të dhomës, e urdhëroi me ashpërsi:

- Ulu aty, maskara!

I arrestuari ndenji pranë tavolinës, aty ku e urdhëruan. Vështroi hetuesin dhe priti.

- Ç'na përrallise ashtu në gjyq? ! - Pyeti hetuesi me egërsi dhe shtoi - Këtu hape gojën në je trim!

Besniku u përgjegj thjeshtë:

- Ato që kisha shkruar në dëshmi këtu në hetuesi. Ju e dinit çfarë do të flitja.

Koloneli i bërtiti i zemëruar dhe me zë të lartë:

- Jo, nuk ishin ato, maskara! I zgjërove dhe i zbukurove. Ti të thuash në gjyq se nuk je dakort me arrestimin e të panderuhit, se arrestimi i tij është i padrejtë? ! Kush je ti? Kush të pyet ty? Ku jemi këtu?

- Ju e dinit se ai ishte mendimi im - Tha thjeshtë i arrestuari.

- Shiko, shiko, bukuroshi! - U rrevoltua edhe më keq hetuesi - Kujton se është në bulevard dhe po u mburret si gjeli në pleh shokëve të vet. Këtu je në hetuesi. E ke të qartë? ! Unë të gre nga ajo karrike, ku je ulur dhe lëviz dhe të mbërthej në atë karrike aty!

Ai shënoi me gisht në mes të dhomës një karrike hekuri të ngulur në çimento dhe shtoi:

- Këtu t'i masësh fjalët se ta masin kokën me penj. Do të marrim leje ty

ne se ç'të bëjmë. Të duket se ç'është Hyseni. Ai është aventurier, vagabond që tradhëton gruan e fëmijët dhe prish qetësinë familiare. Është mendjemadh sa kujton se arriti qiellin me dorë. Do ta lemë ne atë të shkruaj vjersha se paska shkuar kot gjaku i dëshmorëve, sipas teje ta dërgojmë edhe në Perëndim me aeroplan special. T'i japim edhe valutë me vehte. Tani është penduar edhe ai vetë për marrëzitë e tij, por s'i bën fajde. E hedh lotin kaq.

Besniku u vrejt. Kur e kërcnoi hetuesi, uli kokën dhe heshti pa kundërshtim. Mendoi se duhej të ishte i bindur dhe se nuk ishte rasti të ngatrojej më keq, por vendosi t'i tregonte më vonë se nuk trembej nga karrikja e hekurt. Kur hetuesi i tha se Hyseni kishte qarë, u çudit, u zbut dhe i foli:

- E shihni se nuk është armik? !

Hetuesi e akuzoi:

- Ai gënjehet, ka inat me shkrimtarët, rrevoltohet dhe nuk sheh qartë, po ti pse e mbron dhe e nxit? ! Ti je fajtori! Hetuesi i nguli vështrimin e rreptë, sikur t'ia kishte kuptuar qëllimet e fshehta dhe vijoi:

- E kishe bërë planin dje, ishe pregatitur mirë. Na e hodhe. Na fliste maskarai, sikur të ishte Gjergj Dimitrovi! Po mos kij galje, do t'i bish kokës me grushta për ato që bëre.

Ai hapi sirtarin e po nxirrte letër që të zhvillonte hetimin e të arrestuarit, kur hyri një polic dhe i tha:

- Të kërkon ministri në telefon.

Hetuesi u ngrit dhe iu drejtua policit:

- Po u vonova, e shpini në birucë.

Besniku, duke kujtuar se ai mund të mos vinte më aty atë ditë, pa u menduar thellë, foli:

- Me leje. .

- Fol! . - Urdhëroi rreptë koloneli.

- A ka mundësi të më japni letër të bardhë dhe kalem? ! . . Dua të shkruaj.

Koloneli iu afrua. Qëndroi në mes të dhomës dhe e mati me sy të picërruar të arrestuarin. Nuk e njihte. Dinte fare pak për të kaluarën e tij dhe kurrë nuk mund t'ia mirrte mendja se çfarë mendonte atje në birucë i vetmuar. Ai dinte se veprimet e mendimet e tij të kohëve të fundit ishin cilësuar antiparti nga udhëheqja. E kishte dëgjuar me veshët e tij se si ishte shprehur në gjyq, kishte filluar të bindej që ishte armik i fshehur shumë i rrezikshëm i Partisë, se bile ai e kishte shyrë Hysenin në veprime të çmendura, prandaj nuk kishte se si mos të revoltohej nga

gjakftohtësia e tij dhe kërkesa e paskrupull. Nuk mund të kuptonte se si ky i pandehur mund të guxonte t'i kërkonte letër për të shkruar dhe ju hakërrua:

- Palaço! Nuk je fare në vete! Mbledh mendjen dhe kthe rrugë! Ne të japim letër ty? ! Pis! Emrin tënd do ta zhdukim përgjithëmonë nga faqet e letërsisë! Do t'i humbin gjurmët e tua, sa edhe ti mos ta kujtosh veten. E kuptoj mirë çfarë qëllimesh ke. Ti je nga ata që kërkojnë me dinakëri të hipin lart dhe të minojnë Partinë nga brenda! Po ne do të zhdukim!

Besniku kundërshtoi gjakftohtë:

- Kjo nuk është e vërtetë!

Hetuesi bërtiti:

- Pusho, maskara! Pis! Mjaft ke dërdillutur! Të duruam sa plasëm!

Dhe doli. Shkoi në zyrën e tij lart, mori telefonin dhe foli me zë të butë, të ëmbël:

- Urdhëro, shoku ministër. . .

- E muarët Besnikun?

- Si urdhëro. Tani po e pyesja.

- Ç'thotë?

- S'i bën përshtypje fare që e arrestuam dhe mend i ka në hava. Mua më duket më i rrezikshëm se Hyseni, se është i ndërgjeshëm për rrugën e tij dhe diçka bluan me vete. Kam të dhëna të sigurta që nuk i rri goja rehatë.

- U konsultuam edhe me Komitetin Qëndror dhe vendosëm ta intermojmë në Shtyllas. Ai është i gabuar se nuk ka ndonjë bazë të ngrihet kundra Partisë. Atje besojmë do t'i vijnë mend.

- Si urdhëron, shoku ministër - Pranoi koloneli.

Uli telefonin dhe zbriti në zyrën poshtë. Nga ato pak fjalë ai e kuptoi se ministri nuk e kishte shumë inat Besnikun, prandaj i iku zemërimi i madh. U zbut duke qenë i bindur se ata atje lart, e shikonin shumë më thellë problemin. Hyri në dhomën e hetimit sikur të ishte njeri tjetër. Lëvizjet nuk i kishte aq të rrëmbyera, nuk vështronte aq egër. U ul në tavolinë, u mbështet në karrike dhe tha me zë më pak të vrazhdë:

- Do të intermojmë. . Nuk të rri goja rehatë ty. . Llap.

- Mirë. . - Pranoi Besniku gjakftohtë

Fytyra e tij nuk shprehte as hidhërim, as tronditje.

Hetuesi e qortoi:

- E ta dish se na ke dëmtuar shumë. Të të vijë trup. Je nga një familje lufte. Vetë ke qenë partizan. Radiot Perëndimore do të na çajnë veshët.

- Nga kjo pikëpamje pranoj se kam bërë gabim - Tha sinqerisht Besniku.  
 - Kështu pra, të mendosh një çikë. Nuk je i vogël. E kemi mgritur Republikën me gjak dhe e mbrojmë me gjak, kurse ty të merr koka erë. Shko! Nesër do të të nisim.

Besniku u ngrit të ikte. Tek dilte , u ndal në mes të dhomës dhe e pyeti me zë të butë:

- Mund të them një fjalë? !

- Po. - Pranoi koloneli.

- Si ju quajnë ju, lutem?

- Abaz. . - Mezi u përgjegj nëpër dhëmbë ai.

Besniku iu afrua te tavolina dhe i foli:

- Shoku Abaz, duhet ta dini se unë kam qenë komunist dhe kam parë që i vogël vdekjen me sy. Si në këtë karrike të lëvizshme druri i zgjidhur, si në atë karrike hekuri të palëvizur i lidhur, unë jam njësoj.

Hetuesi dhe i arrestuari u panë në sy pa lëvizur qepallat. Pastaj kolonel Abazi, që e kuptoi se këto fjalë ishte përgjigje për kërcnimin që i kishte bërë, u skërmit dhe tha:

- Ke kokë të fortë. Po ajo të mori në qafë. Dije prej meje.

Dera e birucës u tërhoq, u mbyll, shuli u shty dhe Besniku u ndodh prapë vetëm, mes mureve të trasha, ku nga frengjia e vogël, mes hekurash të kryqzuara, vinte pak dritë. Njolla e bardhë e reflektimit të rrezeve po zhdukej. Sigurisht dielli po perëndonte.

Ai e ndjeu veten të shqetësuar. Më parë nuk e mirrte me mend se ç' do të ndodhte me të. Tani e dinte se do ta intermonin. U suall në birucë duke u përpjekur të përfytyronte jetën e atjeshme, por nuk ia arriti dot. Nuk kishte parë ndonjëherë se si jetonin të internuarit në Shqipëri. Po e kishte të qartë se jeta e tij po mirrte një drejtim krejt tjetër nga ajo e gjertanishme.

Kurrë nuk e kishte menduar se ai që ishte bërë komunist qysh në gjashtëmbëdhjetë vjeç, që deri vetëm para pak muajsh mbahej si nga të rritë më të lidhur me Partinë, do të kishte këtë fat. Me shpejtësi vetëtime i kaluan para sysh ngjarjet e kohëve të fundit. Iu kujtua se para një viti ishte krejt njeri tjetër: I gëzuar, i lumtur, pa halle. Atëherë pregatitej të botonte romanin për punëtorët, dashuronte një vajzë flokëartë, shpresonte të shkonte bashkë me të në Moskë, të kalonte një jetë të shkujdesur, plot qejfe. Endërronte që romani të përkthehej në rusisht dhe emri i tij të përmendej në botë. Po gjitha këto ishin përmbytur çuditërisht dhe ai

kishte filluar të bënte një tjetër jetë, të ndryshme me të parën, të trishtuar dhe pa shpresa të bukura.

Mendoi se kohët e fundit i dukej disa çaste e kotë bota, gëzimi i fëmijëve. I vlerësonte si boshe shumë probleme të shoqërisë dhe e quante veten të huaj mes njerëzve. Kishte raste, kur nuk e kënaqte as nëna, as dielli, as gjithë natyra. Nxitoi hapat i tronditur nga këto mendime, kur roja hapi dritarëzën dhe pyeti:

- Pse lëviz kështu?

- Mos është e ndaluar? ! - Pyeti i burgosuri.

- Jo. . Jo. . - U përgjegj roja dhe mbylli dritarëzën.

Besniku qëndroi. Mendimet i lëvrinin në kokë.

Tani gjëndeje mes katër mureve, larg atyre gjërave që i dukeshin bajate. Larg njerëzve, zhurmën e të cilëve në ndonjë moment e përbuzte. Ata ndodheshin atje lart, sipër tij, në jetën e lirë dhe nuk kishin asnjë lidhje me të. Ndjeu shtypje në gjoks. Përfytyroi prapë veten duke ecur si hije nëpër rrugët e qytetit dhe duke përsëritur me vete shprehjen e famshme: "Të rrosh apo mos të rrosh - Kjo është çeshtja." "Iu afrua frengjisë dhe foli me vete: "Dua diell! Dua jetë! Dua të dëgjoj zëra njerëzish të lirë! "

U tremb. Ktheu kokën se mos e dëgjonin. Heshti. Asnjë njeri nuk ndodhej pranë tij. Ishte vetëm mes mureve të trasha, i ndarë nga bota dhe po fillonte një jetë të vështirë.

#### XIV.

Një kamion i vjetër po e shpinte Besnikun gjithënjë e më thellë Muzeqesë duke ngritur pluhurin e rrugës duman. Djaloshi me duar të lidhura në pranga qëndronte i heshtur duke vështruar për rreth fushën e gjërë, si të pafund. Befas makina ndali dhe e urdhëruan të zbriste.

U hodh në tokë dhe vështroi. Para tij ndodheshin një varg i tërë barakash të vjetra, të rrethuara me disa rradhë telash me gjemba, të cilat ishte e pamundur t'i kapërceje. Përballë ngriheshin dy porta druri tepër të mëdha, të mbyllura me dryj të rëndë dhe pranë tyre sogjetonin rojet. Pak më tutje njëra pas tjetrës pranë telave me gjemba lartoheshin truprojet prej dërrase, sipër të cilave policët rrinin të qetë pranë mitrolozave. Pas telave, dyerve të mëdha, truprojeve, në një oborr të madh, ndodhej një shumicë e madhe njerëzish grumbuj grumbuj.

U trondit se gjëndeje para një burgu. Trishtimi i pushtoi zemrën. Mendime të errta i turrën në kokë. Iu kujtuan kampet gjermane, ku kishte vuajtur edhe vetë gjatë luftës dhe iu duk se ky kamp nuk kishte asnjë ndryshim prej tyre.

Drejt tij erdhi një kapiten i mplakur, i thinjur, me fytyrë plot rrudha. Kapelja i kishte shkarë mënjanë. Këpucët i kishte plot pluhur, hapat i hidhte si i pamësuar me stërvipte ushtarake. Qëndroi te një trung, u ul mbi të, nxorri një shami të zhubrosur, fshiu djersët, u shkopsit. Polici, që shoqëronte Besnikun, i dorëzoi një letër. Ai e mori dhe e hapi.

Aty shkruhej shkurtimisht cili ishte Besniku dhe përse internohej. Palosi letrën, e futi prapë në zarf dhe i hodhi një sy të internuarit të ri. Fytyra i mrrol. Vështrimi i tij u bë i rreptë dhe i egër dhe urdhëroi ta fushnin brënda. Megjithëse foli me inat, Besnikut iu duk se nuk shprehte ligësi.

Dy dyert e mëdha u hapën njëra pas tjetrës dhe ai u gjënd mes atyre njerëzve që e tronditën. Roja i bërtiti të futej në një derë tjetër. Në mes të oborrit të burgut ndodhej një barakë e rrethuar me tela. Ajo ishte baraka e të internuarve.

Besniku kaloi derën, një koridor të ngushtë, oborrin e vogël dhe u gjënd brenda në barakë. Hodhi dengun e plaçkave për tokë dhe vështroi për rreth. Nëpër dy anët e barakës, nëpër shtretër dysh prej dërrase, të internuarët, që posa ishin kthyer nga puna, po merreshin me punët e tyre më të ndryshme. Djaloshit iu duk sikur ndodhej në një nga bujtinat ruse të pararevolucionit, të cilat i njihte vetëm nga filmat.

Të internuarit e vështruan me kureshtje të posaardhurin e lodhur, gjithë djersë. Por asnjë nuk e njohu. Një burrë i gjatë, me hundë të shtypur, me kurriz pak të dalë, me flokë të rral luar e të thinjur, me dhëmbë të rënë e të prishur, iu afrua duke mprehur briskun e rrojes në një rrasë dhe i tha me ton miqësor:

- Mirëseerdhe "shok" - Fjalës së fundit ai i dha një theksim ironik - Nga kështu? !

Besniku fshiu djersët me mëngën e këmishës dhe u përgjegj:

- Nga Tirana.

Katër pesë vetë e rrethuan. Të tjerë e shihnin me habi. Ca varnin kokat nga shtretërit e sipërmë. Mes tjerëve iu afrua një burrë i shkurtët, pak i trashë, me ca sy të bardhë të shpëlarë, që e quanin Servet. Fytyra e gjërë, buzët e trasha, hunda e madhe e tregonin si budalla. Ai qëndroi rëndë rëndë me një farë seroiziteti të fryrë dhe pyeti me indiferentizëm:

- Pse të sollën këtu? !

Besniku u mendua një hop se nuk dinte çfarë qëndrimi të mbante dhe së



fundi u përgjegj:

- Isha dëshmitar në një gjyq dhe nuk fola mirë. .

- Po pate thënë të vërtetën, mos u bëj fare pishman. Njeriu kurrë nuk duhet të shmanget nga rruga e drejtë. Të drejtit mund t'i ndodhë edhe të vuaj ca, po mos u mërzit. - E këshilloi si ndonjë filozoh Serveti me sy të bardhë si guak.

Në këtë çast Naimi, si e quanin atë me hundë të shtypur, iu afrua dhe i shkeli këmbën me marifet si shenjë që të heshte. Ai e pandehte Servetin provokator dhe u tremb mos i shpëtonte gjë të porsaardhurit. Në këtë mes u afrua Mit'hati një meso burrë, me sy të vegjël, të ndritshëm, i veshur pastër dhe e pyeti:

- Po mbiemrin si ta thonë? . . . Mos ke vëlla Kadriun?

- Po. - Pranoi Besniku.

- Aha - Ia bëri Mit'hati - Mos ke punuar në Lidhjen e Shkrimtarëve? Më duket se edhe ke shkruar diçka.

- Po - Pranoi djaloshi dhe me që kishte etje të madhe, lypi pak ujë.

Serveti u tregua i gatshëm.

- Si nuk kemi! Të jap gotën time dhe pi jashtë ujë të freskët. A ke ngrënë?

- Jo. - U përgjegj Besniku me turp.

Një malësor, që u përkul nga lart, tha:

- Gjellë të jap vetë. Po bukë nuk kam asnjë fije, pasha zotin.

Një tjetër i afroi një copë bukë. Posa Besniku doli të pinte ujë, Naimi e pyeti Mit'hatin:

- E njeh zoti avukat?

Avukati u përgjegj:

- Ky është shkrimtar. Familja e tij është fund e krye komuniste. E kanë kritikuar për pikëpamje antiparti në letërsi dhe duket prandaj e kanë sjellë këtu.

Këto fjalë ranë si bombë. Naimit iu drodhën qepallat nga frika. U pendua që i shkeli këmbën dhe ia bëri me sy që të ruhej nga Serveti. Zemra iu tkurr. Serveti hapi gojën sa një kamare. Iu zhduk ajo pamje mburrjeje dhe foli me habi:

- Po ky qenka komunist!

- Ka qenë. Tani është si ty - Ia ktheu Mit'hati.

Genci, një burrë i zeshkët me sy të trishtuar, që po luante shah, hoqi llullën nga goja dhe foli:

- Deviator i djathtë. . Renegat! . . . Do të bëjmë mjaft sehir me të. .

Komunistët sillen me devijuesit më keq se me ne.

Këpucari i ra me çekiç këpucës dhe pëshpëriti:

- Dhe ky na duhej. . .

- Bre. . bre - U habit malsori - Po ky qenka i rrezikshëm, pasha qiell e dhe!

Tani nuk ishin indiferente ndaj të porsaardhurit si pak më parë, se ai ishte përjashtim prej tyre dhe kishte tjetër jetë e të tjerë shokë. Tani do të mateshin kur të flitnin në barakë. Ata e ndjenë veten të ndrydhur duke menduar se diçka do të ndryshonte në jetën e tyre, prandaj disi u pikëlluan.

Kur Besniku u kthye, nuk mundi ta kuptonte dot ndryshimin e tyre. Ai vuri re vetëm që malësori që zhdukur lart. Naimi erdhi me gavatën plot me gjellë dhe i foli:

- Urdhëro këtë, shoku Besnik.

Fjala shok këtë rradhë tingëlloi plot përzemërsi.

Ai shtoi pastaj:

- Je sefte dhe nuk të rrëshqet gjella e burgut.

Serveti e pa me inat Naimin. Genci i shkeli syrin dikujt. Të internuarit menduan se Naimi po servilosej për shkak se djali i ri ishte nga familje komunistësh. Besnikut i pëlqeu mirësjellja e Naimit. U ul në shtratin që i caktuan dhe filloi të hante me uri.

Askush nuk e pyeti më. Sejcili shikonte punën e vet. Shumë e vështronin me bisht të syrit. Si hëngri bukë, Besniku vajti të takonte përgjegjësën e të internuarve, Zefin.

Zefi, një burrë i shëndoshë me shpatulla të gjëra, kuqalash, e ndihmoi të ngjitej në shtratin e sipërmë. Pastaj shkundi një batanie, e shtroi, e rregulloi që të rrihej rehatë, e ftoi të ulej dhe u përshëndet me mirësi. E pyeti me fjalë të buta nga vinte, sa ditë kishte ndenjur në birucë, si ishte me shëndet, çfarë prindësh e familje kishte. Mandej e siguroi që do ta shtinte në forcë që atë natë. I qau hallin për sëmundjen dhe i premtoi se do të thërriste doktorin për t'i dhënë raport që mos të punonte, ndryshe do të vdiste në kanal me kazmë në dorë. Pastaj i dha kurajo me fjalë të ëmbla:

- Ç'nevojë të kesh, hajde te baca. Ne do ta ndihmojmë njeri tjetrin. Mos ta mbarofsha unë hallin, një tjetër e nxjerr në krye.

Besniku nuk e ndjente më trishtimin që provoi te dyert e burgut. Po lehtësohej. Ai nuk kishte patur kurrë ide të qarta se si ishin të burgosurit politikë, "armiqtë e popullit" si kishte menduar gjithëmonë. Por nuk i kishte përfytyruar kurrë njerëz si gjithë të tjerët. Pa ditur tamam psenë kishte menduar gjithëmonë se reaksionarët e burgosur do t'i dallonte e do t'i urrente që më të parë, se ata kishin patjetër diçka antinjerëzore. Ai kishte biseduar me njerëz antipushtetit komunist, që ishin tamam si ai, por ata që ishin të burgosur, i pandehte diçka ndryshe. Dhe ja tani hyri në mes

të burgosurve politikë dhe as i neveriti, as i urreu në të parë, as iu dukën të veçantë nga të tjerët, me ndonjë tipar të përbindshëm. Përkundrazi ata u sollën me të shumë më mirë nga policët dhe komunistët, shokë të tij. E pritën me përzemërsi, i dhanë gotën të pinte ujë, i falën racionin e tyre të bukës, i thanë fjalë të mira dhe i qanë hallin. Sidomos i pëlqeu Zefi që e priti me aq nderim, i shtroi batanijen, e qerasi me karamela dhe i premtoi përkrahje. Ai kishte pandehur se kundërshtarët politikë kishin kushedi ç'pamje, prandaj sikur nuk i besohej se ndodhej mes të internuarve dhe iu ngjallën dyshime.

“Ç’janë këta njerëz që vuajnë në këtë kamp? !” Pyeti veten me çudi e dhëmbje. Donte patjetër ta zgjidhte sa më parë këtë enigmë. Atij iu duk se Zefi do t’i thoshte të vërtetën, tamam si baba, prandaj e pyeti i turbull dhe me naivitet:

- Pse ju kanë internuar?

- Hë! . . . - Rënkoj Zefi dhe u përgjegj në një mënyrë që dukej krejt e pafajshme:

- Kot! . . . Kot fare! Sa di ti aq di unë. Ka qenë baca në kohën e Zogut oficer në rekrutim. Ashtu ishte koha. Kur erdhi Italia, më gjeti aty dhe unë ndenja gjersa u prish ushtria shqiptare. Nuk jam marrë kurrë me politikë. Kam vështruar gjithënjë punën time. Ja kaq di baca. A internohet njeriu për kaq gjë? . . . Pse mos vetëm unë kështu? . . . Të gjithë. . . Ç’sheh këtu. . . Na kanë nda prej prindëve, prej grave dhe fëmijëve dhe na mbajnë në këtë qymez pulash. Hë, bir.

Ai psherëtiu dhe pastaj tha:

- Kështu e ka kjo qeveri. Ja ti shihe me veten tande. Ç’ke ba. Ke tradhëtue Atdheun? Ke spiunue? Ke ngranë pare nga të huajt? Ke vra? Ke vjedh? E sheh baca nga sytë që je një djalë i pastër me ndjenja të nalta, tamam fisnik. E pra, pse të sollën? ! . . . Kot. . . Kot fare. . . Ashtu si edhe ne, të gjithëve. Ç’t’i bajsh? Fati ynë i zi. . . .

Këto fjalë Besniku pothuajse i besoi plotësisht. Ishte e para herë që djaloshi bisedonte me një të internuar dhe nuk e dinte se të dënuarit kurrë nuk i pranojnë fajet e tyre, se gjithëmonë thonë se vuajnë padrejtësisht. U trondit dhe zemra iu drydh. Vështrroi i turbulluar të internuarit dhe për çudi syri i zuri një fytyrë të njohur, një plak krejt të thinjur.

- Kush është ai? - Pyeti i shqetësuar.

- Një farë Demosteni nga Vunoi. - U përgjegj Zefi - Djali i punon gjeolog në Kuçovë. Vetë gjithë jetën është përpjekur për Shqipërinë, ka përhapur shkrimin shqip në kohën e Turqisë. Shkurt ka qenë patriot i flaktë dhe tani kalbet në burg.

Ai nukj pati asnjë dyshim se plaku i thinjur ishte babai i Polidhorit, i shokut

të tij që i kishte folur atë mëngjez për të ardhmen e prodhimit të naftës, që i kishte liruuar shtratin, që kishte punuar tërë natën në të ftohtë. Atij iu duk se gjersa ishte internuar edhe babai i shokut, për të cilin kishte patur shumë nderim, mund të ishin të vërteta fjalët e Zefit dhe ndofta gjithë ata njerëz ishin krejt të pafajshëm. Pafajësinë e tyre sikur e përforconte pamja krejt e zakonshme e të internuarve, përshtypjet e mira që i lanë. Ai mendoi se edhe atë e kishin futur aty pa ndonjë arsye të shëndoshë.

Gjithshka iu errësua. Zbriti të takonte babanë e shokut. Doli në oborr dhe hodhi sytë tutje te të burgosurit. Iu kujtuan fjalët e Esatit që i kishte thënë atë natë: "Republika u kalb. Njerëz të pafajshëm i rrasin nëpër burgje, i torturojnë, i vrasin!" "Gjithë vuajtjet, shpresat, ëndërrat personale iu zhdukën pa asnjë gjurmë dhe mendoi se Atdheu, për lirinë e të cilit kishin luftuar, kishin dhënë jetën bijtë më të mirë, ndofta rridhte gjak, dergjej nëpër biruca dhe nuk e dinte fare këtë gjë, por shetiste nëpër rrugët e Tiranës i gëzuar, diskutonte për çart, dashuronte më kot. "Mos vallë Shqipëria është kthyer në burg dhe lëngon nga Tirania? ! Mos vallë nuk kemi më Atdhe? ! "Pëshpëriti me vete i dëshpëruar.

Shkoi në anën tjetër të barakës. Iu afrua babait të shokut, e përshëndeti dhe u ngjit lart te ai. Flokët, mustaqet krejt të zbardhura si borë, i jipnin një pamje të bukur prej plaku fisnik. Gjyslykët, tej të cilave dukeshin të zmadhuar sytë e kaltër, sikur e bënin të nderuar. Plaku i shtrëngoi dorën dhe duke parë si djali i sillej si i njohur, i foli si me ndrojtje:

- Më falni, por unë nuk ju sjell dot në mend. . .

- Unë jam shok i Polidhorit. Kam qenë shpesh në shtëpinë tuaj.

Plaku tundi kokën, u përpoq të sillte në mend diçka dhe shtoi:

- Tani më duket se diku ju kam parë. Ke qenë në shkollë me tim bir.

- Po. Pastaj kam punuar bashkë me të edhe në kantierin e naftës.

- Më gjete një ditë në oborr dhe biseduam gjatë. Ndejte edhe për drekë.

- Po. . Po. . - U gëzua Besniku se më në fund plaku e njohu.

- Tani m'u kujtua mirë. Ti ishe gazetar. - Tha Demosteni dhe heshti një

hop.

Sikur u pre. Iu kujtua shtëpia, i biri, biseda e asaj dite. Internimi i djalit të ri sikur çenonte diçka gjërat e shejta të familjes së tij, prandaj e pyeti me qortim:

- Po ç'të solli këtu, o djalë? !

- Ashtu ndodhi. Fola keq në një gjyq, ku isha dëshmitar për një shok.

Demosteni e shikoi sikur nuk i besonte dhe i foli me keqardhje:

- Të flasësh keq ti, djalë i ri? ! Jo, mirë bir. Pushteti te rinia e ka shpresën. Ju e ngritët, ju ta nbani. Dhe kurrë mos t'i ktheni shpinën. Po nuk e përkrahët ju, filizat e rij, Shqipëria do të vejë si gjer tani e mos më keq. Hajt ne pleqve, na kanë rrjedhur trutë, jemi matufepsur dhe mund të lajthisim, po ju jeni shpresa e këtij pushteti, jeni të lidhur me të si mishi me thuan. Më vjen shumë, shumë hidhur, sikur të kem këtu djalin tim, Polidhorin.

Ai heshti një hop. Fytyra e tij me atë pamje fisnike u hidhërua sinqerisht. Drita e syve iu err. Dukej shkoqur se vuante dhe fliste të vërtetën. Besniku u ngushëllua. Në atë gjëndje të turbulluar, zëri që i drejtohej i dukej miqësor, i drejtë, sikur atij mund t'i besohej plotësisht, prandaj e pyeti se ç'ishin ata njerëz të interruar, për të cilët i kishin thënë se nuk kishin faj.

Demosteni buzëqeshi. Në cepat e buzëve i spikati një ironi e lehtë:

- Faji ka mbetur jetim, o djalë. Këtu ke ajkën e regjimit fashist:ministra, federalë, prefekta. kuestorë, kolonelë, udhëheqës të Ballit, me një fjalë shërbëtorët e fashizmit.

Demosteni që vërtetë ishte përpjekur për atdheun dikur dhe që e kishte simpatizuar luftën çlirimtare kundra fashizmit, nuk mund të mos i fliste kështu shokut të djalit. Këtu i maste mirë fjalët dhe nuk i hidhte ashtu kot më kot sa për të shtyrë muhabetin, si bënte kohët e fundit në Tiranë me shokët e moshës së vet. Tani ishte penduar që i kishte dhënë të njohur një diversanti, megjithëse nuk i vinte mirë që ndodhej në burg. Po fundi merakosej për fëmijët, se për vehte nuk kishte fort gajle.

Ai nuk mund të mirrte kurrë në mend se çfarë shërbimi i bëri Besnikut me ato fjalë të thjeshta. Ai e bindi se ishin krejt të kota dyshimet që e kishin munduar pak më parë në lidhje me fatin tragjik të Atdheut. Tani intermimi i këtyre njerëzve iu duk i drejtë. Thellë në ndërgjegjen e tij kishte mbetur e gjallë urrejtja ndaj bashkëpunëtorëve të fashizmit, e cila kishte lindur në zjarrin e luftës për liri, në çastet më dramatike të jetës së tij. Ai përfytyroi kohën e luftës dhe gati tamam si atëherë ndjeu armiqësi kundra bashkëpunëtorëve të zaptuesit. Iu neveritën këta njerëz që jetonin në këtë barakë, që i ishin dukur të sjellshëm, të urtë, të mirë, megjithëse nuk i dinte me hollësi veprimet e tyre.

Besniku u zgjua në mes natë. Ankthi i shtrëngonte krahërorin dhe ashtu për gjumësh pyeti vehten pse vallë ishte kaq i trishtuar, ku ndodhej dhe ç'kishte ngjarë me të. Pastaj u përmend mirë dhe vështroi për rreth. Pranë tij ndodheshin plot njerëz që po bënin gjumë të thellë. Dikush gërhiste, një tjetër kthehej në brinjë,

njëri mirrte frymë me gojë hapur. Nga dera e hapur dukeshin telat me gjemba të ndriçuar prej dritës së elektrikut. Dëgjohej kërcitja e dërrave të trupprojës. Nododhej në një barakë të çudiqme.

Nuk gjendej në shtëpi, nuk flinte vetëm në dhomë. Nuk shihte dritaret. Nuk nuhaste erën e veçantë të dhomës së vet. Ishte në një barakë të madhe ku rreth e rrotull po bënin gjumë të thellë njerëz të panjohur, që kishin ndihmuar okupatorin. Ai kishte patur gjithënjë një urrejtje abstrakte kundër këtyre njerëzve, kurse tani kjo urrejtje do t' u drejtohej individëve konkretë. Ai vuajti se po flinte mes tyre, në fakt konsiderohej si ata. Nuk mund ta shikonte thjeshtë dhe ftohtë këtë realitet. Mendimet i vlonin. Zemra i dhëmbte. Gjumi iu tret. Nuk mund të rrinte ashtu shtrirë, prandaj u ngrit dhe doli jashtë në oborr.

Ishte natë e errët pa hënë. Qetësi e madhe. Oborri ishte i shkretë, i zbrazët, por plot dritë. Më tej gjithënjë kridhej në errësirë të thellë. Rreth e rrotull shkëlqenin telat me gjemba dhe sikur majat e tyre i nguleshin në zemër. Roja ia mbërtheu sytë me dyshim. Për këtë shkak ai bëri sikur po shkonte në nevojtoje. Rojet, telat, të burgosurit ishin një realitet i ashpër, që i shkaktonte vuajtje, që kërkonte ta demoralizonte dhe pikërisht për ta kundërshtuar këtë ndjenjë pëshpëriti ngadalë:

- Kurrë nuk do të mposhem!

U kthye në barakë. U shtri dhe mendimet i vërshonin në kokë. Ai mendoi se kurrë nuk do të pajtohej me ata që kishte për rreth, se edhe këtu i burgosur nga komunistët do t' i qëndronte besnik shokëve të vrarë për Atdheun, për ëndrrën e Komunistit.

Njerëzit për rreth i ngjallnin në kujtesë kohën e luftës dhe ai përfytyroi me hollësi shumë ngjarje të atëhershme, shumë shokë. Pastaj fantazia e tij mori hov. Në këtë gjëndje i bëhej sikur dëshmorët e njohur mund të ngriheshin nga varret dhe ashtu pa formë mund t' i vinin atij pranë, t' i afroheshin si hije dhe ta vështronin të pakënaqur dhe të trishtuar. Dhe ai sikur mund t' u shtrëngonte duart dhe sikur u premtonte se kurrë nuk do t' i tradhëtonte idealin e tyre të lartë. Tani sytë i shkëlqenin çuditërisht, gjoksi i ndizej nga entuziazmi i idealeve të atyre që ishin bërë fli, nga lumturia se e ndjente që ishte ushtar i atij ideali edhe në këtë barakë, ku të mirrej fryma.

U ngrit dhe shikoi për rreth mos ishte ndonjë zgjuar. Nga fundi u ngrit një njeri me pallto krahëve dhe shkoi në nevojtoje. E priti, kur u kthye dhe e pyeti:

- Mos kini laps?

I internuari u tremb dhe u përgjegj:

- Nesër. .

Dhe shkoi në shtrat.

Po Besniku nuk mund të priste deri nesër. Ai ishte i tronditur nga gjithë ato ndjenja, mendime, përfytyrime dhe dëshëronte t'i derdhte në vargje. Zbriti nga shtrati. Iu afrua Naimit që po gërhiste. U ndrojt një herë, po pastaj u përkul, e tundi, gjersa tjetri u zgjua. Burri i moshuar i trembur dhe i habitur e pyeti:

- Ç'ke? !

- Kimi laps? Dua të shkruaj.

Tjetri e vështrroi me frikë fytyrën e tij të ndezur, sytë e çakërritur dhe mendoi: "Qenka i çmendur fare! ", por e përmbajti veten dhe duke u shtirë i habitur, e lëvdoi:

- Poet! Tamam poet!

Futi dorën nën jastëk, nxori një laps dhe ia zgjati.

Besniku falenderoi. U kthye shpejt te shtrati dhe shkroi në një letër të xhubrosur vargje, ku shprehej besnikëria ndaj shokëve dhe idealit.

Herët, posa zbardhi, Besnikun e zgjoi nga gjumi fërshëllima e bilbilit. Roja hyri brëndë dhe u bërtiti të ngriheshin. I inermuari i ri u çua i këputur se të djeshmen ishte lodhur dhe atë natë nuk kishte fjetur pothuajse fare. Lau sytë me pak ujë. Mori racionin e mëngjezit dhe e vuri te koka që ta hante më vonë.

Ra përsëri bilbili dhe shumica e të internuarve u rrjeshtuan për punë. Vetëm pleqtë dhe ca të sëmurë mbetën në barakë. Besniku, sipas këshillës së Zefit, qëndroi, por dikush e thirri nga jashtë:

- Ai i riu, shkrimtari, ku është?

U ngrit dhe vajti me vrap. Ishte komandanti që, sa e pa, i foli:

- S'ka llafe këtu si atje në Tiranë. Në punë, mxito!

Besniku u vu në rrjesht i shqetësuar dhe u nis në punë bashkë me të tjerët.

Pas pak arritën në një kanal të madh. I lanë plaçkat dhe bukën mënjane, morën lopatat e kazmat, sejcili zuri vendin e tij dhe filloi puna. Edhe Besniku gërmonte me kazmë. Herë pas here hidhte ndonjë vështrim për rreth. Shihte të burgosur dhe të internuar që hapnin kanalin e madh të ruajtur nga rojet, sikur të ishin në Egjiptin e lashtë dhe ndjente një nyje në grykë. Nuk ishte mësuar të punonte. Muskujt nuk i kishte të stërvitur, prandaj u lodh që në orët e para. Zefit, që e dinte se ishte i sëmurë, iu dhemb. Ai iu lut policit që ta lejonte të pushonte pak më tepër djaloshin. Polici pranoi. Besniku hodhi kazmën dhe vajti të pinte ujë te Genci, burrë i shkurtër, i zeshkët, me sy të trishtuar. Ishte ai, i cili, kur kishte marrë vesh se kishte qenë komunist, e kishte quajtur "Renegat". Genci ishte caktuar

t'u sillte ujë të internuarve. I shtrirë në hije ai e pa me ftohtësi djaloshin tek po vinte. Iu bë qejfi që ishte djersitur dhe raskapitur dhe sytë i ndritën me të keq. E mbërtheu me vështrimin e tij të errët dhe i foli me ironi:

- Qenke lodhur. .

- Sigurisht . . - U përgjegj ngadalë Besniku.

- Do të mësoshesh. Kështu ndodh në fillim. - I foli ai, ndërsa i mbushte sapllakun me ujë. - Me kohë, me stërvitje-është gjithshka.

Besniku piu dhe i ktheu kupën duke e falenderuar. Ish federalit iu ngjall dëshira ta ironizonte këtë ish komunist, prandaj, duke e fshehur talljen, i foli me seriozitet:

- Juve ju bën mirë të punoni sa më shumë.

- Pse? ! - U habit Besniku.

Genci u përgjegj ngadalë:

- Më thanë se merreshit me letërsi, se këni botuar një libër. Letërsia sipas gjermanëve është një punë hyjnore. Po duhet ta njohësh thellë jetën që të krijosh vepra të vërteta arti. Unë shoh se fytyra juaj është e qetë. Sytë të shkëlqejnë akoma nga flaka e rinisë. Balli juaj është pa rrudha e mendime. Këtu kini mundësi ta njihni jetën, të formoni konceptin tuaj si shkrimtar.

"Nje njeri i madh i Rusisë, Dostojevski, pas internimit krijoi vepra monumentale. Dhashtë zoti që mos t'u mbajnë gjatë, që mos t'u shkatërrojnë vuajtjet, mos të bëheni pesimist dhe kështu të vazhdoni rrugën e letërsisë. Shkrimtari duhet të ketë akoma besim në jetë që të krijoi vepra arti. Ndryshe çdo gjë i duket e kotë.

Fjalët e tij të ngadalshme, vështrimi i errët, pamja e trishtuar, ashtu si tingulli ironik i zërit, e shtypën shpirtërisht Besnikun. Përshtypjet e mëngjezit, lodhja fizike, sikur donin ta mposhtnin. Po shpirti i tij nuk pranonte të thyhej, prandaj iu ndez një valë vetëbesimi për të përballuar gjithshka që sulej kundra tij. Si të donte të lehtësonte veten, foli pa shumë lidhje me ato që tha bashkëbiseduesi:

- Gëteja thotë mes fjalëve të Faustit se kjo botë për të zgjuarin nuk është memece. I zgjuari nuk dëshpërohet se jeta në çdo shfaqje të saj i flet diçka atij, i zbulon gjëra të vlefshme, të bukura nga mund të kapet dhe të gjejë gëzim.

- Kush ta ka thënë këtë shprehje? - Pyeti i internuari që ndante ujin dhe shtoi - Qenka vërtet e bukur!

- Është një nga të vërtetat më të mrekullueshme që kam mundur të vë re në tragjedinë e poetit të madh gjerman. Kjo është vepra ime më e dashur. Aty përshkruhen me një forcë të madhe vuajtjet e njeriut drejt rrugës për të gjetur të vërtetën. Sidomos më pëlqen skena e fundit. Ajo është unike në gjithë letërsinë



botërore.

Dhe ai filloi të recitonte rusisht dhe të përkthente shqip monologun e Faustit para vdekjes. Recitonte e përkthente me zjarr. I shoqëronte mendimet me duar, sytë i ndrisnin sa Genci u çudit. Djaloshi kishte filluar të mbante në duar këto muajt e fundit së bashku me "Hamletin" edhe "Faustin". Tani, kur duhej të përballonte vështirësitë, nuk iu kujtua Hamleti. Fausti për të kishte kuptim më të dobishëm, prandaj i foli me aq pasion.

- Recitoni bukur. Po të isha mësonjës do t'u vija pesë! - E lëvdoi Genci me ironi.

- Dy vepra çmoj më tepër në gjithë letërsinë botërore, - Vijoi Besniku pa i vënë re fjalëve fyese - "Faustin" e "Prometheun". Këta titanë asgjë nuk i mposht. Ata e shprehin dashurinë ndaj njerëzve me forcë të jashtzakonshme. Madhështia dhe fuqia e tyre habit njerëzit në shekuj.

Në buzët e Gencit lëvizte një hije skeptiçizmi. Për herë të parë haste në burg një njeri që i paraqitej kaq romantik, që i fliste me aq pasion për virtytet njerëzore. Fjalët e të riut sikur donin ta trishtonin më shumë, prandaj iu ngjall dëshira hakmarrëse për ta zhveshur mga iluzionet dhe entuziazmi rinor:

- Ju këshilloj ta harroni Faustin e Prometheun, megjithëse, edhe pa porosinë time, shpejt nuk do t'i përmendi më. Kam bindjen se është e fundit herë që flisni me aq zjarr për to. Rinia është plot fantazi, shpresa, ëndrra, guxim, por me kohë të gjitha bien si gjethet në vjeshtë.

"Mund të them se edhe unë dikur kam qenë i ri, kam pëlqyer Faustin e Promethuen dhe kam dashur t'u shëmbëllej atyre. Por tani u jap ujë të burgosurve.

"Diziluzioni është procesi më i natyrshëm, më njerëzor. Vetëm gjenialët plotësojnë me një vullnet të çeliktë, pas një pune prej skllavi, një pjesë të ëndrave të tyre rinore dhe nuk pësojnë diziluzion të plotë.

"Harroje pra Faustin e Promethuen. Do të vijë një kohë dhe do ta kujtosh këtë kaçube ferre, Gencin e shëmtuar dhe fjalët e tij të vërteta.

Ra bilbili. Polici thirri të internuarin e ri të fillonte punën.

Në barakë në orët e lira të pasditës Besniku u ndodh në një pozitë të tillë, që nuk e parashikonte kurrë. Vetvetiu iu mbiudhën për rrth shumë të internuar dhe filluan të bëjnë biseda të ndryshme. Ishte e natyrshme kjo për deri sa kishte ardhur nga jashtë me lajme të freskta. Ballë tij qëndronte Mit'hati, burrë simpatik, i veshur pastër e hijshëm. Me fjalët, pamjen, pyetjet tregohej familiar me Besnikun, ashtu si i paraqitej policit, komandantit të burgut dhe të internuarve. Fytyrën e kishte

gjithëmonë të qetë, me një shprehje paqësore dhe të përzemërt. Këtë pamje , veçse me shkëlqim dhe autoritet, e kishte patur edhe kur shërbente pranë regjencës fashiste shqiptare. Vetëm para gjyqit ishte shëmtuar duke u munduar të shfaqsohej si para shokësh, duke pranuar ndonjë gabim si fëmijë, pa të keq. Si gjithmonë, edhe në internim, përpiquej të gjente mënyrën më të lehtë për të jetuar. Herë shërbente si berber, herë si ujëmbajtës, herë si intendent. I përfitonte këto privilegje duke u sjellur i afruar me ata të komandës.

Aty pranë dëgjonte me vemendje Naimi. Pyeste dhe herë pas here shprehte nderim gjoja fsheurazi ose tërthorazi ndaj djaloshit duke dashur gjoja të mos e lëvdonte në sy. Te dera ishte shtrirë në shtrat me llullë në gojë Genci. Vështronte jashtë, por mendjen e kishte brënda, te biseda. Herë herë ndërhynte me ndonjë vërejtje të shkurtër therëse. Në shtratin përballë dëgjonte me gojë hapur, si i paditur, Alfredi, një burrë me syza, që pohonte vazhdimisht me kokë. Pranë tij Gjergji, një ish gjykatës, me këmbë të thyer në hetuesi nga torturat, mbahej serioz e i heshtur, bënte sikur lexonte një libër dhe nuk futej në bisedë. Po shpesh lëvizte me nervozitet duke shprehur kështu protestë ndaj ndonjë mendimi.

Gjëndeshin edhe plot dëgjonjës të tjerë.

Në barakë pothuajse kishte rënë një qetësi e plotë dhe mbanin vesh edhe ata të barakës tjetër. Donin të kuptonin nga biseda se ç'ishte ky djalë që të dinin kështu se si të sillleshin. Pyesnin herë njeri, herë tjetri. Biseda zhvillohej lirshëm.

Në Tiranë Besniku fliste dhe arsyetonte pa e çarë shumë kokën, kurse tani , ndofta për të parën herë në jetë, po matej shumë në të folur. Ra fjala edhe për letërsinë shqipe dhe Mit'hati që njihje diçka rrethet letrare, pyeti:

- A çmohet ndopak Andrea si shkrimtar? !

Besniku heshti. Në Tiranë i kishte sharë shkrimet e Andreas dhe gjithë letërsinë shqipe si vepra pa vlerë dhe me krenari i kishte përsëritur në një farë mënyre edhe para gjyqit. Tani e kuptoi se këtu pikëpamjet e tij nuk do t'i kundërshtonin, bile do t'i lëvdonin dhe do të kënaqeshin që një ish komunist, përbuzte letërsinë e re. Kjo atij nuk i pëlqeu. Në këtë çast ndjeu më shumë gjëra të përbashkëta se sa kundërshtime me atë letërsi kundër së cilës fliste mbarë e prapë.

- Sigurisht çmohet - Tha ai me zorr - Veprat e tij kanë të meta, por aty shihet një përpjekje serioze për krijim karakteresh.

Të gjithë me heshtjen e tyre sikur e pranuan këtë vlerësim, veç Genci ktheu kokën nga Besniku, hoqi llullën e foli:

- I kam shfletuar edhe unë si rastësisht disa kapituj të një novele të gjatë

të tij "Dorëzimi i Bereqetit". Ishte një përjashtim se tani më mërzhisin edhe kryeveprat botërore. Për kuriozitet munda të shtyj nja dhjatë faqe. Pastaj e lashë. Atë novelë e kisha lexuar çdo ditë nëpër artikujt e gazetave kryesore. Nuk kishte asnjë ndryshim nga ato. Ndofta veç ndonjë gjë pa rëndësi. .

Genci thithi përsëri llullën.

- Nuk është ashtu. - Kundërshtoi Besniku, që nuk donte të ishte me një mendim me Gencin.

Dhe e lëndoi veprën e Andreas të cilin e përbuzte në Tiranë:

- Shkrimet e tij janë plot dinjitet.

Genci hoqi llullën me një buzëqeshje ironike dhe nguli këmbë në të veten:

- Ai nuk na thotë asgjë origjinale. Nuk ka fare koncept të vetin. Ti duhet ta kuptosh mirë këtë gjë, gjersa më recitove me aq pasion "Faustin" e Gëtes. Bile dyshoj se prandaj të kanë sjellë këtu.

Besniku u skuq gjer në rrëzë të veshëve dhe duke ndjerë ta gërvishte tjetri në plagë, kundërshtoi prapë:

- S'është e vërtetë!

Genci ia priti me qejf:

- Këtë e di mirë ti, por me sa shikoj, nuk duhet të na e thuash neve.

Mit'hati ndërhyri:

- Pusho, o Genc! Na lër të bisedojmë rehat! - Dhe pastaj pyeti prapë - Po Ismaili shkruan më? Nuk po e shohim ndonjë gjë të re.

- Ka një roman në dorë. Besoj se së shpejti do ta mbarojë. Është njeri me zemër dhe pa tjetër do të nxjerrë gjëra me vlerë. Vjershat e tij të Luftës, që janë vërtetë të bukura, ma japin këtë besim.

Genci përsëri ktheu kokën, vështroi ftohtë dhe e ndërpreu:

- Më falni, një pyetje. Sa vjeç është Ismaili? Shkrimet e tij i kam lexuar që në vitin 1937. Së paku duhet të jetë nga dyzetat. Paskemi shpresë të madhe për një Servantes shqiptar. Nga biseda jote kam fatin e madh të marr vesh se shumë shkrimtarë të sotëm shqiptarë ngajnë me spanjollin e madh dhe sigurisht do të kemi shpejt ca kryevepra botërore.

- Genc, mjaft me shakara! - E qortoi dikush.

Besniku u përgjegj:

- Servantesi është një në gjithë letërsinë botërore dhe nuk mund të pretendojmë gjëra fantastike.

Dhe pa e kuptuar se do të përsëriste pikë për pikë fjalët e Filipit, të cilat i ishin dukur fare bajate, vijoi:

- Por diçka është e sigurtë: Letërsia shqipe ecën përpara dita ditës, zhvillohet, rritet dhe përqë. Ajo është më e mirë se letërsia e kohës së Zogut duke përjashtuar Migjenin. Shpejt do të lindin në Shqipëri edhe veprat të mëdha që do t'i kapërcejnë Rilindasit.

Genci e ndërpreu prapë:

- Me ndihmën e metodës së realizmit socialist, më duket e harrove.

Besniku u turbullua. Kohët e fundit atij i ishte dukur absurditeti i realizmit socialist dhe nën parullën e realizmit e kishte hedhur poshtë në mbledhjen e organizatës së Partisë, bile edhe në gjyq. Në bisedat me të tjerët e kishte quajtur, ashtu si me Agimin, dogmë realizmin socialist, klasiçizëm, pengesë kryesore të zhvillimit të letërsisë shqipe. E kuptoi qartë se ironia e Gencit ishte gati e njëlojtë me përbuzjen që kishte shprehur vetë dhe se goditjet kundër realizmit socialist ishin pjesë e sulmit kundër sistemit të ri, për vendosjen e të cilit ai kishte luftuar. Prandaj u përgjegj me plot gojë:

- Sigurisht në bazë të asaj metode.

Sytë e ish federalit shkëlqyen me shpoti:

- Ju lumtë! Jeni vërtetë të mençur! I merrni të gatshme nga Bashkimi Sovjetik dhe gjithshka e bëni me kallëpe. Metoda Levçenko Muhanov, metoda e prerjes së shpejtë, metoda e realizmit socialist. Të ecurit në bazë të metodave kallëpe është bërë vetë metodë.

Kuptohej se fjalët e Gencit ishin sulm kundër ndikimit të Bashkimit Sovjetik. Edhe Besniku ishte ngritur, bile edhe në gjyq, kundër një pjese të madhe të letërsisë sovjetike dhe metodën e realizmit socialiste kishte quajtur të huajtur artificialisht, por tani sikur t'i drejtohej mendimeve të veta, pyeti:

- Ju thoni se realizmi socialist është diçka artificiale, e marrë kallëp nga Bashkimi Sovjetik?

- Ju po i thoni këto. Mos m'i veshni mua. Janë të rrezikshme. Mos i kini përmendur gjetiu? - Pyeti Genci si i pafajshëm.

- Tërthorazi këtë dëshëroni të argumentoni. Po kjo nuk është e vërtetë. Realizmi socialist është pjesë e natyrshme e revolucionit, është rezultat i domosdoshëm i jetës shqiptare. Ai përfaqson epokën e re që u hap nga letërsia sovjetike. Në këtë pikëpamje letërsia jonë ecën nën shembullin e letërsisë sovjetike.

Ish federali u shpreh me përbuzje:

- Këtë e shohim shumë qartë. Nuk ka nevojë të vish këtu në internim dhe të na e tregosh ti.

Djaloshi u mbush me inat, por heshti. Kështu të nesërmen e ditës së internimit

ai mbrojti me këmbëngulje realizmin socialist dhe veprat kundër të cilave ishte ngritur në Tiranë dhe as që mund të mbante tjetër qëndrim. Gjatë atyre tre ditëve në birucë dhe këtu në intermim po i dilnin në pah ato gjëra që e lidhnin me shokët e tij komunistë dhe kur ndodhej kundër kundërshtarëve politikë (Tradhërëve të Atdheut - siç mendonte ai me vehte) pa tjetër do të mbronte letërsinë e krijuar në rrethanat e pushtetit të ri.

Ndaj letërsisë së re kishte shumë rezerva edhe tani, por këto do t'ia shfaqte një shoku, por këtyre ia fshihte se nuk donte t'u jipte shkak dhe të drejtë ta shanin. Cilido që e kishte njohur Besnikun në Tiranë, do të habitej, po të dëgjonte këto debate.

Të internuarit nuk u çuditën. Ata e dinin nga përvoja se gati të gjithë të burgosurit ish komunistë mbronin hapur dhe me këmbëngulje pushtetin e ri. Megjithatë patën një farë shprese se djali i ri mund të bënte përjashtim. Por nuk u doli. E kuptuan se duhej të rezervoheshin me të dhe sjellja e Gencit u dukej marrëzi. Bisedonjësit e aprovonin, kundërshtonin për gjëra të vogla, sa për sy e faqe dhe të jipnin përshtypjen se u pëlqente mençuria dhe thellësia e Besnikut.

Ndërsa vazhdonin të llafoseshin kështu, u dëgjua zhurmë. Dikush po zihej andej nga fundi i dhomës. Genci ktheu kokën dhe foli:

- Ju lutem pushoni. Le të dëgjojmë një simfoni të re që të shlodhemi nga bisedat serioze.

Naimi u ngrit menjëherë duke thënë:

- Pa të shohim ç'bëhet.

Sa herë grindeshin, ai ishte spektatori më tifoz dhe shpesh pjesmarrës aktiv. Mërzija, nervozizmi që i shkaktonte internimi, dobësia e tij shpirtërore, sikur shfryheshin në zenkat banale.

Të gjithë po shihnin andej nga vinte shamata. Grindej Andrea, ai burri të cilit Besniku i kishte kërkuar laps në mes të natës, dhe Serveti. Kishin zënë të dy një copë dërrasë dhe dukej se për të po bënë zhurmë. Andrea ishte skuqur ca. Kishte pamje të inatosur, ndërsa në fytyrën e Servetit shprehej habi dhe indinjatë.

- Kjo është dërrase ime, - I bërtiste Andrea i bindur në drejtësinë e vet - kurse ti e ke përvetësuar padrejtësisht. Hajde të lutem, merr një çikë mundimin të shohësh si kanë mbetur librat e mia.

Serveti gjithënjë me atë shprehje habie e indinjate ia ktheu me të butë:

- Ju lutem, profesor, mos u tregoni pa llogjikë. Dërrasën e gjeta në lluc dhe kam harxhuar një kallëp sapun për ta larë. Mua më kanë mbetur enët te koka.

Genci ishte ngritur ndenjur. Fytyra e tij ndriste nga kënaqësia. Ai foli me zë të lartë:

- Servet efendi , tregohu shpirtmadh dhe jepja dërrasën profesorit. I kanë mbetur librat e hallakatura dhe ato kanë shumë më tepër rëndësi se enët e tua, me që me ato, e dinë të gjithë, ushqehet koka dhe jo stomaku.

Naimi u ishte afruar atyre dhe vështronte me kujdes dërrasën. Pastaj e zuri me dorë dhe u foli:

- Ju lutem, ta shoh pak në dritë.

- Ç'të duhet ty? - U revoltuan ata .

- Si bëni, xhanëm, për një copë dërrasë? Po unë nuk do ta ha. Sa ta shoh një çikë.

Ata e lëshuan të pakënaqur. Naimi doli në oborr. E ktheu dërrasën sa andej këndeje. Picërroi sytë. , si miop që qe dhe u fut në barakë plot triumf.

- Po kjo është dërrasa ime. Kot zihi ju. Kam dy javë që e kërkoj. Kam shahit zotin Gjergj.

Ai iu drejtua burrit që rrinte i heshtur ballë Besnikut. Vetëm tani ai e kishte hequr librin dhe mbante vesh me një shprehje të pakënaqur.

- Zoti gjykatës, a të kujtohet që e solla këtu në kamp para dy javësh?

- Më kujtohet që solle një farë dërrase - Pranoi Gjergji. - Po ç'del prej kësaj?

- Ja njya. Këtu ishte ngrënë ca. Kjo është tamam dërrasa ime. Mezi e kam futur këtu. E lashë aty jashtë që ta sharroja, kur u zhduk. . .

Ai iu kthye Andreas:

- Profesor, këtë nuk e prisja nga ti. Njeri me kulturë, me edukatë të lartë. Ke qenë ministër dhe të marrësh dërrasën pa leje? Me një fjalë të vjedhësh? Turp!

Andrea u hodh i revoltuar:

- Ti mund të jesh hajdut! - Ai iu drejtua Alfredit - Zoti Alfred, nuk kam pyetur për këtë dërrasë?

- Po, ka pyetur. - Pranoi me qejf Alfredi.

Genci i pëshpëriti mënjanë Besnikut:

- Shiko si e përkrah. . Janë kolegë. Kanë qenë ministra në një qeveri. Jo vetëm komunistët kanë ditur të jenë solidarë mes tyre.

Dhe pastaj ai bërtiti:

- Naim bej, mos i bëj padrejtësi profesorit. . Profesor, merre dërrasën me forcë. Ke edhe përkrahjen time morale. Aty , kur nuk kryen punë arësytimi, violenca është e këshillueshme.

Ndërkohë pa u ndjerë fare, kishte hyrë brënda kapterri, përgjegjës për barakën. Ishte një burrë afër të tridhjetave, i kuq në fytyrë, me pamje gjithënjë të pandryshueshme, sikur të kishte vënë një maskë të qetë. I heshtur, hetonjës, pak i rëndë. Edhe zëri i tij kishte po një intonacion. Nuk nxehej kurrë. Fliste shkurt me të burgosurit, ngadalë, në një mënyrë që të impononte respekt dhe pak frikë dhe kurrë nuk e vinte buzën në gaz. Të intermuarit nuk kishin arritur të mësonin asgjë rreth tij. I bindeshin me përpikmëri dhe herë herë dukej se ai kishte më autoritet se komandanti.

Ai qëndroi në prak dhe pyeti:

- Ç'është kjo rrëmujë? !

Të gjithë kthyen kryet nga dera. U habitën kur panë policin dhe sigurisht nuk u erdhi mirë. Serveti sikur u gëzua për ardhjen e tij dhe foli:

- Ja, zoti kapter do ta zgjidhë çeshtjen drejtë. Ky është i gjykueshëm. Ç'të thotë, do të bëjmë.

Dhe tregoi me pak fjalë se si qëndronte puna.

Andrea nuk shprehu aq respekt ndaj kapterit, por shpresonte te ai, prandaj i tha:

- Zotni, ky kërkon të marrë dërrasën time.

Naimi ndërhyri:

- Kjo dërrasë nuk është as e këtij, as e këtij! Ajo është imja.

Me kaq heshti, se nuk thoshte dot që e kishte sjellë fsheruzi në kamp.

Polici dëgjoi pa e prishur fare gjakun, pa u ngutur dhe si mbaruan të tërë, u foli:

- Ma jepni mua.

Ata i dhanë dërrasë dhe kapteri me një lëvizje të fortë e hodhi jashtë telave duke thënë:

- Ndalohet rreptësisht të ndërtohen raftë.

Në barakë ra heshtje.

Andrea, Serveti, Naimi mbetën gojë kyçur, sikur t'u kishte rënë ndonjë fatkeqësi. Gjergji qeshi me vete. Alfredi u çudit dhe kishte pamjen e atyre që po grindeshin. Gencit iu duk një shkëndijë tallje. Mit'hati pëshpëriti:

- Ç'ua bëri mirë!

Polici që nuk kishte ndryshuar fare, pyeti:

- Kush i ka kërkuar komandantit të vizitohet?

- Unë. . - U ngrit Besniku.

- Të porta. Doktor i po pret.

Polici ktheu shpinën dhe u largua.

Andrea i zemruar iu përvesh Naimit:

- Ti i ke fajet!

- Jo unë, po kush merr pa leje mallin e tjetrit - E akuzoi Naimi i nevrikosur.

Serveti, që e kishte inat Naimin, e shau:

- Ti kudo futesh si hajvan!

Naimi u nxe edhe më tepër dhe ia ktheu:

- Hajvanët në kohën e fashizmit i bënin komandanta xhandarmërie. Unë nuk kam qenë komandant xhandarmërie atëherë dhe rrjedhimisht nuk mund të jem hajvan.

Servetit, i cili kishte qenë komandant xhandarmërie në kohën e okupacionit, i dogji kjo dhe u mbrojti:

- Po ti burrë i mirë ke qenë!

Gjergji dukej sinqerisht i helmuar dhe i qortoi:

- Turp të kini! Burra pleq ziheni për një copë dërrasë! I ankohi dhe policit.

Ç' do të mendojë ai për ne? !

Kjo ndërhyrje sikur e fashiti sherrin. Po, kur të gjithë pushuan e grindja po shuhej, Genci i shtrirë në krevat nisi sërish me një ironi therës:

- Unë për vehten time ju falenderoj shumë, zotërij dhe them se humbjet tuaja materiale e vlejné koncertin e sotëm. Një simfoni të tillë klasike ka kohë që nuk e kemi dëgjuar. Pika e saj kulminante, hedhja e dërrasës nga polici, ka qenë madhështore, epike - lirike, mund të themi betoviane, me nuanca tragjiko - dramatike, komike:

“Profesori pësoi një stres të vërtetë se nuk ka ku t’i vendosë librat që i ka të vyera shumë për punët e tij të mëdha. Servet efendiu një dramë, se humbi sapunin, kurse Naim beu na shfaqet komik se bëri një heroizëm, futjen e dërrasës në kamp, pa asnjë dobi. Unë për vehten time ju falenderoj edhe një herë nga zemra. . dhe bile dëshëroj që koncerte të tilla të përsëriten herë pas here. . .

Kjo skenë i bëri përshtypje Besnikut që donte të bindej për kalbëzmin e këtyre njerëzve në çdo shfaqje të jetës së kampit. Grindje të tilla do të përsëriteshin shpesh, prandaj ai çdo ditë do të dëgjonte Gencin të thërriste, kur kthehej nga puna:

- Ka patur sot ndonjë simfoni gjatë mungesës sime? Cilët vallë janë autorët?

Në këto çaste Besnikut i kujtohej vëllazërimi i luftëtarëve të lirisë në burgun e Tiranës gjatë kohës së okupacionit, kur kishte qenë edhe vetë i burgosur.

Të nesërmen mbrëma, si hëngrën darkë, Naimi i erdhi Besnikut te shtrati për



t'i bërë shoqëri. Tregohej aq i afër me të sikur të njiheshin prej vitesh. Kohët e fundit ai e ndjente veten në kamp gjithënjë e më të izoluar, prandaj e gëzoi dhe e ngushëlloi njohja me të riun. Qëkur e pa, iu duk zemër mirë, pa vogëlsira shpirtërore.

Besniku e ndjente se kjo afërsi kishte diçka që nuk shkonte, por e priti mirë dhe u suall njerëzish. Në bisedë e sipër, duke kuptuar se Naimi mund t'i jipte shumë të dhëna rreth të internuarve, e pyeti se ç' njerëz ishin ata që ndodheshin në barakë. Në këtë mënyrë ai shfaqte një farë besimi ndaj bashkëbiseduesit.

- T'i tregon babaxhani ty. . Fije për pe. Më mirë nga unë askush nuk ua di të palarat. - Tha Naimi-me kënaqësi.

Ai ishte fjalaman. I pëlqente të fliste keq për të tjerët, se kështu hakmerrej kundra atyre që e kishin inat. Me shumicën e të internuarve para çlirimit kishte patur marrëdhënie sipërfaqore të ngrohta. I kishte njohur për njerëz të mirë. Por me asnjërin nuk kishte lidhur miqësi të vërtetë. Brënda në kamp kishte ndryshuar krejt qëndrimi i tyre. Gjithshka ishte shfaqur lakuriq, në forma të shëmtuara. Këtu të internuarit të shtypur nga jeta, nuk kujdeseshin shumë të ruanin paraqitjen e jashtme morale. Naimi ua njihte ndyrësitë, mërzi, revoltohej dhe me që ishte një karakter i papërmbajtur, zihej shpesh. Për këtë shkak marrëdhëniet e tij me të tjerët ishin keqësuar shumë. Duke kallxuar anët e dobta të të internuarve, atij i dukej se gati po kryente një veprim human, se merrte pjesë në ndëshkimin e ligësisë.

U fut thellë në roba, u shtrua mirë në krevat dhe e ftoi Besnikun t'i qëndrojë pranë. Nisi të tregonte duke mbajtur dorën te goja me marifet që mos të kuptohej se fliste vazhdimisht. Shënoi me sy nga Andrea, ktheu kokën në anën tjetër që mos të kuptohej se fliste për të dhe tha:

- Ta fillojmë nga profesori.

- E urren atë? - Pyeti pa dashur Besniku.

Naimi sikur u çik në plagë. Vërtet e urrente për shumë arsye personale, por duke dashur t'ia bënte qejfin dëgjuesit, u përgjegj si me pafajësi:

- Sigurisht e urrej. Ai ka qenë ministër i kulturës fashiste në kabinetin më të fëlliqur dhe më reaksionar. Drejtonte gjithë propagandën fashiste. Villte vrer kundër komunistëve. . Ngrinte në qiell Duçen. . Ministër i kulturës fashiste në. .

- E di. - E ndërpreu Besniku që nuk e besoi gjithë atë pasion patriotik të tjetrit.

- Kush ta tha? - Pyeti Naimi me interes.

- Genci. .

- Ai atje? I ziu? - Bëri fshehurazi me shenjë.

- Po. .

- Ç'është ai, ç'është! - Tha Naimi i kënaqur që do ta shante Gencin, i cili s'e linte rehat me talljet e tij. - Do ta tregoj edhe atë fytyrë. Po e kishim fjalën te profesori.

"Ka qenë një nga njerëzit më të fëlliqur të kabinetit. Dridheshin para tij. Ama kishte një grua të bukur që mos e pyet, t'i mirrje kokën.

Ai e cyti me dorë, vështroi drejt e shtoi:

- E sheh atë pranë këpucarit? Tamam ai, Mit'hati që të pyeste për letërsinë. Thonë se ia mballoste gruan. Njerëz tuafë. S'i kuptoj fare. Në ministri u bë skandal i madh atëherë, kurse këtu shoqërohen si vëllezër. Allah! Allah! Për të zënë kokën me duar! Mit'hati ishte zevendës i tij. Ta shihje si vishej: Roba blu, këpucë të zeza llustrafine, këmishë të bardhë, mustaqet spic, bukurosh tamam. Mit'hat bej Frashëri e donte qamet. Tani shitet si komunist. Dallkauk i madh! I kam shumë inat njerëzit servilë dhe hipokritë.

"Vijmë te Genci se duket e ke qejf. Federal i tmerrshëm! Ka lënë nam. "Fashista della prima ora". Bashkëpunëtor i ngushtë i Mustafa Krujës. Hesht, se kush po vjen.

Naimi pushoi. Bënte sikur fërshëllente se ca të internuar qëndruan pranë tyre. Si kaloi rreziku, vijoi me qejf:

- Shokë me Mustafa Krujën dhe me atë është kthyer. Ka bërë qejf që është kënaqur. S'ka lënë grua të bukur pa e shtënë në dorë. Antikomunist i tërbuar. T'i çash barkun, i del Hitleri. Njeri i poshtër, cinik. Gëzohet me fatkeqësinë e të tjerëve. Kërkuj nuk ja do të mirën dhe pret të kthehet prapë regjimi i parë.

Heshti pak. Kontrollloi me sy për kë të fliste dhe vijoi:

- Hë. . Këpucari ka qenë kuestor policie. Torturonte me duart e veta. Njeri shpirtlig. Mua të shkretin ç'më ka gjetur këtu. Kot, bigari hak. Atifashist i klasit të parë që me shtatë prill. Jam internuar dy vjet në fshatrat e Barit se fola turqisht dhe frengjisht kundra pushtimit italian. Mirë italianët, po komunistët pse të më fusin në burg? Pyet kë të duash, nuk të gënjej.

U afrua dikush, prandaj e ndërpreu bisedën dhe tha:

- Tani je mrekulli. Raportin e more. Në punë nuk del më. Ushqimin e ke special.

Një i internuar zgjati kokën te shtrati dhe i kërkoi Besnikut një zarf. Pastaj u largua duke e parë me bisht të syrit Naimin. Naimi u hakmarr duke treguar se me gruan e tij që ishte shumë e bukur dhe mbahej akoma, bënte pallë vite me

rradhë një inxhinier.

Besniku e dëgjonte me çudi këtë burrë të moshuar që, sikur të ishte djalë njëzet vjeç, shkrihej kur fliste për femrat dhe vetëm më vonë do t'i dukej e natyrshme kjo sjellje. Ai do të mësonte se megjithëse i thinjur, ai rronte akoma me kujtimin e grave të bukura të Romës e të Parisit, me të cilat ishte dëfryer. Djaloshi e pyeti për Gjergjin, i cili mbante një qëndrim të ftohtë e serioz dhe bënte sikur nuk e shihte fare.

- Ai që lexon gjithënjë? - Pyeti Naimi dhe tregoi me një farë respekti ndaj tij - Ka qenë gjykatës. . Në kohën e Luftës nuk u ngatrrua, por pas Çlirimit e akuzuan se ka marrë pjesë në një organizatë të fshehtë antipushtet. E torturuan për vdekje në kohën e Koçi Xoxes sa i thyen edhe këmbën.

"Kurse ai pranë, Alfredi, ka qenë ministër në një kabinet me profesorin. . Shihe. . shihe. . Verejmi me kujdes duart. . . Shikoje kur të bëjë kryq. Aman. . Aman.

Me të vërtetë Alfredi bëri kryq dhe ra të flerë. Naimi u revoltua siqerisht edhe pse ata ishin zënë keq një ditë më parë.

- Bah, ç' ministër arësimi! Merre me mend se ç' arësim mund t'i jipte rinisë shqiptare. Drejtonjës i arësimit në gjithë Shqipërinë dhe më bën kryq katërqind herë në ditë. Në ç' duar kishte rënë Shqipëria! U lumtë komunistëve! Ke inat, folu hakun. I qëruan plehrat, megjithëse ka ndonjë përjashtim. Unë kam qenë ateist që i vogël. Turp që një intelektual të besojë Zotin. Ai është jezuit tamam. Përkulet, bën lajka, sikur është me pushtetin. Puro hipokrit. Të vijë edhe një herë koha e tij, të grin me sëpatë. Të gjithë të poshtër janë, fundërina. - Thoshte ai duke përjashtuar vetëm veten.

- Po Serveti? - Pyeti djaloshi.

- Gomar. . . Budalla me gjithë rroba. Ka qenë komandant xhandarmërie. .

Kështu Naimi për dy orë me rradhë i tregoi me qejf dhe siqerisht shumë prej atyre që dinte rreth biografisë të të internuarve dhe i përshkroi karakteret e tyre ashtu si i levërdiste. U ngrit vetëm kur erdhi polici dhe i urdhëroi të flinin.

Shkoi në shtratin e tij duke fërshëlyer lehtë si pa të keq. Ishte i kënaqur se ndofta i kishte hyrë në zemër Besnikurt, se kishte shfryrë dufin kundër rrethit që e përbuzte dhe herë herë e urrente. Po atje thellë e brente ca ndërgegja. Një zë i brendshëm e qortonte.

Pas gjithë atyre që dëgjoi, Besnikurt iu zvordh edhe më tepër ky midis pa përjashtuar as Naimin. Kishte besuar gjithshka të keqe që kishte thënë Naimi për

të tjerët dhe kishte dyshuar në të gjitha anët e mira që i kishte veshur ai vetes. Ishte i bindur se ai shtirej si pro pushtetit popullor, se më kot nuk e kishin sjellë aty. Dhe kështu ishte e vërteta.

## XV.

Besniku me një pamje të zymtë kishte qëndruar në oborr pranë telave. Para tij pas telave kalonin një nga një të burgosurit, burra, të rij, pleq, të veshur si fshatarë, si malsorë, si qytetarë me rroba të vjetra dhe të arnuara. Po ktheheshin nga puna, prandaj ishin të lodhur plot pluhur dhe djersë. Thellë atij i vinte keq për ata që vuanin kështu larg familjeve të tyre dhe përpiqej të përligjte me vehte dhunën e pushtetit popullor dhe të qetësohej.

Pikërisht në këtë çast Genci iu afrua pa u ndjerë, me llullë në gojë, si hije. Ai ishte më i trishtuar se zakonisht. Sytë e tij të errët e shprehnin qartë këtë. Posa kishte lexuar në gazetë që po liroheshin në Bashkimin Sovjetik shumë gjeneralë të Hilerit. Ai ishte mbushur plot inat e urrejtje se po liroheshin kriminelë të mëdhej, kurse ai kishte gati dhjetë vjet i burgosur që nga ajo ditë, kur e kishin plasur në burg partizanët. Ish federali e kishte flakur gazetën me zemërim, kishte dalë nga baraka që të largonte mendimet e hidhura në ndonjë çip të oborrit. E vuri re Besnikun dhe sikur ia lexoi në ballë dilemën. Pandehu se ishte çasti i përshtashëm për t'i shprehur të drejtën e tij, për t'i hapur botën ashtu si e kuptonte vetë atij djaloshi që kishte njohur vetëm bulevardet e Tiranës, përkëdheljet, sukseset.

I qëndroi në brinjë me fytyrë të trishtuar nga të burgosurit që ktheheshin nga puna dhe i foli ngadalë, sikur e bluante dhëmbja:

- Preke, preke me duart e tua të vërtetën. Bindjet kështu i formon vetë, nuk t'i servirin të tjerët. . Shihi. . . Shihi. . . Një kuadër mjaft piktoresk! Bij nënash, baballarë fëmijësh, vëllezër motrash, burra grash që dergjen nëpër burgje. Gjithë ditën janë djegur në diell, kanë lagur me djersë tokën e zezë të Myzeqesë dhe tani presin t'i kontrollojnë imtësisht. Kanë uri, etje, kanë dëshirë të shlodhen, por presin t'u vijë rrada.

Ai heshti një hop dhe vijoi:

- Ja ç'bën pushteti i ri socialist, popullor, humanitar sa s'ka ku të vejë më. Kjo është diçka paradoksale në kokën tënde. Edhe në regjimin tiranik të Satrapit Zog, nuk kishte kaq të burgosur. Po të jesh i sinqertë, duhet ta pranosh hapur këtë

para meje.

Besnikut iu rrudh zemra. E kishte qëlluar mu në plagë. Duhet t'i jipte përgjigje vehtes dhe atij. Nuk mund të pranonte se pushteti i ri i shtypte njerëzit, por edhe nuk mund t'i mohonte të burgosurit që kishte para syve. U kthye nga Genci. Sytë nuk i kishte të trishtuar. Një flakë e brëndshme i ndriçonte.

- Vërtetë Shqipëria nuk ka pasur kaq të burgosur, por nuk e shihni problemin thellë dhe nuk e kuptoni se këto burgime ishin të pashmagshme. Në Shqipëri u bë një luftë e madhe. Një ndryshim rrënjësor në jetën ekonomike, politike e shoqërore. Gjithshka e vjetër u përmbys dhe lindi një botë e re. Ishte e domosdoshme që të bëhej kjo përmbysje që të themelohej Shqipëria si shtet i fortë. Fashizmi dhe klasat sundonjëse nuk e donin këtë, prandaj u bë një ndeshje e ashpër, e përgjakshme. Shumë prej jush u bashkuan me okupatorin. Të tjerë pas çlirimit kundërshtonin reformat, rrezikonin, pengonin që të bëhej një Shqipëri e fuqishme demokratike. Pushteti i ri nuk mund të qëndronte duarkryq dhe i qëlloi pa mëshirë. Kjo ishte e arsyeshme dhe e domosdoshme. Sa të drejtë kishit ju të kundërshtonit, aq të drejtë kishim edhe ne t'u shtypnim, bile edhe më tepër. Kështu ka ndodhur në të gjitha revolucionet dhe përmbysjet e mëdha shoqërore. Kështu vepruan edhe në Revolucionin e Madh Frances, të cilin një ditë ma lavdërove, Historia shpesh e hap rrugën me dhunë. Tani përlëshjet e përgjakshme morën fund. . Reformat kryesore kundër klasave shfrytëzuese mbaruan dhe arrestimet janë më të pakta. Ju vetë thatë një ditë se arrestimet janë rralluar dhe ne do të sjellim një ditë, kur mos të ketë më burgje. Burgjet tona janë të fundit. Ato do të zhduken vetë.

- Pasi të vdesin mijëra. . . - Pëshpëriti hidhur Genci - Pse më mbani në burg? Për çfarë shkaku? Çfarë kam bërë unë? !

Besniku e vështroi me inat. Sytë i lëshonin flakë. Ai foli me përbuzje:

- Ti ke qenë federal i Partisë Fashiste. Ke tradhëtuar Atdheun! Peza digjej, djemtë më të mirë të Atdheut kalbeshin nëpër burgje, vriteshin nëpër rrugë. Toka shqiptare lahej me gjak, rënkonte nën tiraninë më kriminale në histori, kurse ti u bashkove me fashistët, i ndihmove ata në krimet e tyre. A ka vallë faj më të shëmtuar? Për një krim të tillë cilido meriton vdekjen!

Genci këto fjalë i kishte dëgjuar shumë herë, i kishte lexuar nëpër gazeta e trakte, por në gojën e Besnikut tinglluan me forcë, në një mënyrë të re. Megjithatë ai qëndroi i heshtur. Pamja e fytyrës së tij nuk ndryshoi fare.

- Po. . . e Pranoj. . Gam gabuar. . . - Tha ai - Nuk ka njeri të pagabueshëm. Është gënjyer Hitleri, një Gjermani e tërë, shteti më i fuqishëm në botë. Kujt ia mirrte mendja se do të mundej ushtëria gjermane? ! Askujt! Kjo ishte diçka e

pabesueshme, e pakonceptueshme atëherë. Dhe për çudi ndodhi. U gënjeva edhe unë. . .

- Atëhere mbylle gojen! Laji fajet si burrë!

Genci u kthye nga Besniku. Sytë i ndritnin nga një pezmatim i përmbajtur.

- I kam stërta. E lexove gazetën e sotme? Ka aty një lajm për lirin e gjeneralëve nazistë nga qeveria e Bashkimit Sovjetik. Ata kanë vrarë mijëra e mijëra njerëz, kanë shkretuar një Rusi të tërë dhe lirohen. Ata janë gjeneralët më të shquar të Hitlerit. Kurse unë akoma mbahem në burg dhe tani praktikisht pa u gjykuar. Paradoks!

- Çdo shtet vepron sipas konditave dhe interesave të veçanta. Ti ke prishur punë jashtë, kurse ne duam të ndërtojmë jetën e re pa shfrytëzim dhe shtypje. - U përgjegj Besniku.

- Flet kështu se nuk e ke mbushur muajin në intermim. Pas dy tre vjetëve jam i sigurtë se do t'i ndryshosh mendimet dhe do të më japësh mua të drejtë.

- Gabohesh, Genc! Më ngatërron me veten. Unë jam tjetër njeri. Ti nuk e njeh shpirtin tim. Nëqoftëse fati nuk na ndan, do ta shohësh me sytë e tu. Unë nuk do të nënshtrohem. Po të flas me zemër të hapur. Kam ëndërruar gjithëmonë të bëj diçka për Atdheun tim. Shpesh herë mendoj këtu në kamp: Po mos të lirohem, a do t'ia arrij qëllimeve të mia? Nganjëherë një parandjenjë e keqe më ndrydh zemrën. Po unë e mposht atë dhe e qetësoj veten. Edhe po mos të lirohem, unë do ta kryej një detyrë. Do të dëshmoj me shembullin tim se nuk duhet të përkulesh, edhe kur fati të ndëshkon padrejtësisht. Do të qëndroj gjithëmonë komunist, edhe pse i burgosur nga komunistët. Unë besoj thellësisht në komunizmin.

- Komunizmi është fe. - E ndërpreu Genci.

- Feja sot është diçka abstrakte, - E kundërshtoi ai - kurse komunizmi është një detyrë historike, një qëllim praktik i njerëzimit, krejt i realizueshëm në kohën tonë. Komunizmi është zhdukja e pronës private, e shfrytëzimit, e kufijve mes shteteve. Është jeta e lirë dhe e vllazëruar e popujve të të gjithë botës. Dhe kjo ditë ka për të ardhur. Nejse, ku e kishim fjalën? Bile tani po të më marrin nga kampi komunistët dhe të më pushkatojnë, të më djegin, fjala ime e fundit përsëri do të jetë: "Të rrojë komunizmi!" "Do t'i fal dhe do të më vijë keq se gabuan duke mohuar shokun e tyre. Për këtë shembull kanë nevojë njerëzit. Jeta e ime edhe këtu nuk do të shkojë bosh.

Besniku fliste me një sinqeritet euforik dhe besonte plotësisht në ato që thoshte. Ishte një vrrull ndjenjash rinore, entuziazëm. Nuk ishte thjeshtë një fantazi romantike e frymëzuar nga romani "Viti 93" i Viktor Hugoit, ku heroi, megjithëse ekzekutohej

në gijotinë nga shokët e tij revolucionarë, vdes duke thirrur: "Rroftë Republika! ". Por ajo lidhej edhe me egon dhe jetën e tij. Komunizmi, Atdheu i ishin futur në gjak. Me ato ide ishte rritur. Atij i dukej se të jetonin ato, do të thoshte të jetonte edhe ai. Nuk kishte karakter të dobët që në vështirësi të tradhëtonte idealet dhe veten.

Genci shihte me habi fytyrën e përndezur të Besnikut dhe mendonte se entuziazmi i tij ishte i gënjeshtër, fanatizëm, një gjë e kotë, një hiç. Por heroizmi thjesht si fakt, qoftë për një qëllim të imagjinuar, atë e preku. Çdo gjë i thoshte se shpirti i këtij të riu nuk mposhtej. E kishte hetuar këtë edhe në jetën e përditshme. Sapo zbardhej, Besniku ulte kokën mbi libra dhe studionte. Natën vonë shkruante. Tregonte interes për gjuhë të huaja. Por ai nuk desh të besonte se Besniku kishte një rrugë tjetër, të kundër me të veten. Donte t'i ndillte atij humbje, diziluzion, prandaj foli:

- Kam qenë edhe unë dikur si ti plot ëndrra dhe idealizëm. Yjet e zotin më pëlqente t'i kapja me dorë, qiejt t'i përpija. Kisha zemër të zjarrtë, vullnet të çelniktë dhe shpirtin e sakrificës. Për një vizion të bukur të trurit tim isha gati të lë kokën pa ndërje dhëmbje. Kërkoja edhe unë të bëja vepra të larta për popullin dhe u ngrita kundër Zogut. Dëshëroja përparim. Fjalët e bukura të udhëheqësve të mi më rëmbejnë. Besoja në ideale, por shpejt e kuptova të vërtetën. Këtë ma mësoi uria. U mërguam nga frika e Zogut dhe atje, në dhe të huaj, njoha udhëheqësit idealistë. S'kisha bukë, lypja rrugëve, kurse ata hanin në restaurantet më luksoze të Beogradit. Kishin para me grusht dhe mua nuk më jipnin as lëmshë.

"Idealizmi kishte qenë xhepi i tyre. Thirrjet për sakrifica u drejtoheshin budallejve. Atëherë e kuptova ligjin e jetës. U binda se nuk kishte ideale, Atdhe, popull. Vendosa të ëndërroj para, fuqi. Një ditë gjeta shesh dhe bëra përshesh. Më erdhi rasti të realizoj ëndrrat e mia të reja. Pranova detyrën si federal pa hezituar. Bëra qejf. U kënaqa. Urdhërova dhe fitova. Tani nuk jam pishman për asnjë gëzim të kësaj jete. Jam u bindur se po kështu do të ndodhë edhe ty.

U dha lajmi i drekës. Ata e prenë bisedën dhe u futën në barakë të mirmin gavetat. Besniku tërhoqi racionin dhe u kthye në shtrat. Po priste aty të vinte Genci që t'i jipte ushqimin e drekës së tij speciale, që mirrte si i sëmurë nga tuberkolozi, meqë ia kishte premtuar. Befas i zuri syri një kartë. E hapi dhe lexoi i habitur këto fjalë: "Sot Genci të ka folur shumë keq kundër Pushtetit Popullor. Duhet të lajmëroh menjëherë komandën, se ndryshe e ke punën keq! "

Ishte e dyta herë që i dërgonin letra anonime. Atij iu duk se e kishte shkruar e njejta dorë. Në letrën e parë e këshillonin të bëhej nacionalist, t'i urrente

komunistët, të ndërronte rrugë, se ishte i ri dhe kishte të ardhme, se komunistët shpejt do të rrëxoheshin nga fuqia. Besniku kishte qeshur se i ishin dukur budallallëqe ato shpresa, por tani u nevikos. Nuk e mirrte dot me mend se kush i kishte dëgjuar, kush ia kishte hedhur atë letër. Dyshime të shumta iu shpifën. Mendoi se ndonjë i poshtër duke dashur të shitej si pro pushtetit popullor dhe duke e urryer si komunist, vërtetë mund të lajmëronte komandën për bisedën e tyre me qëllim që ta fuste edhe më thellë.

I shkoi mendja edhe se mos e provokonte sigurimi. Një herë nuk dinte fare ç'të bënte. U hëngër me vete. Vendosi dhe u prapësua disa herë dhe më në fund iu duk se ishte më e arësyeshme ta dorëzonte letrën. Atë e vrau ca ndërgjegja se po i bënte keq dikuj, por arësyesoi se jeta ishte e ashpër, se Gencit fundi ia dinin mendimet dhe ai vetë nuk duhet të shkonte kot për dhjamë qeni. Pikërisht në këtë çast vajti Genci në shtrat dhe ai u nis t'ia shpinte gjellën. Ndjeu një dhembje në gjoks se nuk iu duk e mirë që këtej të dorëzonte letrën që në fakt ishte një kallëzim ndaj tij dhe nga ana tjetër i tregohej i sjellshëm, i jipte gjellën. Ai luftoi përsëri me veten, por ia kishte dhënë fjalën para kësaj bisede dhe nuk kishte se si t'ia kthente pse ai do të keqkuptohej. "Do t'i jap" tha i vendosur dhe vijoi rrugën.

Gjatë asaj kohe që fjalosej Genci me Besnikun, Naimi po dëgjonte fshehuazi një bisedë interesante. Qe shtrirë në shtrat, sytë i mbante mbyllur, nuk lëvizte fare, Bënte sikur flinte. Përballë tij Andrea po qëronte furçën që përdorej apostafat për masazhe trupi. Në burg ai kishte patur kujdes të madh për shëndetin, kalitjen fizike dhe kishte kryer me përpikmëri gjimnastikën e mëngjezit, masazhet dhe sipas mundësive banjo me ujë të ftohtë dhe banjo dielli. Ai vazhdonte të ishte i rregullt, t'i jipte vetes rëndësi, sikur të ishte akoma personalitet qeveritar. Pranë i qëndronte Serveti dhe herë herë i afrohej për të dëgjuar më mirë.

Naimit për herë të parë i kapi veshi këto fjalë që i pëshpëriti me zë shumë të ulët Andrea:

- Nuk e kanë të gjatë. Vuajtjet tona do të marrin fund. Shumë shumë do të presim këtë rradhë edhe gjashtë muaj. Do të bëjmë si do të bëjmë dhe do të durojmë edhe kaq.

Naimi nuk mori frymë. Priti me ankth e kureshtje. Hapi fare pak njërin sy. Ata ishin afruar kokë më kokë. Serveti seç pëshpëriti. Fytyra e tij shprehte habi dhe hutim. Zëri i Andreas u dëgjua prapë:

- Kishin vajtur me kohë, por i ka mbajtur gjatë propoganda. Janë të djallëzuar në propogandë. E njoh unë mirë komunizmin që në fillimet e veta, që më 1922.



Atëherë u ndodha në Rusi dhe shpëtova paq. Pastaj ti e di. Jam marrë me këtë sektor. Kam qenë ministër i Kulturës.

Ai nuk shtoi "fashiste".

- Si urdhëro, zotrote. E di fare mirë. . . - U dëgjua zëri i Servetit me një tingull lajkatar.

- Po kësaj rradhe nuk do të shpëtojnë me gënjeshtër.

- Pse? ! Si? ! - Pyeti tjetri me padurim.

- Ka hyrë përçarja. Partia është ndarë në dysh. Prite, kur të pëllcasë. Do t'i hanë kokën njeri tjetrit. . Do të kemi luftë.

Naimi hapi sytë pa dashur. I tronditur vështroi bashkëbiseduesit. Pastaj hodhi sytë përçark. Askush tjetër nuk dëgjonte. Mbylli prapë qepallat. E para herë që i kapte veshi një lajm të tillë për përçarje. Zemra iu shqetësua nga një gëzim i mbytur.

- Luftë? ! - Pyeti me frikë ish prefekti.

- Po, e kemi pritur kaq vjet. Italianët një shkak të vogël duan dhe do të derdhen mizëri. Popullit i ka ardhur në majë të hundës. Së prapthi do t'i therë komunistët. Fara s' do t'u mbetet. E kanë kthyer Shqipërinë në burg. Po tani u erdhi ngordhja.

Naimi mbante vesh si i vdekur dhe provonte ndjenjat më të ndryshme. Ai ndofta do të çmendej nga gëzimi, po të besonte se komunistët vërtet ishin përçarë dhe do t'i hanin kokën njeri tjetrit. Po shumë herë kishte dëgjuar fjalë të tilla, të cilat kishin dalë bosh, prandaj nuk mund të gënjehej aq lehtë. Megjithatë diçka u përkëdhel nga një shpresë e vakët, megjithëse e ndjente që ishte e kotë.

Pastaj qeshi nën buzë me budallallëqet e Andreas, me injorancën e Servetit dhe i ngjallej në shpirt një ndjenjë e keqe hakmarrje. Ai vendosi t'ia punonte Andreas dhe t'ia shpinte të ngrohta Besnikut ç'ka kishte dëgjuar me shpresë se kështu së paku do të fitonte simpatinë e tij.

Andrea uli zërin shumë. Naimi hapi sytë. Po vështronin nga ai. I mbylli sytë e bënte sikur gërhiste lehtë në gjumë.

- Po me ne çdo të bëhet? ! - Pyeti Serveti.

- Sejcili do të kthehet në punën e vet sipas meritës. . . Do të. . .

Nuk i kapi veshi gjë. Çeli sytë. Po fjaloseshin. U inatos se nuk vinte zëri deri te ai. Ra bilbili për drekë dhe ia u tremb. Biseda u pre.

U ngrit dhe Naimi. Mori enën. Sytë i ndrisnin me djallëzi dhe fshehtësi. Ishte i kënaqur që kishte dëgjuar këtë bisedë dhe se do t'ia tregonte Besnikut me hollësitë më të vogla. Tek kthehej e gjeti në ato çaste, kur ai i kishte dhënë fund lëkundjeve të veta dhe po i shpinte gjellën Gencit. Iu afrua dhe i tha:

- Ta sjell salcën?

Besniku heshti një hop i menduar dhe pastaj u përgjegj:

- Mirë. . .

Naimi shpejtoi hapat, u kthye në sekondë me salcën dhe ia hodhi në gjellë duke i thënë:

- Salcë speciale!

Besniku e përzejë dhe po ikte me gazetë në dorë.

- Ku po shkon? ! - I tha Naimi - Erdha që të hamë bashkë.

- Ja, sa t'ia shpie pak gjellën Gencit.

- Gjellën tënde? ! Këtë? - U habit pa masë Naimi.

- Po. .

Ai e kapi gazetën, e tërhoqi nga vetja dhe i foli:

- Ulu, ore, aty. Shpirti i mirë të ka marrë më qafë. Bujaria shkon gjer në një farë pike. Të heqësh çapën e gojës dhe t'ia japish tjetrit? Allah! Allah! . . . Njeri si ti s'kam parë. Mjaltën ta hëngrën bota, brisqet i shpërndave të tërë. Domatet i jep sikur i gjen në rrugë, tani ja dhe gjella. Po ty të ka dhënë gjë kush, veç meje?

- Jo. .

- As nuk do të japin. As morra nuk të japin këta. Ti shite si shpirtmadh.

Bjere mua gjellën! Nuk të lë! . .

Besniku e tërhoqi me vendosmëri.

Naimi i nguli sytë me habi.

- Mirë gjella jote, po salca ime ç'taksirat ka? !

- Një çikë qe. .

- Pak shumë, njësoj është. Një qime floku nuk i jap atij që nuk meriton.

Hajde, hejde, ç'kokë! Të mirin e bëjnë hajvan bota.

Besniku nuk e zgjati dhe vajti te Genci, i cili kishte filluar të hante. Kur pa ushqimin në enë, i tha i habitur shumë:

- E prure? ! . . Pas atij diskutimi të ashpër nuk ma mirrte mendja se nuk do ta harroje fjalën e dhënë.

U afrua dhe vijoi me zë të ulët:

- Besnik, je i vetmi që mund ta bësh këtë gjest bujarie në mes të burrave të këtij kampi dhe çudia më e madhe është se jemi kundërshtarë politikë. As unë nuk e bëj. Në këtë ambient ka vetëm fëlliqsira. Këtu rrojmë si në një gropë qjirizi dhe marrin frymë me zorr.

Ai buzëqeshi pak si me tallje, ndërsa sytë nuk e humbën shkëlqimin e errët.

- Në një pikpamje jam dakort me Pushtetin Popullor. Jam i kënaqur që i

nga larg dhe troket me gaz të madh në portë. Përqafohet me të shtëpisë, uron, pa bën vaki edhe qan nga gëzimi, se helbete dobësohet zemra e shkretë. E pyet me padurim i varfëri se ku është Lamja. Ata të shtëpisë ia presim me gjëmë e kujë: "Lamen e morën prapë. Nuk rrinë dot pa të. Zotrote je vonuar për kafënë e parë, pi këtë të hidhurën tani." Miku derëbardhë gjëndet ngushtë, turpërohet dhe sikur i bie pika. Gjynah!

Këtë rradhë të internuarit nuk qeshën me fjalët e Lames, por heshtën si të vdekur dhe u çuditën se si fliste budallai ashtu para kapitenit. Kapiteni ia njihte kokën Lames, e dinte se ishte burrë në vëshirësi, e kuptonte se nuk i thoshte me të keq këto fjalë, por për ta marrë sa më lehtë vuajtjen.

- Do të vemë përgjegjës - I tha - Zefi është plak.

Lamja vuri dorën në zemër dhe u përgjegj:

- Fjala juaj të zërë vend.

Komandanti iku.

Kampi ziente nga fjalët e Lames. Ngjarjet e jetës së tij pëshpëriteshin gojë më gojë. Thoshin se kishte qenë komandant i çetës së Ballit Kombëtar, se ishte hedhur kundra komunistëve për hiç gjë, se pastaj kishte luftuar me trimëri të madhe, se pas Çlirimit ishte dënuar me pushkatim dhe ja kishin falur jetën me që kishte shpëtuar nga vdekja ca komunistë, miq të vet, se ja kishin zbritur pak nga pak dënimin gjer në dhjetë vjet, nga që kishte punuar shumë në brigadat e punës dhe ia kishte kaluar fort mirë me ata të komandës. E lëvdonin se ishte i zgjuar, se e kishte gojën brisk dhe s'i dridhej kapaku i syrit.

Pas darke Lamja zuri vend pranë Xhevos dhe ia shtroi muhabetit me të si mik të vjetër që e kishte. Ai rrëfeu si e kishin liruar, si kishte dalë nga burgu, ku kishte fjetur atë natë, se si kishte gjetur të nesërmen makinë dhe me të rënë të diellit kishte sosur andej nga fshatrat e tij. Përshkroi me hollësi se si kish kaptuar grykat, si kishte pirë ujë në çezmën e fshatit fqinj dhe se si graria i kishin hapur rrugë të trembura.

Ata që ishin pranë, heshtën të dëgjonin. Pak nga pak të gjithë prenë bisedat. Lanë punët e ndryshme dhe u nemitën, veç Andreas që shfletonte me moskokëçarje një revistë. Kur Lamja arriti në pjesën më tronditëse të tregimit, asnjë nuk lëvizi. Mbretëroi një qetësi e madhe. Në barakë përhapej vetëm zëri i plotë i labit.

- Në të hyrë të fshatit më takon një grua. Më hidhet më qafë dhe puth e shtrëngo. I them me të qeshur: "Moj teze, ç'është kjo dashuri e madhe që rrëfen kështu? ! Po ti në gjyq rrihe gjoksin me grushte e bërtisje: Ç'kam hequr nga Lamja, vetëm shpirti im e di! Kaq shpejt i paske harruar ato të shkretat vuajtje? ! . . ." Ç'nxjerr

ashtu nga goja, o Lame xhani - Ma ktheu tezja - Qoftë larg! Ashtu llapnin ato shtrigat e tjera, që u rëntë një rrufe! Edhe sot më dhëmbin grushtet që ua ngjishja në kurriz. Si të harroj unë Lamen? ! Ti më ke dhënë mua misrin e fëmijëve! ”

“S’e zgjata më. Ç’t’i thosha të gjorës? E ktheva me të qeshur: Duket kam qenë hutuar nga gjyqi dhe më është përngjasur. ”Ashtu të keqen tezja, xhan i tezes. ”Mezi u shqita prej saj dhe vajta në shtëpi.

“Aty te porta po luanin ca kalamaqër. Një djalë prej tyre më shëmbëllen si i imi dhe më bën zemra bam. Por e mbajta veten dhe s’bëra zë. E kisha lënë tre muaj dhe tani duhej t’i kishte mbushur dhjetë vjetët.

“Hyj në oborr. Thërres, por s’përgjigjet njeri. Pyes fëmijët: a janë këtu filanët? ”Po, - Më përgjigjen ata - por do të kenë vajtur për ujë. ”Hap derën e qurit. Futem brënda. Një grua po gatuante dhe s’më kish pikasur. Pyes veten: Cila të jetë kjo? Nusja e vëllait domosdo. Ajo më ndjen dhe kthehet nga unë. Stepet e nuk më jep të njohur. I duket si çudi se u futa në shtëpi pa teklif dhe pyet e ndrojtur: ”Asimin deshe zotrote? ! ”

“Asimin - them unë - ose nusen e Lames! ”

“Asimi s’është këtu. Nusja e Lames ka vajtur për ujë dhe ja erdhi”Unë s’e zgjata. U ula në një shkëmb dhe po prisja. Ajo pastaj siku ra në fije dhe tha: ”Mos vjen nga Lamja ti? ! ”Dhe fap me këto fjalë gruaja e ime ia bëhu në prak dhe ngriu me shtambat në supe.

“Kunata u çudit një herë, pastaj u kujtua, u hodh nga unë, më ra në gjoks. Lotët i vinin çurk e thoshte: ”Më rëntë pika mua që s’të njoha ty. Po ti qenke Lamja, ore! ”

“Gruaja u mbajt si shkëmbi. Uli shtambat dhe u përshëndet si burrëshë. Ama i dridhej buza si fleta e plepit. Thirri djalin dhe i tha: ”Takohu me tët atë! ”

“Po djali më vështroi ftohët. Bëri një hap pas dhe ja ktheu:

“Babai im është në burg. ”

“Eshtë liruar, o budalla! Hidhju bababit në qafë! ”Po shejtani nuk qasej e nuk qasej dhe tha: ”Po mua më kanë thënë se është dënuar për jetë! ”

Të gjithë ishin tronditur sipas karaktereve dhe jetës. Rrëfimi i Lames u kujtonte veten, familjet, vuajtjet. Andrea vijonte të shfletonte dhe ndofta bënte mirë. Për gruan nuk kishte pikë dhëmshurie. Fëmijë nuk kishte bërë. Vuajtjet e të tjerëve i dukeshin hiç para personalitetit të vet. Naimit iu kujtua gruaja e tij, shpresat për t’u kthyer në jetën e lirë. Flaku me nervozizëm romanin “Të mjerët”, që kishte në dorë dhe psherëtiu plot dëshpërim e rrevoltë:

- Ne jemi të tërë Zhan Valzhanë! Mbahemi në këtë barakë njëqind burra pa

gjqy dhe trajtohemi më keq se të burgosurit! ! Shtet është ky? ! Ka ligje këtu? !

Besnikut iu drodh zemra. Mendime të hidhura i vërshuan në kokë. Donin t'ia rrëxonin bindjet. Në mendje i erdhën arsyetimet që bënte në të tilla raste. Psherëtiu dhe foli me vete:

"E vështirë, e përgjakshme ka qenë rruga jonë, po lavdia e saj nuk mund të errësohet. As që mund të bëhej ndryshe."

Në këtë çast në barakë hyri polici dhe lajmëroi të flinin. Të intermuarit shkundën mendimet e hidhura dhe si të vvarë, përgatitnin dysheqet.

Lamja e ndërpreu kallximin. U zhvesh dhe ra të flerë:

Xhevua pyeti:

- Po pastaj?

- Tani flemë. Nesër. . . - Tha Lamja dhe i shtrirë në kurriz përfytyroi se ç'kishte ndodhur vërtetë pastaj.

Atë natë, pas darke, kishte hyrë në dhomën e gjumit. Ishte siç e pat lënë atëherë para dhjetë vjetëve. Aty në hasër pat qenë shtruar dysheku i ri, ku do të flinte me gruan pas kaq kohësh. Pak më tej po bënëin gjumë të thellë dy fëmijët. Ishin zbuluar dhe i vogli kishte hedhur këmbën sipër të madhit. Ai ishte mallëngjyer, për pak i kishin shpëtuar lotët. se tërë atë natë ata i patën ndenjgur larg. Po ishte përmbajtur dhe kishte menduar me vete: "Do të mësohen."

Ishte afruar, ishte përkulur mbi ta, i kishte puthur ngadalë se mos i zgjonte. Befas kishte lëvizur dera. Ishte ngritur shpejt në këmbë, se nuk i pëlqente ta shihnin të mallëngjyer. Kish bërë sikur po zhvishej dhe kishte rënë në dyshekun e martesës. Instiktivisht kishte pritur t'i shtrihej pranë ai trup i ngrohët, i bëshëm, i butë, që e ndizte. Kishte pritur ndofta ta përkëdhelte, të shtypte me duart e tij të ashpra gjinjët e hedhur e të bardhë, të fërkonte qafen e shëndoshë, faqet e fryra. T'i ndizej epshi rinor.

E shoqja ishte zhveshur ngadalë, kish fikur lllampën dhe kishte rrëshqitur pranë tij. Ai nuk kishte ndjerë atë erë dehëse të trupit të saj, që nuk e pat harruar dhjetë vjet të tëra. Ajo ishte mplakur, gjinjët i ishin vyshkur, faqet tharë dhe trupi tretur, bërë shkop. Ai e kishte shtrënguar në gjoks, po nuk i ishte ndezur gjaku dhe kishte ndjerë një dashuri tjetër, gati gati jo si për një femër.

Me që ajo ia kishte plasur vajit, e kishte larguar dhe e kishte pyetur: "Ç'ke? ! "E shoqja ishte përgjegjur duke bëlbëzuar: "Më dhëmben fëmijët. U rritën jetimë. Për vete s'më vjen keq. U mësova:"

Pastaj ajo kishte heshtur një hop dhe kishte shtuar:

“Ti qenke po ai, unë u mplaka.”

Tani po flinte prapë në burg, Fshati, dhoma, fëmija, gruaja, dysheku gjëndeshin përsëri shumë larg, por ai nuk ndjeu ndonjë hidhërim të thellë. Iu kujtua e nesërma në fshat. Kishte shetitur me çap të ngadaltë gjithë fshatin me një buzëqeshje plot hiudhërim të mbytur. Kishte vajtur te lëmi, te ara, te gjoli i bagëtive, te lisi i madh, te shullëri, te kopshti dhe kishte kujtuar çapkenllëqet e vegjëlisë. I ishin dukur kujtime shumë, shumë të largta, por të shtrëjta.

Fshati ishte po ai, kujtimet po ato, po njerëzit kishin ndryshuar dhe për këtë ai u bind të pasnesërmen e me rradhë ditët e tjera. Shumë bënin sikur nuk e njihnin. Ca e përshëndetnin ftohtë. Veç ndonjë më të rrallë i jipte dorën. Gjer kalamajtë s’i qaseshin. Atëherë atij filluan t’i kujtoheshin vitet e ashpra të luftës që në burg i ishte dukur se qenë varrosur për jetë.

Në fshat e mbanin mend shumë mirë, prandaj Lamen e Çobos e ndiqnin me bisht të syrit. Kështu u zhdruk mallëngjimi i parë. I ishte krijuar një tjetër gjendje e trishtuar. Edhe në shtëpi rrinte i vrejtur, sikur ajo nuk ishte e tija. Gruaja, fëmijët sikur i qenë larguar. Edhe në dhomë, edhe në dyshek, Lamja ndjente fshatin, vështrimet e fshehura të kryetarit të këshillit, sikur dëgjonte të flisnin për të, sikur shihte që e tregonin me gisht. Lamja ishte i huaj në fshat. Ai e ndjente këtë, prandaj tri javë s’ju bë të zinte punë me dorë. Njerëzisë u binte bretku gjithë ditën, kurse ai sorollatej kot. Desh të hapë një kanal në tre dylmsh, se tashmë qe mësuar me kazmë, por s’i bënëni duart, sikur t’i ishin prerë damarët. Një parandjenjë e keqe e turbullonte.

Dhe ja një ditë erdhi armiku i vjetër i tij në luftë, që mbante rroba gjenerali. E kishte takuar te lëmi. Ai po vinte me të shoqen e të vëllait për krahu, të ëmëm e atij djalit që ishte vrarë në rrethimin e parë të Lames.

Nëna e veshur me të zeza, që kishte ardhur në fshat për të kaluar ca net, me të parë Lamen, kishte çakëritur sytë dhe i kishte rënë të fikët në vend. Njerëzit ishin turrur ta ngrinin të ëmën e dëshmorit, kurse Lamja kishte qëndruar më këmbë aty dhe ishte vështruar sy në sy me gjeneralin, që duke kërcëllitur dhëmbët, kishte çfryrë:

- I pari ka mbetur!

Lames i kishte ardhur keq për plakën, por sytë nuk i kishte ulur për tokë, si ndonjë çupëzë e zënë në faj.

Të nesërmen kishin ardhur policët dhe e kishin marrë.

Lamja rënkoj dhe psherëtiu: “Na mori vala! ” Me këto fjale ngushëllohej sa herë i kujtohej e kaluara dhe me to desh të thoshte se mund të kishte vajtuer edhe

me komunistët, bile atje duhej, por vetëm kaq, për më tepër nuk ishte pishman.

E kishin rrethuar një ditë vere vetë i pestë dhe gjenerali i kishte thirrur: "Dorëzohu Lame, se s'të prishim! "Atij i kishte ardhur turp të dorëzohej dhe ishte përgjegjur: "Jam Lamja i Çobos unë! E ha barutin me grusht! "Dhe kishte krisur dyfeku si mos o zot dhe ishin përleshur fytyrafyt.

Nuk mund të pendohej Lamja se nuk ishte dorëzuar i gjallë atëherë, se nuk mund të turpërohej para shokëve të vet, nuk mund t'i vinte njollë të zezë vetes para gjithë labërisë. E pastaj kishte vazhduar rrugën e luftës kundra partizanëve me ashpërsi se ata e ndiqnin si armik të parë.

Iu kujtuan shumë ngjarje nga jeta në luftë dhe psherëtiu për të dytën herë plot hidhërim: "Na mori vala! "

## XVI.

Me që të nesërmen do të bëhej takimi i të interruarve me familjarët të gjithë kishin një gjendje të veçantë. Ndjenin më tepër se zakonisht lidhjet me botën e jashtme. Gjykatësi dukej i gëzuar, sikur të qe bërë i ri. Hëngri bukë me lezet e fliste me zë të lartë. Sytë i ndrisnin me një dritë të veçantë. Herë pas here u thoshte fqinjëve: "Nesër më vjen vajza! . . . Ka mbaruar gjimnazin. Eshtë rritur, është bërë goxha perri! "Këto fraza i thoshte në mënyrë të shkëputur dhe kështu kuptohej se mendja i punonte gjithënjë te çupa.

Ai nuk e kthente fytyrën e gëzuar nga Besniku. Po bëheshin dy muaj dhe ata as përshëndeteshin me njëri tjetrin, megjithëse shtretërit i kishin ballë për ballë. Gjergji e urrente servilizmin e kolegëve të tij. S'i pëlqente t'i lëpihej djaloshit dhe kishte antipati për të si për çdo komunist. Besniku e kuptonte qëndrimin e tij armiqësor dhe përgjigjej po me atë mënyrë.

Në një gjendje krejt tjetër ndodhej Genci. Nuk fliste, nuk luante shah, por i shtrirë në shtrat thithte llullën e tij e një hije trishtimi i vizohej në fytyrë. E kishte mendjen te gruaja që do t'i vinte të nesërmen. E brente zhelozia për të shoqen, dyshimi ia thërmonte zemrën. Shpesh i bëhej në ëndër sikur e shoqja e tradhëtonte dhe gjumi i ikte. E mbulonte dëshpërimi i thellë. Nesër do ta takonte dhe ai mendonte se a mund të zbulonte nga shprehja e syve të saj nëse ajo ishte akoma e shoqja e tij.

Naimi vente e vinte me nervozizëm. Nuk dinte me siguri a do ta vizitonte

njeri dhe kjo e shqetësonte. Përfytyronte familjen, rehatinë e atjeshme. Mërzitej. Pastaj iu afrua Besnikut për të shprehur dufin:

- Mizerje! Ç'jetë bëjmë! Shih! - Ai tregoi shtratin. - As dy metra katror për njeri nuk kemi.

Besniku buzëqeshi dhe u përgjegj:

- Mos dashke vilën te Ujët e Ftohtë? ! Je mësuar të bësh qef nëpër Europë dhe sigurisht ky kamp të duket i tmerrshëm. Po duhet ta dish se nuk rojnë shumë më mirë nga ne studentët nëpër konvikte! Për mua këtu është kamp pushimi.

Naimi e vështrroi i pakënaqur dhe i foli:

- Gjynah që s'të kanë mbyllur më parë që të çlodheshe mirë!

Besniku qeshi me të madhe dhe u përgjegj:

- Për nder do të kishin bërë fort mirë. Më rehat se këtu nuk ka.

Andrea krrusur në shtratin e tij po shënonte në një copë letër gjithshka që i duhej, duke mos harruar letërthithëse, një copë leckë për të larë enët e tjera. Si gjithëmonë e preokupnte vetja. I dukej se plotësimin e porosive të tij të tjerët e kishin për nder dhe nuk ishte aspak i mallëngjyer.

Serveti pregatiste të kthente ca plaçka dhe ishte më llafazan se përherë.

Lamja nuk priste njeri, por si gjithëmonë ishte i qetë dhe plot muhabetë të lezetshme. Edhe Pjetrit nuk do t'i vinte kush, por ai dukej i mallëngjyer për vendlindjen se vuri pëllëmbën në faqe dhe nisi të këndoje.

Kur mbaroi, Lamja e përgëzoi:

- Të lumtë goja, mirdita trime!

Mit'hati paraqitej tepër i peokupuar, në qejf të vet dhe nuk e shfaqte arësien. Atë do ta vizitonte gruaja, prandaj ndjente atë natë edhe një afsh prej burri. Ndonjë ishte i piklluar se kurrë nuk i vinte njeri. Në ditët e takimit dëshpërohej tepër dhe më kot përpiquej ta fshihte arësien.

Besniku në internim kishte një ndjenjë të çuditshme. I pëlqente ta harronte bota e jashtme, sidomos familja, të bëhej krejt i huaj për ta. Në çaste të tilla përpiquej të mos kujtonte se të nesërmen do të bëhej takimi. Ose mendohej të mos i vinte fare rëndësi kësaj ngjarje.

Pjetri, si mbaroi këngën, thirri:

- O Besnik, ngjitu lart dhe hajt na trego, bre burrë ndonjë histori librash.

Besniku shkoi te Pjetri. Rreth tyre u mblodhën edhe të tjerë. Shpesh pas darke djaloshi i rrëfente ngjarjet e ndonjë vepre letrare. Ato i pëlqenin shumë Pjetrit, sidomos nga letërsia e vjetër greke, të cilat Besniku detyrohej t'i përsëriste. Para se të largohej, malësori i tha:



- Kur na erdhe, na bahej se kishe nja katërqind dreqna në bark. Po tash besa më dukesh edhe ma i mirë se na. Po na njerëz jemi të tanë, me huqe.

Kështu kaloi pasdarkja në atmosferën e pritjes së ditës së nesërme, derisa erdhi polici dhe vuri qetësi.

Të nesërmen në mëngjez një shqetësim i papritur u përhap në mes të të internuarve. Të parët që dolën në oborr u kthyen me fytyra të prishura dhe sollën lajme të këqija. Atje përtej nja dhjetë të burgosur ishin lidhur nëpër shtyllat e telave. Kjo gjë nuk kishte ndodhur kurrë më parë, prandaj u tronditën të tërë. Asnjë i burgosur nuk dukej në oborr. Policët ruanin nëpër dyert e barakave të mëdha. Në komandë lëviznin të shqetësuar.

Nuk shkoi shumë kohë, kur në barakë u futën nja dhjetë policë duke bërë titur si të xhindosur:

- Shpjet! Jashtë! të tërë!

Po të internuarit nuk ishin të pregatitur për diçka të tillë, prandaj po vonoheshin. Lëviznin me ngathësi. Policët thërrisnin, shanin, gjë e cila ndodhte rrallë.

Në prak ia bëhu komandanti. Gjithënjë kishte pamje të rreptë, gjendje shpirtërore të tendosur, por dukej se kjo egërsi nuk i shprehej në veprime, se më tepër i ishte bërë zakon kjo sjellje me të burgosurit. Po tani vinte si i çakërdisur dhe sytë e flakëruar i shprehnin një tërbim të madh. Hyri brënda në barakë dhe ulëriti:

- Akoma nuk kini dalë? ! Maskarenj! Borgjezë!

Ishte një zë i tmerrshëm që të burgosurit shumë rrallë e kishin dëgjuar. Menjëherë lanë plaçkat dhe shpejtuan kush e kush më parë. Vetëm Gjergji sikur nuk e prishi terezinë. Një rreshter e tërhoqi për krahu dhe për pak e rrëxoi.

- Mos më trazo! - I bërtiti me inat Gjergji.

- Bën edhe fjalë? ! E di ç'të punojmë? ! - Iu kërcnua tjetri.

- Çfarë? ! - Kundërshtoi me guxim Gjergji. - Shpirtin do të më marrësh? ! Më ke në dorë. Nuk dal dot shpejt. Ju i kini fajet. Më kini thyer këmbën në tortura!

Gjergji mori shkopin dhe eci i inatosur.

Kapiteni urdhëroi të internuarit të uleshin rrëzë telave.

Dyert e barakës u mbyllën. Erdhën ca policë të tjerë me shufra hekuri të gjata e të trasha dhe brëndë nisi një kontroll i imtë. Kapiteni i vinte qark barakës se mos gjente ndonjë gjë të dyshimtë, kur një polic iu afrua dhe i pëshpëriti në

vesh. Fytyra e kapitenit u prish. Ai nxitoi me hapa të shpejta brënda në barakë. Diçka e rëndësishme dukej se kishte ndodhur atje. Vajti në fund të barakës dhe i nguli sytë në tokë.

Ndodhej aty një sëpatë e ndryshkur. Komandanti po mendonte se ç'donte ajo sëpatë aty. E kishin fshehur të internuarit me qëllime të këqia apo ishte ndodhur aty rastësisht? ! Shumë hamendje i erdhën në kokë kapitenit dhe me që ishte i zemëruar, vendosi të gjente fajtorët dhe t'i dënonte. Ndofta në një rast tjetër nuk do të ishte sjellë ashtu, por i kishte hipur gjaku në kokë se atë natë kishin zbuluar një kanal që e kishin hapur të burgosurit me qëllim që të arratiseshin. Kështu u rrevoltua nga sëpata e ndryshkur dhe u sul jashtë me inat. Qëndroi para të internuarve dhe pyeti me kërcnim:

- Ç'ju lypset juve sëpata? !

Një drithmë i përshkoi të gjithë. Fjalët e komandantit iu dukën të çuditshme. Sejcili donte të shfajsohej për vehte.

- Çfarë sëpate? !

- Ç'na duhet sëpata neve? !

- Kurrë nuk kemi parë sëpatë këtu!

- S'kemi sëpatë!

- S'kini sëpatë? ! - Klithi me zemrim kapiteni dhe duke u kthyer nga polici, e urdhëroi:

- Sille sëpatën!

Polici hyri me vrap. Doli saakaqë dhe sipas urdhërit hodhi në tokë sëpatën. Ata i ngulën vështrimet përdhe me habi. Ca nga fundi u ngritën në gjunjë që të shihnin më mirë.

Vërtetë aty gjënde një sëpatë, por jo ashtu si mund ta përfytyronin. Ajo ishte e ndryshkur dhe e ngrënë nga dheu, pothuajse e parrezikshme si armë. Në një rast tjetër do të ishin tallur me atë vegël, por tani komandanti i inatosur. gjendja e tensionuar në gjithë kampin, i trembte.

- E kujt është kjo sëpatë? ! Kush e ka futur brënda? ! Kujt i duhej dhe pse i duhej? ! Ju e dini fort mirë rregulloren se nuk u lejohet të mbani asnjë brisk roje. Të ngrihet më këmbë fajtori!

Urdhëroi kapiteni me egërsi dhe dukej se do të ndëshkohej rëndë ndonjë. Të internuarit heshtën. Nuk dinin ç'të bënin e ç'të thoshin.

- E kujt është kjo sëpatë? ! - Buçiti kapiteni sa të gjithëve u shkuan drithmat.

- Të ngrihet ai që ka sëpatën dhe mos të presë kot zoti kapiten. - U hodh

Mit'hati.

- Të pranoi ndershmërisht, po e pat futur njeri - Shtoi Demosteni - Nuk do t'i marrin shpirtin.

- Po, po, të ngrihet, Pse të na marrë më qafë të tërëve! - U ankua Alfredi me përçarje.

- Pse hesht xhanëm? ! Ajo për t'u gjetur ka. - Foli dikush me kompetencë të madhe në përkrahje të kapitenit.

- Pse na shtini në telashe? ! Të dalë i zoti i sëpatës vetë. - Ndërhynë të tjerë.

Të internuarit shikonin njeri tjetrin sikur kërkonin të zbulonin fajtorin. Ca të pakë heshtnin. Mes tyre ishte Lamja dhe Gjergji. Serveti u kthye nga Pjetri, e vështoi me dyshim dhe e pyeti:

- Mos e ke sjellë ti? ! Ju i kini zanat sëpatat.

- E ça po më duhet sëpata allahile këtu? ! Ajo as kryet tand s'e gdhen. - Ia ktheu Pjetri.

- Kush flenë në fund puq me dërrasat? - Pyeti kapiteni.

- Andrea. - U dëgjuan ca zëra, mes të cilëve edhe ai i Naimit.

- Pse? ! - Pyeti Alfredi duke ndjerë diçka të keqe për kolegun e tij.

- Cili Andrea? Të ngrihet menjëherë në këmbë - Urdhëroi kapiteni.

Një herë Andrea mbeti i shtangur, sikur t'i kishte rënë pika. Në këtë gjëndje të turbull, ku dukej se diçka e papëlqyeshme kishte ndodhur, ishte e rrezikshme të akuzoheshë për mbajtje sëpate. Nuk desh të ngrihej, por vështrimet ishin drejtuar atij me një farë lehtësimi dhe disa zëra u dëgjuan:

- Çohu, Andrea!

Ai u ngrit nën presionin e të tjerëve dhe qëndronte gatitu i zbetë.

- Aha. . - Ia bëri i hapitur kapiteni - Profesori. Ç'të lypset ty sëpata? !

Profesorit i dridhej buza, por megjithatë foli me guxim

- Zoti kapiten, nuk kam patur asnjë lloj sëpate. Kurrë nuk kam mbajtur armë të tilla në jetën time.

- Maskara! Borgjez! Gjakpirës! - Iu hakrrua komandanti.

Andrea u mbrojti:

- Po më akuzoni me të padrejtë, zoti kapiten. Nuk jam gjakpirës! Puna ime gjithëmonë ka qenë pena.

- Aq më keq! - Bërtiti kapiteni - Ke mësuar të tjerët të vrasin!

- Nuk mund ta pranosh në asnjë mënyrë këtë akuzë, zoti kapiten - Kundërshtoi Andrea si me heroizëm.

I dukej se po të pranonte akuzat, do të mirrej kot më kot në qafë.

- Po si ministër i fashizmit ç'ke bërë ti? ! Ke ngrënë petulla me vaj? Kot të mbanin ministër? ! Për sytë e bukur? Për t'i shëbyer fashizmit, për të shtypur dhe mashtruar popullin e thjeshtë! Sëpata ç'tu desh. Këtë ma thuaj shpejt.

Andrea e pa se duhej ndonjë rrugëdalje tjetër dhe i zënë ngushtë, u përgjegj:

- Mbase ndonjë mund të ma ketë hedhur për inat. . .

Një valë zemërimi përshkoi të internuarit. Disa pëshpëritën me zë të ulët:

- Shiko sa i dobët!

- Ja hedh të tjerëve për të shpëtuar vetë.

Pjetri foli ngadalë me tallje:

- Pasha zotin, kaq e pati profesori! Do ta varin të shkretin. Më vjen keq. Ka qenë bash burri!

- Kush? Vër gisht! Shpifarak! - E shau komandanti.

- Keni të drejtë të më shani, zoti kapiten, se nuk i njihni disa prej këtyre. Sëpatën duhet ta ketë hedhur nën shtratin tim ndonjë për hakmarrje. - U mbrojti me këmbëngulje Andrea.

- Nuk tregon? ! Kërkon të bësh bisht? ! Lidheni aty! - Urdhëroi kapiteni duke vështuar nga policët dhe shtoi me kërcnim - Do t'ia rregullojmë ne qefin këtij.

- Të vete të marr hekurat? - Pyeti polici i shqetësuar, tërë merak se po ndodhte diçka me rëndësi të madhe.

- Ç'hekura, ore! - U përgjegj kapiteni.

Vështroi rrotull. Gjeti ca tel. E mori, ia zgjati policit duke i thënë:

- Na. .

Andrea iu afrua kapitenit. Polici e urdhëroi të ngrinte duart. E solli telin rrotull, por ishte i shkurtër.

- Lidhe si ta lidhësh! - Bërtiti kapiteni tërë inat.

Polici e tërhoqi në cep Andean dhe i ngeci pak telin.

Kështu mbaroi kontrolli dhe çështja e sëpatës.

Komandanti e policët ikën dhe të internuarit u ngritën. Andrea i tronditur ca mbante kokën lart dhe nuk lëvizte duart nga frika se mos i zgjidheshin dhe i binte teli. Lamja iu afrua buzagaz dhe i foli:

- Po ç' t'u desh me shokët, more Andrea efendi? ! I thoshe troç se ajo sëpatë nuk hyn hiç në punë, se me siguri ka mbetur e harruar qëkur.

- Pse merrte vesh ai? ! Hante arësye? - Kundërshtoi Andrea i rrevoltuar.

- I varfëri ti! Komandanti e kuptoi fare mirë se sëpata nuk ishte fshehur nga ne. Të dyshonte ai, të mbërthente me hekura që të loste tepeleku i kokës e jo me

një copë tel të kalbur. Prit një gjysmë ore, kur të lirojë.

Pjetri ishte afruar me një pamje serize dhe i qau hallin si me dhëmbje:

- Ah, Lame, këtë rradhë i shkreti profesor e piu. Burrë fort i mirë, por fatin gja s'e ndal! E pret trekambshi!

Lamja qeshi, kurse Andrea rrinte i zymtë. Të internuarit u futën brënda që të rregullonin rrobat, që i kishin hedhur policët andej këndeje pa pikë kujdesi. U zemëruan, shanë, bërtitën, protestuan se rrobat ishin bërë lesh e li. Vetëm Besniku qëndroi pranë tyre dhe qeshi me të madhe:

- Ç'ke ore? Mos lojte meç? ! - E pyeti Naimi që sa nuk qante nga inati.

- Nuk e kuptoj se si kanë mundur t'i ngatërrojnë kaq shumë - U përgjegj Besniku dhe u gajas prapë.

Naimi e vështrroi me habi. Desha ta shante, por nuk ia mbajti dhe e lajkatoi me thumb:

- Ti je o i madh o i lojtur mendsh!

Pas një gjysmë ore erdhi komandanti i shoqëruar nga polici i barakës. Tani vala e parë e zemërimit i ishte zhdukur dhe mendonte se kishte shpëtuar paq atë ditë. Kanalën e kishin gjetur. Të burgosurit nuk kishin mundur të arratiseshin. Pastaj të internuarit kishin dalë shumë mirë në kontroll. Nuk bërtiti me inat që të mblidheshin. U muar vesh se komandanti i donte dhe dolën me të shpejtë në oborr.

- Ca maskarenj andej - Filloi komandanti - deshën të hapnin kanal dhe të arratiseshin. Ne i kapëm. Ata do të marin dënimin e merituar, më thellë do të futen. I gënjen mendja kot. Ja u arratisen nga burgu, po ku do të mbyten? Populli i zë të gjallë edhe në vrimë të miut të fshihen. Po nejtse, e zëmë se do të ikin në Greqi, Jugosllavi, Itali. Po kjo është tradhëti. Poshtërsi sa s'ka ku të vejë më. Shqipëria është Atdheu juaj, megjithëse tani ndodhëni në burg. Jashtë keni familjet, far e fisin. Këtu keni lindur dhe jini rritur.

"Pushteti popullor, qeveria, Partia ju kanë dënuar për gabimet e bëra. Po ju nuk do të rrini gjithnjë brënda. Burgu është shkollë. T'i vini gishtin kokës, të pendohi për fajet, të vini në rrugë të mbarë si gjithë populli. Nesër do të liroheni. Nuk ka kush leverdi t'u ushqejë me bukë. Do të kthehet sejcili në familje, në punën e vet. Do të mirmi edhe juve pjesë në punët e mëdha të vendit tonë. Jeni njerëz me shkollë, me kulturë, të mësuar dhe të vuajtur dhe duhet ta dini të ndani të bardhën nga e zeza. E kaluara vate, s'kthehet më. T'u mbushet koka mirë. Kush ka një çikë mend e kupton çfarë mrekullish ka bërë Partia dhe nuk mbjell ferra

rrugës.

Të internuarit, me ndonjë përjashtim të vogël, i dëgjonin me indiferencë këto fjalë dhe qëndronin aty vetëm nga frika e ndonjë ndëshkimi. Besnikut i bëri përshtypje të jashtzakonshme ligjëratat. U entuziazhua duke menduar se kapiteni ishte fshatar analfabet, gjer dje nuk e numëronte kush për hiç, kurse tani u mbante një fjalë të tillë udhëheqsave të pushtetit të rrëxuar.

Para se të ikte, kapiteni lajmëroi:

- Takimi me familjet do të bëhet pasdite.

Fytyrat e të internuarëve u çelën se dallga ishte qetësuar, se familjet nuk do të prisnin më kot. Polici u kthye nga Andrea dhe pyeti:

- Po atij si t'ia bëjmë? !

- Pse aty qenka akoma ai? ! - U çudit kapiteni. - Liroje. .

Andrea nuk lëvizi fare. Priti me durim gjersa polici i hoqi telin.

Komandanti iku dhe kampi kishte po atë atmosferën e natës së kaluar. Shpejt do të takoheshin me familjarët.

Baraka u gjallërua. I ra një hije tjetër. Ca bisedonin te telat, të tjerë mirmin plaçka, ktheheshin në barakë brenda me duar plot. Dikush priste me padurim dhe i shqetësuar, kurse shumica bënin sehir. Në këtë gjyryllydi Besnikut i zuri syri Gencin, që rrinte pranë telave me një pamje tepër të zymtë dhe seç shihte me pikëllim të madh. U afrua të bisedonte me të, ta pyeste ç'kishte se ju dhemb, me që sytë e tij shprehnin një dëshpërim si kurrë ndonjëherë tjetër.

- Genc, çfarë ke? ! Më dukesh shumë i mërziur. . .

Genci mori frymë thellë, diçka e mundonte së tepërmi. Gjëndej në çastin më të turbull të muajve të fundit. Megjithëse e urrente ideologjinë e djaloshit, kishte bindje se atij mund t'ia hapte zemrën pa frikë se mund të përqueshej pas shpin, prandaj u rrëfye sinqerisht:

- Nuk dukem, por jam tepër i mërziur sa askush nuk mund ta marrë me mendje. Kam bërë një gabim trashanik që u martova gjatë atij muaji që u ndodha në lirim. Gruaja ka ardhur të më takojë. Po pres të marr plaçkat që më ka sjellë. Me çfarë i bleu? ! Ku i gjen paratë? ! Me se jetoj? !

“Sigurisht, shumë kush mund t'i falë asaj se është e re dhe e bukur. Dhe unë nuk ndjej asnjë të drejtë morale ta qortoj. Edhe ajo kërkon të jetojë si unë dikur. Nga ana tjetër kështu mund të kënaqë edhe burrin e burgosur me peshqeshe. Pse t'i fiket kot bukuria, rinia? ! Pse të lidhet krejt pas meje, kur fati im nuk dihet? Me ç'të drejtë mund t'i kërkoj asaj gati vetëvrasje për një burrë që s'e ka pranë?

!

“Vetë kurrë nuk do të qëndroja besnik. Do të veproja ashtu si thonë djajtë e kokës sime. Shpirtin e kam plagë. Truri më thotë se ajo ka plotësisht të drejtë të më tradhëtojë. . Ja polici po vjen. . . Gjithë ato plaçka m’i ka sjellë mua. . . Ndofta bashkë me të tjerët. . .

Genci shkoi te polici dhe filluan të hapnin plaçkat, të kontrollonin, të shënonin. Mes të tjerave e shoqja i kishte sjellë dy teneqe të mbushur me gjalp e mjaltë që t’i kishte për gjithë dimrin. Ushqimi i ëmbël dhe aq i vlefshëm, sikur e hëngri të gjallë Gencin, sikur i vertetoi dyshimet.

Dhimbja ia shoi fare atë çikë dashurie që kishte për gruan, për të vetmin njeri të shtrejtë mes njerëzve dhe ai e ndjeu shpirtin të zbrazët. Asnjë nuk kish të afërm në këtë botë. Edhe gruaja i dukej tani aq e largët, aq e huaj sa nuk bëhej. Një trishtim i errët pa asnjë shpresë e mbuloi. Asgjë në këtë botë nuk mund ta ngushëllonte dhe mendoi: “Edhe po të më lirojnë, ku do të vete, unë? ! Të shtrihem si shtazë në shtratin e çnderuar pa patur të drejtë të hetoj dhe të ndëshkoj? ! Më mirë të vdes në burg! ”

Futi duart në teneqe. Po i shpinte brënda. U mundua t’i largojë dyshimet dhe mendoi se do të ngopej atë dimër me mjaltë dhe gjalp. Buza i shkëlqeu nga një gëzim i mbytur. Sytë i ndritën çuditërisht me hare e dhëmbje, sikur nën maskën e qeshur të fytyrës shprehej tragjedia e pashpresë e shpirtit të tij. Duke hyrë në barakë, qëndroi pranë shtratit të Besnikut, se iu prenë gishtërijtë nga pesha e rëndë e teneqeve. Djaloshi po i lexonte dhe po i shpjegonte një artikull Lames. Iu afrua dhe e pyeti:

- Po i lexon artikullin për bombën atomike?
- Po. - U përgjegj Besniku.

Gëzimi dhe trishtimi që shfaqeshin menjëherë në shpirtin e tij, sikur u bënë më të qartë, më të thellë dhe një buzëqeshje djallëzore i shpërtheu. Zgjati kokën e foli:

- Të them sinqerisht nuk dua të vdes shpejt. Më pëlqen të sodis katastrofën e planetit tonë nga pëllicitja madhështore e bombave atomike. Eshtë diçka e jashtëzakonshme, magjepsë, që nuk mund të përsëritet kurrë. Diçka sublime, hyjnore, që njeriu të asgjësojë në disa çaste atë që natyra e krijoi me miliona e ndofta me miliarda vjet. Një fillozof romak ka thënë: “Asgjë nuk më përket veç vdekjes.” Në gjithë eksperiencën e gjatë të jetës sime, nuk kam hasur një të vërtetë kaq të fuqishme. Dëgjo ç’të thotë Genci: Vetëm dy njerëz vërtetë të mëdhej ka ritur dhe lindur njerëzimi. Një në botën e lashtë dhe tjetrin në botën

moderne: Neronin dhe Hitlerin! Të tjerat që të gjitha janë përralla!

Buzëqeshja djallëzore shkëlqeu më tepër. Ai ngriti teneqetë dhe u largua. Lamja ia pat me qortim:

- Përçart e ka mendjen ky Genci!

Një rrëqethje i përshkoi mishrat e Besnikut. Ra në mendime një çast. Iu kujtua vetja, drama për Neronin, mendimet që i erdhën atë natë që shkroi letrën e protestës Komitetit Qëndror. Gjykoi se në esencë donte të shprehte se Neroni dhe Hitleri ishin njerëz të mëdhej. Iu kujtua skena, kur Neroni hidhte në zjarr fëmijën e vogël duke thënë: "Roma nuk meriton të jetojë! Romakë nuk jini gjë tjetër veçse mij të ngopur dhe të uritur!" "I dhëmbi koka nga këto mendime dhe mendoi: "Sa poshtë, sa poshtë kam qenë!"

Në këtë çast e thirrën nga jashtë me zë të fortë. U shkund nga këto mendime. U hodh nga shtrati i tronditur dhe një ndjenjë trishtimi i shtrëngoi zemrën. Mos vallë kishte ardhur ndonjë njeri ta takonte? Nëna? Motra? Vëllai? Kush e kishte gjetur gjer këtu thellë në Myzeqe? ! Mos vallë pas telave me gjermba do të ndriste buzëqeshja e ndonjë vajze, e Jorgjetës? ! Ndofta ajo kishte ardhur si dikur në senatorium e shtyrë nga keqardhja për të? ! Buzëqeshi dhe foli me vete: "Marrëzira! Pse bëhesh kaq i metë Besnik? ! . . . Po kush pra ka ardhur për të më takuar? ! "

U afrua te telat, qëndroi aty më këmbë dhe duart i dridheshin. Polici i solli shumë tesha dhe i hodhi në tokë që t'ia dorëzonte. Besnikut nuk i interesonin ato, prandaj pyeti me padurim:

- Kush ka ardhur?

- Asnjeri. - U përgjegj me indiferencë polici - Dengun e pruri një nga familjet e të burgosurve.

Besniku u zbeh. Një çast më parë e kishte trishtuar ardhja e njeriut të njohur, kurse tani u hidhëruar se nuk kishte ndodhur kjo, se kot kishte pandehur që dikush mund të mirrte rrugën e gjatë nga Tirana për ta gjetur thellë në Myzeqe. "Sa budalla që jam" tha me vehte "Më vajti mendja edhe te Jorgjeta që bën qejf në Moskë dhe as që kujtohet se dikur ka egzistuar një Besnik që ajo e dashuronte! Mua më kanë harruar të gjithë."

Atij i dhëmbi zemra. Dëshëronte në këto çaste që dikush i afërt t'i qëndronte pas telave, ta përshëndeste, t'i buzëqeshte, por ishin të kota shpresat. Pas telave polici kontrollonte rrobat dhe rastësisht gjeti një zarf, të cilin e grisi pa e hapur fare duke i thënë se ishte e ndaluar të futeshin letra në pakot.

Besniku ngriti rrobat në krah, i futi brëndë, i hodhi në shtrat dhe i hapi. I kishin sjellë një jorgan të ri, të pastër, fanela të leshta, dy palë çorape të trasha,



këpucët të rregulluara e të bojatisura, këmishë, të mbathura, pantallona të hekurosura, rrjetën e flokëve, penj, gjilpëra, brisqe rroje, sapun, libra dhe arna.

Në çdo teshë dukej dora plot dashuri dhe kujdes e nënës. Vetëm ajo mund ta qepte aq bukur çarçafin e Jorganit, mund të kujtohej për të rregulluar dhe bojatisur këpucët. Vetëm ajo dinte se po afrohej dimri, se ai mund të mërdhihte dhe i duheshuin gjëra të leshita. Vetëm nëna mund të kujdesej për penj, gjëlperë, arna.

I dukej se e shihte tek rregullonte teshat gjer natën vonë duke shfaqur dashuri e dhëmshuri. Po letrën kush e dërgonte? ! Ç'tuhej në të? !

Doli në oborr dhe vuri re se pranë nuk kishte policë. Iu afrua telave me ndrojtje dhe filloi të mbledhë shpejt copat e letrave. Ato që ishin pranë, i mblodhi, por të tjerat nuk po i arrinte dot. Më kot zgjaste dorën. Kur befas e trembi një zë:

- Besnik. . Besnik. . .

Ktheu kokën i shqetësuar dhe pa Gjergjin. Fytyra e tij nuk ishte serioze dhe e ftohtë si gjithëmonë. Ai i foli me zë të ulët:

- Merre shkopin. Tërhiqe me të! Unë po të ruaj.

Besniku vështroi një hop i habitur. Sikur po hezitonte. Mund ta refuzonte përkrahjen e Gjergjit që i zgjaste shkopin, të cilin e përdorte për të ecur, nga që këmbën ia kishin thyer në tortura komunistët. Por e mori dhe filloi të tërhiqte copat e letrave.

- S'ka njeri. . Mos kij frikë! . . Të ruaj unë! - I fliste Gjergji me zë besnik.

Ishte e para herë pas tre muajve që këmbenin një fjalë. Kohët e fundit Gjergji formalisht mbahej i ftohtë, se pak nga pak kishte kuptuar se Besniku nuk ishte njeri i dobët. Megjithëse ishte me bindje komuniste, me atë mund të bisedohej. E tani zemra i tha ta ndihmonte, ta thyente akullin e të shoqërohej me të. Po merakosej si për vehten e tij, se mos vinte ndonjë polic dhe mbeteshin pa u mbledhur copat e letrave.

Besniku mbaroi punë, i dha shkopin Gjergjit dhe e falenderoi. Shkoi në shtrat se nuk i pritej që të lexonte se çfarë i shkruanin. U mundua shumë gjersa lidhi copat dhe lexoi i tronditur këto rradhë të shkruara me një kaligrafi të keqe:

"I dashur biri im, Besnik! Nëna po lot menç prej teje. Ktheje mendjen, të do nëna fort. Të ka shpirt. Nuk mund të duroj më. Qeveria nuk e ka për të keqen tënde. Ule kokën se nuk mund të dish më tepër se ajo. Ke lënë rrasht e bisht për këtë Parti. Ke luftuar kalama dhjetë vjeç e sot i kthe shpinën. Nëna jote s'e don jetën pa ty. Ajo shkoi dhe u fut nën rrotat e automobilin, bir, nuk desh të rrojë më në faqe të kësaj toke, se nuk ia mban zemra gjithë këtë zeher. E ndali shpejt makinën shoferi, më tërhoqën njerëzit prej rrotash, se nënën tënde nuk do ta gjeje në shtëpi,

po në vorr. Për hatrim tim, për qumshtin që të kam dhënë, për mundim që kam hequr, ke qenë kalama një pëllëmbë dhe të kam bërë burrë, bir, kërkoi falje qeverisë dhe ktheu në shtëpi. Nuk më zë gjumi i natës, s'më përcillet buka, më priten gjunjët. Dëgjoje nënën një herë të vetme, se nuk pashë një ditë të bardhë. E ngrysa jetën në vaj, bir. ”

Besniku i përpiu këto fjalë duke iu dridhur duart, duke iu ligësuar zemra sa më në fund s'u përmbajt më. Rrjeshtat e fundit iu megjulluan e s'i shkoqiti dot. I shpërthyen lotët.

- Më fal. . Më fal. . nëna ime - Tha me zë.

Për herë të parë ashtu pëmbys siç ishte u thellua në marrëdhëniet me nënën dhe u tmerrua duke menduar se sa keq ishte sjellur ndaj saj. E kishte bërë burrë me një mijë mundime. E mbante mend mirë se, kur ishte fëmijë ai. nëna ishte e re, e trashë, pa thinja, e fortë dhe s'i trembej syri. Atij i dhëmbi në zemër se shumë pak kishte mbetur nga ajo nënë e dikurshme. Ishte tretur, zvogëluar, tharë dhe në çdo pjesë të trupit të saj shihej vula e ashpër e jetës, lexoheshin hallet e vuajtjet. Ai kujtoi se nëna kishte shpresuar t'i rritej i biri dhe një ditë të ndjente qetësi dhe ai s'e kishte vënë re fare, si mos të ishte njeri. Asnjë ndihmë nuk i kishte dhënë, veç vuajtje i kishte shkaktuar dhe së fundi e kishte detyruar të përpiqej për vetëvrasje.

Atij i shpërthyen prapë lotët.

Si i kaloi vrrulli i pandalshëm i ndjenjave, u kthye mbarë. Ndenji i menduar dhe pyeti në ishte i penduar për ngjarjet që kishte kaluar në jetë. Ai solli në mendje gjithshka që i kishte ndodhur në vitet e fundit. Përfytyroi veten duke shetituar si hije hamletiane, duke pëshpëritur plot trishtim: ”Të rrosh apo mos të rrosh - Kjo është çeshtja. ”Dhe tha ne vehte: ”Pse e mbaja vallë këtë pozë tragjizmi? Ç'kërkoja? Ç'më mundonte mua? Mos vallë gjithë bota ishte burg dhe Shqipëria nga qelitë më të errta të saj? ”

Ai kujtoi se si punohej në qytetin Stalin. Iu kujtua Kostandini që gjithë ditën raskapitej në uzinë dhe kthehej në ora tre të natës për të fjetur. Në mendjen e tij kishte mbetur e gjallë deri në hollësi gjithshka që kishte parë një natë, kur punëtorët kishin mbledhur naftën që mos të shkonte kot. Ky fakt i dëshmonte tani për heroizmin e klasës punëtore. Mendoi për Polidhorin që hapte puse të reja dhe ëndërronte ta mbushte Shqipërinë me kulla naftë, për Aliun që kishte luftuar me armë për Çlirimin e Shqipërisë dhe tani i ishte kushtuar tërësisht udhëheqjes të ndërtimit të vendit, për drejtorin e kombinatit të naftës, për qendrat e reja të prodhimit

që i kishte parë me sytë e vet. Në këto çaste ndjeu dashuri të vërtetë për gjithë këta njerëz, për veprën e tyre.

Aty pranë kishte të tjerë njerëz që i kishin shërbyer pushtuesit dhe që tani dëshëronin e shpresonin ta përmbysnin pushtetin e komunistëve. Ai u ndje kundërshtarë i tyre.

Por njëkohësisht ai kishte pakënaqësi në shumë pika edhe nga shokët e tij komunistë që udhëhiqnin vendin, pse ata nuk ishin si dikur në luftë, aq të thjeshtë, aq të sinqertë, aq të devotshëm, aq të sakrificës. Shpirti sikur i pëshpëriste këto të vërteta, që ishin sipas tij edhe në kundërshtim me interesat e socializmit, ngadalë, si të fshehura në ndërgjegje, por ai mendoi me vehte se shoqëria vihet në lëvizje gjithënjë nga forca që egzistojnë realisht, të përcaktuara historikisht. "Problemi shtrohet ose këta ose ne. . . Já e njoha botën e perënduar. Fati i Shqipërisë nuk mund të lihet në duart e këtyre njerëzve. Është krim mos të kuptoj një të vërtetë kaq të thjeshtë, kaq të qartë dhe kaq të rëndësishme dhe mos të lidhem me mish e me shpirt me komunistët, mos të ndihmoj me të gjithë forcat e mia, por përkundrazi të ngatërrohem nga ide të turbullta, të shetis si hije e pezmatuar, në një farë mënyre të bashkohem me këta njerëz. Por faktikisht dhe fatkeqësisht ka ndodhur."

Dhe ai kujtoi ç'kishte menduar, çfarë kishte thënë, ç'kishte bërë konkretisht në letërsi. Mendoi se kishte hedhur poshtë me përbuzje romanin e vet për punëtorët, gjithë letërsinë shqipe të kohës, se kishte mohuar me urrejtje teorinë e realizmit socialist dhe kishte quajtur meritë të ngrinte lart figurën e Neronit, domethënë të Hitlerit, tamam ashtu si Gençi. I erdhi shumë keq për vehte e duke kujtuar vuajtjet e heroizmin e tij fëmijë i vogël gjatë luftës, pëshpëriti:

- Si u katandisa!

Nuk mund të mohonte se edhe tani ishte i pakënaqur nga letërsia e kohës, se ai vetë nuk kishte shkruan ende vepra të vërteta arti. Megjithëse e quante të padrejtë përbuzjen ndaj romanit për punëtorët, pse e kishte krijuar atë në mënyrë sipërfaqësore. Ai vendosi që tani e tutje të shkruante tamam ato, për të cilat nuk mund të heshte dot, për gjërat që i kishte njohur mirë. Kujtonte se letërsia që dëshëronte të krijonte ai, ndryshonte ca nga letërsia e kohës dhe bile ishte më tepër socialiste. "Po, - Mendoi ai me vete - duhet të krijojmë një art të lartë socialist duke e kaluar, duke e kapërcyer letërsinë e sotme, por jo duke e mohuar atë. Unë nuk duhet t'i përbuz shkrimtarët e sotëm, por të përpiqem bashkë me ta ta çojmë para letërsinë."

Pastaj mendoi për Hyseinin e veprën e tij, për miqësinë e tyre, për ngjarjet që lidheshin me të dhe tha me vete: "Nuk mund të mohohet se Hyseni ka kulturë,

karakter të fortë, por gjendja e trishtuar, diziluzioni i madh nuk i përkasin Atdheut. Ka shkruar vepra të mira që e lartësojnë popullin, por disa prej vjershave, sidomos poema, shprehin gjëndjen psikologjike të këytre njerëzve të mundur dhe është një turp që unë nuk i kam kuptuar. "Në këto çaste ai nuk ishte në gjendje të dallonte ndryshimin e urrejtjes së Hysenit ndaj pushtetit komunist dhe të urrejtjes së atyre që kishin bashkëpunuar me fashizmin.

Ai mendoi edhe për Edin. Iu kujtua se si e kishte dashur si i marrë, se si ia kishte kërkuar me këmbëngulje dashurinë, se si ishte përlur duke bërë gjëra që i dukeshin të habitshme. Por kjo ndjenjë tani nuk lidhej me gjëndjen e tij të re, sikur kishte mbetur prapa bashkë me pesimizmin dhe lëkundjen e tij.

Kështu u mendua gjatë ai. U largua nga të tjerët për orë të tëra se kishte nevojë për vetmi. Kujtoi gjithshka, të mira dhe të liga dhe më në fund duke ndërë një pakënaqësi gati poshtëronjëse ndaj atyre anëve që i vlerësonte si të dobta, pyeti veten: "A jam penduar se kalova këtë rrugë, se erdha deri këtu në internim? Jo. Kjo ishte rruga ime. Ashtu ishte karakteri im, rrethanat e mia dhe ndofta duhej të kaloja ngjarje të tilla që ta kuptoja jetën kështu."

Pas dreke për herë të parë pas tre muajve, iu afrua Gjergji dhe e pyeti me përzemërsi:

- Nga e kishe atë letër, Besnik?

- Nga nëna. . . - U përgjegj ai plot ngrohtësi.

- Eh, nëna e shkretë! - Psherëtiu Gjergji - Mua shyqyr më ka vdekur. Do të plaste nga hidhërimi. Nuk ia dimë nënës ne.

Pa prituri ia bëhu Naimi dhe tha:

- Oh, një çudi e madhe! Zoti gjykatës këtu? ! Ç'paska ndodhur? !

Gjergjit nuk i pëlqeu kjo ndërhyrje dhe desh të ngrihej, por Naimi e uli me zorr dhe i foli:

- Më duket se i flisje për nënën. Nëna e këtij vuan nga koka e fortë e të birit. Sa herë e kam sharë, por nuk i mbushet. E ka si guri. Tani nuk do të vegjetonte këtu mes nesh i rrethuar me policë, por do të shetiste me çupat nëpër parqet e Tiranës, do të ishte veshur lluks në opera, do të shkonte në Moskë, ku do të bënte qejf dhe do të shihte dynja me sy.

Pas atyre që kishte menduar, Besnikut nuk i bënë përshtypje këto fjalë dhe deklaroi:

- Nuk jam penduar aspak që kam ardhur këtu mes jush. Po bëj tre muaj në internim, por më duket se i kam kaluar tre vjetët. Askund nuk mund t'i afrohesha qëllimeve të mia më tepër se këtu. Asnjë universitet i botës nuk ishte për mua më

i vlefshëm se ky kamp.

Gjergji pranoi me kokë dhe tha:

- Edhe mundet. Sipas njeriut. Këtu vërtet mund të mësosh shumë gjëra. Ka gjithë farë tipash

Në këtë kohë u afrua Serveti me një tepsi me revani. Atë ditë i kishin sjellë shumë ushqime dhe po tregonte një bujari që ishte jashtë rregullave të kësaj barake. Të intermuarit merrnin nga një copë revani duke e falenderuar së tepërmi. Ai e bënte këtë se i pëlqente që të tjerët ta quanin zemërbardhë dhe se revaninë nuk e hante dot gjithë vetë dhe kështu kishte rrezik të prishej.

Naimi e zgjati dorën, rrëmbeu një copë të madhe dhe tha me të tallur, duke u shkelur syrin të tjerëve:

- Për bujari mund të krahasohesh vetëm me Besnikun!

Gjergji nuk pranoi në asnjë mënyrë të prekte revaninë. Edhe Besniku kundërshtoi në fillim, por pastaj e mori një copë të vogël. Serveti kaloi dhe i dha Andreas, Lames, Mit'hatit e disa të tjerëve gjersa tepsia u boshatis.

Kishte kaluar mesi i natës, kur Besniku u zgjua duke ndjerë dhimbje në stomak. Si nëpër gjumë dëgjoj për rreth zhurmë, të goditura, të bërtitura, sharje, ankime. U tremb, gjaku i ngriu. Hapi sytë dhe bëri veshët bigë për të kuptuar ç'kishte ngjarë. Dikush i binte derës me grushta dhe bërtiste:

- Hapeni! Hapeni, zoti polic!

Një aty gogësiu, pastaj filloi të vjellë me zhurmë. Një tjetër dukej se bëri të madhen dhe dikush bërtiti nga lart:

- Ç'bën ashtu, ore? !

- Mos u bëj merak, e nxjerr nga vrima. - U përgjegj ai.

Në fund të barakës Naimi ankohej me zë të lartë:

- Vdiqa! . . . Mbarova! . . . Oh, ç'pata kështu? !

Befas u ngrit rrëmbimthi nga dysheku Andrea, volli me rrymë te këmbët e shtratit dhe pastaj me gjysëm zëri pyeti Naimin që ankohej:

- Hëngre revani nga e Servetit?

- Po. Hëngra. Pse? !

- Po ne jemi të tërë të helmuar. Bjerini derës! Polic! Doktor! Shpejt! Urgjent!

U ngrit me rrëmbim, veshi pantallonat, hodhi diçka krahëve, u sul te dera, i ra me grushta e thirri:

- Zoti polic! Zoti polic!

Polici erdhi më në fund dhe pyeti i zemruar:

- Ç'kini, ore? ! U çmendët? ! Pse klithni si të tërbuar? !

- Zoti polic, hape derën! . . Vdiqëm. . - Foli Andrea.

- Aman, zoti polic!

- Shpejt se mbaruam! - U lutën ca të tjerë.

Polici pyeti me rreptësi prapa derës:

- Pse, ç'patët? !

Andrea i shpjegoi me të butë dhe me përlulje:

- Kemi ngrënë revani me bakër. Jemi të tërë të helmuar. Bëhuni i arësyeshem,

hapeni derën!

Polici kundërshtoi jo aq egër, por i vendosur:

- Eshhtë e ndaluar! Kam urdhër.

- Hape pak, sa të ajroset dhoma, të marrim frymë.

- Nuk mundem! - U përgjegj përsëri në mënyrë të prerë.

Dhe me të vërtetë atë natë komanda për herë të parë kishte dhënë urdhër të prerë që të mbylleshin dyert, për shkak se dheu i kanalit ishte hedhur në nevojtoare natën.

Në këtë kohë Naimi u sul te dera duke mbajtur dorën prapa dhe tha:

- Aman zoti polic, hape se më shpëtoi!

- Kam urdhër! - Nguli këmbë polici.

- Për çfarë ke urdhër? ! Ta lëshojmë në brekë? !

- Kam urdhër të mos e hap derën. Urdhërin tjetër e ke vetë zotrote! - Ja

ktheu si me zemërim zbatuesi i ligjit.

- Aman, ore, bëj se vap! - U lut Naimi.

Pastaj bëri një zhurmë dhe bërtiti:

- Oh. . Oh. . I shkreti unë si u bëra!

- Mbahu Naim bej! Mbahu se na fëlliqe! - Ia priti dikush.

- Ç'pati kështu? !

- I shpëtoi në brekë!

- Në brekë? !

- Ha. . ha. . - Qeshën disa.

- Edhe kësaj dite ia arritëm! - Tha dikush me dëshpërim.

- Vërtetë e bëri? !

- More, ç'të bërë! Të tërë!

- I marrtë djalli, i marrtë! - Mallkoi Naimi dhe shkoi vrap te shtrati.

Filloi të pastrohej shpejt e shpejt. Te dera akoma ziheshin me policin. Përballë Besnikut Alfredi rëkonte:

- Hë. . Hë. . Hë. . .

Gjergji i mbante kokën dhe i thoshte:

- Duro! . . Je burrë!

- Më dhemb. . . Më dhemb barku. . .

- Po mirë. . Të dhemb tani, do të pushoi pastaj. .

- Oh. . Oh. . Oh. . .

- Mjaft më, mos u bëj kalama. Turp kush të dëgjon! - E qortonte Gjergji me një farë zemrimi.

Mit'hati ankohej me zë të ulët. Lëpinte një limon dhe afronte hundën te një plasë e derës që t'i vinte ajër. Andrea u rrek kot me policin, pastaj u kthye shpejt te shtrati se i erdhi të zbrazej. Mori një çamtë të vjetër, me të cilën mbante dikur aktet zyrtare të ministrisë dhe e lëshoi brënda.

- Ua! Mbahi një çikë, o vëllezër, se na prishët ajrin! - Foli Lamja duke zënë hundën me dorë. - Ç'patët kështu, profesor? ! Ç'peshqesh më pure? ! Të lutem, pak më tutje çantën. Merre e vendose te koka e shtratit tënd!

Disa qeshën se morën vesh ç'kishte ndodhur. Një tjetër u ngrit. Vajti te dera dhe vulli bark e zorrë.

- Cili më kështu? - Pyetën në barakë.

- Përsëri Serveti. Ka ngrënë gjusmën e tepsisë.

- E hëngërt mortja!

- Plasja e preftë!

- Dhe ne budallej sa s'ka më. Pritëm bujari nga ai.

- Ha. . ha. . . ha. . .

Seveti vulli prapë me mundim.

- Hajt, të qoftë udhë e mbarë! !

- Marrç edhe gjynahet tona!

E shanin dhe e mallkonin nga të gjithë anët e barakës ata që i kishin ngrënë revaninë dhe tani villnin.

- Ç'ju ka bërë Serveti juve, o vëllezër? ! - I qortoi me të talluar Lamja - Ai u rrëfye burrë, e ndau embëlsirën të tërë. Pse kini stomak të hafiftë ju, ç'faj ka ai? S'bën kështu. I hëngrët revaninë dhe i përmbysni tepsinë. Jazëk! Jazëk!

Kështu baraka, si deti me valë, nuk u qetësua deri sa zbardhi. Shanin, lëviznin plot zhurmë, villnin, ndynin. Një erë e fortë e padurueshme i mbyste të tërë. Edhe Besniku përpëlitej në dyshek me dhëmbje barku. I përzihej, gogësinte, por për fat nuk vulli.

Kur zbardhi, u qertësua pak. U mësuan me erën e rëndë dhe pritej të hapej dera nga çasti në çast. Ishin zgjuar, hidhnin e pritnin thumba. Talleshin sidomos me ata që vuanin shumë. Në mes të bisedave hyri Lamja dhe filloi të dëgjohej vetëm zëri i tij.

- Hë, vëllezër, gjallë jini? ! . . . Shëndoshë e mirë të tërë? U kalua edhe një natë e keqe. Nata e qametit nuk do të jetë më e vështirë. Profesor, si u gdhive? Gjallë mashalla? !

- Nuk të duhet ty shëndeti im. Shiko tëndin! - Ia ktheu Andrea që ishte mërzhitur se tepërmi nga duhma e keqe që i vinte prej çantës.

Lamja u ngrit më të ndenjtur. Nxori kutinë e duhanit. Po dridhte një cigare dhe foli përsëri me thumb.

- Shyqyr! Shyqyr që shpëtua! Eshtë për t'u pirë kafënë, po jini dorështrënguar zotëria juaj! Nejse. E dolët lumin me faqe të bardhë edhe kësaj rradhe! Më vjen keq për zotërinë tuaj, s'ju gënjej, mos paça Perëndi!

- Të të vijë keq për vehte. - I bërtiti prapë Andrea.

- Për vete? ! . . Mazallah! . . . Pse? ! . . Jam aq rehatë sa s'ka ku të vejë më. S'kam qenë kështu se kam lindur. Ta marrësh nga çdo anë jam i përfituar. Në fshat më binin kërbishtat. Sa zbardhej e gjer falej dielli më binin djersët lumë. Hallet e bujku s'kanë të numëruar, nuk i ka njeri në botë. Lëro, mbill, prashit, korr tërë jetën. Pa le, kur s'bëhej i shkreti bereqet dhe korrje bar! U binte lëngata dhenve dhe ngordhnin si mizat! Leqëndiseshe tërë vitin dhe haje një copë bukë misri me një dorë qumësht. Visheshe si mos më keq.

"Kurse tani e kam festen në sy. Tetë orë punë dhe bëj pallë. Buka më vjen te shtrati. Frikë se më vjedh kush, s'kam. Veshje e mbathje si askush. As djemtë e beut nuk mbanin rrobat si të miat. Pse të qahem? Do shoqëri? Sa të pëllicas! Në fshat gjithë gjithë a i gjeje dhjetë burra të zgjuar, kurse këtu ke dynjanë. Nga të katër anët e Shqipërisë. Njerëz me kulturë, me shkollë të lartë, me tre katër gjuhë të huaja, burra që kanë qeverisur shtetin. Ministra, federalë, oficera, avuketër, gjykatës e ç'të dojë e bardha zemër. Ajka me një fjalë të andejme. Ta ka qejfi të bësh një çikë muhabet, se jeni si qitap i hapur. Pa le pastaj t'u qëndrosh në krye e t'u qeverisësh! Të më shfaqej në ëndërr, s'e besoja kurrë! Të urdhëroj gjithë këta burra me grada të larta, udhëheqësit tanë, ku është parë? ! Pa më thuaj zotrote, hape zemrën, pandehje që do të kishe në krye e sipër një çoban nga vendi ku ha pula gur? !

- Na shurdhove veshët. . Mjaft më! . . Do të ankojem në komandë.

- Po puna juaj ndryshon, prandaj më vjen keq. Po ti e merr për ters. Ishit



mësuar një çikë si mirë. Kishit pallate, vetura ju priste te dera, shërbëtori ju vinte sa para mbrapa. Zonjat e bukura i mbanit me qumësht dallandysheje. Ju ngrihej më këmbë milet i tërë, me dorë në zemër! Rrinit nëpër kolltuqe, flinit rehatë nëpër krevate me susta, me jastëqe dhe dyshekë puplash. Dhe tani u katandisët kështu. . . Të çëmbon në zemër. Mbrëmë nuk kishit as ku të zbrazej zotëria juaj. . .

Të gjithë kishin heshtur, dëgjohej vetëm zëri i labit. Shumica e të internuarve e kuptonin shumë mirë tonin tallës të tij, prandaj u rrevoltuan, por nuk guxonin të kundërshtonin. Nuk hahej kush me të se ishte hazër xhevap.

- Po mirë u bë, shumë mirë që u takuam. Helbete, më parë nuk njiheshim fare. Luftova i ziu, u coptova, po për kë? ! S'dija hiç. Tani e njohim njeri tjetrit me dhëmbë e dhëmballë! Perëndia i solli punët si s'ka më mirë, me lezet. Kam luftuar për zotërinë tuaj, këtu kam pse mburrem!

Përfundoi Lamja gjoja me krenari se ra bilbili.

Baraka u gjallërua. Dera u hap. Ajri i qelbët po dilte. Hynte freskia. Të tërë ishin në lëvizje. Pastroheshin, laheshin, rregulloheshin. Ishin të lodhur, të vrarë nga pagjumësia. por të kënaqur se kishte zbardhur. Thithnin ajër të pastër.

Si u nda gjella dhe u hëngër mëngjezi, ra bilbili për punë, por askush nuk po vihej në rresht. Lamja thërriste, kërkonte, por nuk ia varte njeri. Sikur ia bënin për inat, prandaj u nevrikos. Iu zhduk buzëqeshja e zakonshme, sytë e tij humbën dritën, fytyra i ashpërua. Hyri në barakë me vrull, si kurrë ndonjëherë tjetër dhe bërtiti me të egër:

- Jashtë në rresht! Borgjezë!

Një drithmë i përçoi të internuarit. Zhurma u pre si me sëpatë. Zëri i tij buçiti më i frikshëm se i komandantit të burgut dhe të gjithë u sulën jashtë pa e vështruar fytyrën e ashpër të labit.

Atë ditë Besniku i shkroi një letër organizatës së Partisë në Lidhjen e shkrimtarëve, ku bëri autokritikë për ekstremizmin e disa pikëpamjeve që kishte shprehur në mbledhje dhe për më tepër për ato që kishte patur në ndërgjegje. Ai u shpreh gati sinqerisht, ashtu si mendonte tani, ashtu sikur po bisedonte me ndërgjegjen, por prapë mbajti disa rezerva që ishte i bindur që nuk kishin të bënin me problemet themelore. Ai la në anë disa anë të mira të poezisë së Hysenit, të metat që shihte në letërsinë e kohës dhe një farë pakënaqsie për masat e tepruara shtypëse. Ai kërkonte kështu një farë pajtimi, zbutjen e kontradiktave me shokët e tij komunistë në mënyrë që ta kishte më të lehtë rrugën drejt një letërsie realiste socialiste, ca të ndryshme nga ajo e shkrimtarëve të tjerë.

## XVII

Besniku ishte i qeshur, i gëzuar, i gjallë, sikur nuk ndodhej në kamp. Jeta e tij rridhte në mënyrë të zakonshme. Tani nuk e ndjente më veten të shtypur, si në fillim. Sillej i afrova me të internuarit dhe ata nuk e ndjenin kufizimin dhe ndrojtje me të.

Me të zbardhur, posa binte bilbili i zgjimit, ngrihej, lahej, merrte racionin, hante mëngjez dhe pastaj hiqej mënjanë për të studjuar sipas një rregjimi rigoroz. Vazhdonte të mësonte mirë gjuhën ruse dhe italiane, lexonte letërsi artistike dhe marksiste. Natën vonë, kur flinin të tërë, shkruante një novelë duke përgjuar mos e shihte polici. Të djelave lante ndërresat, armonte çorapet, kësmishët. Shkundte dyshekun dhe e nxirrte në diell. Ushqimin e kishte të mirë, pushim bënte, jetonte në ajër të pastër dhe shëndeti i mori për të mbarë. Nuk mërzhitej fare dhe kishte parashikuar të jetonte kështu së paku dy vjet. E quante internimin gati gati një izolim të nevojshëm për zgjeruar e thelluar dituritë që t'ia arrinte qëllimeve të tij dhe përpiqej të përfitonte sa më tepër nga ky rast i volitshëm, ku sipas shprehjes së tij, kur bënte shaka, kishte siguruar gratis fjetjen e ushqimin.

Ndonjëherë dëshpërohej se ishte i ri, se duhej ta shijonte jetën dhe mos të mbyllej në këtë mënyrë. Herë herë e zinte një mall i zjarrtë plot dhëmbje për jetën e lirë dhe vajzat. Por ai i shtypte këto ndjenja dhe zhutej në studime.

Kështu kalonte jeta në kamp, kur një ditë e thirri polici i barakës dhe e urdhëroi të mirrte teshat e të paraqitej në komandë. Besniku u shtang nga kjo e papritur, zemra i rrahu fort dhe pyeti:

- Pse? !

- E di komanda! - Bërtiti polici i nxehur dhe urdhëroi - Shpejt!

Besniku hyri në barakë, shkoi te shtrati dhe filloi të mbledhë teshat, por nga tronditja e madhe i dridheshin duart dhe nuk i urdhëronte dot. "Pse më thërrasin me gjithë plaçkat? Mos do të lirohemi? ! "Pyeti ai vehten dhe një gëzim i thellë matej t' i shpërthente. Por ai shtypi këtë hamendje se nuk besonte që do të mirrnin fund kaq shpejt vështirësitë, që do të kthehej kaq lehtë në jetën e lirë. Mendoj se ndofta po e mirrnin në pyetje, kërkonin ndonjë sqarim dhe më e keqja ndofta do ta nxirrnin në gjy ose kushëdie se çfarë. Pra nuk duhej të gëzohej kot se ndryshe do të pësonte një zhgënjim tepër të hidhur.

Në barakë u hap lajmi se Besniku po dilte me gjithë teshat dhe shumë in

afruan dhe e përgëzuan për lirim. Besniku e mblodhi pak veten. Dukej më i qetë dhe, si u përgatit, vajti të ndahej me Demostenin.

Plakut me flokë e mustaqe të bardha si dëbora i ndriçoi fytyra.

- Po të lirojnë. . . Shumë mirë, shumë mirë - Dhe i dha dorën. Ia shtrëngoi me dashuri dhe shtoi - Do të vesh andej nga shtëpia ime? !

- Po të lirohem, por nuk dihet. .

- U thuaj mos të bëhen fare merak. Unë jam aq mirë sa s'bëhet. Në e takofsh Polidhorin, këshilloje nga ana ime të mos dëshpërohet, mos ta mbajë mendjen te mua, por të punojë mirë. Udhë e mbarë!

U afrua edhe Lamja.

- Na lë, o Besnik! - I foli me dashamirësi - Po mirë, mirë, nuk e kishe vendin këtu. Ishe posi ajo dhija në mes të deleve. Ata e dinin fort mirë këtë, por të sollën për të tërhequr pak veshin. Si i ri, do të kesh rrëshqitur ndonjë çikë. Po ti i tyre ke qenë dhe i tyre do të mbetesh. Dhe ata e dinë mirë këtë, prandaj të mbajtën pak, sa për t'u njohur me ne. Hajt pra, i vafsh shëndoshë e mirë shtëpisë.

Dhe ai e përqafoi me ngrohtësi.

Besniku desh të takohej me të tjerë, kurse Naimi, që i vinte pas, e kundërshtoi:

- Ku vete kështu? !

- Të ndahem me Gencin.

Naimi e qortoi:

- Hajde, ore, merri teshat dhe dil. Ç'të lypset? !

Besniku nuk u bind. Vajti drejt te Genci që luante shah dhe i foli:

- Po shkoj Genc. . .

Genci sikur nuk dëgjoi një herë. Ngriti mbretëreshën, e vuri në një vend tjetër dhe i tha:

- Shah!

Pastaj u kthye nga Besniku. E vështroi me sytë e tij të errët dhe i foli:

- Po lirohesh. .

- Nuk dihet. . . - Shprehu dyshimin e tij Besniku.

- Natyrisht që do të lirohesh. . . Nuk kishte se si të ndodhte ndryshe. . .

Qoke pra! . . .

Ai i shtrëngoi dorën dhe e lavdëroi:

- Nuk ke lënë kujtime të këqia.

I internuari tjetër luajti mbretin dhe qëndroi kokëulur. Ishte i vetmi, me të cilin Besniku nuk fjalosej tani në kamp. Ishin grindur për shkak të historisë së Skënderbeut dhe kishin fyer rëndë njeri tjetrin. Sjellja e tij iu duk qesharake Besnikut,

prandaj i zgjati dorën dhe e përshëndeti:

- Lamtumirë. . .

Ai i dha dorën pa i ngritur sytë duke bëlbëzuar nëpër buzë.

Genci luajti i hutuar, pa u thelluar duke menduar se Besniku po lirohej dhe kushedi ç'fat të keq do të kishte vetë. Në këtë çast ai ndjeu se u këput ajo lidhje që kishte patur në kamp me të intermuarin komunist dhe në esencë tani e tutje do ta urrente si të gjithë ata që e mbanin aty. Tjetri lojti dhe pëshpëriti:

- Shah mat!

- Pse? ! - U hodh Genci duke u shkundur nga mendimet e hidhura.

Studjoi gurët. E kuptoi se lëvizjen e fundit e kishte bërë gabim dhe u dorëzua. Besniku po ndahej me Gjergjin, i cili dukej plot hare dhe thoshte me sinqeritet:

- Nëna do të gëzohet shumë, kur t'i vesh në shtëpi. Shumë mirë u bë.

Ai u mendua pak e shtoi:

- Vetëm një gjë e desha prej teje.

- Çfarë? ! - U çudit Besniku dhe i bëri gjysmë premtimi - Po pata mundësi,

do ta plotësoj.

Gjergji nguroi një hop dhe pastaj foli:

- Diçka e vogël është dhe mund ta plotësosh fare lehtë, po të duash. Mos na shaj andej. Sigurisht nuk them as të na lëvdosh. Njerëz si të gjithë jemi edhe ne, me të mirat e të këqijat tona.

Besniku heshti duke menduar se po të lirohej, pa tjetër do të fliste për botën e vjetër të përmbysur, që kishte parë këtu. Por duke patur besim se do të ishte objektiv, i premtoi me plot gojën:

- Do të flas vetëm të vërtetën!

Gjergjit i ndritën sytë se i besoi fjalës së djaloshit e falenderoi dhe e uroi me këto fjalë:

- Të falem nderit shumë. shumë! Udhë të mbarë dhe sukses në jetë!

Te fundi i barakës Andrea se çfarë po pastronte në shtratin e tij. E dinte se po ikte komunisti, por tregohej fare indiferent. Besniku e kuptoi se atij nuk i pëlqente të takoheshin dhe nuk i vajti fare. Pjetri i bërtiti pas:

- O Besnik, thuej një fjalë të mirë për na e të shkojmë edhe ne tu shpija.

Për qat iqell tash jemi tue u mërzit fort!

Naimi e ndiqte gjithënjë pas. Te dera qëndroi, e përqafoi dhe i foli me buzëqeshje të stisur:

- Tani do të bësh qejf nëpër bulevarde. Do të ngjiten çupat se je bërë më i çuditshëm. Do t'i marrësh në qafë të shkretat! . .

Besniku doli. Naimi u kthye prapa dhe menjëherë iu zhduk buzëqeshja. Picëroi sytë dhe vështrroi i trishtuar burgun. Hyri në barakë dhe hodhi vështrimin në vendin bosh, në shtratin, ku flinte Besniku. "Një komunist si të gjithë të tjerët, nga i cili nuk mund të presësh mirë." Mendoi ai dhe iu shtrëngua zemra, se më kot e kishte lajkatur, se nuk do të kishte asnjë përfitim prej tij.

Në barakë kishte rënë qetësi. Ata sikur po mendoheshin. As Lamja, as Demosteni, as Gjergji nuk i kishin fytyrat të qeshura. Një mallëngjim i hidhur ua ndrydhte zemrat.

Besniku la dengun te roja dhe po ngjitej majë bregores, ku ndodhej komanda. Si u ngjit atje lart, u kthye nga perëndimi, nga deti dhe një fllad i lehtë i mbuloi fytyrën. Para tij shtrihet fusha e gjërë e mbushur me diell vjeshte, ku rrallë ngrihej ndonjë dru i vetmuar, që lëshonte hije të shkurtër mbi tokë. Tej, larg deti shkëlqente nën rrezet e diellit dhe puqej me qiellin. Myzeqeja, deti, dielli, qielli të jepnin përshtypjen e pafundësisë dhe të lirisë. Sytë iu veshën me lotë nga një bukuri e tillë mahnitëse.

Do t'i pëlqente t'i binte Myzeqesë drejt, rrugë pa rrugë, derisa të arrinte në breg, ku të bridhte i lirë, të bërtiste si i marrë, të kënaqej me bukurinë dhe madhësitinë e detit të madh. Iu duk se për herë të parë e shihte para vetes botën e gjërë, të pafundme dhe desh fort të ishte mes saj.

Zëri i rojes ia ndërpreu mendimet. Hyri në zyrën e komandës duke patur në mendje vizionin e pafundshëm të botës, të Muzeqesë, të detit dhe të qiellit.

Komandanti e priti ftohtë. I tregoi se do të nisej atë çast, se e kërkonin në Tiranë. Me kaq Besniku doli dhe roja iu afrua t'i vinte prangat. I internuari hodhi sytë përtej. Pamja sikur nuk iu duk aq e ndritshme dhe madhështore. Ai mendoi se në atë pafundësi e liri ishte i ndryrë, i burgosur, i lidhur në pranga dhe e pushtoi një ndjenjë trishtimi i thellë.

I shoqëruar nga polici arriti në Tiranë në mbrëmje, kur yjet vezullonin lart në qiell dhe kryeqyteti shkëlqente nga dritat e shumta. Zbriti nga makina në sheshin Skënderbe, ku shetisnin burra, gra, djem e vajza, fëmijë me fytyra të qeta e të gëzuara dhe bisedonin të shkujdesur, të lirshëm. Dikur mes tyre edhe ai ishte i lirë dhe i shkujdesur, por tani polici e urdhëroi të ecte më shpejt që të gjendeshin sa më parë në Ministrinë e Punëve të brendshme.

Në postblllok polici i dorëzoi një zarf oficerit të rojes, i cili i porositi të prisnin dhe telefonoi.

Pas pak aty hyri një burrë i gjatë, i veshur mirë, të cilit të gjithë iu ngritën më këmbë menjëherë dhe me respekt të madh. Ai u drejtua nga Besniku, i dha dorën dhe e pyeti si ishte me shëndet. I tregoi se kishte zbritur posaçërisht për të dhe e porositi ta ndiqte pas. E futi brënda në Ministri dhe e ngjiti lart nëpër shkallë.

I internuari i paruar, me leshra krejt të qethura, i veshur keq, i shkonte pas i hutuar, pa kuptuar mirë çndodhte me të. U futën në një zyrë. Pritën pak. Pastaj dera ngjitur u hap. U duk në prak Ministri i Punëve të Brëndshme i veshur me roba gjenerali i gjallë dhe i shkathët, me një buzëqeshje të ëmbël që sikur nuk i përshtatej fare detyrës së tij të rreptë.

Besniku u ngrit menjëherë në këmbë. Gjenerali bëri disa hapa para, i dha dorën dhe i foli me shumë përzemërsi.

- Si je Besnik? Si vete? Hajde brënda!

Besniku hyri në dhomën e ministrit, u ul pranë tavolinës së tij dhe iu duk se ndodhej në botën e çudirave, se gjithshka rridhte në mënyrë të papritur, fantastike, tamam si në përrallë.

Gjenerali u ul në tavolinë, buzëqeshi dhe i foli me një ton dashamirës:

- Jam i ngarkuar të komunikoj se me propozimin e Komitetit Qëndror të Partisë, ti je i liruar që nga ky çast. Jam i porositur gjithshu të shpjegoj se cilat ish-in shkaqet që u detyruam të internojmë. Ti në një moshë të re, pa kulturë të mjaftueshme, pa përvojë, u hyre disa problemeve tepër të vështira, të cilat nuk i zgjidhin dot edhe njerëz kompetentë, akademikë të Bashkimit Sovjetik dhe kështu rëshqite nën ndikimin e ideve borgjeze. Pikëpamjet e tua të gabuara nuk kishin asnjë bazë tek ti. Nuk kishe asnjë arsye të ngriheshe kundër Partisë dhe ne u përpoqëm me dashamirësi të bidnim, por ti ngulje këmbë. Pastaj qëndrimi yt në gjyq ishte i papëlqyeshëm, i dëmshëm dhe ne vendosëm të izoloni. Sigurisht fare lehtë mund të të përfshinin në ndonjë nen dhe të dënonim me burg, por nuk deshëm.

"Ne kemi lexuar me vemendje letrën që ke dërguar në Lidhje, kemi ndjekur me kujdes qëndrimin tënd në internim dhe jemi të gëzuar që i ke kuptuar gabimet. Ne këtë deshëm dhe s'kemi asgjë kundër teje. Bile të çmojmë dhe do të ndihmojmë t'ia arrish qëllimeve të tua, të bëhesh shkrimtar i zoti. Por që të bësh vepra të mira, duhet një punë e madhe. Duhet të zotërosh kulturë të gjërë dhe ta njohësh mirë jetën. Edhe te Hyseni kemi besim dhe nuk do ta lemë në burg. Ne vlerësojmë qëndresën e tij dhe guximin tënd, por nuk duhet të nguteni. Ti tani do ta kesh pak zorr jashtë, por nuk duhet të prekesh.

Ministri i tha se njerëzit për arsye të ndryshme mund t'i mënjanoreshin

ose mund të mos i beosnin. Por ai të vazhdonte rrugën e vet, pa u bërë merak për të tjerët. Pasta e pyeti a dëshëronte të shkonte në punë apo në shkollë dhe i premtoi se do ta shpinin ku t'i pëlqente.

Besniku i shtrëngoi dorën me përzemërsi ministrit, hapi derën, zbriti shkallët dhe u gjend në rrugë. Ishte i lirë, polici nuk i shkonte pas. Nuk kishte zili, ashtu si gjysmë ore më parë, asnjë prej atyre që shikonte për rreth. Në mëndje kishte takimin me ministrin. I kishte pëlqyer shumë qëndrimi i tij, por vetëm diçka i ishte ngulur si gozhdë në tru: fjalët se mund ta kishin përfshirë edhe në ndonjë nën dhe ta burgosnin, por nuk kishin dashur.

Shpejtoi për në shtëpi. Trokiti në portë. U përgjegj kunata. Ajo e njohu nga zëri dhe njerëzit e shtëpisë u sulën të gjithë në oborr. Besniku ndjeu këmbët nëpër oborr. Dera u hap.

Para tij ndodhej vëllai, kunata, fëmijët e tyre, motra. Në oborr doli nëna. Ai nuk u përshëndet me asnjë prej atyre që kishte pranë dhe vajti drejt e te nëna që ishte po ajo nga pamja, por atij iu duk tjetër. Fytyra e saj e gjërë me nofulla të dala, sytë e larmë, të kërcyer, trupi i vogël dhe i drobitur nga jeta e vështirë, iu dukën shumë të dashura. Iu afrua dhe e mori në qafë. Ajo e shtrëngoi me duart e lodhura trupin e tij dhe bëlbëzoi e mallëngjyer:

- Djali i nënës! . . . Bir. . .

Besniku kurrë nuk i kishin pëlqyer fjalët përkëdhelëse të saj. Asnjëherë nuk e kishte përqaftuar me mall të madh, por tani e shtrëngoi fort dhe thirrja e saj plot mallëngjim, e përloti. Ai ndjeu se e donte nënën me një forcë të madhe, se nuk do ta lëndonte kurrë më, se nuk do të zemrohej me të për gjëra të vogla si më parë, se do t'ia falte ndonjë sjellje të saj të papëlqyer, me që ajo ishte plakë dhe ishte rritur në një ambient prapanik.

Ashtu të shtrënguar nënë e bir, u futën në sallon dhe pastaj në dhomë.

Nëna s'i ndahej. I puthte pallton, duart, e përkëdhelte. Besniku kishte shumë mall e dashuri, por prapë përmbahej. Pastaj u shqit nga e ëma dhe u përqaftua me të vëllanë, të cilit i ndriste fytyra nga gëzimi. Motrës iu mbushën sytë me lot. Kunata ishte e gëzuar, por nuk shfaqti ndonjë shenjë të veçantë.

U përshëndetën të tërë, u ulën dhe po bisedonin. Nëna nuk ngopej me djalin. E hidhëronin flokët e qethur, fytyra e parruar dhe sikur i dëshmonin se djali kishte vuajtur andej larg. Por kënaqej tepër se ishte prapë mirë me shëndet, se ishte i qeshur dhe tërë fjalë, se kishte ndryshuar, se tregohej i afërt dhe i dashur.

Vëllezërit të ulur përballë u vështruan në sy. Pakënaqësia e tyre ndaj njeri tjetrit pothuajse ishte zhdukur. Besnikut iu duk sikur ishte Kadriu i kohës së Luftës

dhe sytë e shkëlqyer, fytyra e qeshur dhe vëllazërore ia ngrohnin shpirtin. Tani nuk e kujtoi fare se vëllai kishte dyshuar për të se mos arratisej dhe sikur çdo pakënaqësi ndaj tij ishte zhdukur. Ai mendoi se vëllai i madh gjithë jetën në mënyrën e tij ishte përpjekur për At dheun dhe kurdo ishte gati të jepte jetën për të dhe idealet e Partisë.

Kadriu kënaqej që e shihte Besnikun me fytyrë të qeshur. E dinte se shokët e Komitetit Qëndror kishin mendim të mirë për të dhe i bëhej qejfi që vëllai kishte ndryshuar. Besonte se gabimet e tij ishin gjëra të kaluara, se ai ishte kthyer në rrugën e mbarë, se do t'i bindej Partisë, se nuk do të shkelte më në dërrasë të kalbur, se tani e tutje do të ishin prapë shokë dhe nuk do të vështroheshin me dyshim e frikë, se familjen e tyre nuk e kërcënonte asgjë e keqe.

Megjithatë tani vëllai i vogël kishte një pjesë jete që i dukeshin mister. Këto ishin muajt që ai kishte kaluar në internim.

Besniku rrëfeu ngjarjet e asaj dite në kamp e ministri. Përsëriti potjuajse pекë për pikë fjalët e ministrit. Pastaj tregoi shkurtimisht për shumë të internuar. Nuk gënjeu, por përshkroi ngjarje që paraqitnin anët më negative të kundërshtarëve politikë. Nuk përmendi asgjë që mund të mos i pëlqente të vëllait.

Vonë u ngritën, lanë duart e shtruan bukë. Edhe Besniku shërbente. Mori bukën, e preu. Vajti në oborr të mbushë ujë të freskët. Pastroi tavolinën. E ëma dhe e motra kundërshtuan, i morën gjërat nga duart, por ai nuk u bind. Padashur iu derdh ca reçel në dysheme dhe ai u prek se ndoti dërrasën. Kërkoi një shtupë, e gjeti, e lagu me ujë dhe fshiu dërrasën. E ëma u sul t'ia mirrte nga duart leckën e vjetër, por qe e pamundur. Hëngrën, ngritën së bashku bukën dhe shkuan të flenë.

Pas pak të gjithë i zuri gjumi me përjashtim të Besnikut. Atij s'i flihej dhe përpëlitej në shtrat. Nga dritarja hynte drita elektrike e rrugës dhe ndriçonte dhomën brënda, ashtu si në barakën e internimit, ku flinte një natë më parë.

Tani në të majtë e në të djathtë nuk kishte të internuar të mbuluar kokë e këmbë, të cilët e nevrkosnin me gërhitjet e tyre. Nuk shkruante më në errësirën e madhe të natës dhe nuk ia ndërpriste punën roja. Përjashta nuk dëgjohej trokitje e hapave të policit dhe nga dera nuk shiheshin telat me gjemba.

Drita e rrugës ndriçonte dritaren e njohur që në vogëli, dyshemenë prej dërrase, bibliotekën e dashur dhe portretin e Hamletit. Nuhaste erën e veçantë të shtëpisë së tij, ndjente qetësinë e madhe që i falte ajo. Ai mendoi se të nesërmen do të fillonte nga jeta e re, do të vizitonte Lidhjen e Shkrimtarëve dhe shokë të tjerë, se do të kthehej në jetën e zakonshme të njerëzve. Ai ishte i bindur se po të punonte



me vrrull e vullnet do të bëhej shkrimtar i dëgjuar, se muajt e internimit e kishin ndihmuar t'ia arrinte qëllimit.

Mendoi për veprat që do të krijonte në të ardhmen, për figurat që do të kaliste.

Dalëngadalë po gdhiehej. Besniku nuk kishte mbyllur sy tërë natën. E ndjente veten të emocionuar dhe e dinte se në të tilla raste nuk mund të flinte.

Të nesërmen në mëngjez doli nga shtëpia dhe e ndjeu veten në qytetin e lindjes si në një botë të çuditshme. Iu duk se për herë të parë po zbulonte të fshehtat e tij, megjithëse aty ishte lindur dhe rritur.

Kalonin rrugës burra, gra, pleq e fëmijë, të rij e të reja. Kush ecte serioz e i menduar, kush i qeshur, kush mbahej i qetë, kush fjalosej me atë që kishte pranë. Një hamall i ngarkuar nxitonte. Kalonin automobila pa pushim. Një karrocë vinte nga larg duke përhapur trokitjen e saj primitive, ritmike.

Polici u tregonte rrugën automjeteve dhe njerëzve. Besniku u mallëngjye nga kjo pamje kaq e zakonshme duke menduar se këta njerëz sigurisht kishin punën e tyre, kishin shtëpitë, familjet, ishin të sigurtë se çdo pesëmbëdhjetë ditë do të mirrin rrogën dhe i dukej se asnjë fatkeqësi nuk mund të turbullonte jetën e tyre.

U kënaq se dyqanet ishin plot me mallra, se blerësit hynin e dilnin me rrjeta në duar, se shitëset, vajza të reja, shërbenin me shkathësi e qejf. Iu afrua punëtorëve që po ngrinin një ndërtesë. Soditi punën e tyre, i pyeti për gjëra të ndryshme dhe u largua me zemrën mal duke menduar se Atdheu i tij vërtetë i ngjante një kantieri të madh që po ngrihej me vrrull e sakrifica.

Arriti në qendër të qytetit. Lexoi e soditi me kënaqësi reklamat e filmave, afishet e teatrit, shpallje nga më të ndryshme. Çdo gjë e qytetit sado e vogël i ngjallte një gëzim të veçantë. Atij iu kujtua poema "Horosho" e Majakoskit dhe iu duk se poeti sovjetik në atë vepër kishte shprehur edhe ndjenjat e tij.

U kthye nga polici dhe duke kujtuar vargjet e poetit të madh, tha me vete:

- Polici im!

Nga dreka u nis në Lidhjen e Shkrimtarëve. Hyri në koridor, po ngjitej nëpër shkallë prej dërrase dhe iu kujtua Besniku i dikurshëm plot pakënaqësi, pesimizëm, që e ndjente veten krejt të huaj në këtë ndërtesë. Mendoi se ai njeri sikur nuk kishte të bënte fare me atë tani dhe trokiti me dëshirë në zyrën e redaksisë.

Hapi dorën. Andrea po fliste me Telhanë, i cili rrinte në tavolinën e Hysenit. Në vendin e tij s'kishte njeri. Një hop ata mbetën të shtangur. Besniku u afrua me ngrohtësi dhe u zgjati dorën me përzemërsi. Andrea u ngrit nga vendi. Atij iu

çelën buzët, iu zgjëruan sytë, fytyra sikur i qeshi, por në bebëzat e syve nuk i shkëlqeu shkëndia e një hareje të vërtetë. Telhai e priti pak më ftohtë, me një pamje serioze dhe i zgjati dorën si zyrtarisht.

Besniku u përshëndet, u ul në karrike dhe i vështroi si miq. Atij i dukej se periudha plot kontradikta me shkrimtarët e Lidhjes kishte kaluar plotësisht, se nuk do të përsëritej kurrë më, se do të vijonte filli i jetës atje, ku ishte këputur. Tamam si miqve filloi t'u tregonte me pamje të gëzuar nga kish qenë dhe s'mendonte fare se si do të priteshin fjalët e tij.

Andrea paraqitej i qetë, sikur dëgjonte me qejf, por në të vërtetë nuk e ndjente veten mirë dhe sikur u trishtua. Një trishtim të tillë, po me të madh, si pa shkak, kishte patur, kur kishte lexuar letrën e Besnikut dërguar nga intermimi. Ai e kishte përfytyruar fatin e letrarit të ri shumë më tragjik dhe i kishte ardhur keq. Andrea e ndjente veten krejt ndryshe nga Besniku dhe Hyseni. Diçka e pakuptueshme sikur e largonte nga ata. Edhe tani kishte po këtë ndjenjë.

Telhai dëgjonte ftohtë, bile me dyshim. Kishte një armiqësi që mudohej ta fshihte. Nuk pandehte kurrë se Besniku pas gjashtë muaj internimi do të kthehej kaq i qetë dhe i qeshur dhe do të rrëfente për kampin si për ndodnjë shetitje të bukur. Ndofta do të pëlqente ta shihte të thyer, të dëshpëruar, të gjunjzuar para tij. Edhe letrës ai nuk i kishte besuar dhe kishte thënë: "E pa pisk dhe po e vërtit. Kjo është hipokrizi. Në internim nuk mund të mendohet kështu kurrë!"

- Shumë bukur! Po ti atje paske njohur realitetin! - Tha befaz Andrea me një buzëqeshje të shtirë.

Dera u hap. Ne prak u duk Ismaili. Një hop shtangu si para një hijeje, por duke parë fytyrën e qeshur të Besnikut, duke kujtuar letrën e tij që e kishte mallëngjyer, ai mori me mend ngjarje të pëlqyeshme. Iu afrua.

Besniku u ngrit tepër i gëzuar se besonte gjithënjë se Ismaili ishte njeri vërtetë i mirë. Ata u tokën me mall. Andera e Telhai i panë ftohtë. Besniku vijoi të tregojë cangjarje të tjera nga kampi. Ismaili ra në mendime. Dikush hyri e lajmëroi Telhanë se e kërkonte Filipi.

Telhai shkoi dhe i tregoi për Besnikun. Filipi dëgjoi i qetë dhe tha gati me indiferencë:

- Ishalla ka zënë mend. Ne atë kërkojmë.

Ai nuk priti ta vizitonte ish i internuari dhe vërtetë ashtu ndodhi.

Besniku doli nga Lidhja e Shkrimtarëve ndryshe nga ç'kishte hyrë. Megjithëse dëshëronte të ishte shumë i afërt, mik me Andean, Filipin, Telhanë, e kuptoi se

kishte një hendek mes tyre. Bile e mori me mend se po të vinte herë të tjera në ato zyra, do të ishte i tepërt, Filli i jetës nuk mund të ngjitej atje ku ishte këputur. Ndofta do të duheshin shumë vepra letrare që të nderohej si dikur. Ai mendoi po ashtu si në intermim se edhe letërsia që do të krijonte, megjithëse do të ishte gjithashtu socialiste, do të ndryshonte shumë nga e tyra. Iu kujtua Mihali që kishte vajtur në Tërbuf si ai dikur në qytetin Stalin dhe mendoi se vepra që do të krijonte tjetri, sado e mirë që të ishte, do të kishte patjetër vulën e kornizës së skemës, gjersa nuk ishte prodhim i asaj që shkrimtari nuk mund të rrinte pa e shprehur.

Ai ndjeu se e përceptonte ndryshe letërsinë nga shkrimtarët e Lidhjes, por vendosi mos të mirrej me diskutime, por t'i shtrohej punës për të krijuar një letërsi socialiste vërtetë artistike. Mendoi se kjo ishte një punë e madhe, por besonte se do ta bënte. Atij i dukej se muajt e intermimit e kishin zhveshur nga ca përçartje fluturimesh dhe i kishin shtuar besimin dhe vullnetin për punë konkrete.

Tani ai kishte vendosur të takonte gruan dhe fëmijët e Hysenit, Iu kujtuan gjithë ato ngjarje që i ndanë përkohësisht nga shoqëria dhe shpirti iu err.

Hapi i tronditur portën e Hysenit, kaloi oborrin i përmalluar dhe trokiti me ndrojtje në derën e sallonit.

Dërrasat kërcitën, dikush u ngrit dhe doli nga dhoma, përshkoi sallonin. Dera u hap dhe ball tij qëndroi Sabrija. Atij i ndriçoi fytyra, i rrahu zemra fort. Dësh ta përqaftonte nxehtësisht, por u përmbajt se Sabrija mbeti e shtangur. As dorën nuk ia zgjati. Dukej sikur ajo po shihte hijen e një të vdekuri. U droth dhe balli iu mbush me bula të vogla djerse.

Besniku u prek duke menduar se ajo ndofta nuk e priste fare të vinte, se ndofta e kishte harruar, nuk e kujtonte më dhe as e çante kokën, ku ndodhej.

Futu brëndë. . - Belbëzoi Sabrija më në fund - U tremba se nga dole kështu.

Besniku kaloi sallonin, u fut në dhomë dhe menjëherë i ra në sy fotografia e Hysenit e varur në mur. Iu afrua, e soditi dhe iu mbushën sytë me lot nga malli. Iu duk se vështrimi pak melankolik dhe i zgjuar, buzët e holla, shprehnin diçka të veçantë, se zbuloi në fotografi pastërti, thjeshtësi.

Gjatë kësaj kohe Sabrija e mblodhi veten. Kishte patur arësye të tronditej. Në ato çaste po priste me padurim të trokiste në derë burri i saj që i kishin thënë se do të lirohej ato dy tre ditë dhe ajo sa nuk çmendej nga gëzimi. I kishte puthur fëmijët, u kishte blerë ç' u kish pëlqyer dhe kishte nisur të pastronte shtëpinë e shpejtë si flutur. I kishte f'rkuar dërrasat me tel, ishte lodhur së fshiri xhamat, i ishte këputur shpina duke larë gjithë lëveret e shtëpisë. E kishte bërë shtëpinë xixë.

Ishte raskapitur, por ishte ndjerë prapë e lehtë

Kur ra dera, kishte mbështetur kokën në gjunjë. Priste të shoqin dhe i bëhej sikur dëgjoheshin këmbët e tij, sikur i tingëllonte në vesh zëri i njohur. I ngriu zemra se mos ishte ai, por mendoi "Pse të trokasë në shtëpi të vet? !" Dhe befas si një hije iu shfaq Besniku. E donte këtë djalë, por e kishte harruar fare nga gëzimi i lirit të burrit. Priste të shoqin, jo atë, prandaj u prish në çehre. Ardhja e tij sikur ia mbyti shpresat. Besniku i lirë i kujtonte Hysenin në burg.

U ulën ballë njeri tjetrit. Sabrijes nuk i kishte kaluar plotësisht tronditja dhe përpriqej të shfaqej e gëzuar. Biseduan për Hysenin dhe Besniku i tregoi për fjalët e ministrit. Pastaj i foli shkurtimisht për internimin dhe ç'kishte mësuar atje. U ndanë si miq të ngushtë dhe përshtypja e parë e turbullt e takimit u zhduk.

Një ditë ata u takuan ballë për ballë në rrugë. Ndaluan dhe i dhanë dorën njëri tjetrit shumë ftohtë. Esati që ishte informuar për ndryshimin e Besnikut, desh të paraqitej ndryshe nga ç'i ishte shfaqur dikur:

- Ti e teprove fare kohët e fundit. Unë nuk isha në asnjë mënyrë për ato veprime.

Një zemërim i madh u ndez në shpirtin e letrarit të ri. Ai e urrente shumë hipokrizinë dhe tani që desh ta akuzojë atë për ekstremizëm, i kujtoi me mlllef:

- Këto shitja ndonjë tjetri, jo mua. Mos harro se më ke thënë: "Republika u kalb! Peshku është qelbur nga koka."

Menjëherë pas këtyre fjalëve ata u ndjenë armiq për vdekje. Esati i zbehur i zgjati dorën si akull dhe iku pa i thënë gjymë fjale.

Ata nuk do të përsëriteshin më.

## XVIII.

Pas tre ditësh Besniku kaloi përsëri nga shtëpia e Hysenit dhe trokiti me ndrojtje. Sabrija doli e çelur në fytyrë, me buzë në gaz, plot qejf dhe foli:

- Ku e more vesh kaq shpejt? !

- E liruan? ! - Thirri plot gëzim Besniku.

- Po. . nuk e ditke ti? ! . . Ta paska ndjerë zemra. Takohu me shokun e ngushtë.

Besniku hyri në dhomë. Në një qoshe rrinte babai, në tjetrën djali. Ata u

ngritën të dy më këmbë. Hyseni si gjithënjë ishte i zeshkët dhe i thatë, por sytë s'i dukeshin të parët, nuk i vështronin me egërsi dhe të mjegulluar. Ato lëshonin një dritë të butë si rrezet e perëndimit buzë një mbremje vere, shprehnin paqë shpirtërore dhe qëndrushmëri. Edhe Hyseni e vuri re se Besnikut i shkëlqenin sytë plot optimizëm. U përqaftuan dy herë pa ndonjë emfazë dhe pastaj u shtruan këmbëkryq.

Megjithëse po qëndronin ballë për ballë si dikur, dy shokët dukej se nuk ishin më të parët. Ishte e vërtetë që Hyseni nuk vuante aq shumë dhe vjershat që kishte shkruar në burg ishin pa protestë, të qeta. Ai bile kishte pandehur se do të fillonte një jetë të re, pa kontradikta me komunistët.

Por që atë ditë, posa kishte dalë nga dera e burgut, kishte ndjerë një brengë të pashërueshme. I ishin kujtuar grindjet me shoqërinë dhe i ishte dukur se njerëzit rrugës e vështronin me përbuzje, sikur e poshtëronin dhe mezi kishte duruar gjersa ishte futur në shtëpi.

Babanë, gruan dhe fëmijët nuk i kishte përqaftuar me atë mall që përfytyronte në burg. Shtëpia e pastër, e larë, e zbukuruar, e përgatitur për të pritur miqtë, ia vrau shpirtin. Iu duk poshtërim i madh që njerëzit do të vinin për ta uruar që kishte dalë nga burgu. Atij iu neverit gruaja që sa nuk çmendej nga gëzimi, pse i shoqi ishte liruar dhe as nuk e kuptonte fare brengën e madhe të shpirtit të tij. Në këtë gjendje pati nevojë për Besnikun, por kur e pa aq të gëzuar, sikur ndjeu diçka të huaj.

Gruaja vuri zhezen për kafenetë. Besniku e pyeti shokun nga kishte qenë, kë kishte njohur andej duke shpresuar se ai do të fliste për kalbëzimin e klasave të rrëzuara. Hyseni u përgjegj shkurt se nuk e kishte studjuar aq shumë jetën në burg nga pikëpamja klasore dhe i dha fund kështu bisedës:

- Ç'pret prej tyre. Njerëz të falimentuar që e kanë mbaruar jetën me turp duke u shërbyer okupatorëve. Nuk kanë as kulturë për të qenë, as zotësi veprimi, as qëllime të larta të përcaktuara. Dinin shumë gjuhë të huaja, por pa dobi. Asgjë nuk dinin me themel dhe shpesh tregoheshin shumë qesharakë. Me një fjalë të përshtatshëm për vendin ku janë.

Besniku u entuziasmua nga ky qëndrim dhe përshkroi një varg tipash në një dritë negative, por rrëfeu edhe për Gjergjin e Lamen e ndonjë tjetër që e mbanin veten me dinjitet. Pastaj ata folën për jetën e njeri tjetrit, për birucën, për marrëdhëniet me hetuesit, policët, gjyqin. Hyseni u rezervua ca. Nuk përmendi fare se sa shumë kishte vuajtur në birucë, se kishte patur raste që e kishte ndjerë veten të rënë moralisht. Herë herë ishte paraqitur i butë, herë herë ishte egërsuar,

kishte sharë dhe u çudit se si Besniku e përshkruante me shaka qëndrimin në birucë. Ai e fshehu krejt trishtimin që kishte provuar kur kishte dalë nga dera e burgut, të cilin vijonte ta ndjente edhe në atë çast, megjithëse nuk ishte shuar krejt fryma e pajtimit me shokët e dikurshëm komunistë, prandaj tha:

- Edhe me mut të na ngarkojnë ne me këta do të jemi se s'kemi ku shkojmë. Kur ra fjala për miqësinë tyre, për sjelljen e Besnikut gjatë gjithë këtyre ngjarjeve, Hyseni foli me kënaqësi dhe sinqeritet:

- Asnjëherë nuk kam dyshuar për ty. Ti ke qenë për mua një qiell i kaltër pa asnjë re. Miqësia jote është nga gjërat më të bukura që kam hasur në jetën time. Edhe po mos të egzistonte Horaci, duhej krijuar, se unë e kam parë me sytë e mi.

Besniku u kënaq shumë, megjithëse nuk i pëlqeu krahasimi me Horacin, se kështu duhet të ishte një bisht i Hysenit. Hyseni mori një fletore në dhomën tjetër. Shfletoi dhe lexoi një vjershë kushtuar shokut, ku flitej për miqësinë në përgjithësi që s'e ndanin as dete, as male, as hekura.

Besniku u largua duke kujtuar se Hyseni ndjente pak a shumë si ia.

## XIX.

Po shkante me gëzim te Hyseni, të cilin nuk e kishte takuar që prej një jave. Donte të dinte nëse shoku kishte filluar punë, ç'bënte me planet për të krijuar dhe a e kishte filluar tabllonë "Mbledhja e Celulës". Nuk i ndjente zemra asgjë të keqe dhe hyri plot qejf në shtëpinë e Hysenit. Shokun e gjeti në kuzhinë duke lexuar një libër. Vuri re se ai ishte zbehur e tretur ca, dukej i mërziur dhe sytë i kishte të turbull, plot dëshpërim. Nuk i dha ndonjë rëndësi duke menduar se mund të ishte i sëmurë dhe e pyeti:

- Paskë qenë pa qejf kështu?

Hyseni nuk u përgjegj.

Në dhomë hyri Sabrija. Edhe ajo kishte një pamje të mjerë. Besniku dyshoi se ata ishin të mërziur se mund të ishin grindur me njeri tjetrin dhe i erdhi keq. Duke dashur të mirrte vesh ndonjë gjë të mirë, e pyeti Hysenin a kishte marrë ndonjë lajm për fillimin e punës dhe pastaj u interesua për tabllonë "Mbledhje celule"

- E kam lënë - U përgjegj Hyseni si për diçka të parëndësishme, por një fije zemrimi i fshehtë tingëlloi në fjalët e tij.

Në burg Hyseni ishte penduar sinqerisht për ato vjersha, ku shprehej gati

hapur kundër pushtetit popullor dhe kishte pandehur se do të kthehej prapë në rradhët e komunistëve. Kjo gjë atij i ishte dukur e arësyeshme dhe shumë e lehtë. Por gjatë këtyre dy javëve ishin përmbysur të gjitha shpresat. Një nga shkaqet e këtij ndryshimi ishte se familja e tij po vuante për bukën e gojës, me që rronin vetëm me rrogën e të shoqes.

Hyseni nuk kishte hyrë në punë se, duke e ndjerë vëten poet dhe shumë krenar, i ishte dukur një fyerje tepër e madhe që të trokëllinte nëpër zyrat për të kërkuar punë si ndonjë lypës. Ai dëshëronte ta caktonin vetë më ndonjë vend, por askush nuk po kujtohej.

Një shkak tjetër që e rrevoltonte ishte qëndrimi i njerëzve. Shumica e të njohurve s'e përshëndetnin fare rrugës dhe atij i bëhej se e urrenin. Qëndrimi i shoqërisë ndaj tij i dukej armiqësor. Këto dhe të tjera shkaqe më të vogla e egërsuan. Fryma e pajtimit me komunistët ishte zhdukur.

Në këtë gjendje të re edhe Besnikun e ndjente krejt të huaj, thua se miqësia e tyre gjithëmonë kishte qenë një stisje. Mendoi se Besniku nuk mund ta kuptonte kurrë shpirtin e tij, problemet që e mundonin. Iu duk shoku njeri bajat, që i pëlqente të paraqitej njeri i zgjuar dhe i thellë, i ndryshëm nga të tjerët, por në të vërtetë ishte një egoist, i cili kërkonte të linte gjurmë në letërsi që të përmendej, ishte një shkrimtar pa talent, te i cili në ndonjë çast ishte gënjyer edhe ai vetë.

Ngriti kokën. Kokërdhoku i bardhë i syrit ishte zverdhur dhe rrëzës ishte skuqur. Vështrimin e kishte të turbull dhe të egërsuar. Duke iu përgjegjur më tej pyetjes së Besnikut, ai tha:

- Askush nuk ka nevojë për të! Ti e di fare mirë, se asnjë nuk më do në Shqipëri. Unë i ngaj një lisi plak të vetmuar. Klasat e rrëxuara dhe partitë reaksionare i kam luftuar dhe nuk u kërkoj ndjesë. Qeveria e sotme ka arësytet e veta që më lufton dhe i pëlqen të më fshijë. Shkrimtarët më urrejnë. Për të rijtë jam tepër i çuditshëm, ashtu si edhe për ty. Mos u ushqe me iluzione dhe mos u trego entuziast. Dikur ecëm bashkë një copë rrugë. Por tani jemi shumë larg njeri tjetrit. Po juve duhet t'u mbushet koka se nuk më shuani dot. Vlera kurrë nuk humbet. Edhe këtu, në shtëpi, në vatër ju ndjeni egzistencën time. Mund të bëni sikur nuk më llogarisni, por jo të më zhdukni.

"Vraponi drejt socializmit! Udhë e mbarë! Unë qëndroj këtu, gjithënjë simbol i njerëzve të lirë! Ndofta i vetmuar dhe i përbuzur, por kurrë nuk do të bëhem skllav, shollë e këpucëve tuaja! Prit pak!

Ai u ngrit me rrëmbim dhe vajti në dhomën tjetër. Sabrija gjeti rastin dhe i tha Besnikut:

- Një javë nuk ka shtënë një kafshatë bukë në gojë. Ka të drejtë bota që e quan të çmendur!

Hyseni u kthye. E kuptoi se e shoqja i kishte thënë diçka Besnikut, bile e ndjeu se e kishte sharë dhe kjo e bindi më tepër të vijonte grevën e urisë. Kishte vendosur të mos hante se askush nuk po i jipie punë atij, se i dukej një poshtërim të rronte me paratë e gruas, e cila e quante të çmendur dhe bashkohej me korin e shumicës.

Besniku u trondit. Vetëm tani e kuptoi pse ishte i zverdhur Hyseni dhe ishte tretur aq shumë. Por atë e prekën më tepër bojrat, librat, një karton, ku ishte filluar portreti i vajzës së tij. Megjithëse një javë pa bukë, ai studjonte, bënte art. Kjo forcë e jashtëzakonshme karakteri, e ngrinte në sytë e tij dhe e shfaqte në dritën e njerëzve të mëdhej.

Hyseni u ul. Hapi librin. Lexoi një citat të Bethovenit, ku thuhej se artisti ishte një qenie thellësisht egoiste dhe shoi:

- Ja cilët janë artistët e mëdhej: egoistë të tërbuar, kurse ju i vishni me vellon e altruizmit. Edhe unë jam artist. E njoh thellësisht veten time. Bile nuk mund të jem gjë tjetër veçse artist. Kush më ngacmon, kush më shtyp, do të marrë nga unë përgjigjen që mund t'i jap dhe turpin nga historia.

Besniku mendonte ndërkohë se artisti nuk duhej të kishte asnjë fije egoizmi, se duhej të përfaqonte humanizmin më të lartë e më të plotë dhe nuk i vuri rëndësi citatit të Betovenit. Nuk e kundërshtoi Hysenin se gjendja e tij iu duk tragjike. Nuk e këshilloi të hiqte dorë nga greva e urisë, se e dinte që ai nuk do ta dëgjonte, mandej as e zuri fare në gojë.

Si ndenji edhe ca, ai doli i prekur thellë. Iu duk se Hyseni nuk kishte rrugëdalje në jetë. Dëshëronte me gjithë zemër të luftonin krah për krah për artin socialist. Kishte bindje se së bashku do të ishin më të fuqishëm, më të sigurtë. Ai solli në mendje të kaluarën e Hysenit gjatë luftës Nacional Çlirimtare, mendoi për talentin, aftësitë e tij, për kulturën, karakterin e fortë dhe i vinte për të qarë që shoku ishte shprehur ashtu dhe mbante grevë urie.

Tek ecte rrugës iu kujtua lisi plak i vetmuar. Ndjenjat, mendimet u lidhën me këtë simbol dhe në fantazinë tij filluan të krijoheshin vargje kushtuar lisit plak që ishte rrëzuar papritur nga stuhitë. Atë po e mbyste dëshpërimi pse i dukej që rrugët e tyre ndofta ishin ndarë për gjithëmonë, ashtu si ishte shprehur edhe vetë Hyseni.





## PJESA E DYTE

### I.

Besku po ecte mes arave të mbjellua me pambuk duke thithur ajrin e pastër dhe përshëndeste me përzemërsi fshatarët që kalonin pranë apo që punonin. Fëmijët, që sapo kishin filluar pushimet e shkollave e që kullotnin bagëtitë rrëzë gjerdheve, anash rrugëve, pëshpërisnin nga larg: "Mësuesi! Mësuesi!" dhe bëheshin gati ta përshëndetnin. Gratë që prashitnin, kthenin kokën plot kuriozitet.

Ai hyri në dhomën buzë xhades, ku banonte prej dy vjetësh dhe po pregatiste plaçkat që do të mirte me vehte në Tiranë, kur sirena e lokomotivës fërshëlleu larg. Kyçi derën dhe u nis në stacion. Ishte e shtunë dhe shumë fshatarë po shkonin në kryeqytet. U përshëndet me ta, bleu biletën dhe priti ca. Treni erdhi. Hypi lart. Hodhi sytë vagonit që ishte mbushur plot dhe ndjeu menjëherë atmosferën e qytetit.

Në stacionin e Tiranës altoparlanti jipte lajmet e ditës. Udhtarët e shumtë përpiqeshin të dilnin sa më parë e sa më shpejt. Disa pritnin të afërmit te dera. Hamejt vraponin të mirrin ngarkesat. Karrocët u binin burijeve dhe ftonin pasagjerët. Ndonjë taksi çante ngadalë grumbullin e njerëzve.

Ai ecte mes turmës së panjohur i veshur dosido, me këpucët plot pluhur dhe vështronte me kureshtje. Pasi kishte ndenjur dy javë në fshat, çdo gjë e qytetit i jipte një kënaqësi të veçantë.

Po i afrohej shtëpisë. E hapi portën duke menduar se e prisnin ngjarje shumë të rëndësishme. Ai kishte bindje se ato ditë do të përcaktohej se ç' drejtim do të mirrte jeta e tij. Hyseni dhe Agimi do t'i jipnin përshtypjet për vëllimin me novela që kishte krijuar gjatë këtyre dy viteve në fshat dhe Jorgjetës, që ishte kthyer nga Bashkimi Sovjetik, do t'i kërkonte martesë.

Në oborr nëna po lante enët. Si çdo të shtunë kishte qenë shumë e gëzuar se do t'i vinte djali. Mezi i qe pritur që të kalonte dreka dhe të afrohej orari i ardhjes së trenit. Pas dite kishte qenë tërë veshë mos dëgjohej vërshëllima e lokomotivës dhe posa kishte buçitur atje larg, i kishte thënë vajzës së vogël: "Erdhi treni. Çuni i nënës është tani në stacion."

Ajo la enët dhe përqafoi të birin duke i thënë:

-Mirë qenke. Dukesh nga çehreja.

Besniku u përshëndet me nënën e motrën, u la në çesmë, u ndërrua dhe doli që të shkonte në opera. Fytyra i ndriste. Ndjehej i gëzuar, me besim në vehte dhe bota i dukej e bukur. Ishte i kënaqur që kishte ndërruar ambientin, veshjen dhe që së shpejti do të ndodhej në opera mes burrave të kollarisur dhe grave të stolisura, të cilave as u shkonte në mendje se jeta e tyre u dukej përrallë fshatarëve, sidomos të rejave.

Po ecte rrugës me këto mendime, kur befasi i doli përballë Jorgjeta. Nuk ishte më maturantje e thjeshtë e veshur me grykëse të zezë, me sandale të vjetra, me gërshta të artë që i binin hijshëm në gjirin e parritur mirë. Tani ishte veshur sipas modës së fundit, me rroba luksoze që dalloheshin mes vajzave të Tiranës. Flokët e gjatë, të artë, i kishte mbledhur pas me një krehur që ndriste nga gurëzit e vegjël. Në veshë i shkëlqenin dy vathë të mëdhej. Dorën ia zbkuronte byzylyku. Të ecurit e kishte më të bukur, të lehtë dhe elegant.

-Jorgjeta! - I thirri Besniku me gëzim.

Vajza u ndal. U kthye nga zëri. Fytyra i ndriti shumë dhe briti e kënaqur:

-Oh, Besnik!

Besniku menjëri i tha se "Zoti" ia kishte nxjerrë përpara tamam atëherë kur e dëshëronte dhe i kërkoi ta përcillte në dyqanin e luleve, ku ajo do të blinte një buqetë me trëndafila. Një copë rrugë ata ecën të heshtur. Besniku këto vjetët e fundit nuk kishte njohur ndonë një vajzë që ta tërhiqte. Në fshat ishte i vetmuar dhe kështu mendja filloi t'i rrinte gjithënjë te Jorgjeta, të shpresonte dhe të ëndërronte për të. Atje në fshat i dukej shumë e lehtë t'i propozonte martesë të dashurës së dikurshme, por tani i ngeci gjuha. Megjithatë mori guxim dhe pa u thelluar se

Ç'përgjigje do të mirrte, e pyeti me një farë artificialiteti:

—Dua të hyj drejt e në temë. A mund të më tregoni në dashuroni njeri? !

Jorgjeta e nuhati se ky takim nuk ishte i thjeshtë. Po t'ia bënte këtë pyetje dikur, do të tronditej shumë, por tani nuk ndodhi ashtu. Nga pamja, nga vështrimi, sidomos nga mënyra e pyetjes, iu kujtua Besniku i parë. Buzëqeshi lehtë dhe u përgjegj:

—Më duket se qenke në formë sonte. Ç'është kjo pyetje kështu menjëherë?! Cila vajzë të hapet kaq shpejt? Megjithatë unë do të them të vërtetën:nuk dashuroj.

Besniku mori frymë i lehtësuar, sikur të ishte mbaruar gjyma e punës. Megjithëse kurrë nuk i kishte besuar plotësisht Jorgjetës, tani gati ishte i bindur se ajo nuk e gënjente. Iu duk më e afërt, mori zemër dhe e pyeti prapë:

—Mund të bëj edhe një pyetje tjetër?

—Po..... Megjithëse, edhe po mos të lejoja unë, ti do ta bëje. Sigurisht ndonjë si e para, me sëpatë dardhari. -Ja ktheu ajo më pak e qeshur duke pritur që ai t'i fliste për dashuri.

—A mund të martohemi bashkë? -I propozoi Besnike me plot gojën.

Në këtë çast ndodhi një koinçidencë e rastit. Aty pranë plasi me zhurmë të madhe një gomë automobili sa u trembën të gjithë njerëzit rreth e rrotull. Jorgjeta zuri veshët me frikë, ktheu kokën pas e tronditur dhe e trembur dhe si u sigurua se ndodhej jasht rrezikut, ia plasi gazet. Megjithëse ecnin në errësirë, ajo e vuri re se djaloshi u skuq dhe duke dashur të mos tregohej e paedukuar, i kërkoi ndjesë:

—Ju lutem më falni... Nuk e di se si ndodhi ashtu... Mos u fyeva?

Besniku e ndjeu se nuk kishte të bënte me Jorgjetën e parë. Atëherë, kur i kishte thënë me gjysmë zëri se e dashuronte, ajo ishte prekur shumë, e kishte qortuar me një farë hidhërimi dhe pastaj e kishte porositur që mos t'ia përsëriste kurrë më këtë fjalë. Kurse tani qeshte, megjithëse pa të keq. Por edhe ai kishte ndryshuar dhe megjithëse u skuq, nuk u lëndua. Djaloshi i shpjegoi me buzë në gaz:

—Propozimi im, sado i çuditshëm që të duket, nuk është aq sensacional sa të shoqërohej me buçitje të fuqishme.

Pas këtyre fjalëve ajo e ndjeu vehten të lehtësuar.

Kishin arritur te dyqani i luleve. U futën brënda dhe

Jorgjeta po zgjidhte buqetën. I kishte rënë një nur bukurie. Atij i bëri përshtyoje çdo gjë e saj. E preku vështrimi, mënyra si zgjidhte e kapte lulet, bisadat fare të thjeshta me shitësen dhe i dukej se dyqani kishte diçka të rrallë. Në shpirt pati një çast entuziazmi, poezie dhe romantizmi djaloshar. Po ai mendoi se këtë pamja

vajza e kishte rrallë, se bile herë herë dukej e zbetë dhe e shëmtuar.

Pasi blenë buqetën, qëndruan në një strehë se vesonte pak.

Heshtje. Ajo nuk po i jipte asnjë përgjigje pyetjes së tij.

Djaloshi ndjeu diçka të pa përlqyeshme, prandaj desh ta skjaronte se refuzimi nuk do ta trishtonte si dikur dhe i foli:

-Atëherë, kur në dashuroheshim, isha i mendimit se një djali vetëm një femër mund t'i përshtatej në botë. Tani mendoj se një mashkull mund të martohet me një kategori të tërë femrash dhe se cilën do të zgjedhë prej tyre losin rol më tepër ca rrethana të dorës së dytë.

Për Jorgjetën tani ishte fare e qartë se Besniku kishte ndryshuar, bile iu duk se i shqyptoi këto fjalë me një ftohtësi të akullt. Një pikë hidhërimi errësoi dritën e syve të saj. Gjatë këtyre viteve kishte njohur mjaft djem që kishin dashuruar shoqet e saj, vetë kishte dashuruar dhe e kishin dashur, por te asnjë nuk kishte dalluar pasionin e zjarrtë të Besnikut. Tani asaj iu duk se as Besniku nuk dashuronte si dikur dhe kjo sikur i dëshmonte se në botë nuk kishte dashuri të vërtetë.

-Ti ke të drejtë... . Ashtu është- pohoi ajo me dhëmbje.

Ata dolën nga streha se pikat e shiut pushuan dhe retë po shpërndareshin. Një copë herë u zhytën në biseda të përgjithëshme rreth dashurisë, martesës, marrëdhënieve të çifteve dhe djaloshi u kthye prapë te halli i vet:

-Gjuha shkon, ku dhëmb dhëmballa. Nuk më keni dhënë akoma përgjigje, megjithëse ndofta kuptohet fare qartë.

Jorgjeta u pre pak dhe po ecte e menduar. E kuptoi se Besniku ishte bërë më i qëndruar, por prapë kishte shumë pikëpyetje për temperamentin dhe karakterin e tij dhe kështu nuk ishhte e sigurtë për të ardhmen me të. Bile dikush nga rrethi i saj e kishte qortuar: "Pse shoqërohesh me Besnikun? Ai është aventurier dhe revizionist. Partia e ka goditur dhe e ka shpënë si në formë internimi në fshat." Megjithatë ajo e çmonte Besnikun, kishte besim tek ai, sidomos pas kësaj bisede dhe shpresonte se gjithshka në jetën e tij do të rregullohej. Kështu bluante me vehte dhe nuk përgjigjej, por djaloshi e nxiti:

-Shprehe hapur mendimin. Nuk më vjen keq aspak.

Jorgjeta e zënë ngushtë, u përgjegj:

-As unë nuk e di se ç'të them..... Tani për tani nuk të premttoj dot asgjë... . Më vonë ndofta... . Kushedi.....

Besniku psherëtit. Ata ecën një copë herë të nemitur. Jorgjeta e ndjeu se djali u pikëllua dhe duke dashur ta ngushëllonte, e pyeti:

-Nuk ju ka lindur kështu asnjë dashuri e re veç atyre që dimë?!

Besniku nuk mund t'i tregonte se çfarë i kishte ndodhur gjatë këtyre viteve, prandaj u përgjegj i rezervuar:

-Tre vjet nuk kam dashuruar më.....

-Tre vjet?! - U çudit ajo - Si ke mundur të qëndrosh kaq shumë? Një tip si ti? Pastaj ata u fjalosën për gjërat më të ndryshme.

Erdhi çasti që të ndaheshin. Qëndruan. I dhanë dorën njeri tjetrit. U vështuan dhe buzëqeshën. Diçka të trishtuar kishte në çipat e buzëve të tyre. Jorgjeta u nis në shtëpi dhe një ankth i shtrëngonte gjoksin. Edhe pak do të hynte në apartamentin e saj që i dukej gjithënjë e më i ftohtë, më i heshtur, më i zbrazët, se aty mungonte një burrë, një shok jete. Kishte shkollë të lartë, profesion të mirë, rroba të bukura dhe lluksoze, shtëpi të rehatshme, por s'kishte dashuri. Një lëmsh i shtrëngonte fytyrën. Asaj i erdhën lotë në grykë dhe mezi i kapërdiu.

Besniku, si bëri disa hapa, mbështeti kokën në murin e një shtëpie aty në rrugë, në errësirë. Ishte i bindur se Jorgjeta nuk dëshëronte të martohej me të, për arsye se nuk kishte pozitë të sigurtë në shoqëri, se në fakt ishte mësonjësi i thjeshtë fshati me të ardhme të turbull. Dikur kishte ëndërruar që vajza ta dashuronte pamvarësisht nga pozita e tij, pa kondita dhe i kishte neveritur ato që kërkonin veç njeriut, edhe rehatinë, sigurinë në jetë. Tani e donte Jorgjetën edhe me këtë të metë, se s'kishte ku t'i gjente vajzat e endërruara. Këtu atij iu kujtua se kishte një femër, se ishte Luiza, që mund martohej me të edhe pse ishte tani për tani një mësonjësi i humbur fshati. Po e largoi nga mendja atë se ajo i jipte trishtim.

U tërhoq nga muri dhe me që ishte vonuar për në opera, po ecte në bulevard pa ditur se ku shkonte, kur i doli para Hamiti, që gjithashtu posa ishte kthyer nga Bashkimi Sovjetik.

Sikur nuk kishte mbetur gjurmë nga ai djaloshi pesëmbëdhjetë vjeçar me fytyrë të mitur, me sy të ndrojtur, si të trembur, të cilin e kishte takuar për herë të parë në mbledhjen e shkrimtarëve, ku ishin diskutuar veprat e botuara të Andreas. Tani Hamiti ishte një djalosht i rritur dhe sytë e tij ndrisnin plot gjallëri dhe dritë. Një ndryshim akoma më të madh kishte nga veshja. Atëherë ai ishte paraqitur me një palë pantallona të shkurta, të pahekurosur dhe me një këmishe bezeje të zbardhulur, kurse tani ishte i veshur, si i thoshin, në mënyrë pak a shumë moderne. Atë mbrëmje jo vetëm nuk ndruhej nga njerëzit, por nuk e vinte re fare kush i kalonte pranë dhe sikur të ishte fare i vetëm në rrugë, mirte film pamje të ndryshme me një aparat fotografik gjerman.

Tani ai çmohej nga shumica e lexuesve shqiptarë si poet i vërtetë, që e kishte lënë shumë pas poezinë e Filipit, të Andreas dhe të Telhait. Një poemë e tij, që kishte bërë shumë bujë, kishte fituar çmimin e Republikës. Me t'u kthyer nga Bashkimi Sovjetik, e kishin caktuar menjëherë shef të poezisë në gazetën letrare, në atë detyrë që dikur mbante Hyseni.

Mësuesi i fshatit u gëzua nga ky takim, iu afrua dhe e përshëndeti me një farë malli. Edhe tjetri u paraqit diçka i përzemërt, por me që vinte një veturë lluksoze, i tha:

-Më fal.....

Ngriti aparatit, vuri objektivin në sy, shtypi sustën. Filmi xhiroi. Qytetarët e panë me çudi dhe kuriozitet. Një kujtoi se Hamiti ishte i huaj, prandaj qëndroi dhe e soditi si mister. Poeti i ri e vijoi filmimin pa e çarë kokën fare për kureshtarët. Si kaloi vetura, e ftoi Besnikun:

-Po vjen me mua? Dua të bëj një film për Tiranën dhe po marr ca pamje natën.

Besniku pranoi me qejf. Kaluan në një rrugë tjetër. Hamiti ishte shumë i gjallë dhe fliste vazhdimisht. Ecte me shpejtësi, shikonte sa andej këndeje, e pyeste shokun në i pëlqente objekti për ta marrë në film, ngrinte aparatit, e vinte në sy dhe xhironte. E drejtonte objektivin me një gëzim të sinqertë femënor ndaj çdo gjëje që tregonte përparimin e kryeqytetit dhe duke ecur i fliste Besnikut.

-Tirana ka përparuar diçka, nuk është më ajo e pesë vjetëve më parë. Edhe dritat neon i kanë dhënë një pamje të bukur. Një pjesë e rinisë ka filluar të vishet me gusto dhe kjo është shenjë e mirë. Po lindin filizat e para të një bote moderne. Shikoje këtë femrën. Sa hijshëm qenka veshur! Do ta filmoja, por sigurisht nuk pranon. Ka akoma injorancë të madhe tek ne. Ajo vetë pa tjetër ka qejf. Cilës vajzë të bukur nuk do t'i pëlqente ta shihnin të tjerët në film? Po asaj ia ndryth dëshirat ambienti.

"Unë jetoj akoma me përfytyrimin e Moskës. Është e çudiçme se po bëj një jetë të dyfishtë. Këtu në Tiranë ha, ec, flë dhe me mendje jam në Moskë si në një qytet përrallor, me femrat e atjeshme dhe ndjej një kënaqësi të vërtetë. Jam bërë gati idealist. -Ai qeshi për fjalën e fundit e vijoi-Po e keqja është se kjo gjendje do të kalojë. Kujtimet do të më zbehen dhe unë ndjej se po më afrohet një angushti që do të më kapë për fyti..... Çuditë me ty. Ti nuk je njeri i ngushtë, ke interesa të gjëra, si mund të rrih në fshat?!

Besniku u përgjegj i shtypur shpirtërisht:

-Jeta kudo mund të jetë interesante.

Hamiti vijoi, sikur shoku mos t'i kishte dhënë asnjë përgjigje:

-Për mua fshati gati gati është një burg i gjërë dhe e keqja më e madhe është se ai ka mbetur si jehonë e zbetë e shekujve të vdekur. Njerëz me qeleshe të ndragura, me mustaqe të mëdha, me fytyra të vrazhda plot rrudha, me koka injorante plot paragjykime. Ai nuk di mirë akoma se toka rrotullohet rreth diellit. S'ka parë kurrë televizion. Ka në tru akoma profetin Muhamet, beson Kuranin, nget qetë me parmendë dhe rri ashtu si i veçuar. Çudi si është kjo botë. Një i ri european që do të gdhijet një ditë papritur në fshatin tonë, do t'i dukej sikur ishte tranplatuar misteriozisht në mesjetën e largët.

Për Besnikun Hamiti po e përshkruante fshatin shqiptar në mënyrë të njëjtanëshme. Ai e donte dhe e vlerësonte shumë fshatarin, prandaj e kundërshtoi.

-Ti ke një farë të drejte, por mos harro se ata fshatarë bëjnë bukën për ne dhe këto përparime që merr ti në film, janë bërë edhe me djersën e tyre.

Poeti e shikoi bashkëbisedonjësën me një farë keqardhje dhe i tha:

-Sigurisht unë e egzagjëroj diçka për hir të artit, por ti gjynah që nuk erdhe në Moskë. Atëherë do të bisedonim bashkë. Le femrat. Do të kënaqeshe. Ti këtu ishe kampion në dashuri, po atje më i humburi kishte pesë-gjashtë femra. Mua as më kujtohet mirë se sa të dashura kam patur. Ti atje mund të arrije numrin rekord 200 femra! -Ai qeshi me zemër i entuziazmuar nga kjo ide dhe vijoi -Nuk është gjë e bukur?! Të njohësh dhe të puthësh dyqind femra nga më të ndryshmet?!

Besniku ndjeu një shtypje në gjoks dhe u përgjegj:

-Unë gjithëmonë kam kërkuar një femër. Ndofta edhe atje vetëm një do të dashuroja.

-Edhe kjo më duket mesjetare. Një?! Ç'është një?! Unë kam një dashuri të përgjithëshme, të madhe. I dua të gjitha femrat, u jap kënaqësi dhe më japin. Kështu është sot njeriu modern. Ka interesa të gjëra, dashuron shumë femra, ka telefon, manjetofon, televizor, aparat, vishet bukur, me gusto, njeh pak a shumë letërsinë, muzikën, sidomos ato konteporane.

Besniku që ishte i bindur se njeriu nuk e bëjnë mjetet teknike, por në rradhë të parë mendimet e veprimet, nuk e kundërshtoi, pse nuk i pëlqente të polemizonte.

Kishin arritur te shtëpia e Hamitit dhe hynë brëndë.

Poeti i tregoi televizorin, manjetofonin, fotografitë e vajzave, bile shfaqti edhe filma të shkurtër që kishte marrë në Bashkimin Sovjetik. Ai nuk kishte blerë jasht



shtetit si një shumicë shqiptarësh rroba, frigorifer, maqinëlarëse, asgjë të tillë që mund të shërbente për të zbukuruar shtëpinë ose për të shtuar komoditetin, por kishte sjellë vetëm sende që shërbenin për të bërë një jetë sa më të kulturuar.

Besniku doli nga shtëpia e shokut andej nga ora dhejetë e natës e tek ecte rrugës ndjeu një farë trishtimi. Në mendje kishte qytetin e madh të Moskës, femrat e bukura që kishte parë në film. Po kalonte mes një parku. Aty dhe përtej në bulevard kishte plot çifte. Ai mendoi se të gjithë ata meshkuj e gëzonin jetën, kishin femra, kurse atij i mungonte dhe iu duk se ishte i vetmi në botë që nuk shijonte vajza dhe nuk dashuronte. Ai mendoi se miliona të tilla kishte në botë, porse atij asnjë nuk i takonte, as Jorgjeta nuk e pranonte. Dëshëronte të dashuronte me të gjitha forcat e shpirtit, prandaj pëshpëriti me vehte: "Po ku është ajo që më dashuron mua?!" Iu kujtua se shumë veta e quanin vagabond, se e mburmin që gjoja kishte bërë qejf, bile e akuzonin se kishte braktisur shumë dashnore dhe ai në sytë e tyre sikur e pranonte si faj këtë gjë. Po tani ai mendoi se kjo ishte gënjeshtër me bisht, se asnjë femër nuk e kishte dashuruar atë, se të gjitha e kishin tradhëtuar.

E kaloi parkun dhe po i afrohej një shtëpie të njohur. Aty banonte një grua, me të cilën kishte fjetur një natë. Vetëm me atë kishte dëfryer. Kjo kishte ndodhur në atë periudhë të shkurtër të depresionit moral, kur atë e pat braktisur Luiza. Me ndërgjegje të vrarë ai ishte përmbajtur mos të përsëritej më një gjë e tillë, megjithëse ajo e kishte ftuar prapë. Besniku u brengos se kishte bërë poshtërsi edhe atëherë të vetme që ishte kënaqur me një grua. Me burrin e saj ai kishte një farë bisede.

Ishte i mjerë pra se nuk kishte patur dhe nuk kishte qoftë një femër të vetme, e cila sipas tij ishte nevoja dhe kërkesa më e natyrëshme, më e ligjshme e më e thjeshtë e një genie njerëzore. Ai mendoi se kafshët duhet t'i kishte zili.

Kështu kaloi i vetmuar nëpër rrugët e qytetit, u kthye në shtëpi, hyri në dhomë, u ul në karrike dhe e kuptoi se atë natë kishte pësuar një disfatë, që s'e kishte parashikuar. Jorgjeta nuk kishte pranuar të bëhej gruaja e tij dhe nuk dinte në do të pranonte në të ardhmen. Ndofta shpresonte kot të krijonte një familje të lumtur dhe të qetë.

## II.

Të nesërmen Besniku trokiti në derëm e dhomës së Agimit, e shtyri dhe hyri brëndë. Si përherë shokun e gjeti në krevat duke lexuar. Dhoma e tij ishte rrëmujë dhe kishte si gjithënjë libra në çdo vend: mbi dyshek, poshtë në dysHEME, mbi komodinë, mbi radio, mbi tastjerën e pianos, në dritare. Ai e përshëndeti me përzemërsi dhe u ul në karrike me shpresë se do të lëvdohej për tregimet. Nga mënyra se si hyri dhe ndenji Besniku, nga shprehja e fytyrës dhe shkëlqimi i syve të tij, Agimi e kuptoi se ai besonte që kishte krijuar vepra me vlerë, bile atij iu duk se autori e mbiçmonte së tepërmi vehten, se pandehte që kishte bërë art të madh, prandaj i foli me ironi:

-Po tani, shoku shkrimtar gjenial, pasi na i flake kokës këto kryevepra, ne duhet të shtrihemi barkas para teje?

-Jo, s'ka nevojë... -U përgjegj Besniku pa e kuptuar mirë pse e thumbonte tjetri kështu.

Agimi vijoi me të tallur:

-Unë isha pregatitur të shtrohesh... . Shyqyr që po më shpëton shpirtmadhësia jote gjeniale.

Si e thumboi autorin keqas, sa e bëri të skuqej, mori një pamje më serioze dhe i tha:

- T'i lëmë shakatë dhe ëndrrat tuaja fantastike. Të shohim ç'na ke gatuar. Gjëja më e rëndësishme e këtyre tregimeve është se këtu fryn një fllad jete. Prozërn tonë e kanë mbytur shkrimtarët me parimet e tyre antiartistike duke i futur të gjitha në kallëpe. Kulakun ata e paraqesin gjithënjë të zi, pa asnjë ndjenjë njerëzore dhe patjetër ai do të bëjë diçka të përbindshme, do të mbysë të bijën, apo ndonjë gjë tjetër të këtij lloji. Kurse komunisti është i kulluar, i zbritur nga qielli, pa asnjë të metë, pa kontradikta dhe i di të gjitha. Ndonjë më të rrallë ka ndonjë të metë si puna e atij piperit që djeg pak. Romani "Tharja" i Mihalit është tipik për këtë gjë. Tregimet idealizuese të Andreas nuk po i zëmë fare në gojë.

"Letërsia jonë në përgjithësi është bardhë e zi, romantike, konfliktet dhe zgjidhjet e saj janë të njohura qysh më parë. Shkrimtarët tanë ose krijojnë nga

koka ose e deformatojnë realitetin. Dhe s'ka se si të ndodhë ndryshe, gjersa ata shkruajnë për jetën e prodhimit nga zyrat ose duke bërë në qendrat e punës vizita gati simbolike, ashtu si atëherë ti në Kuçovë. Unë nuk kuptoj se si Lidhja e Shkrimtarëve nuk ka bërë një protestë unanime kundër "Donit të qetë", kur kemi keqardhje për një bjellogardist, për një ballist. Nga kjo vjen pastaj edhe një farë unifikimi stili. Kurse ti ke bërë përpjekje për t'i thyer këto koncepte. E ke futur jetëm ashtu siç është. Ke trokitur në derën e artit dhe të realizmit.

"Mirëpo tregimet tua nuk janë vepra të plota arti. Vetëm ndonjëra prej tyre si "Tregtari" të emocionon vërtetë. Më i realizuari për mua është tregimi në "Burg". Të gjithë të tjerët kanë të meta shumë të mëdha.

Agimi filloi një kritikë të imtë faqe për faqe. Kritikoqi ashpër, pa mëshirë, me sarkazëm skenat e parelizuara, gjuhën e dobët, disa të meta kompozicionale.

Besnikut iu duk se po i analizonte thellë, se ishte shumë më i mençur nga se e pandehte. U kënaq nga lavdërimet, por qortimet ishin shumë më të ashpra nga ç'i kujtonte. Nuk ia kishte marrë mendja kurrë se shkrimet e tij do të kishin kaq dobësi dhe filloi t'i mgjallej pakënaqsia ndaj tyre. Atje në një çip të shpirtit zuri vend hidhërimi. Kishte pandehur se me ca ndreqje të vogla mund të botoheshin, kurse tani po kuptonte se vëllimi nuk ishte në lartësinë e duhur, pra akoma nuk e kishte filluar rrugën e letërsisë.

Pas gati dy orësh, duke i përfunduar vërejtjet, Agimi i tha:

-Kaq kisha unë.

-Në përgjithësi jam i kënaqur... -Tha ftohtë Besniku.

Agimi i shtrembëroi buzët me tallje:

-Si kështu?! Pranoni vërejtje nga një njeri që s'ka haber nga arti?!

Kështu i kishte thënë atij Besniku, kur ai kishte pëlqyer tepër një novelë të Filipit dhe nuk kishte sharë aq shumë një dramë të Andreas.

-Po-Mezi pëshpëriti ai.

-Më vjen shumë keq shoku shkrimtar gjenial. Kur unë një njeri që s'kam haber nga arti, të bëj vërejtje të tilla, ç'dru do të heqë ty atëherë një estet i vërtetë?!

... Nejsë... Tani besoj nuk mendon se jam bosh... .

-Nuk e kam menduar kurrë një gjë të tillë.

-Po ti më ke thënë mua se jam njeri i dështuar.

-Po... Në muzikë... .

Agimi heshti. Ishte prekur në plagë. Megjithëse nuk kishte qitur gjë në dritë në përpjekjet e para muzikore, nuk kishte hequr dorë nga muzika, akoma shpresonte

se mund të bëhej kompozitor, bile i madh. Ai dëshëronte t'i derdhte diku energjitë dhe me që nuk shihte prespektivë të qartë në fushën e kritikës, i drejtohej muzikës duke patur bindje se vepra artistike është një talent dhe nëntë dhjetë e nëntë punë. Në këtë çast mosbesimi i Besnikut në fushën e muzikës e dëshpëroi, bile edhe e inatosi, prandaj e pyeti me një farë ironie:

-Ti e mbron akoma teorinë tënde të talentit?

-Po- Ia priti tjetri në mënyrë të prerë

Agimi buzëqeshi me ironi dhe e pyeti me një zë thumbonjës:

-Po ti, zoti Besnik, ke talent?

-Po, kam predispozita për shkrimtar. Këtë e kam ndjerë gjithmonë-U përgjegj ai me bindje të madhe.

Agimi që vijonte të buzëqeshte me ironi, i tha:

-Po kush ta dha ty këtë bindje? Mos e pe të shkruar në Kuran që do të bëhesh shkrimtar? Sa njerëz qesharakë në këtë botë kanë bindje të plotë se janë gjenialë! Pse mos të jesh ti një prej tyre? Dhe ta dish se unë nuk kam hasur njeri me më pak predispozita për shkrimtar se sa ti, prandaj nuk kam patur besim se mund të bësh diçka. Po faktet po tregojnë një gjë tjetër. Me punë të madhe po arrin të krijosh ca tregime jo të këqija. Më vjen për të qeshur se nuk kupton fare që ti je vertetim i gjallë i teorisë time dhe përgënjeshtrimi më i qartë i asaj tëndes. Ti s'ke patur kurrë asnjë predispozicion për shkrimtar.

Besniku u ngrit nga karrikja dhe shkoi te dritarja i tronditur.

Agimi e preku në pikën më delikate. Të pranonte se nuk kishte patur "kurrë asnjë" predispozitë për shkrimtar për të do të ishte njësoj sikur të hiqte dorë nga letërsia, nga ëndrrat për të bërë diçka të rëndësishme në jetë. Duke dashur t'i jipte të drejtë vehtes, ai i foli me rrevoltë dhe përbuzje:

-Ti kurrë nuk do të arrish t'i kuptosh njerëzit, as mua, se nuk je i zoti të hysh në mbrëndësinë e ligjeve të jetës. Nuk e mohoj, je i zgjuar, diçka kupton, ke kulturë të gjërë, por prapë je i përciptë dhe gjykon vetëm në bazë të librave. Nuk je në gjendje të zbulosh vetë. Ti je mësuar larg jetës dhe ke një shpirt të zbetë, shëndetlig, tamam ashtu si ngjyra e fytyrës tënde. Të gjitha këto kanë një burim. Dielli i jetës nuk të ka rrahur, ti i ndruhesh atij.

Agimi u shtyp diçka në shpirt se ju duk që Besniku kishte një farë të drejte, por nuk donte të përulej, se atë e quante shumë më të gabuar dhe më qesharak, prandaj e pyeti:

-Do të thotë unë jam Wagneri?

-Mos u çudit. Ngjason me disa pika me të.

Ai qeshi i bindur se këto fjalë ishin një marrëzi e kulluar dhe e pyeti prapë:

-Atëherë ti automatikisht del Fausti?

-Faustin e konsideroj njeri. Kam gjëra të ngjashme me të. -Pranoi thjesht Besniku.

-Mos u fryj si gjel deti dhe mos u mbaj si kampion i njohjes së jetës. -Foli tjetri me ton tallës-Tjetër gjë është të kalosh nëpër jetë, tjetër gjë është t'i kuptosh ato dhe pastaj fare tjetër është t'i përshkruash dhe t'i ngresh në art. Është e vërtetë se ti ke parë shumë gjëra, por ç'ke marrë vesh? Shumë, shumë pak. Kjo verteton edhe një herë se ti nuk ke pikë talenti. Po të kishe patur ndonjë çikë, do të kishe dhënë së fundi ca faqe artistike në formë kujtimesh. Talenti krijon nga grimca jete vepra të vërteta artistike. Unë, që sipas teje, nuk kam haber fare nga jeta, i kam shpjeguar dhe kuptuar më mirë mgjarjet që ke jetuar ti... . Këtë e ke pranuar edhe vetë.

-Gjer në një farë pike, por kurrë në esencë se nuk e njeh jetën në mënyrë të gjallë. Ti edhe socializmin e ke kuptuar nga librat.

Besniku mbante mend se një herë Agimi i i kishte deklaruar se kishte filluar të kuptonte marksizmin, pasi kishte lexuar materializmin dialektik dhe historik.

Agimi u bë flakë nga këto fjalë. Ndofta për të parën herë në debatet me Besnikun ai u skuq nga inati. Kishte bindje të plotë se lidhja me socializmin ishte çeshtja më themelore për të dhe tani që shoku donte t'i thoshte se në esencë nuk ishte me socializmin, u rrevoltua dhe e kundërshtoi gati me urrejtje:

-Gabohe rëndë, zotni Besnik! Unë socializmin e kam mësuar nga jeta, së pari kur luftoja kundra tij me armë në dorë dhe pastaj e kam parë me sytë e mi në çdo hap të jetës shqiptare. Nga kjo dhomë unë e kam ndjekur me vemendje dhe pasion çdo grimcë përparimi. Dhe e kuptoj më mirë nga ti se çfarë i ka dhënë Shqipërisë socializmi dhe ç'mund t'i japë. Unë personalisht jam qind për qind i bindur se vetëm në këtë Shqipëri mund të bëj diçka dhe kjo është ajo fije intime personale që më lidh mua në mënyrë të gjallë me socializmin. Po ti kurrë nuk ke çarë kokën të më kuptosh mua. Mëso tani, se veç mënyrave të tjera, unë jam lidhur me socializmin edhe mes teje. Ke sjellur në këtë dhomë time aq material nga jeta sa kurrë s'e ke kuptuar dhe as që do të mundësh ta kuptosh. Kurse unë çdo ngjarje nga jeta jote e kam analizuar, e kam stëranalizuar dhe kam nxjerrë përfundime.

Këto fjalë i bënë shumë përshtypje Besnikut. Zemrimi iu fashit. Iu shtua nderimi ndaj Agimit, e ndjeu më të afërt dhe iu duk se disa herë ishte sjellë

padrejtësisht i ashpër kundër tij, se vërtetë nuk e kishte kuptuar. Agini që e nuhati pak a shumë këtë gjendje të shokut, i erdhi mirë dhe sikur edhe vetë nuk mendonte më aq keq për të. Ata ndjenë një farë pajtimi dhe Agimi përfundoi kështu:

-Tani gjithshka e jetës sime është e lidhur me socializmin, sidomos muzika. Një çikë po të lëkundet besimi në socializëm, shuhen tingujt në kokën time.

Besnikut këto fjalë iu dukën qesharake, të zbraza, artificiale, por këtë rradhë nuk e kundësthoi se i vinte keq ashtu si pa shkak.

Ai doli në rrugë i dëshpëruar. Nuk ishte i sugurtë as për lavdërimet që i kishte bërë shoku. Kishte vënë re se ai disa herë vlerësonte qoftë shkrimet e të tjerëve, qoftë ndonjë shkrim të tij më tepër se ç' meritonin. Prandaj në këto çaste kishte shumë nevojë për Hysenin, i cili sipas tij, dinte ta dallonte saktë ç' është e ç' nuk është art. Nuk i pëlqente të mbahej me gënjeshtër, i duhej e vërteta dhe bile dëshëronte ta mësonte atë sa më parë, prandaj, megjithëse ishte kohë dreke, vendosi mos ta shtynte vizitën për pasditë.

Në bulevard papritur i doli para Skënderi, që i shtrëngoi dorëm fort dhe i foli plot gaz:

-Po ku je zhdukur kështu, o Besnik?! U bënë gati dy muaj dhe s'të kam parë fare. Po bën ndonjë çipikje? Ndofta po rregullon ndonjë bombë me hidrogjen që ta shkatërrosh Lidhjen e Shkrimtarëve, se ato tregimet që i kishe dhënë Hysenit nuk më pëlqyen. Lexova nja tre a katër prej tyre. Ne rrimë me mëmndje se ç' ngatrron atje në fshat, kurse ti numron në vend. Nuk ke shkruar gjë tjetër?

Skënderi nuk i kishte lexuar tregomet "Tregtari" dhe "Në burg".

Besniku u turbullua, u skuq dhe u përgjegj duke bëlbëzuar:

-Gjëra të parëndësishme.....

-Pa na i sill, ndofta ke goditur atje, ku s'e pandeh... dhe na dil.

-Do të vij... -Pëshpëriti tjetri me një fije zëri.

-Dilna pra... -Ai i dha dorën dhe desh të largohej, por befas ndali dhe foli:

-Shiko, shiko, gati harrova kryesoren. Mbrëmë takova Luizën. Më ndali vetë.

Unë s'e njoha fare. U lëndua së tepërmi dhe më tha: "Po të përmend vetëm një emër që ti të më kujtosh. Besnik." Më ra në mendje me një herë dhe i shtrëngova dorën për zemërsisht. Shumë vajzë interesante. Takoje. Bile unë them, martohu me të...

Re të tjera të zeza iu mblodhën Besnikut dhe ai u përgjegj:

-Gjithshka mbetet e kaluar.

Dhe ata u ndanë.

Ky takim qe një grusht i rëndë për Besnikun. Së pari Skënderi ia hodhi poshtë tregimet gati me përbuzje dhe shijes së tij artistike ai i besonte. Pastaj i përmendi Luizën që lidhej me ngjarje të trishtueshme dhe i tha se ajo kishte ardhur në Tiranë. Më në fund atij iu kujtua edhe gruaja , me të cilën kishte fjetur një natë. Ajo ishte e shoqja e shokut më të ngushtë të Skënderit. Të gjitha këto gjëra në këtë çast, kur po i binin iluzionet për punëm shumë vjeçare, ia errësuan gjykimin. I hodhi një sy të kaluarës dhe iu duk se ajo ishte plot gabime, mëkate, aventura, bile edhe me poshtërsi. Atij iu bë se ishte njeri vetëm me të meta dhe si i tillë as meritonte të bëhej artist.

Këtë rradhë, si asnjë herë tjetër, djaloshi po hynte në shtëpinë e Hysenit me frikë në zemër duke e ndjerë vehten të pafuqishëm, të pazotin.

Hyseni nuk kishte patur më kriza të forta në jetë si ajo e pas lirimt nga burgu, kur kishte mbajtur një javë grevë urie dhe ishte stabilizuar në punë në arshivën e shtetit. Po kundërshtimi i tij ndaj pushtetit të komunistëve, me ndonjë luhatje të vogël, ishte i pandryshueshëm dhe përbënte pathosin e veprave letrare që krijonte vazhdimisht pa u trembur, pa u lodhur, me krenari dhe besim në vehte.

Besniku kaloi sallonin pa trokitur, hyri brënda në dhomë me që dera ishte e hapur dhe qëndroi në prak. Hyseni që pikturonte pranë dritares, nuk e vuri re. Besnikut i bëri shumë përshtypje shoku pranë tabllës dhe e veshi pothuajse me një vello misterioze. Iu duk se qafa e tendosur shprehte vendosmëri të patundur, se vështrimi i mprehtë, i përqëndruar në tablo i fliste për diçka të jashtëzakonshme, se lëvizjet e dorës që mbante penelin ishin të sigurta, të shpejta dhe vertetonin se po bënte para edhe në një fushë tjetër të artit. U hutua, iu duk shoku shumë i ditur, shumë i zoti dhe ndjeu frikë në zemër.

Hyseni ktheu kokën se ju paksua drita e dhomës, pa kush ishte, e ftoi të ulej, i kërkoi falje se nuk e tokte dot, me që i kishte duart të zëna dhe i tha:

-Do të presësh pesë minuta. Po bëj ca rregullime dhe e përfundoj. E kam shumë qejf. Në këtë pikturë kam arritur atë, që kërkjoja: thjeshtësinë maksimale të materies, shprehje e një personazhi kompleks me mjete shumë të thjeshta, përdorimin e një ngjyre të vetme për të dhënë të gjitha nuancat psikologjike. Stdujoje këtë anë dhe pastaj jep mendimin tënd.

Këto fjalë për Besnikun ishin të çudiçme, sikur shprehnin një të vërtetë misterioze që ai nuk mund ta kuptonte.

Hyseni u kthye nga tabloja, mgjyrosi penelin dhe vijoi punën. Po pikturonte portretin e një burri në moshë të pjekur. Tiparet kryesore i kishte marrë nga vehtja,

po mezi dalloheshin se i kishte transformuar duke na dhënë gati një njeri tjetër. Burri paraqitej i qetë, plot besim dhe i menduar ca. Duket se kishte gjetur rrugën e jetës, se e kishte të qartë qëllimin. Koka e tij ishte mbështetur pak në dorën e majtë. Portreti ishte pikturuar në ngjyrë të kafes me një penel aq të lehtë sa pothuaj dukej krejt bezja. Besnikut i pëlqeu, e gjykoi shumë pozitiv se shprehte qetësi dhe besim, por nuk pati ndonjë entuziazëm.

Ndërsa shoku punonte, i hodhi një vështrim tabllave të tjera, që ishin rrjeshtuar mbi komo dhe ndali vështrimin e tij te një portret. Aty ishte pikturuar një djalosh me fytyrë të ngërdheshur, me qeshje tallëse dhe përbuzëse, me sy të trishtuar që lëshonin një dritë të keqe plot dyshime. Besnikut iu kujtua se për atë portret kishin bërë debat të rreptë, ishin nxehur, ishin sharë dhe pastaj Hyseni i kishte thënë: "-Ty s'të pëlqen ky personazh, nuk e duron atë, se ky tallet me gjithshka të kësaj bote, edhe me komunizmin që ty të duket diçka e shejtë, si Krishti për kristianët. Po dije mirë se megjithë dënglat e juaja, ai është heroi pozitiv i shekullit, i botës së sotme, kur njerëzit kërcenojnë me mburrje-satanike se do ta zhdukin planetin me bomba me hidrogjen. Ky tallet me lëvdatat, me raketat, me bombat. Duket i dobët, por ka një forcë të tillë, që asgjë nuk e mposht. Ai e njuh botën pa iluzione, lakuriq. Forca e tij është mosbesimi dhe sarkazma."

Besniku kishte buzëqeshur lehtë nga këto fjalë, por tani piktura e hutoi edhe më tepër, e turbulloi, e shtypi shpirtërisht dhe plot dyshime i erdhën në kokë. Njeriu në portret sikur tallej edhe me të, me ëndrrat, përpjekjet, me rrugën e jetës dhe qëllimin e tij, sikur i thohte aq ç'ka besonte dhe ëndrronte ai ishte e gënjeshtë.

Hyseni, mbasi e vështrroi portretin me kënaqësi, lau duart në çesëm, i fshiu, mori vëllimin me tregime të Besnikut në dhomën tjetër dhe filloi:

-Këtu ka diçka prej shkrimtari të vërtetë. Ti di që të shohësh, që të zgjedhësh fenomenet, por pasqyrimi i tyre është i dobët. Edhe përshkrimet janë si të çakërdisura. I hedh frazat sikur truri nuk punon në rregull. I ndërton skenat të mgjeshura, rrëmujë, sikur nuk ke besim në ato që shkruan. Të shohësh më qetë, më natyrshëm, më qartë. Ti duket sikur e ke marrë trastën për kurbet artistik, ke takuar dikë që të ka rëfyer bukur, po si bukur? Sa s'ka ku të vejë më, me gjenialitet. Pasi ka ikur ai, ti je ulur dhe i ke shkruar keq rrëfimet e tij. I ke shtrembëruar. Diku ke shtuar, diku ke paksuar, diku i ke lënë ashtu dhe përfundimi ka mbetur diçka e zbetë, si e gënjeshtërt. Bëjnë këtu përjashtim tregimet "Tregtari" dhe "Në burg". Ato janë të realizuara, megjithëse kanë mjaft të meta stilistike. A të pëlqen të them të vërtetën?



-Atë dua-Tha Besniku-Fol qartë se nuk po të kuptoj.

-Je në udhëkryq. Duhet të lëvizësh se pastaj je tepër vonë. Ky është çasti determinat për ty. Ti ke një të metë të madhe. I ve vehtes një qëllim dhe pastaj përpiqesh me çdo kusht ta vertetosh. Po arti nuk bëhet kështu. Personazhet duhet të jenë të lirë. Jeta nuk mund të përdhunohet. Po ta them hapur. Ti kërkon të mbash me zgjuarsi atë realizëm socialist që krijoi Gorki me romamin "Nëna" dhe Fadajevi me romanin "Garda e re", por nuk do t'ia arrish qëllimit. Këta dy romane mbetën si përfqasonjës të një shkollë, ashtu si dramat e Korneit dhe të Rasinit, por veprat e tjera, që u ngjasin atyre, do të bëhen hi e pluhur.

Besnikut këto fjalë po i zgjidhnin dyshimet, problemet që e mundonin dhe tregimet po i shihte në një dritë shumë të qartë e mund të shpjegonte të metëm themelore të tyre, të cilën e ndjenin Agimi dhe Skënderi, por nuk e kishin të qartë. **Sollë në mendje mënyrën se si shkruante, se si i zgjidhte dhe i krijonte skenat, personazhet dhe u bind se vërtetë i vinte një qëllim vehtes dhe se, për ta vertetuar atë, shtrembëronte gjer në një farë pike ngjarjet, idetë, personazhet.** Përfytyroi zhvillimin e ngjarjeve dhe të personazheve krejt lirshëm dhe pandehte se po të shkruante në atë mënyrë, do të njoillosej socializmi. Ai i mbetej rob i atij iluzioni që i ishte krijuar në intermim: se socializmi ishte i vetmi sistem përparimtar dhe se difektet e tij shpjegoheshin me faktin që posa kishte filluar të kristalizohej.

Ai mendoi se detyrat e socializmit ishin konkrete, historike, se ndofta tani për tani përshtkrimi krejt i saktë i socializmit duke mos përjashtuar edhe disa anë negative, ishte diçka në kundërshtim me to. Në këtë çast atij i erdhi sikur shoku po e mëshironte, prandaj i tha:

-Fol troç, sikur të vjen gjynah. Ne duhet ta themi të vërtetën, sado e hidhur dhe e rëndë që të jetë.

-Ti ke iluzione në kokë. -Vijoi Hyseni-Nuk kupton se letërsia e Mihalit, e Andreas, e Telhait është prodhim i këtij sistemi, se ky sistem nuk e do artin. Ti ja ke veshur gjithënjë fajin personave dhe ke menduar se mund të krijohet art i përkrahur nga ky sistem.

-Po. Kam qenë i bindur gjithënjë se në përgjithësi letërsia e kohës nderohet sot, pse nuk ka një art të vërtetë socialist dhe jam përpjekur ta krijoj atë.

Këto fjalë e nervozuan Hysenin se në fakt shoku desh të thoshte që vepra e tij nuk ishte art i vërtetë, se arti duhej të kërkohej në një rrugë tjetër dhe se ai do ta krijonte atë. Këtu iu kujtuan anët më negative të tregimeve të Besnikut, ia absolutizoi ata, sikur nuk kishte asgjë veç tyre. Duke qenë i bindur se shoku kishte

dështuar me turp në rrugën për një art tjetër të ndryshëm nga arti i tij, i foli me neveritje:

-E ç'na krijove? Lexonjësit i vjen për të vjellë nga tregimet e tua. Ai e kupton se përpiqesh ta gënjesh me qëllim.

Të dy shokët heshtën. Fjalët e Hysenit, që i kujtoi plotësisht të sakta, ishin grushti më i rëndë për iluzionet e Besnikut, shtysa e fundit drejt mosbesimit dhe pesimizmit. Ai ndjeu një dhëmbje të madhe. Sytë i shkëlqyen si të përlotur dhe u shpreh me një zë të ulët, të mekët:

-E kam kuptuar thellë të metën e tregimeve të mia. E ndjej se mund të krijoj vepra të rëndësishme, të pavdekshme, por ato do të vinin diçka në kundërshtim me detyrat imediate të idealit tim. Çdo njeri ka karakterin dhe rrugën e vet. Jam nisur me revolucionin dhe do të vdes për revolucionin. Ndofta po u jap fund përpjekjeve për të krijuar art. Kjo është shumë e dhëmbshme për mua, përmbys ëndrrat më të bukura, por më parë jam komunist dhe pastaj artist.

Kështu ai u bashkua në fakt me Hysenin që thoshte se arti e socializmi janë dy gjëra të ndara dhe këtë gjë kuptoi Hyseni, prandaj tha me kënaqësi:

-Te ti fitoi revolucionari, tek unë artisti. Për mua pa art, s'ka jetë.

Këtu ata e prenë bisedën për tregimet dhe Hyseni pa e çarë kokën shumë për hidhërimin e shokut, i foli me mburrjet për planet e poemës së ardhshme. Si i lexoi ca pjesë, ai tha i entuziasmuar:

-Vepra ime do të jetë një iliadë. Do të ketë të gjitha ngjyrat e kësaj balte shqiptare. Aty do të përshkruhet jeta e kombit në një periudhë të caktuar në të gjitha anët e saj, me këngë e valle, me luftë e vdekje, me trimëri e gëzim. S'e mohoj se poema do të tingëllojë si një hymn për klasën e pasur fshatare, do të tregojë se ajo klasë shkëlqeu edhe një herë me gjithë madhështinë e saj, para se të zhdukej, do të jetë gur varri i asaj klase, që ishte shtylla e kombit për disa shekuj me rradhë. Unë do të mbetem në poezi si përfaqsonjësi i fshatarëve të pasur dhe këtë e kam për mburrje. Pastaj do të shkruaj për luftën pa i përmendur fare komunistët.

-Kjo s'ka mundësi-Kumdërshtoi Besniku.

-Ti do ta shohësh se unë do ta gjej mënyrën.

-Po artisti duhet të thotë gjithmonë të vërtetën.

-Komunistët më kanë vënë prangat për ca vjersha-U përgjegj tjetri me zemërim.

-Megjithatë ti duhet t'u japësh komunistëve atë që u përket. Qëndrimi yt

s'është i denjë për artistin. Ti kërkon të mbulosh të vërtetën për shkak të armiqësisë tënde me ta, prej inatit.

Fjalët e fundit të Besnikut e prekën Hysenin dhe i krijuan atë gjendje të turbull shpirtërore që kishte shpesh atë muaj. Tani që po shkruante me frymëzim kohën, kur kishte qenë i lidhur për vdekje me komunistët, ndjente dhembje se ishte shkëputur prej tyre, me të cilët kishte bërë dikur një punë shumë të mirë. Dëshëronte ta shuante këtë ndjenjë duke menduar se komunistët nuk i botonin veprën, se e kishin burgosur, se e persekutonin, por kjo ishte e pamundur. Këtë plagë tani ia lëndoi edhe Besniku. Si heshti një copë herë i indinjuar, e vështroi shokun në sy dhe i tha:

-Juve ju duket se më vjen mirë që u shkëputa nga komunistët, se për mua ka qenë e lehtë kjo gjë, se unë jam i gëzuar që ndodhi kështu. E pra dije se herë herë kam një pikëllim aq të madh pse rrodhën kështu ngjarjet, sa nuk mund ta përfytyroj askush. Nuk e ndjej tokën nën këmbë, më duket vehtja pa mbështetje, si në hava. Të më besosh se edhe unë dua të jem si atëherë, si ti tani, por dëshirat e mia janë të kota, të perealizueshme. Më kujtohet një herë kur po bënim operacion në brigjet e Himarës. Partizanët kishin kapur një oficer gjerman të plagosur dhe njëri e goditi me grusht. Arrita tamam në atë çast, kur oficeri i rrëzuar përdhe, iu afrua stemës së nazizmit në kapelë dhe e puthi. U çudita. U dhashë urdhër partizanëve të mos e preknin me dorë, ta mjekonin dhe pasdite të ma sillnin mua.

Shtabi kishte zënë vend në një shtëpi pasaniku dhe aty ma sollën gjermanin. I thashë me të mirë të ulej dhe e pyeta: "Ju pashë në mëngjez që puthët kryqin e thyer. Nuk kuptoni se ai kryq i thyer i Hitlerit ju shpuri në katastrofë? Kjo tani duket shumë e qartë!" Gjermani heshti pak dhe pastaj u përgjegj: "Djalosh, jini fort i ri dhe ndofta nuk kini rënë kurrë në dashuri, prandaj nuk e di a do të më kuptoni. Kush dashuron vërtetë, kur e dashura i del e pabesë, diziluzionohet, dëshpërohet, por vazhdon ta dashurojë. Ne i besuam Hitlerit ëndrrat tona më të shtrejta, ne u rritëm dhe u brumosëm me të dhe tani e shohim se gjithshka ishte iluzion, gënjeshtër, gabim fatal. Ne i ishim dhënë me shpirt një ideje, ashtu si djaloshi i ri vajzës së tij dhe tani që u gënjyem, nuk na mbetet tjetër veçse të varrosemi bashkë me të." Atëherë nuk e kuptova, por tani i jap të drejtë gjer në një farë pike. E ta dish se e ndjej vehten fatkeq që nuk jam si ai gjermani, që nuk shkoj dot në varr bashkë me iluzionet e mia.

Hyseni kishte marrë një pamje shumë të trishtueshme, sytë e tij gati ishin mbushur me lotë. Dukej se ai vuante dhe shprehej sinqerisht. Besniku u trondit.

Kaq vite që rrinin bashkë dhe nuk ia kishte marrë mendja kurrë se shoku vuante për shkak se ishte shkëputur nga komunistët. I ishte dukur gjithmonë se Hyseni kënaqej që ishte kundërshtar dhe i pakënaqur ndaj regjimit të ri dhe ja tani zbulonte se kjo nuk ishte e vërtetë.

Me kaq ata e lanë bisedën. Besniku u ngrit, doli dhe po shkonte i trishtuar në shtëpi. Megjithëse ora kishte kaluar nga dy e gjysma, nuk ndjente uri.

Ai e mbante mend vehten gjithënjë me ëndrra, që kishin ndryshuar sipas moshës dhe jetës që bënte. Çfarë veprash të mëdha nuk kishte shpresuar që do të kryente, gjersa më në fund kishte menduar se rruga e vetme e tij ishte letërsia. Kishte shpresuar se në letërsi do të arrinte të krahasohej me gjenitë. Ai nuk kishte menduar se ishin krejt gjëra të ndryshme të fantazojë veten shkrimtar i madh dhe të bëheshe i tillë. Në shumicën e rasteve i kishte pandehur ëndrrat si peng i pakundërshtueshëm i një të ardhme të madhe. Të ndahej nga ëndrrat atij iu duk një tragjedi e madhe, po u detyrua ta përfytyronte vehten si njeri i zakonshëm. Përfytyrimi i kësaj jete pa përpjkeje për diçka të madhe iu bë vdekje për së gjalli, fatkeqësi aq e madhe, sa iu mbushën sytë me lot. Iu kujtua se i kishin rrëfyer që një partizan i hidhëruar për diçka ishte hedhur në sulm me dëshirë që të vritej dhe ishte vra. Nuk dyshoi aspak se po të kishte betejë për rreth, do të sulmonte për të gjetur vdekjen. Kishte bindje se i pëlqente vdekja më tepër mga një jetë e rëndomtë, se nuk e vriste veten vetëm se kështu do të tregohej i dobët. Ai pati iluzionin se ishte një heroizëm i vërtetë që vullnetarisht do të duronte një jetë të zakonshme. Kështu përsëri vijoi ta konsideronte vehten hero, megjithëse nuk do të krijonte asgjë të jashtëzakonshme dhe heroike.

Disa herë atë e thirri Osmani dhe pasi e shkundi nga mendimet, i foli me të qeshur:

-Ç'ke kështu? ... Sikur nuk je në Tiranë... dhe po i bie fluturim universit me pras në dorë. Mirë, mirë, vijo, por ruhu mos të përplasesh me ndonjë satelit. Udhë e mbarë dhe mirëardhsh në tokë.

Osmani kaloi. Besniku e quajti shokun të cektë, të ngushtë, sa meritonte përbuzje se gjoja nuk arrinte të kuptonte kurrë hidhërimin e tij të madh.

Po ecte rrugëve pa drejtim gjithënjë me këto mendime në kokë, kur dëgjoji se dikush e thirri prapë. U kthye mënjanë dhe pa se përballë tij qëndronte Luiza. Ajo nuk ishte vajza e lezetshme dhe çapkëne e dikurshme, që e thirrnin "Zenfira", që e mbushte konviktin me gaz e shaka. Fytyrës së saj i kishte ikur njomësia dhe

shkëlqimi rinor, lëkura i dukej si e rrudhur dhe e vjetëruar. Ishte tretur shumë sa i dukeshin nofullat e dala. Vështronte shtruar, e menduar, drita e bebëzave të syve i ishte venitur. Lëvizte si e lodhur, si e vrarë nga një natë pa gjumë. Buzët e saj nuk e kishin freskinë e parë, prandaj ajo i kishte ngjyrë me të kuq. Besnikut iu duk se i kuqi i buzëve përmblihte gjithë historinë e dashurisë së dikurshme, sikur shprehte venitjen, lutjen e saj që të gjente një copë burrë, sikur e ftonte atë të pranonte dështimin në jetë, prandaj e ndjeu krejt të huaj të dashurën e dikurshme dhe nuk i erdhi aspak mirë që e takoi.

Luiza javën e fundit e kishte përfytyruar e tronditur lumturinë e çastit, kur do të takohej me Besnikun. Sa kishte zbritur në stacion, kishte hedhur sytë për ta kërkuar dhe çdo hap e kishte bërë me shpresë se mos e shihte. Tani, sa e pa, s'ju prit, e thirri dhe gjithë qenia e saj u gjallërua, zemra iu ngroh, sikur i lëshoi rreze në trup. E ndjeu vehten të lumtur dhe kujtoi se pak a shumë kështu duhej të ndodhte edhe me Besnikun. Por e kuptoi menjëherë se kishte gabuar. E kapi ftohtësinë e tij dhe zemra iu drodh. Ata u përshëndetën thjeshtë, këmbyen ca fjalë të rëndomta dhe filluan të ecin bashkë.

Pas disa pyetjeve dhe përgjigjeve të zakonshme, të thata, heshtën, sikur iu menë fjalët. Pranë u kalonin shumë njerëz dhe mes tyre vajza të bukura dhe të reja. Ishte stina e verës, prandaj femrat ishin veshur me lloj lloj fustanesh me ngjyra të shëndritshme e të prera sipas modeleve të ndryshme duke lënë jashtë pjesë trupit që sigurisht i ngacmonin meshkujt. Luizës iu ngushtua zemra, sikur diçka e shtryhte në gjoks. Asaj i erdhën në mendje ato dyshime që e brenin si krimbi sa ia grisnin të ardhmen si copa letrash të panevojshme. E dinte se Besnikun mund ta pëlqenin femra të tjera të reja e të lezetshme, që ishin të tilla si kishte qenë ajo dikur dhe se ai me të drejtë mund të tërhiqej prej tyre dhe ta neveriste atë që ishte tretur nga vuajtjet, që ishte grua e divorcuar me një fëmijë pas. Po Luiza e dashuronte Besnikun dhe i dukej se asnjë femër në botë nuk mund ta dashuronte si ajo, se nuk mund t'i jipte aq lumturi sa ajo dhe e ndjeu vehtem superiore me të gjitha ato femra të freskta që kalonin rrugës.

Besniku sikur i nuhati mendimet e Luizës, prandaj nuk i sodiste me aq kureshtje femrat që kalonin dhe tha me vehte. "Nuk jam aq i lehtë sa të tërhiqem pas çdo femre të bukur. Këto femra i njoh shumë mirë. Janë të cekta dhe aspak nuk e ndezin zemrën time. Unë dua dashuri të vërtetë, e cila nuk egziston."

Kështu arritën në park, u ulën në një stol dhe Besniku mendoi t'i jipte përgjigje

Luizës për letrën që i kishte dërguar para një muaji, ku indirekt i kërkonte të martoheshin bashkë. Gjatë këtyre viteve ai kishte patur edhe çaste dëshpërimi dhe tani në këtë gjendje i përgjithësoi to, sikur vetëm trishtimi kishte mbretëruar në shpirtin e tij, sikur kishte ndryshuar rrënjësisht. Duke i besuas pak a shumë këtyre gjërave, ai i foli të dashurës:

-E shoh të arësyeshme të bëj një skjarim, sidomos pas asaj letre që më kishte dërguar. Ne nuk duhet të gënjejme vehten dhe duhet ta kemi të qartë se e kaluara nuk kthehet më. Mos u prek. Do të flas hapur. Unë jo vetëm nuk të dashuroj ty apo ndonjë vajzë tjetër, por as nuk besoj fare në dashuri. Tani jam i ftohtë akull, jo vetëm ndaj teje, por edhe ndaj çdo femre në botë. U bënë kaq vite që jemi ndarë dhe në shpirtin tim nuk ka lindur shkëndija më e vogël e dashurisë për cilëndoqoftë. Dashuria për mua ka qenë një ëndërr e cila u zhduk së bashku me ty. Diziluzioni ndaj teje ndofta më theu, ndofta rastisi që të takohemi dhe të ndahemi tamam në atë kohë, kur zemra ime do të ftohej. Nuk di se si ta spjegoj. Shpesh kam dashur të lidhem me ndonjë vajzë, por pastaj kam thënë i dëshpëruar: "Pse bëhem budalla? Cila femër mund të më dashuroi mua, gjersa më tradhëtoi edhe Luiza?" Dhe ndjenjat e mia janë mpirë menjëherë. Kjo është e gjitha. Ndofta më vonë edhe mund të martohem, por martesën do ta bëj pa dashuri, si shumica e ndofta gjithë njerëzit e kësaj bote. Pastaj ndofta do të më lindin fëmijë. Thonë se jata pa fëmijë është e zbrazët. Ndofta... Kush e di? ... Po me ju nuk mund të bashkëjetoj pa dashuri, se do të më kujtonit në çdo çast diziluzionin tim.

Heshtje një hop dhe pastaj ai shtoi:

-Besoj se u skjaruam..... Gjithshka është në perëndim... .

Kështu i foli Besniku të dashurës së tij në këto çaste të turbullta dhe kishte një farë besimi se thoshte të vërtetën. Një çast iu kujtua Jorgjeta dhe ndjeu atje thellë diçka të gënjeshtër dhe hipokrite. Ndofta edhe vetë fakti se përfytyronte katastrofale martesë me Luizën, e shtynte të shprehej ashtu.

Luiza u habit së tepërmi nga këto fjalë dhe nuk i bëhej t'i besonte. Ishte gati të thoshte se ai e gënjente, por pamja, zëri, qëndrimi i përshteteshin fjalëve. Nuk kishte se si ta shpjegonte këtë sjellje. Sipas saj ai ishte një djalosh i zjarrtë, plot dëshira, optimizëm, dashuri, plot vendosmëri dhe besim në jetë. Kishte qenë e bindur gjithmonë se i dashuri ishte njeri me zemër të pastër, të bardhë, i jashtëzakonshëm për virtytet dhe nuk kishte se si të pandehte ndryshe, kur në kujtesën kishte fort të gjalla skenat e dashurisë së atëherëshme, sikur i tingllonin akoma në vesh fjalët e zjarrta që thoshte i gjunjëzuar para saj. Të tillë e kishte

njohur në çastet e vështira. Po tani ky djalosh i fliste gjëra krejt të ndryshme nga ato që kishte ëndërruar. U turbullua, nuk dinte ç'të thoshte, prandaj u ngrit të shkonte dhe pëshpëriti nëpër dhembë:

-Sikur të bindesha se thua të vërtetën dhe je tamam i tillë, do të ishte shumë e lehtë për mua.....

Me qaq e qepi gojën dhe u ndanë duke i dhënë dorën ftohtë njeri tjetrit.

Luiza e piklluar arriti në shtëpinë e vëllait, hyri në dhomëm ku flinte dhe u plas në kolltuk me fuqi të prera. Një çast ndenji ashtu e hutuar, pa menduar asgjë. Pastaj, si u kthjellua diçka, filloi të analizojë fjalët e tij që po i shkatërronin ëndrrat. Donte të zgjidhte në ishin të vërteta ato fjalë, në ishte vërtetë ai pesimist.

Iu kujtua çasti, kur pikërisht në këtë dhomë i kishte lindur një shkëndijë e vogël shprese se në të ardhmen mund të martohej me të. Kjo kishte ndodhur në periudhën më kritike të jetës, kur ajo kishte ardhur në Tiranë që ta detyronte të shoqin ta njihje fëmijën. Ai, duke përfituar që nuk kishin bërë celebrim, i kishte shfryrë: "Çoje ne befortrof se nuk e ke me mua, por me atë dashnorin tënd." E mbante mend fare mirë se kishte hyrë në këtë shtëpi me zemër të mgrirë. Vëllai e kunata pothuajse ishin llahtaritur kur e kishin parë me foshnjën në krah. Ajo nuk i pat lajmëruar fare për lindjen. Pastaj, pasi u kishte spjeguar me hollësi gjithshka, e kishin vështruar me qortim si fajtores duke dyshuar se mos vërtetë e kishte fëmijën me dashnorin. Për herë të parë në jetë ajo kishte ndjerë ftohtësi ndaj vëllait, e kishte vështruar si të largët, fare të huaj. I ishte dukur kjo shtëpi sikur po e hante. Do të kishte preferuar të flinte në hotel, po mos e konsideronte turp të madh.

Iu kujtua se atë ditë kishte takuar shumë shoqe të veta, të cilat ndofta e bënin shumë fajtores dhe shprehnin keqardhje sa për sy e faqe. Atëherë të gjithë njerëzit i kishte quajtur të këqij, pse e dënonin pa faj, se së paku as e mishëronin dhe e kishte ndjerë vehten krejt të vetmuar. Pikërisht në këto çaste i kishte ardhur një shok dhe i kishte thënë se Besniku ishte shumë i piklluar nga fatkeqësia e saj dhe se dëshëronite ta takonte. Ajo ishte tronditur, ishte skuqur. Nuk kishte pandehur kurrë që ai do të sillej ashtu. E kishte refuzuar një herë takimin, se e kishte gjykuar pa kuptim, por tjetri kishte ngulur këmbë dhe ajo më në fund kishte pranuar.

*Ishin takuar me Besnikun në mbrëmje, kishin ndenjor bashkë një çerek ore dhe pastaj ai e kishte pyetur: "Pse më braktise atëherë, Luiza?!" Dhe ajo ishte përgjegjur: "Unë i lava të gjitha." Ai nuk e kishte qortuar më gjatë dhe i kishte thënë: "Po pate nevojë për mua, drejtomu." Dhe ata ishin ndarë. Ishte kthyer tamam si tani në këtë dhomë. Aty pranë dritares kishte qenë foshnja e saj dhe ajo e kishte*

parë me gëzim, me një shkëndijë të vogël shprese se i dashuri mund të rregullonte jetën e atyre dy femrave.

Dashuria pas atij takimi i ishte përtëritur dhe filloi ta konsiderojë atë si njeriu më të mirë në botë. Dhe ky njeri tani i kishte folur në një gjuhë të çudiçme, të pakuptueshme. Ajo e pyeti vehten në mos vallë ai kishte ndryshuar pastaj. Iu kujtua se ai vetë e kishte kërkuar para tre vjetëve në Berat, i kishte folur me dashamirësi, kishte pranuar të shkëmbejin letra, megjithëse më vonë e kishte ndërprerë korespondencën. Ajo kishte qenë e bindur gjithmonë se Besniku thellë e dashuronte, prandaj në Berat, në shtëpi, në rrugë, në klasë para fëmijëve, përfytyronte takimet, bisedat, sjelljet, jetën e atij, dashurinë e përbashkët dhe i dukej se ndryshonte nga gjithë bota, se ishte i gjërë pa paragjykime, se ishte i drejtë dhe shumë i dashur. Herë herë re të zeza mbulonim shpresat e saj, por pastaj shpejt daraviteshin. Sa më tepër kalonte koha dhe qetësohej, aq më e gjallë bëhej shpresa e vakët e bashkimit me Besnikun, derisa më në fund ajo ndriçonte vazhdimisht ditët e zymta.

Në dhomë hyri kunata. Luiza e fshehu thellë në shpirt vuajtjen, buzëqeshi sikur nuk kishte asnjë hall dhe bisedonte gjithë qejf. Vitet e fundit kishte mësuar të paraqitej ndryshe nga ç' ishte për mos të ngjallur mëshirën e njerëzve, për të mos gëzuar ata, që sipas asaj, e kishin mëri. Më vonë erdhi dhe vëllai. Si hëmgrën darkë, u ngritën të flinin. Luiza hyri në dhomën e vet dhe prapë i erdhi në mendje Besniku. U zhvesh, ra të flinte, po gjumi nuk po e zinte.

I sillej në mendje e kaluara, ëndrrat dhe i dukej se jeta po i futej prapë në greminë. Po ajo donte të jetonte, të krijonte familje, të ishte e lumtur bashkë me Kozetën. Nuk donte të besonte se Besniku ishte ndryshe nga ç' e kishte pandehur. Përpëlitej në dyshek, përpiquej të gjente rrugë dalje dhe iu bë një çast sikur po loste menç. Pati frikë. U ngrit në këmbishë dhe ndezi dritën. Hodhi sytë në tryezë. Duke parë aty librat e saj, fletoret, stilografin, befas vendosi t'i hapte zemrën të dashurit. Kurrë nuk i kishte shprehur atij dashurinë, ashtu si e ndjente. Tani që ai e kishte refuzuar kategorikisht, e quajti të nevojshme të derdhte gjithë afshin e zemrës.

U ul në tavolinë, mori penën dhe shkroi ç' i thoshte zemra, pa gjykuar shumë, ashtu turbull, pa u kujdesur as për piksimin.

"I dashur Besnik, kam rënë të flë, po gjumi nuk më zë. Vërtitem nga të gjitha anët, nxjerr dhe fut duart në rrobat, mbulohe dhe zbulohem, mëndjen e kam të turbull dhe më duket sikur po los menç. U ngrita në mes të natës dhe për t'u



qetësuar, vendosa të bisedoj me ty, me penën dhe fletën e fletores. Nuk po të shkruaj unë, Luiza, se ti thua nuk më dashuron, por zemra ime, mendimi im, që është drejtuar vetëm te ti. Bile as ty nuk po të shkruaj, por zemrës tënde, se ato mund të mirren vesh me njëra tjetrën.

Sa e lumtur kam qenë dikur. Nuk dija ç' ishte brënga, psherëtima, lotët, por ç' e do, se pastaj u desh të njiheshim bashkë, të dashuroja aq shumë, të vuaja dhe pastaj të shkatërrohesh përsëri. Dhe si shpërblim dëgjova fjalët që nuk mund t'i besoj se i ke thënë ti. Vuajtjet e mia nuk duhej t'i shpërbleje kështu.

Besnik i shtrejtë, a më kupton apo jo? A do të gjejë vallë qetësi, gëzim shpirti im? A do të m'i falësh ti mua ato? Unë çuditë se si nuk i meritoj, kur kam vuajtur, vuaj për ty, megjithëse gabova një herë në jetë së bashku me ty. Mos vallë qenka i pafalshëm njeriu, kur ndjen, premtion? Ti Besnik më ke dënuar mua me vdekje, sepse nuk thellohesh të kuptosh shpirtin tim, ëndrrat e mia në lidhje me ty. Ti nuk kupton se ke hyrë thellë në zemrën time, se ngado që shkoj të shoh ty, të kam pranë, konsultohem. Pra unë nuk e meritoj këtë dënim, Besnik, ti nuk je një gjykatës i drejtë.

Do të çuditëse, po të më shikojë në këto çaste me lot në sy. Ti nuk më ke parë kurrë kështu. Po këto janë lotë gëzimi që shpërthejnë nga shpresa që kam në ty, ty të përkasin. Luiza."

Ajo e shkroi, u çlirua, sikur ajo letër do t'i rregullonte jetën. U shtri me mendimin se të nesërmen pa e rilexuar fare, do t'ia postonte në fshat, ku Besniku do të nisej qysh atë natë dhe e zuri gjumi.

### III.

Besniku u kthye në Lals. Hyri në dhomë, ndezi dritën, u shtri sipër krevatit pa u zhveshur dhe po rrinte ashtu duke menduar se sa ëndrra kishte përkëdhelur dy ditë më parë dhe sa i dëshpëruar ishte tani. Tek dergjej ashtu i piklluar, dëgjoi se dikush fërshëllente. Vuri vesh dhe dalloj se fërshëllima ishte shumë e hollë, si prej femre. U çudit se ç'donte femra para dhomës së tij, kur ora po shkonte dhjetë. U ngrit, çeli derën, por jashtë ishte errësirë dhe nuk dalloj asgjë. Po vinte një makinë dhe nën dritën e saj vuri re një femër, të cilën e kishte parë edhe një herë dhe i

kishte bërë përshtypje bukuria, veshja elegante e saj. Ishte habitur kur i kishin treguar se ajo ishte nga ato.

Ai qëndroi disa çaste në prak të derës me fytyrë nga ajo. Vajza e vuri re, iu afrua ashtu si kot dhe i foli:

-Hyr brënda se ftohe.....

Besniku u përgjegj pa u menduar:

-Edhe ti mund të ftohesh... .

Ajo u afrua. Duke dashur të gjej shkak të hyjë në bisedë, e pyeti:

-Ke pak ujë?

Besnikut iu drodh trupi plot kënaqësi mga epshi dhe u përgjegj:

-Si jo...

U fut brënda, ngriti shtamën në çip të dhomës dhe po mbushte gotën.

Ajo qëndroi një çast në prak. Pastaj hyri në dhomë pa teklif dhe hodhi sytë për rreth. Shprehu habinë se si nuk kishte frikë që rrinte vetëm dhe mori gotën e po pinte.

Djaloshi e vështroi me epsh. Femra ishte e lezetshme, e pastër, e veshur mirë, me trup të hedhur, me buzë të freskta dhe sy tërheqës. Atij iu err mendja dhe posa ajo mbaroi së piri ujë, iu sul i tronditur. E përfshiu dhe e puthi në buzë, në sy, në ballë, në faqe. Tek e puthte, habitej se ndjente po atë shije të ëmbël, atë kënaqësi, që kishte provuar edhe me vajzat, të cilat sipas tij i kishte dashur marrëzisht

Femra u tremb pak se ai iu hodh me furi, me sy të çakërritur, si i çmendur, sikur donte ta coptonte fare, se e përplasi në shtrat, sikur donte ta mbyste.

Pastaj ai e lëshoi, mbylli derën, dritaren, fiku llampën dhe iu hodh prapë. E shtrëngoi në krahëroë, e puthi, e përkëdheli dhe i foli me zë të ulët, të ëmbël, dashamirës:

-A më dashuron?

Kjo pyetje e çudiçme tregonte se djaloshi u zbut, prandaj ajo u qetësua. E kishte parë disa herë mësuesin, e kishte pëlqyer, por nuk kishte guxuar t'i afrohej se i dukej shumë i rregullt e serioz. Kurse tani ai po e pyeste në e dashuronte atë. Dhe ajo u përgjegj prerë:

-Jo... Nuk të dua.

Besniku u mpi nga kjo përgjigje saktë dhe e ftohtë. I dhëmbi shpirti se asnjë, qofshin edhe nga ato, nuk e dashuronte. Ai nuk e shtrëngoi më, nuk e puthi dhe po ngrihej që ta linte të qetë femrën. Bindja e tij kishte qenë gjithëmonë se nuk mund të puthte një femër, cilado që të ishte ajo, nëqoftëse nuk dashurohej prej saj.

Por ajo që kishte ndenjtur gjer tani si trung, kur e kuptoi se djaloshi po çohet dhe po e lironte, i hodhi krahët, e tërhoqi drejt vehtes, e pushtoi, e shtrëngoi, e puthi me afsh dhe filloi t'i ndukte gjoksin pa ndrojtje e turp që t'i ndizte epshin. Djaloshi u çudit se nuk i kishte ngjarë kurrë kështu. Befas iu ndez gjaku dhe jetoi disa çaste i kapërthyer fort nga epshi.

... Besniku u hoq mënjanë i turbulluar, i vrarë shpirtërisht. Ajo në fillim kujtoi se djaloshi po mirrte ndonjë gjë që të fshihej, prandaj qëndroi e shtrirë, e palëvizur. Por, kur dëgjoi rënkimin e tij, u çudit, iu afrua dhe e pyeti kurioze:

-Cfarë ke?!

Ai nuk u përegjegj dhe e shtyri. Nuk ishte i ndezur dhe veprimi që bëri iu duk i ndyrë dhe vehtja e poshtëruar. Atij përsëri iu kujtuan ëndrrat më të mëdha. Nga mosha njëmbëdhjetë vjeçare e gjer në atë çast, për gati njëzet vjet, kishte ëndëruar femër të përsosur, dashuri të lartë si askush, vepra të lavdishme, emër të nderuar, të pavdekshëm mes popullit të vet. Ai mendoi se më kot e kishte pandehur vehten të dalluar mes njerëzve, të caktuar për të bërë diçka të madhe. Tani po e shihte vehten të zhveshur nga lulcat, në llum dhe nuk ishte së paku as njeri i rregullt, i ndershëm si zakonisht gjithë të tjerët.

Ajo, të cilës nuk ja mirrte mëmdja kurrë se ç'bluante djaloshi dhe me që iu dhemb se e shihte që po vuante vërtetë, e pyeti me zë të ëmbël:

-C'ke kështu? Pse mërzite?

Kësaj here nuk dëgjoi të largohej, iu ngjit pas trupit dhe po përpiqej ta ngushëllonte, ta gëzonte me përkëdheljet, me puthjet e fjalët esaj. U bë edhe kurioze pse vuante ai djalë që e kishte kapur aq befasisht. Duke e lëmuar, dora i vajti te qimet e gjoksit dhe i tha:

-Sa shumë paske!

Besniku qeshi hidhur duke menduar se ku e kishte mëndjen ajo e ku ai. Vajza pandehi se e gjeti pikën e dobët dhe filloi ta guduliste. Por nuk e bëri të qeshë më. Përkundrazi. Ai u largua dhe i kërkoi:

-Më lë të qetë.....

Atëherë ajo u tërhoq që mos ta mërziste dhe rrinte ashtu pa zë. E ndjente vehten të fyer, por i vinte keq edhe për mësuesin. Duke nuhatur turbull shkakun e asaj dhëmbje, i foli për ta ngushëlluar:

-Pse mërzite?! Nuk bëre ndonjë gjë kushedi se çfarë, të turpshme, por diçka

natyrale, të nevojshme për trupin. Nuk po të kuptoj pse hidhërohesh kaq shumë

Besnikut i bëri shumë përshtypje se ajo kërkonte ta ngushëllonte me përkëdhelje, me shaka, se e pyeste butë, se i përgjigjej me ëmbëlsi dhe se tani arësyetonte në mënyrë të çudiçme. Ai nuk mund t'i rrefente asaj për ëndrrat e veta dhe zhgënjimet, se kishte mundësi t'i dukej qesharak dhe i çmendur, por prapë ndjeu nevojën t'i shprehte diçka sinqerisht dhe i foli:

-E kam ëndërruar jetën ndryshe. Gjer sot nuk kam puthur kurrë një femër që nuk e kam dashur dhe tani... .

Ajo iu afrua, e përkëdheli dhe qeshi. Po gëzohej me hidhërimin naiv të këtij djali. Nuk pandehte kurrë se do të haste ndonjëherë ndonjë burrë që do të trishtohej diçka tamam si ajo, kur ishte zhvirgjëruar. Sjellja e tij iu duk qesharake, foshnjarake, por prej njeriu të mirë. Ai po i fliste butë. Nuk e përlpuste si të tjerët. E largonte ngadalë që mos ta fyente. I hapte zemrën si motrës, si të dashurës. Turpërohej para saj aq shumë sa muk qante.

-Sa i çuditshëm qenke! -I foli ajo sinqerisht-Pse bëhe merak kot? Unë aty po prisja një inxhinier që të më mirrte me motorr. Ai ka në Tiranë grua, një fëmijë të vogël dhe unë flë gati çdo natë në dhomën e tij të ndërmarrjes. Ai nuk e çan kokën fare. Kështu ngjiet me të gjithë. Kurse ti je beqar, ke nevojë të domosdoshme për femër. Ti shyqyr që më takove dhe hidhërohe! ..., . Sa i çuditshëm!

Besniku psherëtiu prapë, i vinte keq për ëndrrat dhe i foli:

-Ndofta të tjerët kanë të drejtë, ndofta unë jam budalla. Por nuk mund të jem ndryshe.....

Ajo heshti një hop dhe mendoi se mos vërtetë ai ishte budalla dhe kishin të drejtë ata që tradhëtonin gratë, fëmijët, që dëfreheshin me të dhe pastaj e paguanin? Megjithëse me ata njerëz ishte lidhur ngushtë përkohësisht rehatia, gëzimi, koha, shpresa, shoqëria, ajo ndjente jo rrallë se i kishte inat, se po të ishte e rregullt, nuk do të kishte dashur të mirrte për bashkëshort asnjë prej tyre. Bile herë herë i urrente ata si armiq. Shpesh vetëm zakoni, rrjedhja e ngjarjeve, e detyronte të shkonte pa dëshirë në krahët e tyre. Dhe ajo u përgjegj:

-Jo, ti ke të drejtë,ti mendon thellë, tamam si njeri. Ata janë të cekët dhe nuk vështrojnë larg.

Asaj iu kujtua se ai në fillim e kishte pyetur në se e dashuronte. Këto fjale i ishin dukur të çuditshme, pa kuptim dhe i ishte përgjegjur ftohtë:"Jo. . Nuk të dua", por tani po kënaqej që e kishte pyetur ashtu. Ajo tani po e përkëdhelte butë, ëmbël, plot dashuri. Edhe Besniku e ndjeu shumë të afërt dhe i qau hallin:

-Sot kam përzënë një vajzë, e cila më dashuron prej vitesh.....

Ajo u gjallërua dhe e pyeti:

-Po ti e dashuron atë?

-Po... E dua... -Ai i lëshoi ashtu si kot këto fjalë.

-Po pse e përzure?!

-Ashtu është historia jonë.....

Ajo heshti një hop dhe pastaj pyeti:

-Eshtë e bukur ?

-Ka qenë shumë e bukur, por tani ka rënë se ka kaluar ngjarje shumë të hidhura.

-Ka shkollë kështu si ti?

-Po...

Ata heshtën të dy një copë herë dhe pastaj ai i foli:

-Eshtë e para herë dhe e fundit. Me mua kurrë nuk do të takohesh më. Më kupton?

-Po. . -U përgjegj ajo me buzë në gaz.

-Tani nuk di se si të them. . Zakonisht në fund. . Më falni... Ju japin para...

Vajza buzëqeshi hidhur, se ai kishte turp të zinte në gojë paratë, kurse të tjerët me ato e fillonin që t'ia prishnin mëndjen. Tani nuk mendoi fare për pagesë. Ishte shumë e kënaqur se i dukej djaloshi si dashnor dhe pyetja e tij ia shoi diçka harenë në shpirt. Por prapë u përgjegj me zë të ëmbël:

-Nuk dua... Po deshe, më dhuro një libër. . Të jetë i bukur, të flasë për dashuri...

-Mirë- U përgjegj ai.

Mori në raft romanin "Martin Iden" të Xhek Londonit dhe desh të shkruante një shënim si kujtim, prandaj e pyeti:

-Të shkruaj diçka?

-Jo. . -Refuzoi ajo-E shohin të tjerët. . Po shkoj që të lë të qetë. Ti mos u mërzit...

Hapi derën ngadalë, i shtrëngoi dorën me përzemërsi dhe i foli me të butë:

-Natën e mirë! . . Qetësohu! ... Unë po iki...

Ajo doli nga dhoma. Dera u mbyll. Ai ndezi dritën dhe vështroi shtratin e tij. Nuk shtrihej dot. I dukej se vinte një erë e ndyrë, e padurueshme. I shkundi rrobat, derdhi një shishe kolonjë dhe pastaj ra të flerë. Por nuk zinte rehatë, sikur e hanin çarçafët.

## IV.

Kur u zgjua të nesërmen, dielli kishte lindur me kohë. Para tij ishte fusha e gjërë. Në arë zverdhëllonte gruri dhe jeshilonin degët e pambukut. Fshatarët po rregullonin një urë. Ca gra po prashitnin. Gjithshka këtu në fshat ecte si zakonisht. Kërkush nuk dinte gjë për atë vuajtje që kishte patur një ditë më parë. Edhe ai u ndje ndryshe. Ishte i kthjellët dhe jeta nuk i dukej e zezë si të djeshmen. Kujtoi se kishte vendosur të hiqte dorë nga letërsia dhe papritur e pyeti vehten: A nuk ishte turp të dorëzohesh? A nuk i pëlqenin karakteret e fuqishme, të pampushtur? A nuk kishte dashur t'u mgjante atyre? Bile, a nuk kishte deklaruar në intermim se ishte i fortë, se nuk përkulej? Ai mendoi se bëhej qesharak, kur vuante për vepra që nuk egzistonin akoma. Duhej t'i krijonte një herë dhe pastaj të shihte a i shërbenin detyrave aktuale të socializmit apo jo.

Por për t'i shkruar ato vepra, parandjeu se do t'i duhej një punë e madhe. Solli në mendje vitet e kaluara plot përpjekje dhe e pyeti vehten në e vlente barra qiranë të vijonte. Ndjehej ca i lodhur. "Pse po përpiqem? Pse po mundohem kaq shumë? -Tha me vehte-Për lavdinë time? Për rehatin tim? Sa gjëra qesharake, meskine dhe poshtëronjëse! Duke synuar drejt artit, unë kam shkruar deri në intermim. Por kur njeriu ka mundësi të bëjë diçka të dobishme dhe nuk e bën, poshtërohet, në një farë mënyre tradhëton vehten dhe njerëzit. Nuk do ta pranoj kurrë poshtërimin, tradhëtinë! Po a do t'u shërbejnë njerëzve veprat e mia? Po, për vepra arti njerëzit kanë shumë nevojë.

"Unë kam ndjerë këtë në vehten time. Gjithmonë, kur kam lexuar "Hamletin", "Faustin", "Martin Iden", "Iliadën", "Si u kalit çeliku" e kam ndjerë vehten ndryshe, botën e kam kuptuar dhe e kam dashur më shumë. Kështu sigurisht ndodh edhe me të tjerët, së paku me ata njerëz që më mgjajnë mua. Pra vlen të përpiqesh që së paku disa njerëz të kombit tim t'i mbush me entuziazëm e dashuri për jetën. Për këtë qëllim vlen të vuash, vlen bile edhe të dështosh duke synuar drejt tij. Unë do të vijoj! Nuk do të lodhem, gjersa të të kem fuqi në dejet e mi, gjersa të vdes! ..."

Ai s'ishte më i hidhëruar. Trishtimi që e kishte munduar një ditë më parë

sikur nuk kishte qenë fare, sikur kishte kaluar pa gjurmë. U çudit se si kishte kërkuar vdekjen, kur bota ishte kaq e bukur, kaq e gjërë.

Pas tri ditësh vendosi të fillonte nga puna krijuese. Atë mëngjez i trokiti në derë postieri dhe i dorëzoi letrën e Luizës. Ai e hapi i pakënaqur dhe e lexoi shpejt e shpejt, pa u thelluar. U trondit në disa vende, por në përgjithësi letra iu duk artificiale, e gënjeshtër, me qëllime të caktuara. E la mënjanë dhe nisi të lexonte tregimin "Në burg", të cilin shokët e kishin pëlqyer shumë dhe desh të kuptonte se çfarë gjëje të veçantë kishte ai.

Besniku i përpiu faqet e para. Pastaj ndali i çuditur dhe po mendohej. Ai zbuloi se kishte përshkruar me saktësi, në lëvizje, në ndryshim botën shpirtërore të fëmijës, se kishte zbërthyer qartë dialektikën e shpirtit të tij, tamam ashtu si e kishte përcaktuar Cernishevski për veprat e para të Tolstoit. U krrus, lexoi më tej dhe pastaj e la. Nuk kishte nevojë të vijonte më tutje. E pati të qartë se ç'gjë të veçantë kishte tregimi. Mori tregimet e tjera po me ngjarje nga fëmënia e tij dhe po i shfletonte. Edhe ato Hyseni i kishte kritikuar pse ishte përpjekur të vertetonte një ide të caktuar qysh në fillim, pse edhe aty jeta dhe personazhet nuk zhvilloheshin lirshëm. Ai u bind se kritika ishte e drejtë. Duke dashur të paraqiste fëmijën trim, besnik, plot cilësira të larta, kishte fshehur ca të meta, ca lëkundje dhe në disa vende ia kishte zmadhuar artificialisht vetitë. E përfytyroi fëmijën realisht, megjithë kompleksitetin e ndjenjave dhe të mendimeve, të veprimeve. E la të veprojë e të mendojë mirë a keq, krejt sipas psikologjisë së tij dhe u çudit se si ngjarjet zhvilloheshin vetvetiu me lehtësi, vertetësi dhe bukuri, tamam si me magji. Pa pritur erdhi në përfundim se në bazë të atij materiali mund të shkruhej një roman.

Pastaj atij iu kujtuan ngjarjet e viteve të fundit. U ngrit dhe qëndroi në mes të dhomës. Mendoj se në shpirtin e tij kishin ndodhur procese psikologjike të tilla që mund t'i analizonte si ato të fëmijës, që po ëndrronte ta krijonte si personazh romani. U afrua në tavolinë dhe u ul.

Përfytyroi se si mund të shkruhej personazhi në ato ngjarje që kishte kaluar vetë, si në dashuri dhe në jetën politiko-shoqërore dhe erdhi në përfundimin se në bazë të atij materiali mund të krijohet një prototip letrar. Duke e zbërthyer personazhin në mënyrë dialektike, në lëkundje e zhvillim, ai pati besim se mund të shkruante një vepër të madhe.

"Personazhet e mi-Tha ai me vehte- do të kenë esencën e karaktereve të gjalla, të cilët unë i kam marrë si model, ligjet e brëndshme të psikologjisë së tyre dhe pastaj në bazë të kësaj esence dhe të këtyre ligjeve do të zhvillohen lirshëm në

përputhje me ambientet, ku i vendos unë. Do të luftoj me ashpërsi që ndjenja e komunizmit, e patriotizmit, e drejtësisë dhe e moralit mos të më dëmtojnë në art duke e deformuar realitetin gjoja në dobi të tyre, mos t'i japin veprave ngjyra të gënjeshttra subjektivistë. Tamam ashtu si natyra mëmë do të krijoj bletën dhe grenxhën, pëllumbin e gjarpërin, djallin dhe ëngjëllin pa ndërje kënaqësi dhe neveri ndaj tyre, pa urrejtje e dashuri. Unë do ta gjej kënaqsinë e lumturinë gjatë procesit të krijimit, kur të arrij të jap qartë fenomenet e botës reale, personazhet."

Ai ndjeu kënaqësi shumë të madhe nga këto mendime i bindur se kishte gjetur rrugën e artit, që e kërkonte prej kaq kohësh. Këtu i doli problemi që kishte menduar të Hyseni. Arti i tij deri në fund realist a do të ishte qoftë pjesërisht në kundërshtim me detyrat imediatë të revolucionit? Nuk kishte asnjë dyshim se romani me ngjarje nga lufta ishte revolucionare, por ai filloi të mendojë për veprën që do të krijonte në bazë të ngjarjeve autobiografike të viteve të fundit. E përfytyroi të mbaruar, e analizoi se ç'tendecë do të shprehte dhe iu duk se do të militonte për detyrat imediatë të socializmit.

"Ajo që thotë Hyseni-Mendo ai - se socializmi nuk e do artin e vërtetë, është gënjeshtër. Unë e pranoj kritikën konkrete për tregimet e mia, por i hedh poshtë përfundimet e tij teorike. Veprat e mia jo vetëm se do të tregojnë historikisht forcën e socializmit, por do t'i shërbejnë edhe detyrave aktuale të revolucionit. Socializmi është vetë e vërteta e kohës dhe s'ka nevojë për zbukurime, për fshehjen e kontradiktave. Ai që fsheh kontradiktat e socializmit, që e zbukuron, në fund të fundit nuk ka besim të plotë në të, ka dobësi ideologjike, nuk e njeh procesin e vërtetë të jetës dhe e pengon atë."

Atij iu dukën shumë të rëndësishme këto mendime, prandaj hapi ditarin dhe i shënoi shpejt e shpejt. Pastaj, si e la penën, përfytyroi se si do të paraqitej dashuria në roman. Kujtoi me hollësi ngjarjet reale edhe me Luizën dhe në këto çaste e dashura iu paraqit në një dritë të ndryshme. E shpjegoi diçka ikjen e saj. I erdhën në mendje ashtu si të skalitura thellë në kujtesë dhe në ndërjegjen e tij fjalët që i kishte dërguar Luiza me shoqen e vet të ngushtë, ditën kur qe larguar nga Instituti.

"Vetëm një njeri kam dashur në botë dhe ky je ti. Do të vdes me kujtimin tënd në zemër. Nuk do të harroj dot edhe sikur të dëshëroj. Po shkoj të martohem me të fejuarin, po bëj diçka kundër dëshirës sime, për të keqen time. E di se po e dënoj veten, por nuk kam rrugë tjetër. Të kam thënë se jam e dobët dhe nuk e mposht dot opinionin shoqëror. Le të bëhet ç'të bëhet. Për mua nuk ka rëndësi njeri tjetër veç teje. Ta dish se të kam dashur shumë, prandaj mos më kujto për



të keq."

Ai solli në mendje se emrin Luiza e kishte gdhendur në mënyrë të pashlyeshme në faqen e një shkëmbi të lartë në brëndësi të pyllit të Lalsit dhe i erdhi keq për të dashurën. Zgjati dorën, kapi letrën që kishte marrë atë mëmgjez, e hapi, e rilexoi dhe u trondit. I besoi gati plotësisht fjalëve të saj dhe u dëshpërua që nuk e kishte përfillur, që e kishte bërë të vuante kaq kohë. Iu dukën përralla fjalët plot trishtim që i kishte thënë ca ditë më parë. Do t'i pëlqente që Luiza mos ta kishte braktisur, por prapë ai gjykoi se për atë gabim nuk mund ta përbuzte, së vërtetë kështu po tregohej tamam sipas fjalëve të saj: "gjykatës jo i drejtë."

"Do të martohemi bashkë-Vendosi ai në formë të prerë-Ajo do të jetë gruaja e ime besnike, shoku im i jetës. Martesa e saj dhe vajza e vogël nuk kanë pse të pengojnë lidhjen tonë. Nuk kam njohur asnjë femër që të më përshtatet mua më tepër nga ajo." Dhe ai ndjeu një gëzim të madhe që vendosi të martohej me Luizëm. E parashikoi se njerëzit e familjes do ta kundërshtonin këtë martesë, sidomos për shkak të vajzës së vogël, por këtë gjë e quajti krejt e parëndësishme. Po çuditej se si po zgjidheshin me lehtësi problemet që më parë e kishin munduar kaq shumë.

Si vendosi çeshtjen e martesës me Luizën, solli në mendje prapë veprat që do të krijonte dhe iu kujtua se ato do t'i aprovonin për botim Filipi, Mihali, Andrea dhe Telhai. Dyshonte shumë që ata t'i pranonin shkrimet, sidomos veprën, ku do të përshkruheshin realisht tipat e shkrimtarëve, por nuk u dëshpërua. Ai solli në mendje Aliun dhe vendosi t'ia çonte atij romanin, pasi ta mbaronte. Pothuajse ishte i sigurtë që ai do ta pranonte.

Djaloshi mori zemër nga këto përfundime dhe filloi prapë të imagjinojë skena nga romani i ardhshëm. Përfytyroi se si do të ishin personazhet e dorës së dytë dhe i dukej sikur çdo gjë e jetës i hapej si me magji në formë të vërtetë artistike, sikur jetonte në botën e artit si në botën e përrallave, sikur jeta kishte qenë plot mistere dhe po e zbulinte befas. U entuziazmua aq shumë sa desh ta fillonte menjëherë këtë vepër, por shpejt ndërroi mendje. Vendosi të shkruaj një herë atë me temë nga lufta dhe pastaj këtë me temë të aktualitetit.

Përfytyrimet e skenave të veprave që do të shkruante, i vinin njëra pas tjetrës të fuqishme, të shumta, të vrrullshme dhe të ndryshme. Ca ditë më parë kritikata e shokëve dhe zbulimi i të metave në shkrimet e veta e kishin dëshpëruar, sa kishte dashur të vdiste, kurse tani që po e shihte jetën dhe artin në mënyrë më reale, që përfytyronte pak a shumë në mënyrë të saktë ato që

do të shkruante në të ardhmen pas shumë kohe, pas shumë disfatash, e ndjente

vehten të lumtur dhe të fuqishëm, sikur veprat t'i kishte në tryezë, të gatshme për botim. Dhe në këtë gjendje frymëzimi herë herë ai kalonte krejt në botën e fantazisë. E përfytyronte vehten shkrimtar të madh, plot lavdi. Në mendjen e tij së bashku me përfytyrimet reale përzihej e vërteta dhe gënjeshtra, deri dhe përçartja maniakale.

Kështu vijonte të mendonte Besniku dhe nuk vinte re kohën, as e kuptonte se kishin kaluar gati gjashtë orë dhe kishte harruar të hante drekë. Nuk kishte uri, por prapë shkoi në klub, porositi gjellë, futi ca kafshata, por nuk i shtyhej më. Ishte i tronditur. La gjellën, pagoi. U kthye në dhomë, ku iu turrën prapë ngjarje, skena, tipa nga jeta.

Ishte errur, kur dikush trokiti. Hapi derën. Ishin dy femra. Njëra prej tyre kishte një farë lezeti dhe fliste ëmbël dialektin shkodran.

-C'kërkoni?! -Pyeti ai.

-Pak ujë... -I thanë ata me një buzëqeshje të djallëzuar.

-Megjithë qejf. . -U përgjegj djaloshi.

Vajti në fund të dhomës, mori katroven, gotën. Ato hynë në dhomë krejt pa teklif. Hodhën sytë rreth e qark dhe folën me keqardhje:

-I shkreti, beqar dhe vetëm! ... .

Ai u zgjati gotën me ujë. Ato, sa e cekën pak , e lanë në tavolinë. Shkodranja iu afrua shtratit dhe pyeti:

-Ka mundësi të rri këtu?

Ai që kishte idera të tjera në kokë, nuk mund të pranonte ç'ka dëshëronin ato dhe u përgjegj:

-Jo, s'ka mundësi.

-Pse?! - U çuditën ato.

-Deshët ujë, ju dhashë. Tani ç'kërkoni? -Ia preu ai.

-Mos dëshëron të na përlesh? -Pyetën ato të sigurta se do të mirrin një përgjigje të butë, por u gënjyen se djaloshi u foli:

-Njerëzit nuk mund të rrijnë kot në dhomën e huaj

-Qenka budalla ky! -Tha njëra-Beqar dhe s'deshka qejf. Bile as pa para! Besniku u rrevoltua nga vullgariteti i tyre. Hapi portën dhe urdhëroi:

-Ju lutem...

Ato e kuptuan se çdo përpjekje ishte e kotë dhe dolën duke pëshpëritura të pakënaqura:

-Budalla si ky s'kemi parë!

Besniku mbylli derën. Iu kujtua femra e asaj nate dhe pati bindjen se ajo

-Këtë kam pritur vite me rradhë!

Besniku dëshëronte t'i shpjegonte asaj diçka për rrugën e tij dhe i foli prerë:

-Gjëja më e shtrejtë në jetën time ka qenë, është dhe do të jetë arti. Kam patur gjithënjë një parandjenjë se do të krijoj diçka të vlefshme, pse ta fsheh, që do të mbetet në historinë e letërsisë shqipe. Tani kam bindje se gjëndem në prak të sukseseve. Unë do t'ia arrij qëllimit edhe sikur të detyrohem të lyp bukë portë në portë. Në rrugën drejt artit, më falni për ndofta fjalën e ashpër, por duhet ta dini të vërtetën, unë do të shkel edhe mbi fëmijët e mi.

Ky sqarim i ashpër për qëllimin e tij nuk mund të mos e trembte Luizën. Diçka e errët iu paraqit jeta në lidhje me rrugën e artit të të dashurit, por tani pandehte se çdo sakrificë për bashkimin e tyre do t'i jipte asaj lumturi. Kishte në zemër shumë dashuri sa çdo pengesë i dukej e vogël, prandaj u përgjegj:

-Kuptova shumë mirë. Nuk kam asnjë kundërshtim.

Besniku u kënaq shumë nga këto fjalë.

Ata u panë në sy dhe psherëtitën, sikur shprehën kështu se ishin lodhur shumë në rrugën e gjatë të dashurisë së tyre, por më në fund e kishin mbaruar me sukses.

Kishin arritur te shtëpia e vëllait të Luizës. Ajo u fut brënda që të linte librat dhe pastaj të dilnin bashkë. Hyri në dhomën ku flinte. Asaj iu zhduk hutimi, iu kthjellua mendja. Filloi të kishte ndërgjegjen e asaj që po ndodhte dhe iu duk vehtja si në përrallë. Kishte patur gjithënjë besim se do të bashkohej me Besnikun, por kjo kishte rrjedhur sidomos nga përshtypjet e dashurisë së parë dhe dëshira e saj. Prandaj tani mendoi se po kryhej diçka e çuditshme dhe se po i vinte një lumturi e pakrahasueshme. U afrua te pasqyra që të shihej dhe të zbukurohej. Fytyra sikur po i mirrte jetë. Ata sy të vvarë nga vuajtja po ndrisnin.

## VI.

Besniku po ngjiste shkallët e shtëpisë botuese. Aty do të lexonte regensionet për librin që kishte shkruar atë verë. Përshkroi sallonin me hapa ritmike, trokiti në derën e redaksisë, e hapi dhe pyeti me një zë plot mirësjellje në ishte aty redaktori. Një nëpunës, që e njohu kush ishte, i tha të hynte brëndë se redaktorit i kishte dalë një punë dhe kishte ikur, por i kishte lënë aty materialet për t'i lexuar.

Besniku u fut i ndrojtur, u kërkoi të falur nëpunësve për shqetësimin dhe u ul aty në qoshe. Në fillim mori të lexonte reçensionin, ku si i kishin thënë, libri i tij çmohej ftohtë. Dhe ashtu ishte e vërteta, por nuk mbeti i pakënaqur. Nuk ishte dakort me vlerësimin e përgjithshëm, disa rekomandime për ndreqje nuk mund t'i pranonte kurrë, por kryesorja ishte se reçensenti pranonte të botohej libri dhe kjo i mjaftonte. Pastaj nisi të lexonte reçensionin tjetër pa pritur ndonjë gjë të veçantë, edhe për shkak se me reçensentin ishin grindur dikur. Qysh në paragrafin e parë u çudit nga përcaktimi i vlerës së veprës. Pastaj i pëlqeu shumë mënyra se si e kishte vijuar analizën, se si kishte zbrëthyer metodën artistike të personazheve dhe e vlerësoi shumë të saktë gjykimin mbi psikologjinë e heroit kryesor. Sa më tej e lexonte reçensionin aq më shumë tronditej, gjersa në një pikë sytë iu mbushën me lotë, gërmat iu mjegulluan sa s'lexonte dot. I fshiu lotët që mos të turpërohej në sytë e të tjerëve. Ishte tepër i mallëngjyer në ato çaste se një njeri kishte shkruar fjalë shumë të ngrohta për librin e tij, e kishte pëlqyer më tepër nga Agimi dhe Hyseni dhe më kryesorja i kishte zbrëthyer personazhet, tamam ashtu si i kishte konceptuar ai vetë. Kjo donte të thoshte se patjetër do të gjendeshin edhe njerëz të tjerë që do të gjykonin në mënyrë të tillë.

Si u qetësua, vijoi leximin. Në fund reçensenti bënte ca kritika të rrepta, të cilat në përgjithësi autori i pranoi aty për aty. Duke e përmbajtur vehten, pa shprehur aspak atë ndjenjë gëzimi dhe fitorje që i mbushte shpirtin, Besniku i ktheu reçensionet, i përshëndet prapë plot nderim dhe u largua. Në sallon i hodhi prapë çapat ritmikisht dhe askush nuk mund të kuptonte nga sytë, nga pamja, nga të ecurit se ç'lumturi kishte në shpirt. Doli nga ndërmarra me një besim akoma më të madh në forcat e veta për ta filluar romanin me ngjarjet e aktualitetit.

E ema u gëzua shumë, kur i tha se libri do të botohej. Ajo e shkretë ëndërronte që të birin ta nderonin ashtu si dikur.

Të nesërmen Besniku u nis i qetë në shtëpinë e Hysenit duke marrë me vehte edhe veprën e tij me përjashtim të një vëllimi, të cilin ia kishte dhënë për lexim Agimit pa ditur gjë autori. Ai i kishte hedhur një sy veprës së shokut si parapregatitje për veprën që do të krijonte, ku do të përshkruante mgjarjet që u kishin ndodhur atyre gjatë këtyre viteve. Ishte i bindur se duke i qëndruar besnik metodës realiste me të cilën kishte shkruar romanin nga lufta, do të krijonte i frymëzuar nga ideali socialist një vepër arti të vërtetë, krejt e ndryshme nga letërsia e realizmit socialist dogmatik e skematik që sundonte aktualisht në Shqipëri. Në përshtaje me këto ide e qëllime rileximi i veprës së Hysenit në një pjesë e kishte lënë të ftohtë dhe ishte

rrevoltuar nga poema "Udhëtim nëpër shekuj", ku profetizohej shkatërrimi total i socializmit.

Plot besim në vertetësinë e pikpamjeve të veta hyri në shtëpinë e Hysenit, u përshëndet plot përzemërsi me Sabrijen, i dha dorën thjesht shokut dhe filloi biseda të tjera pa thënë asgjë rreth shkrimeve. Hyseni e nuhati se shoku nuk ishte i kënaqur nga rileximi i veprës. U trishtua diçka, u nevrikos, por u përmbajt pa dhënë asnjë shenjë së jashtmi. Si biseduan edhe pak për gjëra të parëndësishme, Besniku desh të fillonte, por me që e zonja e shtëpisë nuk po largohej, iu lut asaj t'i linte vetëm. Sabrija u çudit se po e "përzinte" në shtëpinë saj, por prapë u detyrua të dilta. Kjo gjë e rëndoi më tepër atmosferën në mes dy shokëve.

Besniku hapi dorëshkrimet, mori një fletë me shënime, lexoi diçka dhe filloi me një farë emocioni. Pasi bëri një analizë të gjërë për gati një orë, ai përfundoi:

-Fatkeqësisht vepra jote në një pjesë ka dështuar dhe njeriut i vjen shumë keq. Unë jam i mendimit se këtë pjesë të artit tënd e kanë dëmtuar lëkundjet ideologjike. Po të kishe gjithënjë një vështrim të qartë mbi fenomenet e sidomos një botëkuptim marksist, do të krijohej një vepër të mahnitshme. Ndofta bile me një punë të madhe vërtetë do t'i kishe arritur gjenitë.

Besniku mbaroi dhe e vështrroi Hysenin. Vetëm tani duke parë se atij iu drodh një pejz në faqe, si i ndodhte zakonisht, kur zemrohej shumë, e mori me mend se ndofta e kishte tepruar.

Hyseni sikur pësoi edhe një farë diziluzioni në fund se ndofta priste së paku një mbyllje më të butë. Por për çudinë e madhe "referuesi" me pamjen e zërin e një akademiku të pagabueshëm e kishte gjetur shkakun e "dështimit" të një pjese të veprës së tij në mungesën e përvetësimit të marksizmit. Këtu rrevolta e Hysenit kishte arritur kulmin, prandaj ai i foli me zemrim:

-Dalim tami? ... Më duket e kotë dhe e panevojshme të diskutojmë më gjatë. Pikëpamjet tona janë krejt të kundërta. Përfitimi i vetëm i kësaj bisede është se ne shkëmbyem mendimet. Vetëm për diçka më vjen mirë: unë këtë e kam parashikuar dhe ti nuk më ke gënjyer dot. Dhe atëherë, kur kujtoje se ishim krejt në një mendje, unë e kuptoja se ishim të ndryshëm dhe bile ta kam thënë këtë gjë. Gjer në një farë pike pra këto pikëpamje që shprehe, për mua nuk janë të reja dhe të papritura. Ti jo vetëm kohët e fundit ke mbajtur një qëndrim indiferent ndaj veprës sime, por edhe atëherë nuk e ke pëlqyer. Ndryshimi është vetëm se për pjesët që u përpoqe t'i rrëxosh tani, dikur heshtje.

-Po, edhe mua më kujtohet mirë. -Pranoi Besniku i qetë, megjithëse e shihte

se tjetri kishte një dëshpërim tepër të madh-Kur më ke lexuar poemën "Udhëtim nëpër shekuj" nuk ndjeva asnjë entuziazëm në shpirt, ashtu si ngjet, kur lexoj një vepër të vërtetë arti, megjithëse ti e quaje atë kryevepër. Dhe kjo më nderon mua.

-Ty kjo të poshtëron! -Ia ktheu Hyseni me zemrim.

-Unë këtë vepër nuk mund ta pranoj. -Kundërshtoi Besniku i rrevoltuar.

Hyseni ia priti me inat të tërbuar:

—Pikërisht rrevolta jote dëshmon vlerën e asaj vepre. Ju shihni aty një pasqyrë artistike, ku jini pikturuar me një dritë të vërtetë dhe këtë s'e duroni dot. Po kjo më gëzon mua dhe verteton se jeni para një vepre artistike.

-Eshhtë e vërtetë se unë rrevoltohem, por aspak pse ti ke arritur të na përshkruash me art ashtu siç jemi, por se aty shoh thjeshtë një dokument antisocialist pa vlera artistike. Ajo është një pasqyrë e shtrembëruar e botës. Krejt qëllimi yt është të tregosh se njerëzimi ka luftuar për një botë të lumtur dhe më në fund ka krijuar socializmin, që sipas teje është një sistem shtypës, mekanik, jo natyral, kundër spontanitetit të zhvillimit shoqëror. Po kjo është një gënjeshtëri e plotë. Unë e shoh çdo ditë socializmin në Shqipëri dhe e di që socializmi pamvarësisht nga të metat e mëdha që ka si një sistem fare i ri, e ka shpënë Shqipërinë në rrugën e përparimit. Cdo njeri që nuk është qorr, e kupton se ti e ke gabim.

Hyseni i përsëriti plot mllef e bindje atë që i kishte deklaruar edhe një herë tjetër:

-Socializmi është sistemi i inkuizionit mesjetar dhe Shqipëria shembulli më tipik dhe më i keq i tij.

Tamam si atëherë edhe tani Besnikut iu drodhën mishrat nga këto fjalë të fuqishme, tronditëse. Kishte kaluar vetë nëpër birucat e sigurimit, në internim. Kishte parë me sytë e vet burgjet të mbushura plot. Por, duke patur iluzionin se këto ishin kalimtare, se thelbi i sistemit socialist ishte diçka tjetër, u përgjegj:

-Vepra artistike që ka idenë themelore të gënjeshtërt është e destinuar të dështojë. Pikërisht kjo ka ndodhur me poemën tënde. Po këtë gjë verteton edhe poema e luftës që po shkruan ti. Ajo sigurisht do të dalë e mirë se mbështetet në një ide themelore të drejtë, pamvarësisht nga idetë sekondare. Po e pate mbaruar, ma jep ta lexoj dhe do të shohësh se do të vertetohet mendimi im.

Ishte fjala për poemën, për të cilën Hyseni i kishte folur para disa muajve.

Hyseni kundërshtoi me përbuzje:

-Mua më vjen ndot që ti të shfletosh dorëshkrimet e mia.

Në këtë çast u hap dera. Sabrija hyri me fytyrë të prishur dhe pyeti me qortim:

-Ç'kini që ulërin?!  
-Dil jashtë! -Urdhëroi Hyseni me një ton shumë të ashpër.

Nuk i pëlqente që gruaja të dëgjonte se Besniku ia hidhte poshtë veprën në atë mënyrë. Sabrija mbeti një hop në prak dhe duke kuptuar se çdo ndërhyrje për pajtim ishte e kotë, duke u ndrojtuar mos shahej më shumë, u spraps e hidhëruar.

Fjalët e fundit të Hysenit e kishin fashitur diçka grindjen dhe i kishin dhënë fund pa pritur bisedimit letrar. Besniku e kuptoi se miqësia e tyre mund të prishej në ato çaste, i erdhi keq për këtë gjë, prandaj nuk i dha asnjë përgjigje. Hyseni filloi të mbledhë dorëshkrimet. Ishte i zverdhur pak dhe duart sikur i dridheshin. Besniku i tha:

-Mungon një vëllim me vjersha.

Hyseni, duke kujtuar se diçka e keqe fshihej aty,pyeti:

-Ku është?!

Besniku u mendua një hop dhe u përgjegj:

—Më falni. Pa lejen tënde ia kam dhënë Agimit.

Hysenit iu drodhën pejzitet e fytyrës nga zemrimi i madh. Duke e vështruar në sy me kërcnim bashkëbisedonjësin, iu çfry:

-Ti dhe shokët e tu, gjithë Lidhja e Shkrimtarëve, nuk më poshtëroni dot mua. E kuptoj. Ti do të jesh tani e tutje armiku im më i tërbuar. Por gabohe, kur pandeh se mund të më mundësh. Akoma s'më ke njohur mirë. Unë jam Mero Lamçja!

Mero Lamçja ishte një personazh i një pozije, e cila i kishte pëlqyer shumë Besnikut. Aty tregohej se si një komit shqiptar përbuzte me madhështi përfaqësuesit e sulltanit dhe e hidhte vetë litarin në grykë.

Ata të dy u hëngrën sy në sy duke u ndërë pothuaj armiq për vdekje. Besniku pa lëvizur qepallat, me një farë inati të fshehur, por me qetësi, i tha:

-E di fare mirë që je Mero Lamçja, por kjo nuk ka asnjë rëndësi në këtë rast konkret. Këtu nuk kemi punë trimërie, por flasim për poezi. Dhe poezia nuk bëhet vetëm me trimëri. Duhet të jesh i sigurtë se unë nuk ja kam dhënë vëllimin Agimit për të poshtëruar, por për të nderuar. Kisha një vuajtje shumë të madhe se një pjesë e veprës nuk më pëlqente dhe dëshëroja të isha i gabuar. Ia dhashë atij që të kontrolloja vehten. Ai, megjithëse atë pjesë të veprës e pëlqeu më shumë nga unë, prapë në thelb ka këtë mendim. Pastaj ti gabohe, kur thua se unë jam armiku yt më i tërbuar. Ta them troç:Jam armiku i asaj vepre dhe do të jem për jetë! -Ai

shënoi prapë me gisht poemën. -Po u botua ajo, unë i pari do të luftoj në shtyp kundër saj, pse godet padrejtësisht idealin tim, mua personalisht dhe kryesorja nuk është artistike.

Hyseni e kishte vënë re gjithënjë se Besniku ishte njeri i fortë, por tani e shihte këtë forcë ballë tij të vendosur dhe të fuqishme, ashtu siç ishte edhe vetë.

-Nuk të kam frikë ty dhe shokët e tuaj as me penë, as me armë. Ju, duke përfutur nga rasti që kini pushtetin e se unë jam vetëm një person, më kini vënë prangat. Por unë nuk jam thyer dhe kjo dëshmon mirë se me kë kini të bëni ju.

Besniku, duke pandehur se të gjitha bisedat e tyre kishin marrë fund, u ngrit dhe i tha

-Më prit pak. . Për gjysmë ore do ta sjell vëllimin.

-Do të bënit shumë mirë. -E këshilloi tjetri dhe pastaj, duke qenë i bindur se denoncimi i shumë konkluzioneve politike të shprehura në mirëbesim, mund ta shpinte prapë në burg, shtoi-Para se t' i japem fund bisedës, kërkoj diçka prej teje. Po deshe të tregohesh i ndershëm, mos nxirr asgjë nga kuzhina ime në publik.

Besniku e kuptoi se këto ishin fjalë funerali për miqësinë tyre dhe u përgjegj:

-Po qe nevoja, unë do të flas vetëm për ato që dihen, ose do të dihen publikisht.

-Shumë mirë. Kjo më tepër do të nderojë ty, pse nuk do të sillesh si maskara. Por edhe unë do ta kem një përfitim. Do të jem i kënaqur se shoku im i dikurshëm nuk ka qenë i poshtër.

-Të jesh i sigurtë për këtë! -Premtoi Besniku dhe doli me dëshpërim në shpirt.

Po shkonte në shtëpinë e Agimit që të mirrte vëllimin. Nuk kishte pandehur kurrë se vërejtjet e tij do të kishin këtë përfundim. I vinte shumë keq që po ndaheshin, megjithëse nuk ishte pënduar aspak për kritikën që i kishte bërë. Nuk dëshëronte të këpuste lidhjet me Hysenin se çmonte shumë anë të tij. Pikësëpari nuk kishte hasur asnjë njeri që të kishte një karakter aq të fortë sa Hyseni, që të ishte aq trim, i singertë dhe besnik në miqësi. Pastaj nuk njihje asnjë poet a shkrimtar, me të cilin të bisedonte me aq pasion për klasikët e letërsisë dhe për artin në përgjithësi, pamvarësisht se shoku, sipas tij, shfaqte disa herë pikpamje idealiste në të kuptuarit e çështjeve. Askush nuk ishte sjelluar aq pamëshirshëm kundra të metave të tij artistike dhe nuk i kishte dhënë aq këshilla të dobishme.

Ai kishte shpresuar gjithmonë se me Hysenin, megjithëse me kontradikta, do të shkonte duke u afruar në rrugën e artit dhe ja tani prisheshin fare. Dhe më kryesorja Besniku besonte se shoku kishte talent të vërtetë dhe pamvarësisht se kishte dështuar në një pjesë të veprave, një pjesë e madhe i pëlqente dhe shpresonte



se në të ardhmen mund të krijonte gjëra të bukura, sidomos , po të ndreqej ideologjikisht. Këtu ai mendoi se padrejtësisht i kishte nënvleftësuar krijimet e mira të Hysenit dhe kështu zemrimin e shokut e justifikoi diçka.

Arriti në shtëpinë e Agimit, mori vëllimin dhe po kthehej. Tani ishte i qetë. Ndarja nuk e trondiste aq shumë se si dukej krejt e paevitueshme. Iu afrua shtëpisë së shokut sikur nuk po ndodhte një gjë e rëndësishme, sikur kjo miqësi që po këputej, mos të kishte qënë nyja kryesore e ngjarjeve të tyre për disa vjete me radhë.

Trokiti dhe hyri në dhomë.

Hyseni ishte më këmbë afër tavolinës dhe po shfletonte dorëshkrimet. Edhe ai nuk kishte atë pamje të rrevoltuar dhe të zemruar. Gjysmë ore më parë, pasi kishte dalë shoku, e kishte ndjerë vehten të dëshpëruar duke menduar se një njeri si Besniku nuk e takonte dot më, pamvarësisht nga kontradiktat e mëdha që mund të kishin. Atëherë ai ishte ngritur dhe kishte shfletuar vëllimin me vjersha. Intuita e artistit e kishte shpënë te krijimet me vlera të vërteta artistike dhe ishte çuditur se si Besniku, që njihje ai, nuk i kishte pëlqyer ato. Këto mendime kishte, kur ai erdhi me vëllimin e poezive në dorë. Fakti që i solli kaq shpejt vjershat, tregonte korrektesë dhe sikur ishte një dëshmi se nuk ia kishte dhënë Agimit me qëllim të keq. Një farë lloj qetësie, pajtimi, bile edhe dëshpërimi në fytyrën e tij, i dhanë të kuptonte se ai ishte si gjithënjë njeri fisnik. Edhe atij i erdhi keq që të prishej me këtë njeri dhe i foli i zbutur, me një ton lutës dhe mallëngjenjës:

-Si mund ta hedhësh ti, Besnik, poshtë këtë vjershë?!

Ai kishte në dorë vëllimin të shkruar në burg.

-Unë e çmoj atë... Ndofta sot u mora më shumë me kritika dhe i nënvleftësova diçka anët pozitive.

Këto fjalë e lehtësuan Hysenin.

-Po këto vjersha?!

Hyseni shënoi ca tituj vjershash.

-As ato... -U përgjegj tjetri. -Këto janë nga krijimet më të bukura të letërsisë shqipe dhe as nuk mund të krahasohen me vjershat e Andreas dhe të Telhait.

Hyseni nuk i vuri ndonjë rëndësi faktit se Besniku i kishte hedhur poshtë një shumicë krijimesh, me të cilën gjë nuk ishte fare dakort dhe tha papritur:

-Atëherë në esencë ne nuk kemi ndonjë kundërshtim të madh. Një njeri që ka krijuar qoftë edhe dhjetë poezi të bukura, nuk shkulet dot nga trualli i artit. Ai mbetet.

Besniku heshti, por me këtë nuk ishte aq dakort. Hyseni shtoi:

-Lexoje edhe poemëm e re dhe do të bindesh më shumë për vlerën e veprës sime.

Besniku ndjeu një lehtësim të madh nga kthesa e Hysenit. Kjo do të thoshte se miqësia e tyre nuk po prishej: Ai e mori në dorë poemëm dhe i tha:

-Sa do të dëshëroja të kesh krijuar një vepër me të vërtetë të mirë. Do të shkoj ta lexoj që tani.

I dha dorën shokut dhe doli. Arriti në shtëpi, hyri në dhomë dhe nisi të lexonte pa ngrënë drekë. Pasi hëngri bukë, e vijoi leximin me gëzim. Nuk e lëshoi nga duart poemën gjersa e mbaroi dhe e vuri në tavolinë me lehtësim.

Aty për aty ai nuk e kuptoi plotësisht vlerën e asaj poeme, as idetë e saj. Por për të ajo ishte prodhimi më me vlerë i poezisë shqipe pas çlirimit. Tani iu shtua besimi se Hyseni do të mbetej si poet. Ishte shumë i gëzuar se miqësia e tyre kishte fituar një bazë të re, që i përforconte marrëdhëniet e mira në të ardhmen.

Të nesërmen, pasi Besniku i dha Hysenit përshtypjet rreth poemës, ata të dy u ndanë si miq. Kjo vepër pas shumë peripecish do të hynte në procesin e botimit qysh atë muaj.

## VII.

Të pasnesërmen Besniku i hypi trenit në stacionin e Lalsit që të shkonte në Berat për të takuar Luizën. U ul pranë një plake te dritarja dhe vështroi jashtë. Pas pak fushat, kodrat, shtëpitë që i njihte aq mirë, u zhdukën dhe ja lanë vendin të tjerave. Atëherë atij i erdhi në mendje Luiza, ngjarjet e dashurisë, që i kishin lidhur aq shumë.

... Ajo kishte ardhur në shtëpinë e tij që të daktilografonin, ftesat për një mbremje vallëzimi, që do të organizohej në Universitet. Aty në dhomën e tij ai, që i kishte kërkuar ta linte të fejuarin dhe të martoheshin bashkë, iu afrua që ta puthte. Ajo kishte kundërshtuar e tronditur, kishte heshtur kokëulur disa çaste, gjersa e kishte qetësuar vehten dhe i kishte folur:

-Unë të dua, por kam tre vjet e fejuar dhe ndarja do të ishte një gjë shumë e rëndë. Nënë e kam të sëmurë nga nervat dhe shqetësohem mos do të çmendet

fare. Motrave më të vogla nuk dua t'u jap një shembull të keq. Pastaj ti je i fortë, e përballon opinionin, kurse mua opinionin më shtyp.

Dhe ata kishin marrë ftesat dhe ishin kthyer në universitet. Por prapë Luiza nuk ndahej prej tij dhe çdo pushim mes orëve të mësimin rrinin bashkë.

Një natë, kur ai i kishte thënë se në çaste fatkeqsije e zinte gjumi rehatë dhe se nuk flinte dot vetëm kur kishte ndonjë gëzim të madh, ajo e çuditur e kishte pyetur plot kuriozitet:

-Çfarë gëzimesh të mëdha qenkeshin ato sa ty të lënkam pa gjumë?!

Ai ia kishte kthyer i buzëqeshur:

-Po të më thojë ti se do ta lidhje jetën me mua, atë natë nuk do të mbyllja sy fare.

Dhe ajo, kur po ndaheshin, i kishte thënë si për diçka fare të parëndësishme:

-Shko! ... Nuk po të them asgjë, pse nuk dua të lë sonte pa gjumë.

Dhe ishte larguar sakaqë duke e lënë të dashurin të shastisur.

Të nesërmen, pasi ishin puthur në errësirën e një rrugice, ai i kishte kërkuar asaj ta lajmëronte të fejuarin për vendimin e vet dhe vetëm pastaj do të takoheshin bashkë prapë.....

Kishte arritur në Durrës. Treni qëndroi dhe ai vështroi nga deti që lëkundej në ngjyrë të gjelbër. Ishte dimër. Dallgët e shkumbëzuara e rrihnin bregun me zhurmë. Qielli i himtë, i zymtë, sikur e shtrëngonte detin dhe tokën. Era frynte. Natyra ishte e egërsuar dhe atij i erdhën në mendje përfytytrimet e asaj nate dramatike.

... . Atë natë po bëhej mbrëmja. I fejuari i Luizës kishte ardhur në Tiranë i dëshpëruar nga dyshimet se e fejuara e kishte braktisur dhe kur disa studentë i thanë se ajo dashuronte një tjetër, kishte kërcnuar: "Unë do t'i vras të dy!" Ata kishin qenë bashkë tej kodrave të Tiranës dhe i kishin gjetur shokët e shoqet e tyre të tronditur. Gjithë universiteti ishte i shqetësuar. Shumë çifte kërcenin me ankth dhe pritnin që krismat e rrevoles të mbytnin tingujt e muzikës. Të dashuruarit kishin dalë fshehurazi nga Universitetit duke u përcjellë nga shokët e tyre që u bënin roje pas dhe prapa, kishin vajtur në shtëpinë e motrës së Besnikut.

Të nesërmen në mbrëmje policia kishte trokitur në portën e shtëpisë të motrës së tij, ku rrinte i fshehur bashkë me të dashurën. Nënë Sania, që kishte hyrë me një pamje të mjerë bashkë me policët, ja kishte plasur vajit mu në mes të oborrit. Ajo ishte gjithë helm e vrerë, pse i biri kishte rrëmbyer një vajzë të fejuar dhe e kishte shpënë vehten gjer atje sa të kërjohej nga qeveria. . Luiza e dërmuar nga

të gjitha këto që po ndodhnin, ishte mbledhur kuspull me kokën të mbështetur në gjunjë aty në kuzhinë. Besniku ishte gjunjëzuar në dysHEME para saj, e kishte përfshirë në krahëror dhe i kishte folur:

-Luiza, të dashuroj me të gjitha forcat e shpirtit tim, ashtu si nuk kam dashuruar kurrë, ashtu si nuk mund të dashuroj askush! Ti je femra që kam ëndëruar, që kam kërkuar në jetë me ngulm, me zjarr! Mos u tremb! Unë jam lindur të përballoj vështirësitë dhe vuajtjet më të mëdha. Bashkë do të jemi të lumtur dhe të pathyeshëm! Ngrehu tani. Policia na kërkon!

Makina e policisë ishte nisur me Luizën përpara dhe me atë prapa në karrocari.

Kur e dashura kishte hyrë brënda në zyrat e policisë, ai kishte mbetur te porta. Një parandjenjë e keqe i kishte ndrydhur zemrën. Pastaj një monolog i trishtuar, si prelud ndarje, kishte filluar vevetiu t'i jehonte në ndërgjegje. Pas pak e dashura kishte dalë e shoqëruar nga shefi i policisë, i vëllai dhe kunata. Ajo kishte kaluar para tij kokëulur, e nemitur dhe e pikëlluar. Ai kishte ngrirë në shpirt dhe i kishte folur me zë të mekët:

-Po ikën, Luiza?!

E dashura kishte vijuar gjithënjë rrugën kokëulur, e nemitur, e pikëlluar gjersa ishte zhdukur në errësirë.

Të nesërmen kishte braktisur provimet e shtetit dhe kishte shkuar të martohej...

Pas një udhëtimi të lodhshëm Besniku arriti në Berat. Doli nga makina dhe hodhi sytë se mos e shihte gjëkund Luizën. Pastaj kaloi nëpër qytet e shqetësuar, takoi një shok dhe e dërgoi në shtëpi të saj për t'i thënë se e kërkonte një njeri i panjohur. Shoku trokiti, kërkoi Luizëm, e cila doli shpejt. Besniku ishte fshehur pas një porte dhe zemra i rrihte fort, E dashura pyeti e habitur dhe e tronditur:

-Mos është Besniku?! Fol! Mos është Besniku?!

-Nuk di... Ja ku është- u përgjegj tjetri.

-Xhankë e mamit, rri një çikë, ja ku erdha-I foli ajo Kozetës që e mbante për fustani dhe u sul menjëherë te porta. Në errësirë jo dalloj siluetën e dashnorit, pastaj fytyrën e tij të mbushur, sytë e shkëlqyer dhe buzët që u çelën ëmbëlsisht. Zemra i rrahu me hare, fytyra i ndriti e tëra e thirri me çudi:

-Besniku!

Dhe iu hodh në qafë pa u merakosur për njerëzit që kalonin pranë. I dukej sikur ishte në ëndërr dhe e shtrëngonte me mall. Vajza e vogël që e ndoqi pas t'ëmëm, e dëgjoi thirrjen "Besniku" dhe e mori me mend se burri i panjohur, që

përqafofte Luiza, ishte "babai" për të cilin i fliste ajo, prandaj e kapi nga këmba dhe i thirri e gëzuar;

-Besniku... Besniku... Besniku...

Ai u shkëput nga Luiza i prekur nga thirrja e ëmbël dhe i çuditur se si e mori vesh kaq shpejt kush ishte. Gjithënjë kishte menduar a do ta tërhiqte fëmija në mënyrë të natyrëshme, a do t'i bëhej e dashur vevetiu, a kishte ajo cilësi që t'i pëlqenin shumë atij. Dhe tani që e shikoi për herë të parë, iu zgjidh dilema që e mundonte. Ishte e pamundur mos t'i bënin përshtypje sytë gështenjë plot dritë të zgjuar, pak të ndrojtur që shkëlqenin nga dashuria. Nuk kishte se si mos t'i bëhej e afërt fytyra e mbushur, faqet e njoma, mos ta trondiste gëzimi i çiltër, mos t'i hynte në zemër, mos ta quante si fëmijën e vet po në atë çast.

U përkul vevetiu dhe desh ta puthë, por ajo sikur u tremb dhe u largua. E ëma natë ditë i kishte folur për atë burrë dhe i kishte pëshpëritur në vesh se ai ishte babai i saj. Ajo, po ashtu si e ëma, e puthte në fotografi burrin e panjohur, por tani u step. Besniku e përkëdheli pa e puthur.

Luiza, pasi e ftoi në shtëpi, hyri brenda që të rregullonte dhomëm e të lajmëronte prindët. Ai eci dhe qëndroi në prak. U ndrojt të futej brenda se nuk dinte ç'njerëz ndodheshin atje. Kozeta, që vrapoi para, duke ndjerë se pas nuk po vinte "babai", u kthye, doli ne prak dhe e ftoi plot hare;

-Hajde, hajde brënda!

Besniku hodhi prakun. Kozeta vrapoi gjithë gëzim, ngjiti shkallët me zhurmë, hapi portën, e nbajti çelë, priti gjersa ai u afrua, rendi te komodina dhe tregoi me gisht një fotografi duke thirrur:

-Besniku! . .

Në komodinë ndodheshin shumë fotografi të tij dhe ajo nuk la asnjë pa ja treguar, ndërsa fytyra gjithënjë i shkëlqente. Ai e zuri nga dora, e përqafoi, por ajo u shkëput prapë, vrapoi nëpër dhomë. Hypi në një krevat, u hodh në një tjetër, u përkul në hekurin e tij, kërceu në tokë, rendi nëpër dhomë, doli te dera dhe thirri:

-Mami, hajde!

Luiza u duk në prak. E bija e zuri për dore dhe e afroi te Besniku. Ata të dy e panë të mallëngjyer Kozetën. Pastaj u përqaftuan, por nuk u puthën. Fëmija u hodh dhe tha:

-Edhe mua... Edhe mua... .

Ata u përqaftuan të tre. Pastaj vajza e vogël u shkëput dhe i vështroi e menduar. Asaj iu kujtua e motra e Luizës, që vinte shpesh me të shoqin dhe se si flinin ato,

prandaj u foli duke treguar me gisht krevatin e vogël:

-Unë do të flë aty.

Pastaj tregoi me gisht krevatin e madh e shtoi:

-Mami dhe Besniku do të flenë atje.

Sytë e saj u qepën mbi ta për të kuptuar çfarë do të thoshin. Ai buzëqeshi dhe pyeti:

-I ke thënë gjë?

-Kurrë! -U përgjegj Luiza-Po çuditëm.

Kozeta rendi prapë nëpër dhomë e foli fjalë me kuptim, sikur ta kishte mësuar njeri. Herë pas here vështronte "babanë", sikur nuk i besonte syve dhe thoshte me habi, plot gëzim:

-Besniku!

Pas pak erdhi i jati i Luizës me të cilin Besniku u përshëndet me përzemërsi. Më vonë hyri e ëma me një pamje krenare dhe të përmbajtur, me floktë të bardha, që i jipnin hijeshi dhe të ngjallnin nderim. Sytë e saj shihnin mprehtë, me ndrojtje e mosbesim. U përshëndet dhe u shtruan në bisedë.

Familja e Luizës që dikur e kishte kundërshtuar këtë lidhje, kuptohej se tani e pranonte si lumturi dhe i fjalosej dhëndërit me shumë respekt. Ata nxorrën me kënaqësi të madhe pije dhe meze. Besniku sillej i matur dhe ndofta pak i ftohtë. Kozeta gjithënjë bridhte nëpër dhomë, pyeste, fliste, gëzohej duke ndërprerë shpesh bisedën. Lëvizjet e saj i ndiqnin të gjithë të habitur me një farë mallëngjimi dhe në mënyrë të ndryshme mendonin për atë fëmijë që ishte rritur pa baba dhe që tani të gjithë i thonin se ky burrë i panjohur ishte babai i saj. Më në fund fëmijën e kapiti gjumi nga lodhja dhe e vunë në krevatin e vogël.

Pinë gjer vonë dhe si hëngrën, u shpërdanë. Luiza i shtroi Besnikut në dhomë, kurse vetë gjoja do të flinte në sallon. Si ikën të tjerët, ata u bashkuan në krahët e njeri tjetrit. Qëndruan ashtu një copë herë të gjatë dhe Luiza i tha:

-Sa mirë bërë që erdhe! Nuk e merr me mend se sa e lumtur që jam. Të mendoja në Tiranë dhe papritur më dole para, sikur mbive nga dheu!

Të nesërmen Besniku u çudit edhe më tepër nga sjellja e Kozetës dhe iu duk se vajza e vogël e lidhi më fort me Luizën.

Pasi u ngritën, e ëma e Luizës hyri me dy gota qumësht. Kozeta shtangu në vend dhe menjëherë iu shua gazi. Ajo ndoqi me vështrim të brengosur gjyshen që eci ngadalë nëpër dhomë dhe vuri gotat në tryezë. Pastaj, kur gjyshja po dilte, iu hodh përpara dhe thirri me një ton amkues:

-Po unë?! ...

Nëna e Luizës e kapi për dore dhe i foli:

-Hajde poshtë se kemi plot qumësht në kuzhinë... .

Kozeta u pre në fytyrë.

Besniku u prek nga thirrja e saj e dëshpëruar, nga vështrimi pyetës, i ndrojtur dhe foli:

-I sillni Kozetës të hajë me ne.

-Ajo han poshtë me mua. -Nguli këmbë gjyshja.

-Jo, Kozeta do të hajë me ne. -Kundërshtoi Besniku.

-Po s'kemi as filxhan tjetër. -Foli me turp ajo, se i kishin lypur edhe ato dy filxhanë të bukur.

-Me tas. Me ç'të jetë. Sillni edhe një karrike tjetër.

Fëmijës iu çel fytyra. Vrapoi tërë qejf në sallon, kapi një karrike të madhe dhe donte ta fuste brenda. Besniku i doli para, i mori karriken dhe e vendosi në tryezë.

Kozeta tha me gëzim:

-Unë këtu, ti këtu, mami këtu.

Ajo e vuri vehten në mes.

Prunë një tas dhe ato u ulën të tre në tavolinë. Kozeta hante duke i hedhur sytë herë t'ëmës, herë Besnikut. Kur pa se ai po e pinte qumshtun, e la lugën dhe filloi edhe ajo të rrufiste me tas. Pastaj kërkoi edhe nga e ëma që ta pinte si ata të dy. Befas e la tasin dhe e vështrroi Besnikun me habi. Iu kujtua se e ëma i kishte thënë që do të shkonin në Tiranë, prandaj pyeti me merak, bile si me frikë:

-Ka bukë në Tiranë?

-Po. -U përgjegj Besniku me seriozitet.

Fëmija sikur u qetësua dhe pyeti prapë:

-Po shtëpi?

-Po, tamam si kjo. -Ai ktheu ai.

-Po lodra? -Pyeti ajo pas një çasti pa ia jequr vështrimin që ia kishte ngulur në mënyrë të çudiçme.

-Edhe lodra... . Ç'të duash ti ka në Tiranë.

Ajo qeshi dhe vijoi të hante bukë.

... Besnikun e brente ndërgjegja për marrëdhëniet imtime të pahijshme që kishte patur për një kohë të shkurtës me gruan e martuar në periudhën e diziluzionit

të dhëmbshëm të dashurisë. Kjo e fshehtë sikur e digjte në krahëror. Dëshëronte që e dashura të njihte çdo skutë të shpirtit të tij, qoftë edhe të errët. Vendosi t'ia zbulonte këto marrëdhënie edhe që dashuria e tij të ishte e plotë se vetëm kështu i dukej do të meritonte të dashurohej sinqerisht prej saj. Pastaj ai mendonte se rrëfimi i këtij sekreti bashkëshoertes së ardhshme do ta ruante atë në një masë të madhe që mos të përsëritej kurrë sjellja e keqe morale.

Pas dite, kur po shetisnin në park, u ulën në një stol. Kozeta u vinte rrotull si një flutur. Ai i zymtë, me një zë të brengosur, i tregoi gjithshka. Luiza e dëgjoji e qetë. Nuk pandehte kurrë se i dashuri i saj mund të krijonte marrëdhënie të tilla imorale, por nuk u lëndua dhe u kënaq që ai i hapi zemrën. Besniku sikur u çlirua nga një ankth. Falenderoi për mirëkuptimin, e afroi në gjoks dhe e puthi me një dashuri të madhe, më të zjarrtë. Kozeta qëndroi një çast e shushatur, pastaj u sul drejt tyre dhe tha:

-Edhe mua... . edhe mua... .

Ata e puthën atë dhe të tre të kapur për dore dolën në fotografi.

Të nesërmen Besniku do të kthehej në Tiranë dhe këtë ia tregoi edhe Kozetës. Fëmija bërtiti plot hare me shpresë se do të shkonte edhe ajo me Besnikun. Të gjithë u mallëngjyen dhe asnjë nuk guxoi t'ia griste shpresat. Në mëngjez herët e zgjoi e ëma dhe ajo kërkoi të vishte fustanin më të bukur që të shkonte në Tiranë. Por e ëma i shpjegoi se atë ditë do të shkonte vetëm babai. Pasi të gjente shtëpinë, pasi të përzinte një plakë të keqe, pasi të blinte bukë e lodra, atëherë do të shkonin të dyja. Kozeta kundërshtoi dhe vetëm pasi e ëma u lodh shumë, iu mbush mendja dhe u vesh të përcillte babanë. Kështu mendoi gjatë gjithë rrugës, por kur erdhi autobuzi, e ktheu prapë e filloi të qante në heshtje se donte të shkonte në Tiranë. Atëherë Besniku i foli:

-Unë do të gjej shtëpi, do të blej plot bukë e kuklla dhe do t'u thërres juve. Kështu?

Kozeta u mendua. Vështrroi në mënyrë të veçantë, sikur donte të kuptonte në e gënjente apo jo dhe u përgjegj e bindur:

-Mirë... .

Vetëm atëherë, pasi e përqafoi dhe epërkëdheli fëmijën, ai hipi në autobuz. Pastaj ia bëri me dorë nga xhami i makinës. Luiza me vajzën hopa shkoi pranë autobuzit. Kozeta iu afrua xhamit dhe e puthi në atë vend, ku ishin buzët e Besnikut.

Makina u nis. Kozeta, të cilën e ëma e kishte lëshuar për tokë, përshëndeste me dorë: "Mirë u pafshim!" Pastaj vrapoi drejt autobuzit duke tundur gjithënjë dorën



dhe sikur lutej që Besniku ta mirrte me vehte, mos ta harronte. Makina u largua mjaft, por atje tej nëpër mes xhamit të saj dukej një fëmijë i vogël që vraponte pas autobuzit dhe përshëndeste me dorë. Pastaj u zhduk, por silueta e saj mbeti në mëndjen e djaloshit. Nuk i përfytyrohej fare fytyra e të dashurës, por i dukej sikur e shihte akoma Kozetën që vraponte drejt tij.

## VII.

E motra e Besnikut, Fatimja, kur mori vesh nga i shoqi ç'kishte vendosur vëllai i vogël, u lebetit. Ajo rendi që t'i tregonte gjithshka Kadriut, i cili u çudit se pandehte që Besniku kishte ndryshuar mendim pas asaj bisede që kishin bërë bashkë natën e kaluar. U nxe së tepërmi dhe e këshilloi motrën që t'i tregonte gjithshka nënës. Fatimja zbriti poshtë dhe thirri:

-Nënë! . . . Nënë! . . .

-Hë, bijë, ç'ka?! -U tremb ajo.

-A e di ti ç'po bën budalloi jonë që kemi në katund?!

-Besniku?! . . . Çfarë?! -Pyeti ajo e çuditur dhe qëndroi në vend duke pritur diçka të hidhur, por kurrë atë që kishte ndodhur me të vërtetë.

-Do të martohet me atë vajzën e atëhershme.

-Me cilën?! -Pyeti Sanija që e kishte harruar fare Luizën.

-Me atë që erdhi te shtëpia ime.

Sanija u pre në fytyrë.

-Ç'fol kështu?! . . . Nuk u martua ajo?! . . .

-U martua, bëri fëmijë, ka katër vjet e ndarë nga burri dhe ky kërkon ta marrë prapë.

Nënës iu morën mend dhe iu mbështet në mur që mos të rrëzohej. U ul në minder duke u mbajtur dhe rëmkoi me dëshpërim:

-Qyqja! Qyqja unë! Po kush ta tha ty, moj nënë, këtë turp?!

E bija u përgjegj:

-Ai vetë ia tregoi mbrëmë Kadriut dhe tim shoqi. Na porositi që ta themi edhe ty.

-O Zot si nuk lëshon një çikërrë që të më lësh në vend?! Pse nuk ma merr

shpirtin?!

Klithi ajo dhe u shkreh në vaj.

Askush nuk pandehte se lajmi i martesës së të birit do ta pikllonte aq tepër. Fatimesë i mgriu zemra se mos vdiste nëna në çast. I ngjiti shkallët si e lafitur duke thirrur të vëllanë se nuk dinte ç'të bënte. Motrës së vogël i rrëshqitën lotët nëpër faqe. Ata u çuditën për hidhërimin e saj të jashtëzakonshëm pse nuk dinin ç'shpresa kishte mbështetur te djali i vogël ajo nënë e heshtur dhe e vojtur . .

Vajzën nuk e kishte dhënë keq, por te ajo nuk mund të mbështetej. Djali i madh i dukej pak i ftohtë dhe nusja e sertë, prandaj nuk i pëlqente të rrinte me ta. Djalit të vogël më parë nuk i kuptohej filli, sjelljet e tij nuk ia ngrohnin zemrën dhe ajo qante me zemër pleqërinë e saj që po afrohej e zezë. Por ja

se vitet e fundit vinte re ca ndryshime te i biri. Ai sikur u shtrua, me qeverinë sikur ishte në rregull dhe me femra nuk ngatrhohej kot më kot. Fliste ëmbël, nuk bërtiste, tregohej gjithënjë e më i afërt. Asaj i dukej më i mënçur, më i mirë dhe ajo filloi ta donte më shumë, ta parashikonte të ardhmen lidhur vetëm me të. Herën e parë gëzohej se djali i bëhej njeri si gjithë të tjerët dhe nuk do të shkonte kot pjella e saj e rritur me mundime. Pastaj edhe jeta e vet mund të mos ishte e keqe. Çdo ditë i paraqitej djali më i mirë dhe zemra i ngrohej e fytyra i çelej. Endërronte t'i kthehej në shtëpi, t'i gjente nuse dhe pastaj t'i mbyllte sytë e lumtur. Këto shpresa përkëdhelte ajo, kur mori vesh mandatën. Mendonte t'i jipte vajzën më të mirë të Shqipërisë, kurse ai sipas saj mirrte një kurvë dhe përmbyste ëndrrat më të bukura të pleqërisë, prandaj hidhërimi nuk kishte si mos të ishte tepër i madh.

-Pse bën kështu?! -I thoshte Kadriu-Ç' ke ti?! Ne do t'ia kthejmë mendjen. Nuk e lëmë kurrë që të martohet me të.

-Ah, e njeh nëna kaptinën e atij. Ai është kaurr, dushman. T'i bish me plumb në lule të ballit dhe nuk e kthen.

Më kot u lodhën fëmijët. Ajo nuk u qetësua. U detyruan ta ngrejnë nga minderi dhe ta shtrijnë në shtrat.

## IX.

Atje në Lals në mbremje vonë Besniku po mendonte për veprën që do të fillonte të shkruante të nesërmen. Librin, që po botohej, e quante vetëm një provë të thjeshtë në fushën letrare dhe kishte bindjen se ky roman do të zbulonte në do të bëhej apo jo shkrimtar i vërtetë. Personazhi kryesor i kësaj vepre do të kishte tiparet esenciale të karakterit të tij, do të jetonte pak a shumë ngjarjet që kishte jetuar edhe ai, prandaj do të ishte i detyruar t'i analizonte me hollësi ndjenjat, mendimet e veprimet dhe do të jipte gjykime mbi to. Ai thoshte se në roman do të njihje vehten .

Por veprimet e personazhit kryesor do të zhvilloheshin në ambientet më të ndryshme të jetës shqiptare dhe kështu do të mendonte për fenomenet që zhvilloheshin në to dhe për parimet estetike në bazë, të të cilave do të reflektoheshin. Pra në fakt sipas tij në këtë roman do të njihje jo vetëm vehten, por edhe shoqërinë shqiptare dhe do të formulonte parimet ideologjike dhe estetike. Ai kishte bindje se po mos të krijonte këtë vepër , nuk do të bëhej dot shkrimtar me kuptimin e plotë të fjalës. Në fillim të kësaj pune të madhe ndjeu një farë frike dhe dyshimi në zemër. Nuk kishte besim të plotë në do t'ia dilte në krye punës, prandaj, para se të fillonte, pyeti vehten: "Ç' gjë vallë më ka shtyrë të besoj se do të bëj diçka të veçantë mes njerëzve, se nuk do të kaloj në jetë si një njeri i rëndomtë?! Egoizmi, mëndjemadhësia, përfytyrimi i gënjeshtër i aftësive të mia apo vlera reale që ka qenë e fshehur tek unë? Nuk e di. Këtë dilemë do ta zgjidhë romani."

Kështu tha ai me vehte dhe u shtri të flinte.

Të nesërmen u zgjua i vendosur të fillonte punën. Me që jipte vetëm gjashtëmbëdhjetë orë mësim në javë (E kishte kërkuar vetë të ishte nën normë dhe kështu paguhej 400 lekë në muaj, tre qind më pak), e kishte rregulluar që orët e para të mëmgjezit të ishte i lirë dhe kështu të mund të punonte për letërsinë. Edhe atë ditë e fillonte mësimin vonë, prandaj, si u la e hëngri bukë, u ul në tavolinë, mprehu lapsat dhe u mat të shkruante. Nuk kishte besim, nuk ishte i sigurtë, nuk kishte vrrull dhe nuk po i ecte. U ngrit i shqetsuar dhe po shetiste nëpër dhomë. Pastaj dikur e gjeti fillin. Shkroi dhe mendimet i rrodhën me qetësi, shpejtësi, qartë,

pa tronditje. Lapsi lëvizte sikur po shkruhej ditari mësimor. Sytë e fytyra nuk shprehnin asgjë të veçantë. Ora e mësimit erdhi shpejt, prandaj u ngrit me ngut, mori librat dhe rendi në shkollë. Pasdite si hëngri bukë e pushoi, u ul prapë në tryezë me shpresë se puna do t'i vinte mbarë. Shkroi me lehtësi e shpejtësi shumë faqe, por pa pritur ndjeu diçka si ftohtësi. Hodhi kalemin dhe ndenji i palëvizur në karrike.

E kishte filluar romanin me një skenë dashurie, që ishte krijuar në bazë të dashurisë së tij me Jorgjetën. Ishte munduar të përshkruante dy të rij që dashuroheshin fort e sinqerisht, por nuk ia kishte arritur. Mori fletët dhe i lexoi. Gjithshka, që kishte shkruar, iu shfaq bajate, pa forcë.

U ngrit dhe po sillej nëpër dhomë i mërzhitur duke menduar se nuk shkruhej ashtu, se për Jorjetën kishte patur një dashuri aq të vagët, sa në bazë të saj nuk mund të krijohej asgjë në art, se romani nuk kishte filluar aty, ku duhej, se ndofta mund ta linte fare. Në antitezë me dashurinë për Jorgjetën atij iu kujtua Edi, dashuria për të. Përfytyroi një tip që do të mbështetej në tiparet e Besnikut të asaj kohe dhe u trondit. Iu duk se personazhi që do të dashuronte Edin, do të dilte një njeri i mrekullueshëm, me dëshirë e vrrull kolosal, i ngjashëm me Demonin, Hamletin, Faustin, se dashuria e tij ndaj Edit ishte vërtetë një dashuri e madhe, e rrallë, megjithëse ishte e paralizuar dhe se, po të ngrihej në art, do të krijonte një kryevepër botërore.

Ai ecte tani nëpër dhomë shumë i emocionuar me sy të ndezur, i bindur se kishte në shpirt një zjarr të pashuar, të pakrahasueshëm. U sul te tavolina, mori lapsin dhe filloi të krijonte me shpejtësi planin e një vepre të re.

Mendoi ashtu me fantazi të ndezur dy orë dhe besoi se planin e romanit e kishte gati, se frymëzimi i tij nuk mund të priste më dhe kështu duhej të derdhej që të nesërmen. Besniku sikur ishte po ai që i shkonte si i marrë Edit në senatorium.

Te nesërmen nuk kishte shkollë fare dhe u ul në tavolinë me besim të jashtëzakonshëm se do të bënte një kryevepër. Shkroi orë të tëra sipas tij me zjarr të madh, faqe të vërteta arti, që mund të barabiteshin me pjesët më të bukura të Dostohevskit, të Shekspirit, të Tolstoit. Sikur po shihte që fama e tij përhapej në gjithë botën. Por kjo gjendje nuk vijoi shumë. Filloi t'i dhëmbte koka, iu paralizuan mendimet, fantazia nuk i punonte më, sikur po i hapeshin trutë. Nuk mund të vijonte, prandaj e la penën. Ndjeu se diçka nuk ishte në rregull, por se çfarë konkretisht, nuk mund ta kuptonte. E quajti të nevojshme të shkëputej fare nga mendimet e romanit, prandaj u ngrit. Doli jashtë, mbylli derën dhe u nis për në qëndrën e

kooperativës.

Atje po bëhej mbledhja e kryesive të kooperativave, ku do të bisedohej për bashkimin e kooperativave në një të vetme. Dikush lajmëroi se po vinin të deleguarit. Për çudinë e Besnikut mes tyre ndodhej edhe Aliu duke biseduar me përzemërsi me fshatarët. Në këto çaste Besniku ndjeu ngrohtësi për anëtarin e Byrosë Politike, pse i ishte paraqitur dashamirës në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme të jetës së vet. Romani, që mendonte të shkruante, ishte lidhur shumë me këtë njeri. Ai jo vetëm do të ishte personazh aty, por shpresonte se do ta ndihmonte për ta botuar dhe do t'u priste hovin atyre që do të përpiqeshin ta pengonin.

Aliu që e vuri re qysh së largu, iu afrua me një pamje të përzemërt dhe i tha:  
-Këtu qenke gjithënjë ti, Besnik?

-S'e lëshojmë Besnikun ne-U hodh një plak me të qeshur-E kemi bërë fshatar.

Besniku i gëzuar u shkëput nga grumbulli i fshatarëve, i doli para dhe i shtrëngoi dorën me nxehtësi. Anëtari i Byrosë pastaj u përshëndet me fshatarët e tjerë. Përpara se të fillonte mbledhja, ai u takua prapë me arësimtarin. E pyeti si e kalonte në fshat, ç'po shkruante, pse nuk dukej fare në mbledhjet e shkrimtarëve dhe u gëzua kur mori vesh se po botohej një libër i tij. Besniku nuk i foli asgjë për romanin që përpiquej të fillonte se nuk dinte fare ç'do të bëhej me të.

Sjellja e anëtarit të Byrosë Politike me mësuesin u bëri shumë përshtypje disa fshatarëve dhe llogaritari u tha atyre:

-Ç'ju duket juve Besniku, ndonjë përshesh me dhallë?! E ka shprazur dhjetë vjeç!

Mbledhja po fillonte.

Besniku u ul andej nga fundi së atje fshatarët ishin më të lirë, hidhnin ndonjë thumb dhe bisedonin me të.

Besniku po kthehej shumë i kënaqur në dhomën se kishte marrë pjesë në një mbledhje shumë interesante, ku i kishte njohur më mirë problemet e fshatit dhe se kishte takuar Aliun. Tani nuk i dhëmbte fare koka dhe mëndjen e kishte të kthjellët. Hapi portën duke menduar gjithënjë për problemet e fshatarëve. Ndezi llampën dhe në tavolinë pa fletët e romanit të posafilluar. Ai ndjeu pakënaqësi të madhe ndaj atyre që kishte shkruar. Nuk kuptonte mirë, ku qëndronte e meta e atyre shkrimeve, por ishte i bindur se personzhi që mishëronte Besnikun, nuk ishte paraqitur drejt, se ishte i sëmurë shpirtërisht dhe mendërisht dhe nuk i ngjante aspak Faustit e Hamletit.

I mblodhi faqet dhe i grisi.

Tani pandehu se nuk e shkruante dot romanin, se kjo do të thoshte që nuk kishte talent, se ishte treguar mëndjemadh. Iu kujtua ajo ditë në Tiranë, kur kishte dashur të vdiste dhe ndjeu po atë dhëmbje. Vështroi gotën dhe mendoi një grimë se po të ishte helm, ndofta do ta pinte, ashtu si kishte dashur të bënte Fausti dikur. Po papritur qeshi me vehte, u tall se po mirrte pozën e Faustit. U ngrit, eci nëpër dhomë dhe mendoi:

"Më tepër se gjithshka njeriu duhet të pëlqejë të vërtetën dhe për atë të përpiqet. Nuk dua të gënjej as vehten, as të tjerët. E pra po të zbuloj në këtë çast se jam një njeri pa asnjë vlerë të veçantë, kjo më tepër duhet të më gëzojë se sa të më hidhërojë, se fundi e njoha të vërtetën rreth vehtes. Njeriu kurrë nuk mund të dalë jasht natyrës së vet se e pëson si bretkoca që desh të trashet sa një ka. Vërtetë më vjen keq se nuk u shërbej shumë njerëzve, por e pamundura nuk mund të bëhet. Jeta edhe si njeri i thjeshtë është e ligjshme dhe e bukur."

Ai e largoi mendimin për romanin dhe po pregatitej me zell për mësimet e nesërme. Pastaj rregulloi dyshekun, ra të flinte dhe shpejt e zuri gjumi. Të nesërmen gdhju po me atë mendje. Dha mësim dhe pasdreke pregatitej të shkonte në Tiranë se ishte e shtunë.

Iu kujtua intermimi. U ul në karrike duke përfytyruar me hollësi personazhet në intermim, tipat e atjeshëm. Iu krijuan në fantazi skena të bukura dhe ngjarjet e bisedat rridhnin vevetiu, prandaj një entuziazëm i vërtetë ia ndezi shpirtin.

Nga larg u dëgjua buria e trenit. Ai vrapoi në stacion.

Hypi në tren dhe aty mes njerëzve mendoi se ndofta romanin nuk e bënte dot, porse mund të shkruante kujtime të bukura.

Kur zbriti në Tiranë, kishte vendosur që posa të kthehej në fshat, të fillonte të shkruante vetëm për intermimin.

\* \* \*

Me t'iu afrua portës së shtëpisë, iu larguan mendimet për letërsinë. Ai ndjeu se kishte ardhur çasti, kur do të grindej me pjestarët e familjes për çeshtjen e Luizës. Hapi portën i shqetësuar. Në kalldrëmin e oborrit po ecte njeriu që ndofta donte më tepër në këtë botë, nëna. Ajo kishte një pamje krejt të ndryshme nga herët e tjera. Fytyra e saj dukej e ngrirë, sytë të palëvizur, të mekur, si të ndonjë të vdekuri. Mbante në dorë një qypshe uji dhe po shkonte në çesmë ngadalë fort, sikur ngrihej nga shtrati pas

një sëmundje të rëndë dhe këmbët mezi e mbanin. Nuk ngriti kokën, kur u çel porta, sikur ta dinte kush hyri. Përshëndetjes së djalit nuk iu përgjegj, por lëvizi buzët pa zë. I biri e kuptoi shkakun pse nëna i qëndroi aq ftohtë. Shkoi në sallon, u ul në minder. E ëma i kaloi para si kufomë pa i folur fare, u fut brënda në kuzhinë dhe nuk po dilte. Ai u ngrit, vajti te dera e kuzhinës dhe e pyeti:

-Ç'ke, o nënë, kështu?

-Jam sëmurë... -Pëshpëriti ajo.

Atij iu duk qesharake kjo përgjigje, se nuk e dinte fare zhvillimin e ngjarjeve, prandaj vuri buzën në gaz dhe pyeti prapë:

-Pse nëkon?

-Kam zemrën e ftohtë-U përgjegj ajo.

Kaloi pranë tij e heshtur dhe hyri në dhomë që të binte në shtrat, ku kishte ndenjor gjatë gjithë javës. Besniku po mendonte në sallon se ç'kishte ndodhur vallë, pasi i kishin thënë mendimin e tij, kur u hap porta dhe hyri motra e martuar. Ai i doli para dhe i zgjeti dorën, por ajo e qortoi e pezmatuar:

-S'ta jap fare dorën, ma ke prishur zemrën. E cilën do të marrësh për grua ti, o vëlla, kurvën?! Pse nuk paska Tirana goca të tjera për ty?! Hidh sytë, o qorr, e shiko! Rrugët janë plot vajza të reja, të freskta, ti merr grua të martuar me fëmijë, atë që të ka tradhëtuar. Unë jam femër dhe nuk ia hedh sytë burrit që më del nga fjala dhe jo të martohem me të. A je në vete apo jo?! -Përfundoi ajo me një farë zemrimi.

Vëllai nuk u shqetësua, buzëqeshi, bile i jipte edhe ca të drejtë, se e dinte që këtë qëndrim do të mbante ajo derisa kishte karakter të qëndrueshëm dhe i urrente dobësi të tilla si të Luizës.

-Pse të la? Pse shkoi të martohej me të?! -Filloi prapë.

-E shtynë rrethanat. -E shfajsoi Besniku.

-Çfarë rrethanash?! Të thoshte drejt e në polici:Ja do të vdes, ja do të marr burrë Besnikun. Po ishte bisht lojtur dhe i pëlqente të bridhte.

-Përsëri ajo është e mirë.

-Ec në shtëpinë time dhe ta tregoj unë mirësinë e saj.

Ajo e mori me vehte duke e sharë burrin e vet që pranonte këtë martesë. I kishte pëlqyer Luiza atëherë, por dobësinë e saj nuk mund ta justifikonte. Ata ndenjën vonë, u grindën shumë, por pa dobi.

Nga mesnata Besniku u kthye në shtëpi. E ëma flinte. U zhvesh, fiku dritën dhe u shtri pa fjalë. I rrinte në sy e ëma me fytyrë të ngrirë, të brengosur, që ecte

ngadalë, fort ngadalë me qypshen në dorë dhe sikur i buçisnin veshët nga fjalët e motrës: "Cilën do të marrësh për grua ti, o vëlla, kurvën?", "Unë jam femër dhe nuk ia hedh sytë burrit që më del nga fjala dhe jo të martohem me të." Vuante, përpëlitej, kthehej sa në një krah në një tjetër, por ishte e pamundur ta qetësonte shpirtin. Vonë, shumë vonë e zuri gjumi. Andej nga mëngjezi iu shfaq në ëndërr babai që kishte vdekur para shumë vitesh. Iu fanit i gëzuar, fytyrë qeshur, sikur po bënte një punë shumë të rëndësishme dhe iu drejtua të birit plot vrrull, dashuri, vendosmëri.

-Hajde, Besnik, e mbarojmë këtë punë.

U zgjua e hodhi sytë për rreth. Ishte në dyshek e sa po zbardhte. Kishte parë ëndërr babanë pas shumë vitesh. Ishte i lehtësuar dhe i gëzuar. Nuk e ndjente dhëmbjen e madhe të peshës që e kishte shtypur në darkë. E pyeti vehten pse vallë i ishte shfaqur babai. Sigurisht nuk besonte në ndikimin e një fuqie të mbinatyrëshme. I jati i ishte ngulitur në mendje si njeri shumë i mirë, që e vështronte thellë jetën dhe rrjedhimisht ndofta, po të kishte qenë gjallë, do të arësyetonte, do ta pranonte, do ta përkrahte. Pse e gjykonte të tillë, prandaj vetë ndërgjegjja e tronditur ia kishte sjellë në ëndërr. Endrra e kishte bërë më të vendosur. Zbardhi, lindi dielli dhe gjumi nuk e zinte më. Vuri re se e ëma lëvizte shpesh. Mendoj se ndofta edhe ajo nuk flinte dhe nuk ishte i gabuar. Nëna Sania mezi ç'priste që të zbardhte gjithë hidhërimin e saj.

Gjatë kësaj jave ishte bindur edhe më tepër se martesë e djalit me Luizën do t'i zezonte jetën atij dhe asaj. Në rrethin e vet kurrë nuk kishte ndodhur që një djalë të mirrte grua të ndarë me një fëmijë pas, prandaj i bëhej se po e mbulonte një turp i madh, sikur pas kësaj martesë nuk kishte ç'e donte jetën më. Shkurt, nënë Sanijes i bëhe se po përmysej bota.

Kur Besniku po vishej, hodhi jorganin, u ngrit në të ndenjtur dhe duke shpresuar fare pak se do t'ia kthente mendjen, iu derdh me dëshpërim të madh, sikur ai të kishte vdekur dhe ajo e vajtonte:

-Ç'ka marrë vesh nëna, bir. Me kurvën do të martohesh dhe do të shkosh jetën, bir. Ajo të bjen kopilin prapa dhe është turp prej gjithë dynjasë, bir. Po nëna jote donte të martonte si gjithë njerëzit, të bënte dasëm dhe të kërcente, bir. Po tani më mirë të vdes se nuk rroj me gjithë këtë hall, bir. Hiq dorë, hiq dorë se do të bëj haram qumshtin e gjirit që të kam dhënë, bir!

Besniku u prek nga fjalët e fundit dhe e quajti nënën shumë të padrejtë. Ngriti kokën dhe i bërtiti me zemrim:



-Bëj ç'të duash. Unë kështu jam.

-Ti nuk je i keq, por ta bën koka, bir. Dëgjoje një herë nënën se nuk e ke dëgjuar kurrë, bir! Ja më jep zhivë e më mbyt me dorën tënde se nuk mund të rroj me gjithë këtë zehër, bir. A merr vesh, a dëgjon, a je rob zoti?! Më mbyt me dorën tënde, se nuk mund të duroj dhe pastaj martohu...

Nëna mbuloi fytyrën me pëllëmbët, uli kokën dhe u shkreh në vaj.

Po Besnikut nuk ju dhemb aq shumë, se ishte i bindur që vuante kot. Doli nga dhoma se nuk e duronte të qarët. Në sallon aty më këmbë po rrinte motra e vogël me sy të përplotur dhe bënte sikur rregullonte tavolinën. Asaj i shpërthyen lotët, kur nëna e kërcnoi të vëllanë të hiqte dorë nga martesë se do t'i bënte haram qumshtin. Ktheu kokën nga i vëllai dhe e pa ashtu me sy të përplotur. Ai i nguli vështrimin e rreptë një çast dhe pa i bërë zë, kaloi sallonin, oborrin, hapi portën dhe u gjend në rrugë.

Ishte i dëshpëruar. Zëri i nënës i jehonte i përvajshëm, plot dhembje: "Hiq dorë se do të bëj haram qumshtin e gjirit!" Vëllai, motra e martuar dhe sidomos nëna kërkonin mos ta mirrte Luizën dhe i kishin thënë se po të ishte pa fëmijë hajde de, por me një çilimi pas nuk bënte fare. I tingllonin në vesh fjalët e nënës: "Ajo të bjen prapa kopilin!" "Ju përfytyrua Kozeta ashtu si e mbante mend në takimin e parë." "Ajo krijesë e vogël është shkaku i të gjithave. -Tha ai me vehte- Po vallë ç'faj ka ajo që njerëzit janë të egjër me njeri tjetrin, se u sollën mizorisht me të, kur akoma ishte në mitër?! Jo, kurrë nuk do të braktis as Luizën, as Kozetën! E dua nënën dhe lumturinë e saj, por nuk mund të bëj fli jetën time, të Luizës dhe të Kozetës për hir të paragjytimeve dhe të ngushtësisë së saj. Është e dhembshme të shkosh kundra nënës, po për hir të së drejtës do ta bëj. Ndofta do të vij rasti dhe t'ia shpërblej diçka këtë hidhërim dhe dashuria ime do të jetë më e madhe, më e ngrohtë, më e thellë"

Ai ecte rrugës me sy të trishtuar, i heshtur. Nuk vaji fare në shtëpi atë ditë. Hëngri drekë në rostiçeri dhe pas dite u takua me Agimin. Atë muaj ishte botuar një kritikë e shokut, ku çmohej shumë poezia e Hamitit. Kritika kishte bërë përshtypje në qarqet kulturele dhe e kishte ngritur mjaft autoritetin e tij si kritik. Sukseset në aktivitetin letrar i kishin lidhur akoma më shumë dhe ata e ndjenin më tepër nevojën për njeri tjetrin.

Besniku i tregoi se ç'i kishte ndodhur me romanin, kurse për çështjen familiare heshti. Agimi e dëgjoi me vemendje, i tha se puna ishte në proces dhe i dha të lexonte një artikull të Belinskit. Besniku u kthye në shtëpi andej nga ora dhjetë.

Poshtë nuk kishte njeri, kurse lart te vëllai kishte shumë zhurmë. E kuptoi se ishte mbledhur gjithë familja, se ndofta bisedonin çeshtjen e martesës së tij, por hyri në dhomë pa u merakosur, se e kishte mendjen te romani. U ul në tavolinë dhe e përpiu artikullin e Belinskit duke ndaluar me vemendje te rreshtat e nënvizuara. I bënë përshtypjet përcaktimet për tipin romantik dhe qëndroi në këtë paragraf:

"Kush në rini nuk ëndërroi, nuk u hodh në krahët e gënjeshtres, nuk rendi pas hijeve dhe kush nuk pati diziluzion? Kujt këto diziluzione nuk i shkaktuan vuajtje dhe kush pastaj nuk qeshi me ato me gjithë shpirt? Por për natyrat e shëndosha është e nevojshme llogjika praktike e jetës dhe eksperiencia. Ata kështu zhvillohen, piquen, burmohen, kurse romantikët shkatrohen."

Ai mbeti i mahnitur nga këto fjalë dhe shpjegoi krejt karakterin e tij. Mendoi se kishte qenë një djalosh plot ëndrra, shpesh me shpresa të gënjeshttra dhe praktika e jetës e kishte zhveshur nga iluzionet e kota e po e bënte gjithënjë e më tepër realist. Ai përfytyroi skena të ndryshme dhe përcaktoi ligjin e zhvillimit të brëndshëm psikologjik të personazhit kryesor. Ai

do të kalonte nga bota e romantizmit në atë të realizmit, nga subjektivizmi, në objektivitet si në art dhe në jetë. E ndjeu vehten aq shumë të gëzuar sa i bëhej se romanin e kishte shkruar dhe ndodhej aty në tavolinë.

Njerëzit po zbrisnin dhe ai doli në sallon që t'i takonte. Ata u çuditën se ishte i qeshur, se u suall sikur nuk kishte ndodhur asgjë.

Të nesërmen Besniku u kthye në Lals. Të pasnesërmen filloi të bënte planin e romanit. Pas tri javësh filloi të shkruante, por nuk e kishte aq të lehtë sa e kishte përfytyruar në Tiranë. Pasi shkroi dy javë të tëra, nuk kishte një mendim të prerë për vlerën e punës që bënte, por vijonte duke menduar se po përshkonte atë rrugë, që ishte e domosdoshme qoftë si eksperiencë.

Besniku dëshëronte të martohej atë vit, prandaj vendosi të bëjë prezantimin e Luizës me familjen me qëllim që martesë të dukej sa më e natyrshme. Pengesa kryesore si gjithënjë ishte nëna. Ai vendosi që në fillim ta shpinte Luizën në shtëpinë e motrës dhe të far e fisit, Nëna, duke parë se të gjithë do ta kishin futur brënda nusen e djalit, do të përkulej dhe do të pranonte. U muar vesh me kunatin në telefon dhe i vajti në shtëpi. Fatimja, sado që kishte kundërshtuar rreptësisht, buzëqeshi dhe e fejuara e vëllait tamam si atëherë iu duk e thjeshtë, e urtë, e mirë. Si hëngrën llokume, pinë limonatë dhe kafe çifti i ri, u ngrit të shkonte në shtëpinë e dajës, ku u pritën shumë mirë. Bënë edhe një dy vizita të tjera dhe dolën të shetisnin në

bulevard.

Në këtë kohë ishin mbledhur te Kadriu dy motrat, dhëndëri, daja e të tjerë dhe bisedonin rreth Luizës. Kadriu, që kishte refuzuar të prezantohej me Luizën, ngulte këmbë që për të mirën e Besnikut dhe të gjithë rrethit familiar, të pengohej me çdo mënyrë kjo martesë duke arritur gjer atje sa t'ia mbyllnin portën vëllait e mos t'i flisnin më me gojë. Por të gjithë e kundërshtuan, shfaqën mendimin se vajza nuk u ishte dukur e keqe. Atëherë Kadriu e kuptoi se martesë e mirë apo e keqe duhej të pranohej, se ishte budallallëk të ngulte më këmbë dhe u spraps.

*E nesërmja zbardhi shpejt. Atë ditë do ta prezantonte Luizën me vëllanë dhe nënën. Të fejuarit mezi pritën të vinte ora e caktuar për vizitë dhe e hapën portën të shqetësuar. Njeriu i parë, që takuan në oborr, ishte nëna. Edhe ajo mezi e kishte pritur këtë çast. Natën e kaluar duke parë se të gjithë po e pranonin Luizën, i ishte dukur e lehtë dhe e kënaqshme vizita e saj, por sa më tepër kalonin orët, aq më e rëndë i bëhej. I kujtoheshin të gjitha anët negative të kësaj martesë dhe zemra i ngushtohej. Friksohej shumë për të ardhmen e saj dhe të djalit, prandaj erdh e u mpi dhe u bë si trung nga hidhërimi, sikur të ishte e ngrirë.*

Lëvizte shumë ngadalë, tiparet e fytyrës së saj u ngurosën, sikur të kishte vënë një maskë të palëvizshme. Sytë iu zvogëluan, iu futën thellë, mezi i lëshonin një dritë të zbetë plot dëshpërim. Këtë pamje kishte, kur hyri djali me nusen, prandaj ishte e natyrshme që të rijtë të tronditeshin, sikur paraqitja e saj t'i fliste për diçka misterioze. Nëna hodhi vështrimin e zbetë dhe të piklluar mbi Luizën. Si në mjergull iu kujtuan tiparet e vajzës së dikurshme dhe ndjeu mëri ndaj asaj femre, që i kishte hutuar dhe grabitur djalin, që ndofta do t'ia shkatërronte pjellën. Por meqenëse gjithshka kishte marrë fund dhe ishte e pafuqishme kundër asaj që kishte bërë emër i madhi Zot (Si thoshte ajo tërë mëngjezin) u afrua ngadalë, sikur t'i kishte këmbët të ngrira dhe pëshpëriti shumë, shumë ulët me zemër të thyer:

-U trashëgofshi!

Besniku psherëtit i lehtësuar. Sido që të ndodhte, e ëma e kishte dhënë fjalën dhe nuk do ta kthente.

Të rijtë u ngjitën lart. Kadriu i priti pak ftohtë, si në zyrë, por mjaft i sjellshëm. I hodhi një sy Luizës dhe u çudit se si ajo kishte një jetë të çrregullt pse në pamje i ngjau shumë e thjeshtë dhe e urtë. Pastaj filluan bisedën duke u ngecur fjala. Më në fund Kadriu i këshilloi të kishin kujdes në jetë, se jeta nuk ishte fushë me lule, se do të hasnin pengesa, por gjithënjë duhej të ishin të bashkuar dhe të kalonin të lumtuar, se të kaluarës si do të kishte qenë, duhej t'i vinin pikë dhe të vështronin

të ardhmen. Fjalët e tij ishin të sinqerta, besonte se kështu po i ndihmonte ata. Të rijtë u vështruan në sy. Një buzëqeshje fort e lehtë shkëlqeu në çipat e buzëve të tyre. Pastaj dolën në dhomën tjetër, ku do të takoheshin me nënën.

Aty ishte vetëm motra e vogël. Besniku zbriti poshtë të kërkonte nënën dhe e gjeti në kuzhinë duke u falur. Ai eci ngadalë që mos e shqetësonte, u ul në karrike dhe po priste me durim.

Nëna e tij nisi të falej shumë e tronditur. I trembej të ardhmes dhe i lutej Zotit që ta ndihmonte. Falej për gjynahet që mund të kishte bërë, për të cilat sipas saj ndofta Perëndia po e ndëshkonte. Falej që fajet mos të binin në kokën e djalit, që ai ta

kalonte mirë dhe nuses t'i jipte mëndjen e hajrit. Ajo lutej që gjithshka të shkonte bukur e mirë, ashtu si dëshëronte zemra e një nëne dhe shpresonte se Perëndia e madhe nuk do ta neveriste atë në pleqëri, se do t'i vinte gjynah për një copë plakë të humbur.

Kështu si derdhi dëshirat e saj në lutjet fetare, u ngrit gati si njeri tjetër. Paragjykimet ishin mposhtur. E shtytur nga dashuria ndaj të birit, ajo kishte vendosur ta pranonte martesën, ashtu si po i vinte dhe dëshira e saj e vetme ishte që të këqijat të mirrin fund dhe e ardhmja të ishte e mirë. Për këtë i ishte lutur Zotit. Nuk mund të dyshonte në mirësinë e Tij, prandaj kishte besim se edhe atë nuk do ta dënonte, por do t'ia plotësonte dëshirat.

Nuk ishte si më parë e ngrirë dhe e ngurosur. Tiparet i ishin gjallëruar, fytyra sikur i ishte shkrirë dhe ndriçonte. Sytë i ishin çelur dhe lëshonin një dritë të ngrohtë plot dashuri. Asaj sikur i kishte rënë një nur i shejtë. U kthye nga i biri pra me këtë pamje.

Besniku e kuptoi se ç'tronditje të madhe kishte e ëma, gjersa falej në këto çaste, prandaj u mallëngjye shumë. Iu hodh në qafë dhe i heshtur e shtrëngoi fort. Sytë iu përlotën. Edhe ajo e shtrëngoi. Emë e bir ndenjen ashtu një çast të përquafuar. Pastaj nëna u shkëput që të takonte nusen. E hapi derën me buzë në gaz, me sy të qeshur. U drejtua nga Luiza, e zuri në grykë dhe e uroi me gjithë zemër:

-U trashëgofshi!

Pastaj u kthye nga i biri, e mori edhe atë më qafë dhe i foli fare e qetë, nga zemra:

-U trashëgofshi!

Besniku e shtrëngoi me dashuri dhe sytë e tij prapë u përlotën.

Dhe u ulën të katër. Nëna e pyeti Luizën për familjen e saj dhe po bisedonte

me të si me të bijën. Besniku e ndjente vehten të lumtur si rrallë herë dhe mendonte se tani e tutje kurrë nuk do të kishte kundërshtime të rëndësishme me nënën.

## IX.

Besniku hëngri bukë shpejt e shpejt se në ora tre do të shkonte në plenumin e shkrimtarëve. Me që libri i tij ishte futur në procesin e botimit, kishte filluar të ndiqte mbledhjet e shkrimtarëve, ku nuk e ndjente vehten të huaj dhe të tjerët nuk e quanin të tepërt. Herë herë shkonte edhe në klub për të takuar shokë. Ndëgjonte bisedat që zhvilloheshin në ndonjë tavolinë dhe vetë ndërhynte pak.

Te porta e klubit u takua me Agimin dhe të dy e tokën me buzë në gaz. Edhe shoku ishte nisur në plenumin e poezisë. Kohët e fundit ai kishte botuar ca artikuj kritikë që ishin çmuar nga shumë intelektualë si tepër të mirë. Agimi kishte filluar të mirte pjesë në jetën intelektuale të qytetit dhe nuk e ndjente vehten të huaj mes njerëzve të artit dhe të letërsisë. I përpirë nga kritika letrare ai kishte hequr dorë dhe gati i kishte harruar krijimet muzikale.

Besniku u shkëput nga Agimi dhe i doli para Ismailit që po vinte ashtu si gjithënjë diçka i ndrojtur me një buzëqeshje të lehtë. E përshëndeti gjithë gëzim dhe i foli:

-Këto ditë lexova fragmente nga libri yt që u botuan në revistë. Ta them sinqerisht: kam patur festë në shpirt. Aty njerëzit flasin e veprojnë natyrshëm, pa pikë artificialiteti. Tek ju përshkruhet jeta ashtu siç është.

Sytë e Ismailit ndriçuan.

-Më bëhet qejfi shumë nga këto lëvdata. Unë ty të besoj edhe nga një anë tjetër, se ti e ke njohur luftën. Po mjaft njerëz thonë se aty nuk ka krijim artistik.

-Kjo nuk është fare e vërtetë. -Kundërshtoi Besniku -Aty nuk ka krijim artificial. Vërtetë mund të kishte një shoshitje, një tretje më të mirë të ngjarjeve, fakteve, por aty ka vërtetësi, nuk ka montim, ka art. E dini se në shumicën e romaneve tona gjen shumë pak faqe artistike?

-Jo... Ç' thua kështu?! -Kundërshtoi me një buzëqeshje Ismaili.

-Po... Po... Kështu është. Dhe ne duhet ta themi të vërtetën. Kurse librit yt në përgjithësi është vepër arti.

-Të falem nderit shumë! .. Të falemderit shumë! Ti po më mburr mua, por të tjerët i hodhe poshtë! Po vete ç' ke shkruar? ... Sikur mora vesh se kishe një roman në dorë... .

-Po... Po krijoj një roman që përshkruan jetën e shkrimtarëve... .

Ismaili pati një turbullim se dikush i kishte thënë se çfarë problemesh trajtonte vepra, po prapë i foli:

-Gëzohem shumë. Kur ta kesh mbaruar, dua ta lexoj edhe unë... .

Ata hynë në sallë.

Atje në krye po fjaloseshin një grumbull shkrimtarësh, mes të cilëve ndodhej Filipi, që tani kryesonte Lidhjen e Shkrimtarëve, Andra, Telhai. Në çip të sallës ishin mbledhur një grup poetësh të rij, që njiheshin tani mirë nga lexonjësi dhe bisedonin lirisht me njeri tjetrin pa e çarë kokën kush ishte në sallë. Mes tyre ishte edhe Hamiti që kishte fituar famë edhe më të madhe me poezinë e tij.

Hamiti nuk e kishte atë pamjen gati gati prej turisti të huaj. Nga veshja nuk dallonte aspak me të tjerët dhe bile këpucëve të tij i ishin ngrënë thembrat në mënyrë të pahijshme. Ai nuk xhironte më filma dhe aparatën fotografik e kishte shitur. Poeti i ri nuk e ndjente më atë angushti mbytëse, megjithëse jeta e Shqipërisë gjithënjë nuk ishte ajo e qyteteve të mëdhej. Bile ai po zhutej gjithënjë e më tepër në problemet praktike të saj. Sytë e tij nuk ishin më aq të gjallë, si të etur, por ishin më seriozë dhe shëndritnin me një shkëlqim plot mënçuri dhe mprehtësi. Ndjenjat i ishin ekuilibruar edhe pse pak kohë më parë ishte fejuar me një vajzë të bukur.

Besniku e Hamiti u takuan me përzemërsi. Në këtë kohë Skënderi iu afrua Besnikut, i shtrengoi dorën fort dhe i tha:

-Ç'është kështu? Fillove prapë të na sulmosh?! Kam dëgjuar se po shkruan një roman raketë, ku kemi nderin a fatkeqsinë të jemi të gjithë personazhë.

Ai shtoi me një ton recitativ enfatik:

-Ljubi nadjezhni, tihi ljubi na dollgo nas ne obmanull.\*

Në këtë çast në sallë hyri Edi.

-Ç'është kjo?! -U habit Skënderi-Po na mblidhen miqtë e vjetër.

Edi nuk ishte më vajza e dikurshme konviktoze me grykëse të zezë, romantike, me sy melankolikë dhe fytyrë pak si të verdhë. Ajo ishte martuar dhe pamja e saj kishte ndryshuar krejt. Tani ishte grua e zhvilluar, plot shëndet, fytyra i ishte mbushur dhe çelur, sytë i ndrisnin me kënaqësi dhe qetësi. Ecte më natyrshëm, po

\*Shpresat e dashura, dashuritë e qeta, gjatë nuk na gënjen.

më imponante. Kohët e fundit kishte filluar të mirrej me letërsi, prandaj e kishin ftuar në mbledhje. Andrea, që ishte interesuar direkt për pjesëmarrjen e saj, i doli para dhe i dha dorën plot përzemërsi.

Në këtë plenum do të diskutohej zhvillimi i poezisë gjatë këtyre dy vjetëve të fundit dhe të gjithë e ndjenin se mund të shpërthenin hapur kontradiktat që viheshin re në krijimet poetike. Referati i ishte ngarkuar një profesori të Universitetit dhe jo rastësisht pikërisht atij. Profesorin e mbanin gati si kritik të paanshëm. E pëlqente poezinë e Hamitit dhe të poetëve të tjerë të rij, por nuk mahnitej prej saj dhe njëkohësisht çmomte poezinë e Mihalit, të Andreas, të Tehlait, të Skënderit dhe të të tjerëve. Këtij pra si pa dashur i ishte ngarkuar referati si mjet ekuilibri, për t'u ruajtur nga ekstremitetet.

Referati ishte tamam ashtu siç pritej. Aty analizoheshin në përgjithësi vëllimet e fundit të Andreas, të Telhait, të Hamitit dhe një të riu tjetër dhe të gjithë çmoheshin në mënyrë të konsiderueshme. Andrea dhe Telhai lëvdoheshin për tematikën e rëndësishme, për lidhjen me problemet madhore aktuale dhe kritikoheshin se në disa poezi binin gati gati në prozë pa ndjenja. Poetët e rij dhe sidomos Hamiti, lëvdoheshin se sillnin në poezi nota të reja, tema të reja, freski dhe pastaj kritikoheshin ca për vargun e çregullt, për hermetizëm e paqartësi. Referati ishte i ftohtë dhe nuk ngjalli asnjë emocion të vërtetë.

Pas një pushimi të shkurtër shumica e pjesmarrësve zunë vend me mërzi. Ata ishin të rrevoltuar se në këtë plenum po thuheshin gjëra bajate dhe nuk po realizoheshin parashikimet e tyre. Por shpejt u bindën për të kundërtën. Zjarrin e ndezi Telhai. Ai e kishte përgatitur me shkrim diskutimin kundra disa të rijve dhe sidomos kundër poezisë së Hamitit.

Telhai dhe Hamiti punonin të dy në Lidhjen e Shkrimtarëve, bile në një zyrë. Ata ishin të ftohtë me njeri tjetrin, bisedonin vetëm për punët e gazetës që mxirmin, bënë ndonjë shaka dhe i fshihnin kundërshtimet. Vetëm më të rrallë kishin patur ndonjë grindje të vogël që kishte shprehur tërthorazi se ç'ndjenin për njeri tjetrin. Thelbi i kësaj ftohtësie ishte vepra letrarë, pra konsiderata për vlerën e njeri tjetrit. Për Hamitin poezia e Telhait ishte krejt pa vlerë dhe loste një rrol regresiv. Nuk e honepste as si njeri, pse gjykonte të ngushtë, meskin dhe cmirëzi. Telhai e ndjente se ç'opinion kishte Hamiti për të dhe sigurisht kjo ia shtonte pakënaqsinë ndaj veprës së tij. Ai mendonte se Hamiti kishte një farë talenti si gjithë të tjerët, por jo kushedi se çfarë. Nga ana tjetër atij s'i pëlqenin vargjet e thyera, e rrevoltonin disa figura ekstravagante, vendet e mjergullta dhe disa herë kujtonte se veç atyre

s'kishte gjë tjetër poezia e Hamitit. Gjithashtu nuk i pëlqente fare se poeti para se të fejohej, kishte patur marrëdhënie me disa femra. Nga të gjitha këto ai ishte i bindur se poezisë shqipe po i vinte një rrezik, prandaj kishte vendosur t'i dilte para së keqes. Duke patur bindje se kishte plotësisht të drejtë, zuri vend si gjithënjë në podium me një pamje impozante, të sigurtë në vete dhe filloi:

-Unë dua të flas pak rreth disa problemeve të poetëve të rij dhe sidomos të Hamitit. Për anët e tyre të mira këtu u tha mjaft dhe unë mund të shtoja edhe të tjera, por qëllimi i diskutimit tim është të vë gishtin në disa të meta, të cilat mund t'i dëmtojnë shumë të rijtë. E kam fjalën sidomos për "vargun e lirë", që kohët e fundit është bërë shumë pretencioz, që kërkon të thyej normat tradicionale të metrikës nën pretekstin e një farë novatorizmi. Ky fakt nuk duhet shikuar se një çeshtje thjeshtësisht formale, por si një goditje që i bëhet esencës kombëtare të poezisë sonë. Shpesh në këtë lloj poezije gjen mjegullime, përçartje, figura ekstravagante. Duket sikur vetë të shkruarit ekstravagant është në thelbin e kësaj poezije. Është rasti që ne të kujtojmë futurizmin dhe fatin e tij, Kjo rrugë atje të shpie. Mos të harrojmë se nga pikëpamja filozofike futurizmi ka lidhje me instiktin e Frojdit, me poezinë puro të Kroçes që degjeneron në poezi te Marioneti. Unë do t'i dokumentoj konkretisht këto të meta të të rijve.

Dhe ai lexoi shumë vargje të errta, figura ekstravagante, që i kishte kërkuar me kujdes në vëllimet e poetëve të rij. Mes shembulla që solli, lexoi për të keq edhe figura të bukura, gjë që shkatoi indinjatën e pjesmarrësve.

Telhai mbaroi me një farë ndjenje triunfi. Shpresonte që mbledhja do ta përgëzonte, por nuk ndodhi kështu. Duartrokitën shunë pak njerëz, gati fare formalisht. Telhai e vuri re me bisht të syrit se Aliu nuk i lëvizi fare duart. Në sallë ra një atmosferë e rëndë. Shumë poetë të rij u ngrysën, u humbi gjallëria. Besniku i tha Agimit në vesh:

-Në sulmin që na bëri dikur neve, ishte më i ndershëm.

Andrea që e kishte aprovuar këtë diskutim, duke parë se mbledhja nuk e priti mirë, i tha Mihalit:

-Më duket se u tregua pak ekstremist.

-Sigurisht. Nuk jam dakort të shtrohet ashtu problemi. -U përgjegj tjetri.

Filipi qëndronte gjithënjë i qetë, kurse Ismaili u zymtua pak.

E mori fjalën një djalosh që njihej si kritik dhe diskutoi për poemat me subjekt e pa subjekt. **Pasta foli edhe Andrea për lidhjen e poezisë me aktualitetin, për thjeshtësinë e saj. Mbledhja e dëgjoi fjalën e tij me indiferencë, pse priste të**



prekeshin problemet që kishte shtruar Telhai, por shpejt edhe kjo ndodhi.

Hamiti u ngrit nga vendi dhe u drejtua ne podium. Një farë gjallërie u ndje në sallë. Një pjesë e madhe u gëzuan se e parashikuan që Telhai do të mirrte një përgjigje të merituar. Hamiti me një pamje të thjeshtë filloi me një zë të ulët e të qartë:

-Unë nuk kisha ndërmend të diskutoja, por Telhai ngriti këtu një problem që ka rëndësi parimore. Nuk e kam fjalën te disa shembulla që solli. Çdo poet ka vargje të dobta. Çështja është te fryma me të cilën diskutoi ai. Ishte fare e qartë, m'u duk mua, se Telhait nuk i pëlqejnë vargjet e disa poetëve të rij dhe të mijat personalisht. Po mirë. Nuk ka asgjë të keqe. Çështje gustoje fund i fundit. Po të ngrësh teza teorike për t'i hedhur poshtë në emër të estetikës marksiste nuk lejohet dhe është një punë jo e hishme. Ai u nis nga vargu. Por arti së pari është brendi dhe këtej duhet të nisemi. Unë mendoj se përmbajtja e re ka sjellë disa forma të reja shprehje herë me sukses, herë pa sukses.

"Thonë kemi çthurur vargjet. Po. Metra dhe ritme të shejta nuk ka. Ka ide të mëdha, ka përmbajtje të madhe dhe të shejtë dhe për këtë kemi folur në vargun tonë të lirë. Vargu i lirë u lidh këtu me futurizmin dhe Kroçen. Po të nisemi nga këto pozita formaliste, atëherë duhet të pohojmë se vargjet e rregullta kanë lulëzuar me tërë akademizmin e tyre pranë oborreve mbretërore. Duke u nisur nga pozita formaliste, poetin e madh proletar, Majakovskin, e akuzuan për filo amerikan. Dhe këtë akuzë është sinjifikative e bënin tamam të patalentuarit. Telhai godet këtu poezinë e poetëve të rij (Nuk është fjala vetëm për timen) dhe nuk tha asnjë fjalë për poezitë e dobta me varg të rregullt dhe bile më ndonjë kritikë i ka lëvduar. Kështu në emër të rutinës, të vargjeve klishe ai po godet diçka të mirë. Dhe kjo do të thotë në fund të fundit t'ia presësh rrugën poezisë së re.

Hamiti vijoi të flasë kështu me nënteks kundër poezisë së Telhait, Andreas e të tjerëve. Kur mbaroi, shumica rrahu shuplakë me entuziazëm. Salla u gjallërua. Poetëve të rij u shkëlqente fytyra. Aliu prapë nuk duartrokiti, por kishte një pamje të gëzuar. Agimi i tha i buzëqeshur Besnikut:

-Ç'jua dërmoi samarin!

Telhai heshte i tronditur. Fytyrës së Andreas i kishte rënë një i zbetë i lehtë. Ismaili kishte po atë pamje të hidhëruar. Dhe Filipi ishte gjithashtu i qetë. Të pranishmit akoma duartrokisnin, megjithëse u dha lajmi për pushim dhe një pjesë u ngritën. Besniku kur po dilnin, e takoi Hamitin dhe i shtrëngoi dorën për diskutimin. Ai desh t'i thoshte se Telhai kishte pjesërisht të drejtë, kur kritikonte

disa figura për çart dhe të mjergullta, por heshti se këtë bisedë e kishin bërë edhe herë të tjera.

Ishin në koridor. Ballë tyre ndodhej Aliu. Besniku u shkëput nga poeti i ri, shkoi drejt Aliut dhe i dha dorën i ndrojtur. Në sjelljen e anëtarit të K. Q. ai mdjeu nderim dhe kjo e kënaqi.

Në këtë kohë, kur pushimi po mbaronte, Telhai po u thoshte një grupi shkrimtarësh:

-Diskutimi i Hamitit mua nuk më duket i thjeshtë dhe i rastit. Unë dyshoj, bile dyshoj shumë se kjo mund të ketë rrënjë të thella dhe është përgatitur me qëllim të caktuar. Mua nuk më pëlqen aspak shoqërimi i tij me Besnikun, i cili në esencë ka mbetur i pari dhe vijon të ketë miqësi të ngushtë me Hysenin. Ka rrezik të formohet një grup antiparti në fushën e letërsisë, bile ai gati është formuar.

1964

## KAPITULLI I FUNDIT

Besniku, pasi i dorëzoi dorëshkrimin e romanit "Shkrimtari" Samiut, zevendës drejtor në drejtorinë e Kulturës dhe të Propagandës pranë Komitetit Qëndror të P. P. Sh. , po kthehej në shtëpi i trishtuar duke thënë me vehte: "U kalua lumi Rubikon!" Kishte bërë një veprim që nuk ç'bëhej dhe që mund t'i sillte pasoja të hidhura. Ato ditë në shtyp po bëheshin kritika të rrepta ndaj disa veprave letrare që konsideroheshin me gabime ideologjike. Vetë Udhëheqësi i Partisë kishte kritikuar një poet të ri për formalizëm dhe thuhej se ishte rrevoltuar kur kishte lexuar një dramë. Në qarqet letrare kishte një atmosferë të nderë. Në këto rrethana kishte shumë të ngjarë që të goditej rëndë edhe romani i tij, prandaj dyshime të zymtua ia kishin rënduar shpirtin. Iu kujtua se katër vjet më parë Agimi ia kishte ndjellë të keqen: "Shkruaje, shkruaje romanin, ama bëhu gati për një internim të dytë!"

Nga larg ai dalloi Kozetën që po shkonte në shkollë me librat e muzikës në sjetull. Tani ajo kishte mbushur tetë vjet dhe posa kishte mbaruar klasën e dytë.

U turr drejt tij me fytyrë të ndritur e sy të qeshur dhe e përqafoi. Besniku në këtë çast pati ndaj saj një ndjenjë më të ngrohtë se zakonisht. Duke vështruar një qese të vogël që mbante në dorë, e pyeti me qortim:

-Nuk paske ngrënë mëmgjes?

Ajo uli kokën si fajtoreshë dhe u përgjegj:

-Jo... U vonova për studim në piano...

Ai e puthi i shqetësuar dhe e bija u largua me vrap.

Besniku hyri në shtëpi. E ëma që fshinte oborrin, ngriti kokën, drejtoi trupin dhe u ankua:

-Më ka gjetur halli me Kozetën. Sorollatet kot më kot, i bëhet vonë dhe nuk ha bukë... Mezi ia mbusha mëndjen të marrë një çikë me vehte... .

Ai u mallëngjye më tepër se zakonisht për atë përkujdesje të nënës ndaj Kozetës, si ndaj një mbese të gjakut të vet. Mendoi, si shpesh në të tilla raste, se nëna e tij me gjërësinë, thellësinë dhe mirësinë e zemrës së saj shuante pa lënë asnjë gjurmë fjalët e vrazhda që kishte thënë dikur për Luizën: "Ajo sjell edhe kopilin me vehte!"

Hyri në dhomën e gjumit me sy të përplotur. Sot atij gjithshka i bënte një përshtypje të veçantë dhe i ngjallte emocione të forta. Shpresa e vogël dy vjeçare po flinte dhe balli sikur i rrezatonte. Habitej gjithënjë me mençurinë e saj. Një ditë, kur po e shpinte në krah te doktori me temperaturë dyzet, ajo e kishte patur mëndjen të pyeste: "U lodhe, babi?!" Kjo iu kujtua atij dhe ndjeu dhëmbje në zemër.

Porta e shtëpisë u përplas. Luiza hyri me vrrull, hapi derën, e vështroi Besnikun me shqetësim dhe e pyeti:

-E dërgove?

. Po... -U përgjegj ai thjeshtë.

-Ka ndodhur gjë? .. Më dukesh i mërzhitur...

Besniku u rrëfyte:

-Kam një parandjenjë të keqe...

Luizës iu dhëmb i shoqi. E kishte parë dy vjet rrjesht, çdo ditë, orë të tëra mbi dorëshkrimin e romanit, pasi kthehej nga shkolla i raskapitur. Tani jo vetëm nuk do t'i shpëblehej munda, por edhe po rrezikohej. Po rrezikohej ai, po edhe ajo, edhe familja. U frikësua, por nuk u shfaq dhe desh t'ia lehtësojë vuajtjen.

-E po çdo gjë me kësmet, o burrrë! ... Ti për të mirë je përpjekur. Ika se më fillon mësimi. U shkëputa pak se isha në merak të madh...

Dhe u nis në shkollë si fortunë.

Besniku mbeti i vetëm në dhomë me Shpresën që flinte. Vuante. I dhëmbte shpirti se ndjente që kishte kontradikta me shoqërinë, me shokët bashkë me të cilët kishte luftuar, me Shqipërinë dhe socializmin, për të cilat kishte dhënë prova që nuk kursente as jetën. Pasi ishte kthyer nga internimi, gjatë gjithë atyre dhjetë vjetëve, ishte përpjekur të mirëkuptohej. Kishte mbaruar Universitetin me diplomë Shkëlqyer. Detyrën e arësimitarit e kryente mirë. Kishte marrë pjesë vazhdimisht në veprimtari të ndryshme shoqërore. Kishte ndenjur në fshat katër vjet që të përfitonte për të krijuar një letërsi realiste. Romani autobiografik për luftën ishte pëlqyer, por tani e rrezikonte vepra, ku konçentrohej gjithë pasioni dhe personaliteti i tij, ku kishte përshkruar shoqërinë shqiptare ashtu si e kishte parë dhe ndjerë, pa censurë të brendshme, pa u friksuar nga asgjë.

Ndeshjen me shoqërinë e kishte fare pranë. E parandjente se afroheje e stuhishme.

U ngrit më këmbë dhe po shetiste nëpër dhomë. E donte popullin, Shqipërinë, socializmin, e simpatizonte Partinë dhe Udhëheqjen, po atëherë pse e flaknin?! Pse ta dënonin për librin, ku shkruhej e vërteta?! Gjatë kohëve të fundit, tek ripunonte romanin, i ndodhte nganjëherë t'i vinin këto pyetje në kokë dhe bluante me vehte. Përpiqej të zbulonte shkakun e kësaj pozite të tij në shoqëri dhe në këtë dilemë kishte vendosur që, posa të mbaronte romanin, të lexonte me vemendje veprat e klasikëve të marksizmit për t'u thelluar mbi shoqërinë dhe personalitetin e vet. Tani kishte ardhur koha për këtë gjë, duhej ta bënte me ngulm, me pasion. U afrua te biblioteka dhe mori veprat e zgjedhura të Marksit dhe të Leninit. U ul në tryezë që aty të gjente një përgjigje për dramën që e mundonte. Kishte lexuar letërsi marksiste qysh në kohën e luftës në moshën trembëdhjetë vjeçare dhe vazhdimisht gjatë gjithë jetës. Po tani po lexonte ndryshe, me një qëllim të caktuar, me vuajtje dhe shpresë, që të zgjidhte enigmën që i bëhej si një nyjë gordiane.

Pas dhjetë ditësh në shtëpinë e Besnikut hyri kunati. Ishte i prerë në fytyrë. Kuptohej se diçka e keqe kishte ndodhur. U ul dhe pyeti ngadalë, me hidhërim:

-Ke shkruar gjë ndonjë roman ?

-Po- U përgjegj Besniku-!a kam dhënë shoqërisht për ta lexuar një shoku në aparatën e Komitetit Qëndror të Partisë.

Kunati i dha lajmin e hidhur që e priste:

-Sot u zhvillua plenumi i Komitetit të Partisë për Tiranën. Unë isha aty i ngarkuar me instalimin e mikrifonave. Sekretari i parë i komitetit të Partisë e quajti

romanin tënd "reaksonar". E dëgjova me këto dy veshët e mi. E tha me plot gojë: "reaksonar!".

Heshtje. Kunati kishte ngrirë si statujë me sy hapur.

Besniku ndjeu një shtërëngim të fortë zemre si kurrë ndonjëherë në jetën e vet. Iu kujtua internimi që i kishte ndjellë Agimi dhe iu duk se e kishte fare pranë. I hodhi sytë krevatit të Shpresës. Mos vallë së shpejti do të shkëputej prej saj?! Pas largimit të vëllait në dy dhomat e shtëpisë së tyre ishte futur një qeraxhi. Besniku me gjyq kishte fituar të drejtën t'i liroheshin dhomat për nevoja të domosdoshme. Mos vallë do ta intermonin dhe shtëpinë të gjithë do ta zinte qeraxhiu që gjithashtu ishte ngushtë me banesë?! Ishin bërë tre vjet që nuk flitnin fare me Kadriun dhe për këtë mëri ishte bërë shkak martesë e motrës së vogël. Po ai kishte qenë i bindur gjithënjë se vëllai i kishte prerë marrëdhëniet me të që t'i dilte të keqes para. Ndofta kunata e tij do të mburrej që e kishte parashikuar se si do të përfundonte ai. Nallanet e nënës kërcitnin në oborr. I dhëmbi shpirti se do ta hidhëronte atë plakë të drobitur. Luizës i kishte deklaruar dikur se parandjente që do të bëhej i famshëm sa ta trondiste Atdheun. Dhe ajo e kishte besuar. Dhe tani ç'e priste vallë?!

Ai e përcolli kunatin dhe mbeti i i piklluar. Iu afrua bibliotekës, mori librin e Marksit "Lufta civile në Francë", u ul në tryezë dhe nisi të lexonte këtë herë për t'u qetësuar dhe për të lehtësuar dhëmbjen. Dhe atij i ndodhi diçka që nuk e priste në atë çast. U mahnit nga parathënia e Engelsit, ku theksohej qartë e prerë se funksionarët e lartë në shtetin socialist duhej të shpërbleheshin me pagë punëtori, si në Komunën e Parisit dhe se ky parim ishte një kusht i domosdoshëm që shteti socialist të mos kthehej nga shërbëtor në zot të shoqërisë, ashtu si kishte ndodhur në të gjitha shoqëritë e më parëshme. E përpiu me një frymë gjithë librin dhe u trondit si rrallë në jetën e vet. Ai pati bindjen se dilema dhe enigma e tij ishte zgjidhur, se e kishte gjetur shkaku e konfliktit të tij me shoqërinë socialiste egzistuese dhe udhëheqësit e saj.

U ngrit dhe po shetiste gjithënjë i tromditur nëpër dhomë. Ballafaqonte realitetin e udhëheqjes komuniste shqiptare me teorinë marksiste mbi shtetin. Nuk kishte të dhëna, shifra të sakta se si konkretisht shpërbleheshin funksionarët e lartë, po atij iu kujtua blloku, ku ishte veçuar udhëheqja me dyqane të veçantë dhe klinika speciale. Solli në mendje shtëpitë e pushimit të destinuar vetëm për funksionarët e lartë të përhapura në gjithë Shqipërinë. Kishte dëgjuar se frutat e perimet për udhëheqësit rriteshin në parcela të veçanta dhe se kishte zona të tëra gjuetie vetëm për ta. Ishte fare e qartë se një nga pikat më thelbësore të teorisë së Marksit për

shtetin ishte shkëlmuar, megjithëse në çdo rrugë kryesore të çdo qyteti dhe gati në të gjitha sallat e mbledhjeve shkruhej me gërma të mëdha: "Lavdi Marksizëm Leninizmit!" Tu kujtua se brigadieri i Lalsit në një ditë vere duke soditur veturat që nxitonin për në plazhin e Durrësit si pikat e shiut, kishte qortuar: "Shkoni me vetura lluksoze në plazhinë Durrësit, bëni qejf sa të plasni, o vëllezër, se ka kush e prashit pambukun për ju." Tani po kuptonte se fshatari me këto fjalë kishte shprehur në mënyrë të pandërgjegjshme pakënaqsinë për padrejtësinë që i bëhej, se në fakt kishte dënonuar shfrytëzimin. Pra në Shqipëri, ashtu si edhe në të gjitha vendet socialiste, ishte krijuar një shtresë e privilegjuar së pari ekonomikisht dhe si rrjedhim shteti ishte kthyer nga shërbëtor në zot të të shoqërisë, siç kishte ndodhur në të gjitha shoqëritë e mëparëshme. "Këtu është dhe thelbi i konfliktit tim me shoqërinë" tha ai me vehte.

Iu kujtua përcaktimi i Marksit mbi varësinë e superstrukturës nga baza ekonomike dhe mendoi: "Baza ekonomike e privilegjuar e administratës dhe sidomos e udhëheqjes së lartë të Partisë dhe të shtetit, rrezaton në gjithë superstrukturën dhe kështu në çdo shfaqje të saj spikat padrejtësia dhe gënjeshtria. Këtu është burimi i të metave të letërsisë sonë dhe shkaku pse dënohet romani im që shkruan të vërtetën." Nuk mund të përfytyronte, as të pranonte se sistemi socialist ishte i destinuar të shkatërrohej, ashtu si e kishte përshkruar Hyseni në poemën e tij, por erdhi në përfudimin se në Shqipëri dhe në gjithë botën, socializmi kishte pësuar një shtrembërim që e kërcëonte ta zhdukte, se ishin shkelur ligjet e brëndshme të zhvillimit duke krijuar shfrytëzues dhe shtypës të rij më të këqij se ato borgjezë, se socializmi ishte kthyer kështu në një sistem shoqëror më poshtë se kapitalizmi dhe se romani i tij i bënte jehonë kësaj të vërtete.

Ai u trondit, pati frikë nga këto përfundime. Truri iu turbullua. Qëndroi ashtu i heshtur disa çaste. Pastaj energji të reja buruan në shpirtin e tij dhe iu duk se ishte imperativ historik kapërcimi i devijimit të socializmit dhe zhvillimi i një shoqërie socialiste vërtetë të lirë, pa shfrytëzim e shtypje, që e kërkonte artin realist si diçka jetike, të domosdoshme, gjë të cilën ai e kishte ndjerë qysh në internim.

Porta u hap dhe Luiza hyri në shtëpi, por nuk u fut në dhomën e fjetjes. Atij nuk i shkoi në mendje se ajo nuk e kishte takuar për shkak të lajmit të hidhur për romanin që i kishte dhënë dhe asaj kunati. Gruaja ishte e piklluar vetë dhe sikur do ta rëndonte më tepër të shoqin po t'i zinte me gojë atë që kishte ndodhur.

Me librin e Marksit në dorë, me një pamje të entuziazmuar ai shkoi në kuzhinë, ku e shoqja po gatonte. Ajo, që priste ta shihte të piklluar, e pyeti e çuditur:

-Ç'ka ndodhur!

Besniku filloi të lexonte nga libri i Marksit. Luiza u ul në minder dhe dëgjonte pak e habitur. E kuptoi që i shoqi ishte aq i tronditur pse në atë libër kishte diçka të përbashkët me shpirtin e tij, që kërkonte, si i dukej asaj, gjithënjë e kudo drejtësi. Ia nuhati gjëndjen shpirtërore, mendimet e tij, por nuk i dha të drejtë, sidomos tani pas disfatës që po pësonte në letërsi. Ajo nuk mund të pranonte kurrë që socializmi mund të ishte ndryshe nga ai që ishte ndërtuar dikur në Bashkimin Sovjetik dhe tani në Shqipëri dhe mendoi se i shoqi flurturonte në retë e ideve utopike, prandaj i foli:

-Kujton ti se udhëheqja nuk i ka lexuar Marks, Engelsin dhe Leninin?! Dhe nuk i di ato që po thua?! ... . Marksi dhe Lenini kanë shkruar ashtu, pse e tillë ishte koha... Ashtu u është dukur atyre dhe të tjerëve atëherë. Po pastaj jeta solli fakte të tjera dhe mendime të tjera... Stalini nuk i mori parasysh ato udhëzime e parime. Asnjë nga vendet socialiste... As Kina... . Po pse, more burrë, veç botës do të dalësh ti?! Ti do t'i japësh mend gjithë dynjasë?!

Dhe ajo doli se e thërritën.

Besniku u kthye në dhomë i lënduar, pse Luiza sipas tij nuk po e kuptonte edhe në këtë problem themelor dhe mendimet i vërshonin të furishme. Për atë tani shoqëria ishte përfshirë nga një lloj egoizmi dhe meskiniteti dhe e dhënë pas cikrimave materiale dhe morale shkelte interesin e përgjithshëm, mbi ligjet e shoqërisë socialiste. Dëshira për të fituar sejcili sa më tepër për vehte, e ngjashme me një farë morali ballist, po frynte në Shqipëri dhe po përpiquej të shuante pathosin revolucionar të luftës Nacional-Çlirimtare. Gjithënjë ai kishte menduar se njerëzit e kohës së luftës kishin patur një frymë tjetër, se nuk i përfillnin interesat personale para atyre të përgjithshmeve, se e donin njeri tjetrin me sinqeritet deri në sakrifikimin e vetes dhe pikërisht kjo frymë dhe këta njerëz i kishin vënë themelet Shqipërisë socialiste. Ai mendoi se shteti socialist shqiptar mund të qëndronte vetëm, nëqoftëse nuk shuhej pathosi revolucionar i luftës, përndryshe do të shkatërrohej. Atij iu kujtua shprehja e Majakovskit: "Rini, ozonin e Tetorit thith!" dhe mendoi se poeti i madh proletar e kishte nuhatur pakësimin e frymës së Tetorit dhe ishte asfiksuar nga mungesa e ndjeshme e tij.

Në mbremje doli dhe po shetiste nëpër rrugët e Tiranës i vetëm dhe gjithënjë mendohej. Ndjehej i çliruar shpirtërisht pse po i dukej se errësira që e rrethonte, ishte shpërndarë dhe i shihte qartë kontradiktat e shoqërisë së re. U kthye vonë në shtëpi. Hëngri bukë pa fjalë dhe u shtri të flinte. Gjumi nuk e zinte. Mendimet

gjithënjë e shqetësonin. Fjeti keq dhe u zgjua pas mesit të natës. Një ankth, një brengë e thellë e shypte, sikur në shpirtin e tij kishte diçka të keqe që ia kishte këputur gjumin në mes. Ç'ë mundonte atë vallë tani?! Frika se mos e shpinin në një internim të dytë?! Jo, nuk ishte kjo. Ai nuk trembej. Filloi të kërkonte në qëndrimin e tij ndaj shoqërisë diçka të gabuar dhe erdhi në përfundim se konfliktin me socializmin egzistues dhe me shtresën e privilegjuar të tij nuk duhej ta trajtonte si antogonist në rast se zhvillohej me ritme prodhimi dhe ruhej pavarësia e vendit. Nga iluzioni se socializmi egzistues kishte mundësi të kapërcente difektet e veta, atij i dhëmbej ta flakte në plehra atë dhe ato që e mbanin me forcë në këmbë. Gjithashtu nuk thellohej, duke mos patur edhe fakte të mjaftueshme, se ekonomia shqiptare rrëshqiste çdo ditë e më tepër drejt greminës.

Pak nga pak filloi të zbardhej. Errësira sprapsej nga dhoma, sendet po i shfaqeshin të qarta. Atij iu duk se iu sqarua edhe kuptimi i ngjarjeve që zhvilloheshin në kampin socialist. Erdhi në përfundimin se natyra e shtetit burokratik shpjegonte hegjemonizmin e Bashkimit sovjetik, konfliktet e tij me shtetet e tjera socialiste dhe me Shqipërinë.

Dielli kishte lëshuar rreze në dhomë. Besnikut i bëhej se po mirrte frymë lirisht. Ishte i sigurtë në të vërtetën e vet, ishte i vendosur që asaj t'i kushtonte jetën, që çdo mendim, fjalë, mendim t'i shërbente domosdo demokracisë socialiste dhe se nuk do ta trembte në këtë rrugë asnjë pasojë, sado e hidhur që të ishte.

Tani po i vinin lajmet nga të gjitha anët se romani i tij po kritikohesh ashpër. Mori vesh se vetë Samiu në shumë qytete të Shqipërisë në mbledhje të rretheve intelektuale informonte për shfaqjet e huaja në letërsi dhe në mënyrë të veçantë kritikonte romanin "Shkrimtari". I kishte ardhur në vesh se një anëtar i K. Q. Të Partisë kishte ulëritur: "Të shporret Besnik Dajti një herë dhe përgjithmonë!" Kurse sipas Osmanit po bisedohej që ta intermonin. Një valë e fuqishme përplasej kundër Besnikut. Që ta përballonte me sa më pak rrezik, vendosi të pregatiste shpejt e shpejt një vëllim me tregime, ndonjë prej të cilëve e kishte botuar. Aty do t'i përshtatej kërkesave të letërsisë së kohës, por njëkohësisht në mënyrë të tërthortë do të fuste idetë e socializmit demokratik. Ishte i ndërgjegjshëm se tregimet nuk do të kishin ndonjë vlerë të veçantë dhe se kishte shumë pak mundësi t'i botoheshin, por qëllin i tij ishte që ato t'i shërbenin për të zbutur ndërshkimin që i kërcnohej.

Filloi të shkruante me vrrull si asnjë herë tjetër.

Një ditë u takua me Hamitin, që mbahej tani poeti më i shquar në Shqipërinë socialiste dhe fama e tij përhapej gjithënjë e më tepër në botë. Ata nuk kishin



shoqërinë e parë, por prap takoheshin me përzemërsi. Këtë rradhë Hamiti e ndaloi vetë dhe i tregoi se në një plenum të K. Q. të Partisë, ku kishte marrë pjesë edhe ai, kryeministri e kishte kritikuar vrazhdë romanin "Shkrimtari" duke cituar edhe pjesë prej tij.

-Nga sa kam dëgjuar-Shtoi Hamiti-mua më duket se romani yt ka diçka të ngjashme me "Doktor Zhivagon".

Besniku nuk u përgjegj dhe i kërkoi poetit që mos t'ia jipte tani për tani romanin sipas fjalës që kishin lënë. Hamiti nuk kundërshtoi dhe ata u ndanë pa e zgjatur.

Ishte zhytur në valën e krijimit, kur i erdhi Lajmi se Hyseni që ishte i internuar në Peqin gati një vit më parë, kishte hyrë në grevë urie. I dhëmbej shoku që shprehte në këtë formë rrevoltën ndaj padrejtësisë që i bëhej. Nga ana tjetër iu duk se tani po zbulonte edhe shkaku nga buronte tragjizmi i Hysenit. Sipas tij depresioni dhe pesimizmi i shokut vinin si rrjedhim i atij devijimi të socializmit, gjë që e bënte ta krahasonte sistemin socialist me inkuizionin mesjetar. Ai vendosi ta ndërpriste punën krijuese dhe të shkonte ta takonte Hysenin.

Luiza u tremb, kur e mori vesh këtë gjë. Po lante enët dhe ktheu kokën nga i shoqi e indinjuar. Një zbehtësi e lehtë i kishte mbuluar fytyrën. Ajo kundërshtoi e revoltuar:

-Ç'të lypset të shkosh gjer në Peqin, te një i internuar që mban edhe grevë urie?! . . . Hyseni s'është në vehte, more burrë, e kanë lënë ment! . . . Për të gjithë ai është i çmendur... Ne tani kemi fëmijë dhe nuk mund t'i marrim më qafë kot më kot...

Besniku nuk mund t'i shpjegonte asaj motivet që shtynin në këtë vizitë dhe ishte i bindur se ajo as do ta kuptonte, prandaj doli nga shtëpia pa asnjë përgjigje. Bleu biletën e trenit dhe gjersa të vinte ora e nisjes, shkoi te Agimi që t'i fliste për zbulimin që kishte bërë.

Agimi e priti me fytyrë të vrarë. Ishte në dijeni se romani "Shkrimtari" po kritikoheshin ashpër dhe kjo e kishte dëshpëruar shumë. Para një viti edhe ai kishte shpresuar se vepra mund të botohej dhe kishte klithur: "Hej, çdo të jetë! Do të vërviten djajtë nga fundi i ferrit!" Por tani nuk i kishte mbetur pikë iluzioni dhe e kishte pushtuar hidhërimi se mund të kishte edhe vetë pasoja të këqija, me që dihej se e kishte përkrahur romanin. Për këtë ishte bindur atë mëngjez, kur shkoi në redaksinë e revistës "Nëntori" që të pyeste pse nuk ishte botuar artikulli i tij kritik sipas

premtimit që i kishin dhënë. Redaktori ishte përtypur dhe e kishte përcjellë pa asnjë shpresë. Ai po ndjente se ishte mbyllur si në një rreth të hekurt që nuk dihej në do të çahet ndonjëherë.

Kur hyri Besniku, pati përshtypjen se nuk e kishte marrë vesh se ç'po ndodhte dhe e quajti pozitën e tij për të ardhur keq. U ul në divan me një farë nervoziteti duke përplasur një libër si kot më kot. Besniku e vuri re gjendjen e tij, por nuk e mori me mend shkakun dhe pa i dhënë rëndësi këtij nervozizmi, tha:

-Kam ardhur të lexoj diçka...

Agimi ia priti i piklluar:

-De profundis?!

-Jo-U përgjegj ai dhe filloi të hapte librin "Sheti dhe revolucioni", ku ishin sintetizuar pikpamjet e Marksit dhe të Engëlsit.

Agimit iu duk skandaloze dëshira e Besnikut për të cituar në këto çaste pjesë nga vepra e Leninit, të cilëm sipas tij, dhe kështu ishte e vërteta, e kishte lexuar dhe stërlexuar shumë më thellë nga shoku dhe bërthiti:

-Lëre, mor, atë. . Shumë, shumë i mençur është Lenini. Gjenialitetin e tij e admiron gjithë bota. Por ty po të digjet mjekra dhe ti thua, prit sa të ndez cigaren! Të paktën kuptoje se po e ndez në flakët e mjekrës sate. A e di se çfarë thuhet për romanin tënd?!

-E di... -U përgjegj qetë e thjeshtë Besniku.

-E di?! -Agimi gati u tërbua-Dhe më vjen të më tregosh librin e Leninit?! ... Je vërtetë i lojtur! Tani s'është për të patur pikë dyshimi... Unë po plas nga dëshpërimi. Lajmet më vërtiten si plumba kresë! A e ke dëgjuar se romanin tënd e kanë quajtur reaksionar... Raksionar. . A e ke idenë e kësaj fjale?! U radhite me fashistat e ballistat dhe më vjen qetë qetë për të më lexuar mua Marks-in, Engëls-in dhe Leninin!

Besniku heshte gjakftohtë. As trishtohej, as vuante. Nuk e mundonin dyshimet. Ishte i mbushur me besim në vetvehte se e vërteta dhe e drejta ishin me të dhe kjo sikur ia kishte rritur fuqinë shpirtërore, sikur i kishte siguruar qetësinë, prandaj foli:

-Ke më?! ... A do të më lejosh të lexoj?

Agimi e nuhati gjëndjen e tij dhe iu duk tepër e pakuptueshme, e habitshme, si gjysmë çmendurie. Shrembëroi buzët me përçmim dhe pranoi:

-Hajt të shohim...

Besniku filloi të lexonte nga parathënia e Engëlsit për "Lufta civile në Francë"

dhe Agimit iu zhduk ngërdheshja tallëse. Ai u bë më serioz, hapi veshët mirë, vështrimi i tij u përqëndrua. Pastaj Besniku citoi paragrafe të ndryshme të Marksit dhe të Leninit mbi shtetin e diktaturës së proletariatit dhe demokracinë socialiste. Agimi mendohej. Po bluante kuptimin e mësimëve të Marksit mbi shtetin. I kishte studjuar klasikët e marksizëm-leninizmit me vemendje të madhe. Kishte nënvizuar paragrafe të tëra me viza të kuqe dhe të zeza, kishte bërë shenja të veçanta sipas vlerës dhe thellësisë së mendimit. Edhe këto citate sigurisht i kishte nënvizuar, por nuk u kishte dhënë atyre rëndësinë e duhur. Vitet e fundit ai përpiquej me ngulm të sqaronte kuptimin e ngjarjeve tronditëse në kampin socialist, të kontradiktave që ishin shfaqur duke studjuar dhe analizuar lloj lloj materialesh nga burime të ndryshme. E nuhati se mendimet e Marksit kishin lidhje me atë problem të madh që e mundonte gjithë këto kohë, por prapë nuk po i treste menjëherë. E pati të qartë se

ato ishin me vlerë të madhe, po si mund të zbatoheshin, pse nuk ishin zbatuar dhe cili ishte ndikimi negativ i shmangies prej tyre, nuk po e shpjegonte dot, prandaj tha vetëm:

-Interesant... Tepër interesant... Kjo mund të qartësojë shumë gjëra... Ndofta këtu është dhe thembra e Akilit! . .

Dhe ai ndjeu një farë shtypje. E vlerësonte Besnikun, por vehten e konsideronte shumë më të zgjuar dhe më të kulturuar. Dhe ja tani ky njeri vinte dhe i jipte mësimë për çeshtje themelore. Iu kujtua se mësimë të tilla i kishte dhënë dikur me kritikata ndaj letërsisë sovjetike të kohës dhe mendimit të saj estetik, të cilat atëherë vetë i shihte me një farë admirimi. Nuk mund të mohonte se shpesh Besniku e habiste me nuhatjen e tij dhe këtë duhej ta pranonte dhe ta vlerësonte. Ai mendoi se duronte thasë të tëra marrëzish dhe budallallëqesh të shokut pikërisht për këto thërrime inteligjence që nuk i kishte hasur te asnjë intelektual tjetër në Shqipëri.

Besniku doli se mos i ikte treni.

Agimi mori kopjen e vet të librit "Shteti e revolucioni" dhe zuri ta shfletonte. Thelbi i mendimeve të Marksit, të Engëlsit dhe të Leninit, të cilat ia kishte lexuar Besniku, ishin nënvizuar në mënyrë të veçantë, por nuk kishte kuptuar se aty fshiheshin mendime me rëndësi të jashtëzakonshme. Gjithë atë ditë ai ndenji mbi librin e Leninit.

Besniku arriti në Peqin. Gjeti me të pyetur hotelin dhe u ngjiti lart në katin e dytë, ku i kishin thënë se rrinte Hyseni. Te shkalla ndodhej një polic. Dera e dhomës ishte hapur. Sabria, që e priti në koridor, i foli me shpresë:

-Ah, sikur t'ia mbushje mendjen të heqë dorë nga greva e urisë! Do të bëje një mrekulli! Kurrë nuk do ta harroja këtë nder!

Ai hyri në dhomë.

Hyseni ishte shtrirë në shtrat i mekur, i zbetë, me një qetësi këputëse. Kishte dy javë që nuk kishte shtënë asgjë në gojë dhe e mbante shpirtin gjallë vetëm me ujë duke denoncuar kështu hapur se vuante padrejtësisht interminim. Ishte i bindur se e kishte kryer me përpikmëri detyrën e përkthyesit dhe nuk kishte ndonjë faj ndaj shtetit. Shkrimet e tij vërtetë kishin një frymë rrevolte, por nuk gjëndej në to asgjë që mund të interpretohej si agjitacion dhe propagandë kumder pushtetit. Kjo grevë urie shfaqej me një forcë të madhe se ai kishte vetëdijën e plotë të vlerës së veprës së tij dhe bile e konsideronte atë gjeniale.

Hyseni e përshëndeti shokun lehtë, pa gjallëri. E priti me mirëdashje ardhjen e tij, pamvarësisht se e mirrte me mend se nuk e miratonte grevën e urisë. Mendimet dhe rrugën e Besnikut i quante të gabuara, por besonte në sinqeritetin dhe ndershmërinë e tij dhe kjo e bënte ta ndjente të afërt, të dashur dhe të respektuar.

Besnikut iu dhëmb shumë shoku i shtrirë, i raskapitur nga të pangrënët që mezi nxirrte një fije zë të fikur dhe nuk dinte ç't'i thoshte. T'i spjegonte se cili sipas tij ishte problemi themelor i socializmit dhe ta bindëte atë se aty ishte burimi i diziluzionit dhe i vuajtjeve të tij, iu duke e kotë, e pavlefshme, e padobishme dhe e pa pranueshme për të, sikur do të tallej me tragjedinë e tij. Mendimet e veta fundi i fundit ishin supozime për të ardhmen, kurse shoku buzë vdekjes ishte një realitet tragjik para syve. Megjithatë nuk mund të mrinte pa i folur diçka jo lëndonjëse për plagën e tij:

-Ti gjykon vetë Hysen, por unë mendoj se kjo nuk është rruga e zgjidhjes së problemit tënd dhe të kombit. Papjekuria e përgjithshme e shoqërisë është shkaku i gjithë atyre të metave dhe gabimeve që ne vuajmë. Duhet të përpiqemi me durim, me shpirtmadhësi, pa u dëshpëruar, pa e humbur fillin për kapërcimin e kontradiktave midis nesh mes pengesash, përparimesh dhe dështimesh. .

-Gjithkush ka rrugën e vet të luftës për të drejtën dhe të vërtetën... Kjo është imja. E jotja është ajo që ndjek ti. Për një tjetër një e tretë dhe kështu gjithkush ka armën, mjetin e tij. Ashtu si thua ti shoqëria jonë është e papjekur dhe në një masë apo një tjetër ne të gjithë jemi fajtorë. Dhe në këto momente letërsia ka një vlerë të jashtzakonshme. Kjo është bindja ime. Jo pse këtë e shtron Komiteti Qëndror, por kjo është kërkesa imediate e kohës. Letërsia sot është problem jetik për shoqërinë shqiptare, pse vetëm ajo mund ta shkundë dhe ta ngrejë ndërgegjen

e kombat. Kurse tek ne i vemë këmbën në fyt atij që po krijon një çikë art të vërtetë. Kjo është vrasje! ... Krim! . . Ky është zëri i singërtë i një njeriu që përpëlitet buzë vdekjes.

Dhe ai heshti. Heshti dhe Besniku dhe nuk dinte ç't'i thoshte më. Nuk gjente asnjë fjalë që ta lehtësonte gjendjen e tij, asnjë këshillë tjetër që ta nxirrte nga qorrrokaku. Ai ishte i mendimit se Hyseni qëndronte më lart nga dhëmbja dhe dëshirat e tij. Doli me sy të përllotur. Sabrija e priste me ankth.

-Hë, ç'tha?! ... A ju mbush mendja

-Jo. . -Pëshpëriti Besniku i piklluar.

Ai u turpërua se nuk i justifikoi shpresat e të shoqes së Hysenit dhe zbriti shkallët me kokë të varur. U nis në Tiranë me dëshpërim në zemër duke menduar se fenomeni i tragjizmit të Hysenit ishte i lashtë, se ishte në thelb të "Iliadës", se protesta e tij ngjasonte me zemërimin e Akilit që i fyer në sedrën e vet prej shfaqjeve të arbitraritetit të Agamenonit, u largua nga lufta dhe u bë përkohësisht keqëdashës ndaj bashkëatdhetarëve të vet. Besniku pandehte se vetëm socializmi demokratik, ashtu si e përfytyronte, ai mund të vinte ekuilibër të vërtetë mes shoqërisë dhe individit që ishte për të bazë e vetme e shpëtimit dhe e përparimit të sotëm të shoqërisë njerëzore.

Në shtëpi gjeti Shahinin. U përqaftuan me mall dhe u shtruan në bisedë. Besniku e solli fjalën atje ku i rrinte gjithënjë mendja. Shahini e dëgjoi me vemendje dhe pastaj ia priti me buzë në gaz:

-Bukur paskan shkruar Marksi dhe Lenini dhe shumë bukur po flet ti! ... Po ku t'i gjejmë ata njerëz që të mbajmnë atë drejtësi që thua ti?! . . Ne po e shohim se sot gjithsejçili përpiqet si e si të zhvasë më shumë... Njeriu është shat. Po nga vehtja tërheq.

Besniku e kundërshtoi:

-Nuk është i tillë njeriu. Këtë e ka provuar jeta. Fshatari gjatë Luftës e ndante çapën e bukës me partizanët. Vinte në rrezik gjithë pasurinë dhe familjen për idealin e përbashkët. Djem të rij linin rehatinë e shtëpinë dhe rrezikonin jetën malit me pushkë në dorë, të zbathur e të zhveshur! Fëmijë, pleq, gra, burra, të rij e të reja ishin të gjithë të bashkuar top dhe nuk kursenin as jetën për njeri tjetrin .

-E hu... . Ajo ishte kohë tjetër! ... -Pëshpëriti me dëshpërim djali i nunit dhe shtoi-U prish zemra e njeriut...

Po Besniku nguli këmbë:

-Për mua ai është tamam njeriu, njeriu i vërtetë, thelbi i njeriut. Kjo që shfaqet

tani është e përcipta, e përkohëshmjia, dobësia e tij.

-Kurse unë them se ajo koha e luftës ishte: zuri qeni një lepër... Njeriu është veç për vehte. E po të mund të bëhej ashtu si thua ti, kush nuk e do atë kohë?! Atëherë do të ishte tamam sikur të kishte zbritur perëndia në tokë! ...

Shahini doli. Besniku u kthye në dhomë që të vijonte punën krijuese. Shkruante, shkruante me vrrull dhe ndjente gjithënjë e më tepërt dhëmbjen e kokës që i kishte filluar atë javë. Erdhi një çast dhe e hodhi lapsin. U vesh dhe doli të shetiste. I ishte bllokuar truri. Kishte lodhje të sistemit nervor. Puna trevjeçare mbi romanin, mësimi katër orë në ditë, leximi i tensionuar me vemendje të madhe i klasikëve të marksizëm-leninizmit, tronditjet nga kritikak ndaj romanit, ndjenjat e fuqishme që e kishin pushtuar pas zbulimit, si quante ai: e vërteta e shoqërisë socialiste, dhe tani krijimi letrar i sforcuar e kishin bërë efektin e vet raskapitës.

Shetiti në kodrat e Tiranës orë të tëra dhe u kthye në shtëpi i lehtësuar ca. Të nesërmen vijoi të shkruante. Dhëmbja e kokës iu shfaq prapë. E la punën dhe doli nga kodrat e qytetit. Nisi të bënte shetitje. Në darkë nuk e zinte gjumi. Ai po ballafaqohej me një realitet të vrazhdë. I jati kishte vuajtur nga sistemi nervor gati njëzet vjet, gjer në vdekje. Herë herë kishte patur çaste çmendurie të plota dhe Besnikut nuk i kishte shkuar kurrë mendja se në botë kishte sëmundje psiqike që mund të pësonte fatin e bababit. Tani po e ndjente këtë rrezik, por prapë shpirti i tij nuk mposhtej, nuk e mbyste dëshpërimi e pesimizmi, nuk e linte vullneti dhe vijonte të krijonte.

Atë mëngjez vendosi të shkonte te mjeku për ndonjë qetësues, kur ra zilja e telefonit dhe Samiu e thirri që t'i jipte romanin.

Besniku u vesh shpejt e shpejt dhe u nis në aparatin e K. Q. të Partisë. Veprën po ja kthenin pas dy muajsh. E kishte plotësisht të qartë se Samiu do ta kritikonte me vrazhdësi romanin duke mbajtur kështu një qëndrim të kundërt nga ai që kishte mbajtur para një viti, kur e kishte lexuar për herë të parë. Me një copë letër të vogël kishte shënuar përgjigjet që do t'i jipte duke peshuar mirë çdo fjalë. E kishte gjykuar se nuk duhej të acarohesh. As t'i pranonte kritikak, as t'i hidhte poshtë.

Kur po i afrohej ndërtesës së K. Q. të Partisë, pa Aliun që hipi në veturë dhe po vinte drejt tij. I rrahu zemra me dashuri. Kishte mall ta shihte nga afër dhe ta përshëndeste, prandaj kaloi në anën tjetër që ta kishte më pranë veturën. Po në çastin që vetura ndodhej fare afër, Aliu që e vuri re Besnikun, ktheu kokën menjëherë me nervozitet në anën e kundër. U kuptua se ishte zemruar aq shumë me të për

shkak të romanit të tij sa nuk dëshëronte as ta shihte me sy dhe jo të pranonte të përshëndetej nga ai. Një çast Besniku qëndroi si i ngrirë në vend, plot dëshpërim. Ishte armiqsuar me Aliun që e kishte dashur dikur, qysh prej kohës së luftës dhe vazhdimisht, te i cili kishte shpresuar se do ta përkrahte romanin. Kjo i vertetonte se përplasja dhe ndarja me socializmin egzistues dhe udhëheqësit e saj ishte totale. Pastaj eci përpara, mori lejen e hyrjes te postblloku, kaloi në sallonin e gjatë duke u përpjekur të qetësohej dhe hapi derën e dhomës me numrin e caktuar.

Samiu e priti më këmbë, me mirësjellje, po jo i buzëqeshur. E ftoi të ulej dhe filloi me një ton të thatë:

-Më fal se romanin ta mbajta një kohë të gjatë dhe se kam folur për të përpara se të bisedoja me ty.

Heshti një hop, sikur kishte nevojë t'i përmblihte mendimet dhe vijoi:

-Ne e dimë se ti ke pikëpamjet e tua dhe duke njohur kembënguljen tënde, e marrim me mënd se nuk heq dorë lehtë prej tyre. Këtë e dëshmon edhe vetë fakti se ke përsëritur në një variant tjetër po ato teza që i ke shprehur vite më parë, për të cilat je dënuar. Kjo është e drejta jote. Po edhe neve ama nuk mund të na e ndalojë askush që të godasin me vendosmëri pikëpamjet e tua të gabuara.

Zëri i Samiut sikur nuk dilte nga goja e tij, po sikur ishte kumbimi i gjithë asaj ndërtese të madhe e solide, prandaj ky zë sikur kishte një timbër të veçantë, të rreptë dhe solemn. Dhjetë vjet më parë një sugjerim nga këto zyra e kishte mbyllur brutalisht djaloshin ëndërronjës brënda një internimi të rrethuar me tela me gjemba. Dhe pastaj një sugjerim i dytë pas ca muaj e kishte kthyer si në ndonjë përrallë në gjirin e familjes me shpejtësi e lehtësi. Pra kuptohej lehtë se këto vërejtje vendosnin mbi fatin e tij dhe të familjes.

Besniku dëgjonte i përmbajtur.

Zevendës drejtori i i drejtorisë së kulturës dhe të propagandës pranë K. Q. të Partisë filloi të fliste ngadalë, qetë, por pak nga pak zëri i tij u ngrit, u forcua, u bë plot pasion.

-Ti ke pasqyruar- thoshte ai- jo Lidhjen e Shkrimtarëve, por blozën e oxhakut të saj. Po, po, blozën e oxhakut dhe vetëm atë dhe kështu ke dhënë të shtrembëruar figurat e shkrimtarëve tanë militantë që i kanë kushtuar jetën idealit të popullit dhe të Partisë. Po këtë gjë ke bërë edhe me të gjitha aspektet e jetës socialiste. Ke qëmtuar me një ndjenjë keqdashëse gjarpëri kudo, ku ke gjetur negativën: në zyrat e sigurimit, në internim dhe ke ngritur në piedistal elementë të kalbur politikisht, ideologjikisht dhe moralisht. Kjo vepër është për t'u botuar në vendet kapitaliste

dhe revizioniste. Po, atje ndofta do t'i jipnin edhe çmim, por ne e flakim me neveritje.

Besniku dëgjonte i nemitur, herë herë shënonte ndonjë gjë. Nuk ishin të papritura këto mendime, vetëm forma ishte e re për të. Sikur e therën në zemër shprehjet: "Ke parë vetëm blozën e oxhakut", "Ke qëmtuar kudo me një ndjenjë keqdashëse gjarpëri" dhe zemra i dhëmbi, sikur diçka e shtypte, e shtrëngonte, e ngushtonte. Iu përfytyrua Aliu që kthente kokën me nervozizëm dhe një çast iu duk se Samiu po thoshte të vërtetën, se shoqëria socialiste egzistuese ishte e vërteta e kohës. Iu errësua gjithshka dhe po e mbulonte trishtimi. Po menjëherë iu sulën në kokë përfundimet që kishte arritur për socializmin dhe i shkundi dyshimet e zeza. U lehtësua, zemra nuk po i dhëmbte më, trishtimi po i tretej dhe tha me vehte: "Kam vënë gishtin mbi plagët që ato të shërohen."

Jo, nuk mund t'i fliste Samiut sinqerisht për të vërtetën që sipas tij kishte zbuluar. Jo vetëm kaq, por në këto çaste ndofta ishte e çudiçme se si edhe vetë i pranonte dhe i mbronte mësimet e Marksit mbi shtetin, kur në shpirt i jehonte i fuqishëm zëri i Luizës: "Po pse, more burrë, ti do t'i japësh mënd gjithë dynjasë!" Besniku mendoi se nuk e quante vehten më të zgjuarin e gjithë botës, por ama edhe nuk mund të hiqte dorë nga ajo që e besonte si të vërtetë, se kjo do të thoshte për të vdekje morale.

Samiu mbaroi dhe po priste me ankth. Vështrimi i tij i tensionuar ishte mbërthyer mbi Besnikun. Ndruhej se mos përleshej në një debat të ashpër, se mos do të ishte i detyruar të vërsulej me ashpërsi edhe më të madhe dhe pastaj përfundimi mund të mos dihej. E njihte autorin si koklëfortë dhe nga lart ia kishin cilësuar "rebel". Besniku e nuhati këtë gjë, prandaj u përpoq të fliste sa më butë.

-Kam jetuar me këtë vepër tre vjet dhe kjo është futur thellë në ndjenjat e mia. Ta hedh poshtë në këtë çast kjo do të ishte e habitshme dhe e pakuptueshme edhe për ju. Do të mendohem thellë për vërejtjet që më bëtë. Tani mund të them vetëm diçka: metoda artistike që kam përdorur është empirike dhe suksesi i saj nuk është gjithënjë i sigurtë. Po unë në fund të fundit kam stërvitur dorën duke pikturuar personazhet dhe jetën në mënyrë fotografike që të kem mundësi të kaloj në krijimin artistik të realitetit... Dhe sa për ju unë kam një kritikë.

Samiu ngriu. Iu drodh zemra. Pati frikë se mos autori e akuzonte se dikur e kishte përkrahur romanin.

-Vitin e kaluar i bëtë shumë vërejtje romanit... .

Samiu sikur u shkri, u çlirua, fytyra e tij u çel dhe ai nxori me gisht nga një stivë librash e shkresash një copë letër me shënime që kishte bërë dikur për romanin.



Besnikut iu bë se në atë stivë kishte edhe mjaft material, ndofta ndonjë dosje, që mbahej për të.

-... por ju duhej ta kishit hedhur poshtë pa hezitim.

Nëpunësi e pranoi me qejf këtë qortim, pse i ishte bërë edhe nga udhëheqja. Tensioni i tij nervor ishte shkarkuar dhe foli me ton miqësor, familjar, dashamirës.

-Ke të drejtë! ... Duhej ta kisha thënë qysh atëherë: "Flake në koshin e plehrave!"

Nyja që i kishte lidhur ata për një vjet të tërë, u zgjidh plotësisht. Besniku ishte i kënaqur nga ky përfundim se nuk dëshëronte në asnjë mënyrë t'i shkaktonte në asnjë formë, asnjë fije shqetësimi atij njeriu që e kishte mirëpritur dhe kishte dashur ta ndihmonte.

U ngrit. Ata i shtrënguan dorën njeri tjetrit me shumë përzemërsi. Një farë miqsie dhe simpatie që kishin patur nuk ishte prishur krejtësisht. Besniku doli nga aparati i K. Q. të Partisë dhe po ecte.

Ecte në një rrugë të veten, e cila i dukej e vetmja rrugë e vërtetë dhe dinjitoze për personin e tij, që do ta ruante mos t'i shkatërrohej personaliteti, që i jipte forcë të përballonte çdo pasojë pa u dëshpëruar. Kishte besim se ndonëse ndjehej i vetmuar, ndodhej pa dyshim me synimin e tij në thelbin e zemrës njerëzore.

Të nesërmen ai shkoi te psiqiatri. I tregoi se vuante nga dhëmbja e kokës, nga pagjumësia dhe i kërkoi që përkohësisht të shkëputej nga profesioni i arësimit dhe të kalonte në punë të thjeshtë fizike. Mjeku e quajti të vështirë këtë gjë dhe i dha vetëm një recetë me ilaçe qetësuese. Pas disa muajsh shkrintari pësoi një tronditje aq të madhe psiqike sa e shtruan në psiqiatri duke e futur me detyrim në një autoambulancë. Mjekët, pasi i bënë elektrohok, e diasnostikuan me sidromën maniakale depressive.

1989



Në vitin 1964 romani "Shkrimtari" i dha shoqërisht për lexim nëpu-nësve të aparatit të K.Q të ish P.P.SH dhe u lexua nga udhëheqja e lartë. Ajo e karakterizoi atë: "Reaksionar". Si dënim, autorit iu hoq e drejta e botimit për një çerek shekulli. Kjo vepër mund të themi se është e para në gjithë Lindjen që përshkroi disidencën letrare duke denoncuar hapur hetuesinë, birucat, burgjet dhe kampet e internimit.

"Ky roman që flet për raportin e intelektualit (shkrimtarit) me diktaturën, afro tridhjetë vjet më parë, nuk është një tablo e pikturuar me penel, në telajo, në studjo, që krijohet për t'u ekspozuar në sallone, por një dëshmi autentike dhe e ndershme njëlloj si muralet e të burgosurve, të cilat fati i krijimit dhe i krijuesve, "defektet" artistike ua kthen në vlera estetike me magjinë e papërsëritshme të vërtetësisë së tyre tragjike."

*Kiço Blushi*